Musine Kokalari

vetëdija e shkrimit
dhe e qëndresës

Konferenca Shkencore

Musine Kokalari

vetëdija e shkrimit
dhe e qëndresës

BIBLIOTEKA KOMBËTARE E KOSOVËS "PJETËR BOGDANI"
THE NATIONAL LIBRARY OF KOSOVA "PJETËR BOGDANI"

Tiranë, 2018

BIBLIOTEKA KOMBËTARE

BOTIM NË KUADËR TË 100-VJETORIT TË LINDJES SË MUSINE KOKALARIT

Titulli:
Konferenca shkencore "Musine Kokalari: vetëdija e shkrimit dhe e qëndresës"

Botues:
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës

Përgatiti:
Prof. Dr. Persida Asllani

Redaktore:
Loreta Loli

Dizajn:
Rudina Dahri

© Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

ISBN: 978-9928-4494-0-5
ISBN: 978-9951-13-076-9

Parathënie

Bashkëpunimi i vijueshëm mes dy Bibliotekave tona Kombëtare është pasuruar vitet e fundit me organizime të përbashkëta veprimtarish kulturore, që synojnë thellimin e mëtejshëm të shkëmbimit të informacionit dhe njohjes me aspekte specifike të kulturës sonë, e kryesisht me autorë të rëndësishëm, veprat e të cilëve, teksa ushqejnë rrjedhën tonë të përbashkët kulturore, paraqesin një pasuri më vete në fondet e njërës bibliotekë ose tjetrës. Ky shkëmbim i vazhdueshëm, na lejon të pasurojmë dijen tonë mbi to dhe vlen njëkohësisht si një ftesë miqësore ndaj studiuesve dhe universitarëve të të dyja vendeve, për të bashkuar energjitë në një studim të ri bashkëkohor e të përbashkët të tyre.

Rezultat i këtij bashkëpunimi të suksesshëm është edhe ky vëllim i përbashkët që prezanton sot punën e dy institucioneve tona si dhe të studiuesve të shumtë përgjatë vitit 2017, teksa i kushtuam një vëmendje të veçantë figurës emblematike të shkrimtares së parë shqiptare dhe intelektuales së shquar Musine Kokalari.

Veprimtaritë tona publike kushtuar Kokalarit e patën fillesën më 10 shkurt të 2017-s në Tiranë, në mjediset e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, pikërisht në kremtimet e 100-vjetorit të saj të lindjes përmes konferencës shkencore e ekspozitës "Musine Kokalari, vetëdija e shkrimit dhe e qëndresës", për të vijuar edhe gjatë Javës së Bibliotekave në Kosovë, në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani", e për t'u përmbyllur tashmë me këtë botim të akteve të konferencave tona së bashku me aneks-albumin që paraqet elementet vizuale që dokumentuan e shoqëruan ekspozitat tona librore.

Kremtimet e 100-vjetorit të lindjes së shkrimtares së parë shqiptare dhe intelektuales së shquar Musine Kokalari, përkuan gjithashtu me shpalljen e këtij viti si "Viti i Kujtesës" në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, me qëllim nxitjen dhe promovimin e çdo akti kujtese, veçanërisht atij ndaj viktimave të diktaturës komuniste. Ne besojmë se rivendosja në vend e kontributit por edhe dinjitetit të tyre njerëzor, është një domosdoshmëri për shoqërinë shqiptare, për emancipimin tonë të mëtejshëm, për vendosjen e piketave tona sa kulturore aq edhe politike

në ringritjen shpirtërore të një shoqërie demokratike të bazuar mbi vlerat më të mira dhe në respektin e dinjitetit njerëzor.

Duke ndërmarrë këtë homazh ndaj "Vetëdijes së shkrimit dhe të qëndresës" që përshkon jetën dhe veprën e Musine Kokalarit deri në frymën e saj të fundit, ne rikthyem në vëmendje të publikut pasurinë letrare, erudicionin e thellë dhe qëndresën e lartë morale në rrethanat më të skajshme të jetës nën dhunën e persekutimit komunist.

Ne e kërkojmë lirinë jashtë vetes, ndërsa ajo gjendet brenda nesh - pohonte në shënimet e veta studentore gjatë viteve '40 zonjushë Musine Kokalari! Është pikërisht kjo liri brendashkruar qenies së saj që i dha shtysën e energjinë të hynte në letrat shqipe me zë e penë unike, që përcillte ligjërimet e munguara femërore në gjirin e letrave shqipe. Po kjo liri i dha forcën dhe dinjitetin e pashembullt për t'u shfaqur me aureolën e një ikone martirësh në gjyqin komunist kundër saj. Persekutorët nuk ia falën dot kurrë (as në ditët e tyre të vdekjes) vetëdijen e saj të lirisë: të quheshe Musine Kokalari, të botoje artikuj e libra, të studioje e të diplomoheshe për letërsi në Universitetin e Romës, të themeloje Partinë e parë Socialdemokrate Shqiptare, të botoje "Zërin e Lirisë" dhe të kryesoje grupimin e parë antikomunist të opozitës shqiptare. Të ishe e bukur, e talentuar, inteligjente, e kultivuar dhe me kurajë intelektuale në vitet e Regjimit Komunist përbënte diçka të pafalshme!

Shkrimtarë e intelektualë të njohur e admiruan dhe e çmuan si një thesar njerëzor: Sotir Kolea, Aleksandër Xhuvani, Lasgush Poradeci, Zijaudin Kodra, Ernest Koliqi, Karlo Tagliavini etj. Mitrush Kuteli shpallte më 1944 se "... Musine Kokalari afirmohet në rangun më të mirë të letërsisë shqipe, jo si relativitet femëror, si mund ta shohë dikush, por si vlerë absolute". Në vitin e vdekjes së saj, më 1983, vetëm Ibrahim Rugova pati vetëdijen letrare e politike të shkruante për të dhe të botonte diçka nga vepra.

Sot, vetëm leximi i shkrimeve të Musinesë mund t'u kthejë kuptimin e bukur këtyre titujve: T'isha një lule, Siç më thotë nënua plakë, Nënua plakë në Romë, Rreth Vatrës, ... sa u tund jeta, Jeta ime universitare etj.

Me këtë mision iu rikthyem veprës së Kokalarit gjatë seancave të ndryshme të konferencës sonë të përbashkët me titull "Musine Kokalari, vetëdija e shkrimit dhe e qëndresës". Studiues të letërsisë e filologjisë shqipe, filozofë e antropologë, historianë, arkivistë e bibliografë, sprovuan leximet e tyre si te vepra ashtu dhe te faktet mbresëlënëse të jetës së saj. Aktet e kësaj konference ndërkombëtare, me pjesëmarrje të gjerë studiuesish nga Universitetet Italiane, Universiteti i Tiranës, i Prishtinës, i Gjirokastrës etj, rreken të ndriçojnë dy tiparet thelbësore të figurës së

Musine Kokalarit: atë të vetëdijes së shkrimit, si akt themelues i veprës së saj letrare; dhe atë të vetëdijes së qëndresës përballë dhunës e persekutimit absurd komunist si akt themelues i rezistencës intelektuale e qytetare.

Kontributet e studiuesve në këtë botim janë grupuar sipas afërsisë disiplinore ose tematike me qëllim që të mund të vihen në pah edhe perspektivat e larmishme që nxisin ndër studiues vepra e jeta e Kokalarit. Të vetëdijshëm se ky botim është i pari në llojin e tij, menduam ta pasurojmë edhe me botimin e një grupi shkrimesh të tjera që nuk ishin pjesë e drejtpërdrejtë e konferencës sonë. Ato variojnë nga shkrimi i famshëm kritik i Lasgush Poradecit për veprën Siç më thotë nënua plakë, te eseja mbi fotografinë e fundit të Kokalarit shkruar posaçërisht për këtë botim nga poeti e piktori Parid Teferiçi, e deri te artikuj të tjerë shkencorë që u sollën në këtë pjesë të dytë të botimit të akteve me qëllim pasurimin e leximeve mbi veprën e saj.

Ndërsa në pjesën e tretë ky botim pasurohet nga një përzgjedhje imazhesh ilustruese e dokumentuese me të cilat u ndërtuan disa tipe ekspozitash mbi të, nga ato librore deri te ekspozitat virtuale, në Tiranë, Prishtinë, Romë, Milano etj. Këto ekspozita kanë sjellë për publikun dëshmitë e fillimeve letrare, më pas botimet e para të veprave të plota të Musine Kokalarit, si shkrimtarja e parë në letrat shqipe, dhe kanë vijuar me pjekurinë e saj si qytetare e person politik, si themeluese e Partisë Socialdemokrate Shqiptare dhe intelektuale e shquar. Një vend të rëndësishëm ze edhe dëshmia e persekutimit ekstrem por edhe e qëndresës së saj të pashembullt në emër të demokracisë dhe dinjiteti njerëzor.

Le të jetë ky botim një homazh për të e përmes saj një nderim për vetëdijen mbi shkrimin e mbi lirinë, të cilën ajo nuk e humbi për asnjë çast të jetës së saj. Në mbyllje, dëshirojmë të pohojmë se pa shkrimet e Musine Kokalarit letërsia shqipe sot do të ishte më e varfër, pa kurajën dhe vetëdijen për lirinë të Musine Kokalarit kuptimi ynë për lirinë dhe qëndresën (edhe aty ku ajo duket e pamundshme), do të ishte më i zbehtë dhe më i thyeshëm.

Prandaj dhe ky botim është vetëm fillimi i një vargu të gjatë studimesh e monografish që janë tashmë në proces e sipër hartimi e botimi kushtuar veprës dhe figurës së saj. U shprehim mirënjohjen tonë të gjithë kontribuuesve shkencorë të këtij vëllimi që na mundësuan të hidhnim së bashku hapin e parë. Ju faleminderit!

Persida Asllani dhe Fazli Gajraku

EKSPOZITA DHE KONFERENCA SHKENCORE

Musine Kokalari, vetëdija e shkrimit dhe e qëndresës

në 100-vjetorin e lindjes
së shkrimtares së parë shqiptare dhe intelektuales së shquar

MINISTRIA E KULTURËS

BKSH, Salla shkencore, 10 shkurt 2017, ora 10:00

BIBLIOTEKA KOMBËTARE

PËRMBAJTJA E LËNDËS

AKTET E KONFERENCËS SHKENCORE

Prof.As. Dr. Mauro GERACI - Universiteti i Mesinës - Itali
Musine Kokalari dhe fuqia e ëmbël e poezisë: letërsia, autobiografia dhe antropologjia 15

Prof. Dr. Ardian NDRECA - Universiteti Urbanian, Vatikan
Musine Kokalari: provimi i jetës i nji "zemre mendimtare" 31

Prof. Dr. Dhurata SHEHRI - Universiteti i Tiranës
Musine Kokalari: Vetëdija e shkrimit 41

Dr. Kujtim RRAHMANI
Musine Kokalari: hi e hir i një fustani 47

Prof. Dr. Persida ASLLANI - Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë
"Nënua plakë në Romë"- aventura romane e zemrës shqiptare 61

Dr. Albanë MEHMETAJ - Universiteti i Prishtinës
Kokalari për Kokalarin 81

Dr. Femi CAKOLLI
Përralla dhe teologjikja në veprën e Musine Kokalarit 103

Doc. Dr. Agron TUFA - Universiteti i Tiranës
Msc. Elvana ZAIMI
Kodi i ligjërimit bisedimor në prozën e Musine Kokalarit 111

Msc. Blerina ROGOVA-GAXHA - Universiteti i Prishtinës
Musine Kokalari: Gruaja 117

Simonetta CEGLIE
"Një jetë e lehtë, e këndshme dhe plot ëndrra": vitet e Musine Kokalarit në "La Sapienza" mes kujtimeve dhe dokumentit 123

Uran BUTKA - Instituti i Studimeve Historike "Lumo Skëndo"
Persekutimi shtetëror i Musine Kokalarit 151

Dr. Dorian KOÇI -Muzeu Historik Kombëtar
"Muza" e Rezistencës Antikomuniste 163

Brunilda DASHI -Universiteti La Sapienza
Instituti i Studimeve Shqiptare
Veçori gjuhësore në veprat letrare të Musine Kokalarit 173

Prof. asoc. Mimoza ZEKAJ - Universiteti i Gjirokastrës
Vlera e leksikut dialektor e krahinor në krijimtarinë e M. Kokalarit 197

KONTRIBUTE TË TJERA PËR FIGURËN E MUSINE KOKALARIT

Parid TEFERIÇI 209
Lasgush PORADECI 211

Nexhat HAKI
Talente femrore 215
Me rasën e librit "Rreth vatrës" të Musine Kokalarit 217

Dilo Lefter
Siç më thotë nënua plakë 221
Musine Kokalari dhe Xhexhe Frosua 223

Prof. Dr. Persida ASLLANI - Universiteti i Tiranës
Identitetet femërore si ligjërim në prozën e Musine Kokalarit 225

Prof. Dr. Mimoza KARAGJOZI KORE - Universiteti i Tiranës
Vepra e Musine Kokalarit, dëshmi etnolinguistike e Gjirokastrës së viteve '30, memuar i çmuar i ditëve të sotme *245*

Meliza KRASNIQI - Instituti Albanologjik, Prishtinë
Musine Kokalari përballë Migjenit 255

Aleksandër ÇIPA

Etnoteksti i shkrimtares disidente (Ese) 273

ALBUM/EKSPOZITË VIRTUALE 278

Prof. As. Dr. Mauro GERACI
Universiteti i Mesinës - Itali

Musine Kokalari dhe fuqia e ëmbël e poezisë: letërsia, autobiografia dhe antropologjia

Kur – për herë të parë – lexojmë veprat e Musine Kokalarit, kuptojmë menjëherë se, edhe pse të ndryshme mes tyre, ato rrjedhin të gjitha nga e njëjta poetikë bazë që shkrimtarja dhe poetesha përkryen që nga adoleshenca, që nga studimet e para. Çka i bashkon poezitë e saj, historitë e shkurtra me karakter moral, përrallat dhe rrëfenjat e frymëzuara nga folklori toskë, shkruar kur ishte pak më shumë se njëzet vjeç, artikujt (te "Gruaja shqiptare", revistë e themeluar prej saj, ose "Shtypi" e "Tomori"), kujtimet italiane të viteve universitare në Romë dhe në fund, traktatin politik e autobiografik *Si lindi Partia Socialdemokrate*, hartuar në përfundim të tragjedisë së vet, në të vërtetë është qasja e një mirëkuptimi të ëmbël përballë botës, të gjërave të natyrës dhe atyre njerëzore që megjithatë përzihen me një forcë të kthjellët njohëse, pasqyruese dhe rezistente si çeliku. Në veprat e Musine Kokalarit tensioni qytetar dhe demokrat, të cilin ajo deri në fund diti ta ruajë duke i rezistuar dënimit dhe përndjekjeve të regjimit komunist shqiptar, duket se bashkëjetojnë e harmonizohen me një ndjesi të ëmbël, të lartë e të heshtur antropologjike mirëkuptimi për

të gjitha gjërat: lulet, pemët, detin, natyrën, fëmijët, për çdo qenie njerëzore, për çdo histori, edhe atë më brutalen e banalen.

Këtë vështrim melankolik, soditjeje dhe në të njëjtën kohë denoncimi e kallëzimi të ashpër me të cilin kundron ndryshimet, kontradiktat, anakronizmat, dramat, sidomos të botës bujqësore dhe blegtorale shqiptare, Musine Kokalari pati mundësinë ta thëthinte që fëmijë, duke u rritur në një familje intelektualësh me prestigj: gjyshi Hamit kish përfunduar studimet e larta të teologjisë dhe filozofisë në Turqi; i biri, Reshati (1875-1946), i ati i shkrimtares, kishte studiuar për jurisprudencë në Stamboll, ku qe vendosur bashkë me familjen; kështu dhe vëllezërit e tij Mumtazi (1896-1944), Vesimi (1898-1944) dhe Hamiti (1909-1989) kishin një formim të mirë, si në fushën gjuhësore-letrare, ashtu edhe në atë juridike. Dhe në të vërtetë, Musineja u rrit mes librave, muzikës së dëgjuar në gramafon dhe sidomos përrallave, rrëfenjave, historive dhe këngëve tradicionale shqiptare të dëgjuara me veshët e saj në Gjirokastrën e vet. Më pas në Tiranë, pranë institutit «Motrat Qiriazi» dhe shkollës së mesme liceale «Nana Mbretneshë» ku studioi deri në vitin 1937, ajo arriti rezultate të shkëlqyera përmes shkrimeve që tërhoqën menjëherë vëmendjen e personaliteteve të letërsisë, gjuhësisë, filologjisë, etnografisë, studimeve të folklorit të qarqeve intelektuale shqiptare me të cilat Musineja e re pati mundësinë të binte në kontakt. Për marrëdhënie të tilla luajti rol edhe libraria «Venus», e hapur nga i vëllai Vesimi, librari që në kryeqytetin shqiptar u bë një pikë e rëndësishme reference dhe thellimi kulturor; si dhe shtëpia botuese «Mesagjeritë shqiptare» e drejtuar nga vëllai tjetër, Mumtazi, përmes së cilës u përkthyen e u botuan vepra themelore si ato nga Edgar Allan Poe, Walter Scott, Shekspiri, Omar Khajami, Vicente Blasco Ibáñez. Pra, prirja poetike e Musinesë lulëzonte në një klimë veçanërisht pjellore, të gjallë dhe të favorshme për diskutimet, kërshëritë dhe risitë intelektuale, ku dituritë kanonike të së drejtës civile dhe të historisë ndërthureshin në mënyrë efikase me ato humanistet e gjuhësisë, letërsisë si dhe të një filozofie politike përthithur prej shumë vitesh nga leximet shkollore të rinisë (nga Aristoteli te Montaigne, nga Paskali te Nietzsche).

Një të tilli formim kulturor i bëjnë jehonë veç të tjerash disa mendime të mbledhura e të shënuara nga shokët e saj në një bllok kujtimesh, dhuruar në fund të liceut e që sot ruhet pranë Arkivit Qendror të Shtetit, bashkë me këngën e parë popullore nga Gjirokastra, të mbledhur prej saj kur ishte vetëm 10 vjeç. Në veçanti, Musine Kokalari u bë shpejt e njohur si vëzhguese e vëmendshme e folklorit vendas, si të Gjirokastrës ashtu edhe të Vlorës, Tepelenës, Korçës, Shkodrës dhe Shkupit (ku ndërkohë i vëllai, Hamiti ishte caktuar konsull). Aq sa më 1937, pas gjimnazit, ajo nisi të botonte skica letrare në prozë dhe poezi në gazetën «Shtypi», në të cilat ndalet dhe nis të përsiasë mbi plagët shoqërore të Shqipërisë: varfërinë, padrejtësitë, analfabetizmin dhe sidomos gjendjen e skllavërisë, kontrollit dhe veçimit shtëpiak ku – në ambientet më të prapambetura – jetonin ende gratë shqiptare, të trajtuara si skllave, haptazi të diskriminuara në lidhje me burrat. Edhe pse vinte nga një familje aristokrate, Musineja vëzhgonte me mprehtësi dhe kurajë realitetin e popullit shqiptar, dhe kjo sipas një projekti të dyfishtë të njohjes shkencore dhe në të njëjtën kohë, të betejës civile. Prirja sistematike etnografike, falë së cilës që e re regjistronte dhe dokumentonte aspekte, situata dhe narrativa të kulturës folklorike shqiptare, për Musine Kokalarin duhej të shërbente për krijimin e atyre njohurive historike-antropologjike të domosdoshme për të sjellë në vëmendjen e shoqërisë civile dhe ndërgjegjes politike përhapjen e shfrenuar të varfërisë dhe padrejtësive që ende bënin kërdinë në vend. Që këtej e kanë burimin shkrimet e saj të akuzës dhe denoncimit të kushteve sociale, që nisi t'i botonte shpeshherë nën pseudonimin «Muza» ose «Tacita». Epiqendër e këtyre tregimeve etnografike, si «Kur sundon tradita», «Skllavëri» dhe «Vatra e shkatërruar» është figura e gruas shqiptare, mungesa e saj e lirisë, skamja, kushtet e tmerrshme të veçimit dhe analfabetizmit në të cilat ndodhej. Hera-herës, Musineja i përcaktonte vetë subjektet e këtyre rrëfimeve etnografike duke u nisur nga proverbat dhe frazeologjia e shqipes popullore, për shembull në tituj si "Burri shoku i qënit", "Një qen që hamullit nuk ha", "Mos qofshin vjehrat e zeza". Duke përshkruar përmes dialogëve dhe situatave tipike, gjithë dramaticitetin

e këtyre kushteve, autorja lëshon në të njëjtën kohë britmën e saj për ndryshim në rrëfime, balada, poezi që andej nga fundi i viteve '30 nisi t'i mblidhte dhe t'i botonte në librat e saj të parë, si *Kolla e vdekjes*, dhe *Siç më thotë nënua plakë*. Vepra rinore, që megjithatë nxjerrin në pah një pjekuri progresive, të shpejtë e të thellë etiko-politike që edhe këtu aspiron për forma më të larta të shprehshmërisë letrare.

Kur më 1938 do të mbërrijë në Romë, për të filluar studimet universitare pranë Fakultetit të Letërsisë në La Sapienza, Musineja kish hedhur kështu pas shpatullave botimin e vargjeve poetike dhe rrëfimeve të përmbledhura në *Kolla e vdekjes* (1937-8) dhe qe programuar tashmë botimi i *Siç më thotë nënua plakë* (1939). Përmbledhje që në tërësinë e tyre dëshmojnë prirjen e fuqishme antropologjike, politike dhe njëkohësisht letrare me të cilën, që në këto poezi dhe "tregime etnografike" Musine Kokalari kish arritur të ngjallte interesin e letrarëve me rëndësi si Lasgush Poradeci, Ali Asllani dhe mbi të gjitha, Ernest Koliqi, te La Sapienza themeltar i Institutit të Studimeve Shqiptare. Edhe pse i thirrur në Tiranë nga viti 1939 gjer më 1941 në rolin e Ministrit të Arsimit, ishte mbi të gjitha Koliqi ai që u bë shpejt një pikë themelore referimi për shkrimtaren dhe studiuesen e re, një model për t'u ndjekur qoftë në rrafshin shkencor, qoftë në atë poetik-letrar.

Me pak fjalë, ai i Musine Kokalarit të re është një formim humanist dhe njerëzor në të njëjtën kohë. Është një formim i përgjithshëm të cilin, mes viteve 1937-1941 shkrimtarja pati sidomos mundësi ta perfeksionojë dhe strukturojë në Romë gjatë viteve universitare pranë Fakultetit të Letërsisë në La Sapienza, përmes një kurrikulli studimesh në masë të madhe të përqendruar te disiplina që kanë të bëjnë me përdorimet dhe arsyet e fjalës, me ato që vite më vonë, Michel Foucault (2004) do t'i emërtojë si «rendet e ligjërimit»: filozofia, filologjia, historia e letërsisë, gjuhësia, antropologjia dhe demologjia. Një prirje poetike të cilën Musineja e përkryen paralelisht, qoftë në rrafshin e një zhgënjimi e deziluzioni të ëmbël me të cilën ushtrohej duke vëzhguar jetën e vet në raport me atë të shoqërisë shqiptare dhe italiane, qoftë në atë shkencor dhe akademik që e pa të përballej

në provimet universitare me autoritetet më të shquara të kulturës italiane të kohës, që nga Giovanni Gentile te Natalino Sapegno, nga Paolo Toschi te Antonio Muñoz dhe Mario Praz. Dhe është pikërisht ushtrimi antropologjik i të vëzhguarit të disa botëve të mundshme, si dhe në të njëjtën kohë, të reflektuarit mbi mënyrën e vet të të qenit në botë (stare al mondo) dhe për ta imagjinuar atë, që i dha shtysë Musinesë së re të ndiqte, në shumë aspekte, zhanrin letrar të tregimit etnografik, rrymë narrative që në Shqipëri ishte inauguruar – mes viteve '20 dhe '30 të shekullit të kaluar – nga shkrimtarë të mëdhenj si Millosh Gjergj Nikolla (i njohur me pseudonimin Migjeni) dhe sërish, Ernest Koliqi, gjuhëtar i rafinuar, folklorist por edhe poet e tregimtar shkodran, Ministër i Arsimit në Shqipëri nga viti 1939 deri më 1941, veç të tjerash themelues më 1939 i të sipërthënit Institut të Studimeve Shqiptare, ku nën udhëheqjen e dijshme të Namik Resulit, po ajo Musine punoi për doktoraturën mbi Naim Frashërin, 1876-1900. Përmes kërkimesh të gjata arkivore për të cilat u ndihmua nga vetë nipi i poetit të madh, Mit'hat Frashëri, mik i saj dhe i familjes, si dhe personalitet i spikatur i jetës kulturore dhe politike të kohës, Musine Kokalari ilustron me hollësi detajesh aspektet e shumanshme që në Shqipëri e kanë bërë Naim Frashërin simbol të letërsisë dhe jetës kombëtare, falë personalitetit të tij poliedrik të iluministit, romantikut, idealistit, pedagogut dhe filozofit.

Megjithatë, edhe pse ua njeh madhështinë dhe bazën e ditur etnografike që mbështet veprat monumentale epike si, p.sh. bukoliket e Naim Frashërit, të botuara me titullin *Bagëti e Bujqësi* ose poemën e Gjergj Fishtës, *Lahuta e Malcís*, botuar më 1937, në rrëfimet dhe poezitë e saj Musine Kokalari mban njëfarë largësie nga gjurma patriotike e letërsisë shqiptare të fundit të shekullit XIX, haptazi në funksion të mbështetjes së një lëvizjeje të përgjithshme nacionaliste në gjendje t'i shpinte përpara mëtimet e një Shqipërie të pavarur prej perandorisë osmane përmes një "letërsie shqiptare", në shqip, mbi historinë shqiptare dhe një "albanologjie" të gatshme të njihte në doket dhe zakonet bujqësore e blegtorale shenjat autoktone, legjitime dhe të pashkëputura të një shtetshmërie si të themi, "të natyrshme".

Përkundrazi, duke iu qasur perspektivave poetike tashmë të ravijëzuara nga Migjeni në *Vargjet e lira* dhe në *Novelat e qytetit të veriut* dhe nga Koliqi në tregimet *Hija e maleve* dhe *Tregtar flamujsh*, Musine Kokalari shfaqet jashtëzakonisht e fortë dhe e pjekur kur rrëfen sesi kultura popullore shqiptare nuk është ajo mrekulli përrallore, idil malësor e fshatar i ngritur në qiell tej çdo caku e kufiri, mes tetëqintës dhe nëntëqintës nga Naim Frashëri, nga Gjergj Fishta dhe ushtria e poetëve-apostuj të Rilindjes Kombëtare të cilët, siç thoshte Eqrem Çabej, "shpesh janë detyruar të ndërrojnë penën me pushkën" (2002: 94). Ndërsa Musineja është shumë e ashpër kur denoncon mungesën e lirisë së grave shqiptare, martesat me detyrim, urinë, mjerimin dhe kushtet e tmerrshme të shfrytëzimit, përjashtimit dhe analfabetizmit të përhapur në fshat; kur në "Pas xhameve të dritares" përshkruan "vajzat fantazma" të mbyllura pas xhamave të dritareve, të detyruara të mos dalin para detyrimit martesor; ose në "Reth pjatës" ku punëtorët e vegjël lëshohen si këlyshë rreth pjatave me kos që u sillen për drekë. Poezia e Musinesë është shumë e fuqishme kur ndalet mbi goditjet e "Kollës së vdekjes" që shënon sëmundjen dhe fundin e një vajze shumë të varfër e cila, në çastin kur vdes, "triumfon" përjetë mbi indiferencën e një shoqërie moderne që nuk ka kohë të ndalet e të mendojë, të qajë një nga gratë e shumta dhe të një natyre që – si te Giacomo Leopardi – vazhdon e pamëshirshme shiun e saj të ftohtë, që bie rrebesh. Denoncimi i Musinesë është shumë i fortë; edhe kur vetëdijesohet për pushtimin dhe shkatërrimin e dhunshëm të natyrës të shkaktuar nga njeriu, kur idealizon edhe një lule për të mos u këputur, as për dashuri e as për t'ua shpënë të vdekurve, një lule për t'u lënë rehat, vetëm me veten, mes ferrave: Të isha një lulë… ndoshta kështu do kish dashur të ishte edhe ajo. Do kish dashur të ish një zë i gjallë, ama i egër; një zë i pazbutur nga moda, retorikat, konvencionet, detyrimet e rënda të traditës, manierizmat, patriotizmat, nacionalizmat, nga regjimet; Musineja kultivon dellin e saj poetik në intimitetin e adoleshencës, të dhomës së vet, të tavolinës së punës, të marrëdhënieve të saj me natyrën, me Shqipërinë, në maturi dhe me ndjesinë e cipës e të turpit, në delikatesën me të cilën jetoi e shkroi përherë.

Figura e gruas shqiptare dhe ndërgjegjësimi i saj progresiv, si dhe emancipimi shoqëror bëhen kështu pikëmbështetja mbi të cilën rrotullohet poetika e Musine Kokalarit që shoqëron një aktivizëm politik të dëshmuar nga roli parësor që pati shkrimtarja në themelimin e "Gruaja shqiptare" (revistë e grave antifashiste) në të cilën bashkëpunoi Ali Asllani, edhe ai autor i një narrative të rëndësishme të përqendruar te folklori. Do jetë përherë kjo pirje antropologjike, e qartë edhe në *La mia vita universitaria* – kujtimet e viteve të studimit në Romë, të cilat kam pasur fatin t'i analizoj bashkë me arkivisten Simonetta Ceglie (2016) – që e shpuri Musine Kokalarin drejt përkryerjes e pjekjes politike që, të nesërmen e Luftës Botërore do ta shohë mes themeltarëve të Partisë Socialdemokrate nëpërmjet të cilës synohej ndërtimi i një Shqipërie demokratike, antifashiste dhe antistaliniste. Nuk ndodhi kështu, për fat të keq dhe Musine Kokalari – si dhe mësuesi i saj Koliqi, pranë katedrës së të cilit u diplomua në vitin 1941 me pikët maksimale – u përndoq përtej çdo kufiri nga regjimi komunist në lindje e sipër, së bashku me të vëllezërit Vesim dhe Mumtaz (botues me shumë kulturë, pronarë të librarisë plot gjallëri "Venus" të Tiranës), pushkatuar menjëherë më 1944 gjatë spastrimit të parë të kryer prej Republikës Popullore që sapo kish lindur. Trupat e tyre, bashkë me ato të shumë intelektualëve të tjerë të pakëndshëm për regjimin, u gjendën pas një muaji në bodrumet e hotelit Bristol të Tiranës, vigjiljen e Krishtlindjeve[1]. Burgun – si dënim për një program antikomunist të hartuar "për instalimin e një sistemi

1 Bëhet fjalë për masakrën e 12 nëntorit 1944, gjatë të cilës skuadrat partizane eliminuan anëtarët e Grupit Bashkimi Demokrat, i lindur si iniciativë e intelektualëve, kryesisht të së majtës që kishin vendosur të krijonin një parti socialdemokrate me të cilën të hynin në zgjedhje. Zgjedhjet, edhe pse iu kërkuan aleatëve anglo-amerikanë, nuk u zhvilluan kurrë dhe regjimi komunist i Hoxhës gjeti aktin e vet themelues në këtë masakër që - bashkë me tridhjeteshtatë të tjerë - i pa vëllezërit e Musine Kokalarit, Vesimin dhe Mumtazin, të arrestuar e të pushkatuar. Trupat e tyre u gjendën në bodrumet e hotel Bristolit të Tiranës, në ditët e Krishtlindjeve. Vëllai i tretë, Hamit Kokalari shpëtoi pasi qe i sëmurë me tifo, për këtë arsye nuk u rrëmbye dhe shpëtoi nga vrasja si dy vëllezërit e tjerë të Musinesë. Të shkruara në fillim të viteve '80, në vitet e hekurta të komunizmit e për këtë arsye plot me kalesa e zbrazëti që u mvishen klimës së terrorit dhe censurës së vendosur nga regjimi, kujtimet e Hamitit (2008) përbëjnë një burim të rëndësishëm dokumentar për sa i përket rindërtimit të origjinave të familjes Kokalari.

demokratik e pluralist", nënshkruar bashkë me intelektualë të tjerë, bashkë me një notë për t'iu dërguar diplomatëve anglo-amerikanë me qëllim që të favorizonin shpalljen e zgjedhjeve të para demokratike në Shqipëri[2] – Musineja do ta provojë për gjashtëmbëdhjetë vjet, nga 23 janari 1946, datë në të cilën u arrestua; më pas, nga viti '61 deri në ditën kur vdiq (13 gusht 1983), do të internohet në një banesë të mjerë caktuar nga regjimi në qytezën e vogël, të ftohtë e të humbur të Rrëshenit, mes maleve të Mirditës, në një torturë fizike, psikologjike dhe morale të cilën ajo e konsideronte edhe më tragjike se periudhën e mëparshme të burgosjes. Tragjedi finale e shënjuar prej izolimit të detyruar, mbikëqyrjes nga afër, vuajtjes, sëmundjes, gjatë së cilës Musineja, megjithatë, nuk e humbi kurrë prirjen e saj njerëzore dhe humaniste, dashurinë për librat – që pa i thënë asnjë fjalë, i jepeshin përmes sportelit të bibliotekës qytetase e që ajo, i merrte nën krah e shkonte t'i lexonte ulur mbi shkallët rrethore të atij kopshti të vogël publik të Rrëshenit. Edhe sot, kush shkon në Rrëshen, mund të ulet mbi po ato shkallë si dhe ta ndiejë ende afërsinë e Musinesë, si një shoqe, një Muzë, që me zërin e vet, fjalët dhe poezinë, zjarrin e vet intelektual arrin ende të na frymëzojë ngrohtësinë, forcën dhe kurajën e nevojshme për të tejkaluar çdo dhunë, çdo detyrim, çdo tragjedi dhe për të ecur para. Në ato vite të fundit të izolimit, Musineja nuk e humbi vështrimin e saj antropologjik mbi botën që e rrethonte. Një

2 Gjatë rrjedhës së marrjeve të shumta në pyetje pas arrestimit, Musineja me kurajë rrëfen mospasjen e ndonjë reticence në zbulimin e mënyrave e skenarëve të takimeve dhe emrat e njerëzve të përfshirë, projektin e hartuar për ndërtimin e një koalicioni politik demokratik, sa antifashist aq edhe antikomunist. Shkrimtarja zbulon rolin e rëndësishëm të zhvilluar prej saj në arritjen e një marrëveshjeje mes lëvizjeve politike që edhe pse në shumëllojshmërinë e tyre ideologjike dhe programatike, synonin së pari në ngritjen e një shteti të lirë prej çdo diktature: mes këtyre sidomos Partia Socialdemokrate të Shqipërisë te e cila shkrimtarja bënte pjesë që nga themelimi; grupi monarkist që luftonte sidoqoftë për një riafirmim elektoral të monarkisë shqiptare; dhe Balli Kombëtar. Në shumë raste, Musine Kokalari u deklaroi kështu gjykatësve hetues se «nuk kishte sekrete» dhe përshkroi në detajet më të imta veprimtarinë dhe programin politik të koalicionit demokratik që mes artikujve të ndryshëm, parashikonte shpalljen e menjëhershme të zgjedhjeve, lirinë e shtypit, neutralitetin e Shqipërisë në lidhje me fuqitë e mëdha. Të ruajtura pranë arkivit të Ministrisë së brendshme shqiptare, akte të tilla gjyqësore janë bërë sot të qasshme në vëllimin e botuar kohët e fundit nga Leka Ndoja (2015), prej Institutit të studimeve të krimeve dhe përndjekjeve të komunizmit në Tiranë, të drejtuara nga historiani Agron Tufa.

vështrim të cilin e përvetësoi me përpikëri në shkrimin e veprës së saj të fundit, *Si lindi Partia Socialdemokrate*, sprovë historike-politike por edhe autobiografike të cilën e mbaroi së shkruari më 1972. Mes përsiatjeve origjinale, si dhe personale e historike-antropologjike mbi Shqipërinë bashkëkohore, që meritojnë analiza të thella në të ardhmen, mbaj mend atë ku Musine Kokalari, bashkë me fuqinë habitëse të thjeshtësisë shprehëse, rrok e lidh bashkë në një frazë të vetme kontradiktat e tragjedisë socialiste me atë të vetën: «Puna e krahut është e rëndë në socializëm, i cili thotë megjithatë se do ta ngrejë klasën punëtore në pushtet. Punëtorët mbeten të gjithë në fund, qoftë nga pikëpamja kulturore, qoftë nga pagesa, qoftë edhe pse mbeten të mbyllur mes katër mureve të fabrikës. Këtë kam parë dhe ky është realiteti. Dhe meqenëse nuk kam dashur ta pranoj këtë rrugë, unë u gjenda vetëm, e vetme me letërsinë; ndoshta kjo është puna më e rëndësishme».

Si ai i mësuesit të saj Koliqit, vështrimi i Musine Kokalarit është – siç e ka përkufizuar Dalan Shapllo në hyrjen e një përmbledhjeje antologjike të shkrimtares, «etnografik-artistik, ku të dy aspektet konvergjojnë njëri te tjetri, megjithëse e gjithë vepra priret drejt etnografizmit» (2004: 20). Është një vështrim i pjekur e i zhvilluar mes Tiranës dhe Gjirokastrës (qyteti i saj i lindjes) që nga vitet e para të formimit universitar, të cilin pati mundësi ta mprihte në kontakt me studiues të mëdhenj, si antropologu Paolo Toschi, gjuhëtarët Carlo Tagliavini dhe Angelo Leotti me të cilët vazhdimisht shkëmbente letra mbi çështjet e dialektologjisë shqiptare, albanologët Giuseppe Schirò jr. dhe Namik Resuli, relatori i saj i tezës. Edhe para se të regjistrohej më 1938 në Fakultetin e Letërsisë në La Sapienza, mes viteve '37 dhe '44, Musineja i botoi veprat e saj: rrëfimet e frymëzuara nga folklori toskë dhe dramat e gruas shqiptare në jug, *Siç më thoshte nënua plakë* (1939); tregimet e shkurtra me karakter moral ...*sa u-tunt jeta* (1944) plotësuar me një fjalor të kujdesshëm të dialektit toskë; përrallat *Reth vatrës* (1944); poezitë dhe novelat e shfaqura në gazetën "Shtypi" e më pas të mbledhura në *Kolla e vdekjes* (1937-8). Skicat letrare, si *Siç më thoshte nënua plakë* në veçanti, nxjerrin në pah një sintezë të frytshme

mes punës dokumentare të kryer nga Musine Kokalari dhe asaj përsiatëse, poetike dhe morale që në vetë formën e këtyre rrëfimeve na bën të njohim dialektin toskë; fjalët e urta dhe shprehjet, mënyrat e të thënit të Gjirokastrës; jetën familjare tradicionale; strukturën e roleve shtëpiake dhe tensionet që lindin prej saj mes burrit dhe gruas, vjehrrës dhe nuses, gjyshërve dhe nipave; kushtet e vështira të gruas; martesën dhe jetën bashkëshortore si në aspektin ritual ashtu dhe në kontrastet sentimentale dhe ekzistenciale; dramën e punës, të vështirësive ekonomike, varfërinë, urinë dhe emigrimin.

Ajo e arrirë nga Musine Kokalari është pra një poetikë që niset nga një vëzhgim i kujdesshëm etnografik i realitetit folklorik shqiptar, në kontrastet e saj morale dhe në shndërrimet e veta historike, për t'u bërë aluzion çështjeve më të gjera dhe dinamikave antropologjike, që veç të tjerash, rezultojnë të shumta dhe të prekshme në kujtimet romane. Kujtime të një studenteshe shqiptare dhe myslimane që nis të humbasë e ta rigjejë veten në një Itali fashiste, në kryeqytetin e krishterë të një vendi që po në ato vite kish pushtuar të sajin. Musineja arrin kështu të gjejë një italishte lineare, të ëmbël dhe të rrjedhshme me të cilën të përshkruajë kolonadat dhe forumet e lashta, Koloseun, radhët e pareshtura të pallateve, duke shquar aty shtypjen perandorake, monarkiste, umbertine, liktoriale, futuriste, moderne. Është frika levishtrosiane e modernitetit kolonialist – e simbolizuar bukur nga asfiksia që ndjeu nga ngrohja qendrore e banesës së saj të parë romane në Viale XXI Aprile, 8 – më shumë se ndaj një rehabilitimi romantik të Shqipërisë e shtyn drejt një fenomenologjie melankolike të jetës në të cilën krahasimi i peizazheve të ndryshme shërben për të paraqitur kontrastet sentimentale, familjare, sociale, historike, kulturore (vetëm pjesërisht italo-shqiptare) të përjetuara prej saj gjatë katër viteve të studimit. Kështu, kur ndalet te banesat, te rrugët e drejta, te zënkat e hasura nëpër markatat e Romës, kur përshkruan zërat e artizanëve të Foxhës ose zhurmën e rrugëve të Napolit ose Pompeit, grindjet e përditshme si p.sh. mekanizmat e sofistikuara të përjashtimit të përdorura ndaj saj nga borgjezia romane, Musineja krahason e ndanëvendos mjediset folklorike shqiptare me ato të metropoleve

italiane dhe romane, duke i bashkuar me karakteristikën e veçantë të vështrimit të saj dhe të një dinamizmi social-kulturor që nuk arrin të zgjidhet në kundërvënien e gabuar mes "traditës" dhe "modernes", por të cilës tenton t'i rikthejë konfliktet transversale, tensionet, dramat. Nuk është e rastit që pikërisht me ftesën e Koliqit – që menjëherë e çmoi mprehtësinë kritike të studenteshës – perspektivat etnografike të eksperimentuara më 1939 në rrëfime si «Kur sundon tradita», «Skllavëria» dhe «Vatra e shkatërruar» vazhduan më 1940 me artikujt e botuar në gazetën italo-shqiptare "Tomori", në një lloj shtylle antropologjiko-letrare me titull *Nënua plakë në Romë*. Me sytë e një nëne plakë shqiptare, të shpërngulur në kryeqytetin italian, Musineja ndalet në një botë që ndryshon, duke rrokur në tërësinë e detajuar të iluzioneve, deziluzioneve dhe deluzioneve përjetuar prej saj si studenteshë në një Romë futuriste dhe luftëdashëse, një zjarr prometean, ekzaltues e lartësues, ama të vuajtur në lëkurë, të përsiatjes antropologjike. Një poetikë e tillë zbulon veç të tjerash sintoni me atë të arrirë në po ato vite nga Mitrush Kuteli – i njohur për *Rrëfimet e moçme shqiptare* (2009) – dhe sidomos nga Lasgush Poradeci, autor i përmbledhjeve poetike mjaft të rafinuara për nga shpikja e sendërgjimi gjuhësor, në të cilin peizazhet shqiptare, liqenore dhe malore marrin jetë dhe bëhen ravijëzime të një vizioni panteist të ngjashëm në disa aspekte me atë të Musine Kokalarit dhe sigurisht jo në përputhje me diktimet poetike të realizmit socialist, që do t'u lerë gjurmë autorëve të regjimit.

Pra, forca e poezisë dhe prozës së Musinesë është antropologjike: pjesë e vëzhgimit të skenave të jetës së përditshme, dialogëve, raporteve të pushtetit, marrëdhënieve, të situatave për të nxjerrë në pah kontradiktat e hidhura të historisë sociale. Kjo forcë njohëse në veprën e Musinesë është megjithatë edhe kërkim i një pozicioni të tjetërsuar nga e cila me cipë e turp, rezervim dhe ëmbëlsi të mund të shohë madhështitë dhe vogëlsitë e jetës. Musineja përsiat vazhdimisht mbi botën dhe vendin e saj në botë, mbi unin dhe pozicionimin e saj kulturor, social, politik; dhe e bën me një poezi tejet delikate, të rreptë dhe të përdëllyer në të njëjtën kohë, ose me

bocete filozofike që duken – siç do thoshte Friedrich Nietzsche, të cilin Musineja e studioi në Romë – «të bëra prej cergash merimange, kaq të lehta sa të transportohen prej valësh dhe kaq të forta sa të mos merren me vete prej erës» (1993: 94-95). Subjektet e zbuluara dhe të rrëfyera prej Musinesë në tregimet e saj u ngjajnë kështu atyre ajrore, të ravijëzuara prej cergave të merimangës që në ligështimin e veprimeve dhe raporteve njerëzore, tregojnë në kundërdritë raporte të mundshme, poliedrike korrelacionesh, shkak-pasoje, pak a shumë të paqarta, të brishta e të paqëndrueshme, të përkohshme, rezistente. Forca poetike e Musinesë është e ëmbël njëkohësisht sepse zbulon efemeren, dyshimin, të brishtën, kalimtaren, elementi iluziv pas çdo gjesti, çdo projekti njerëzor, çdo gjykimi, pas çdo regjimi. «Asgjë nuk zgjat përjetë», shkruan në *La mia vita universitaria*: «Kështu është edhe jeta e njeriut: ne lindim, piqemi dhe vdesim; ndërsa të tjerë vinë pas nesh. Çdo vit i jetës tonë që kalon, nuk kthehet më; si petalet e trëndafilave, që era i merr një nga një me vete e nga të cilat nuk mbetet gjë veç pluhurit. Vetëm natyra, me format e saj të luhatshme, është e përjetshme. Edhe ekzistenca jonë nuk është gjë tjetër veçse një e shkuar e botës, një përparim i kohës.» (2016: 131).

Kështu, tensionet e vogla, të mëdha, të prodhuara nga largimi jashtë shtetit i një vajze të re për arsye studimesh, në rrëfimet e Musinesë bëhen shkas për të na zbuluar shqetësimet gjithmonë e më në rritje në atë kohë në familjet shqiptare: ato të grave, që ashtu si ajo vetë, dilnin nga shtëpia për të hyrë në universitete, në biblioteka, duke shkruar dhe vepruar më shumë në favor të grave të tjera; gra të cilat, si edhe ajo vetë në Romë quheshin "shqiptarja", ndërsa këtej e pak kohë më vonë, nga viti 1939-1942 të gjithë shqiptarët do bëheshin "italianë" me pushtimin fashist të Shqipërisë, për të cilin Musineja jep dëshmi të drejtpërdrejta. Përtej kronikave universitare, Musineja na raporton mbi statusin e saj të arrirë të shkrimtares emergjente, në rolet e reja të studenteshës, humanistes, biografes së vetvetes, të intelektuales që solidarizohet me të rinjtë antifashistë romanë, të një myslimaneje që kërkon dialog me banorët e qytetit të Krishtit. Bëhet fjalë për një rrëfim plot vizione intime, por jo solipsist, një rrëfim përherë kureshtar, i

hapur, ekumenik madje edhe kur gërmon e hulumton nëpër hutimet e studenteshës që gjendet e vetme fillikat në Romë; sepse kushte të tilla në vazhdimin autobiografik të rrëfimit nisin gjithmonë nga një përballje mes historive të jetës së të rinjve të tjerë me të cilët kishte hyrë në kontakt që nga ditët e para të leksioneve, sipas një antropologjie të emocioneve studentore, të paragjykimeve dhe racizmit më të fshehtë, të grindjeve dhe afrive mes kolegëve që Musineja ua kthen lexuesve, duke na sjellë dialogët e tyre mbi shumëllojshmërinë e përkatësive, të identiteteve të mundshme, të kulturave dhe besimeve, mbi vlerat e ndryshueshme për t'iu caktuar religjionit, historisë dhe studimeve. Gjërat e shumta që themi dhe mund të themi për Musinenë tregojnë sesi sot, në ditën e njëqindvjetorit të saj të lindjes, ajo është ende këtu mes nesh. Me veprat e saj dhe me fuqinë e ëmbël poetike ju siguroj që, sa të kemi frymë, do ta gjejmë krah nesh si mësuese të madhe të jetës, të solidaritetit njerëzor dhe demokracisë, si asistente tonën, si mike dhe konfidente. Për mua – që kam pasur fatin të studioj në të njëjtat salla dhe biblioteka të frekuentuara prej saj në Romë dhe që pa e ditur – kur isha dymbëdhjetë vjeç, falë një koincidence të jashtëzakonshme (frekuentoja miq të familjes që banonin e banojnë ende dhe sot në të njëjtën ndërtesë romane në Viale XXI Aprile, 8, aty ku banoi ajo studenteshë, mes viteve 1938 dhe 1939) Musineja është bërë tashmë një shoqe e pazëvendësueshme jete, por edhe një kolege më e çmuar se kushdo tjetër.

Si kolege, Musineja më mëson çdo ditë atë që më tha dhe njëherë im atë, duke më shtyrë të ndiqja vokacionin që shfaqja që kur isha djalë, ndoshta për të kuptuar ndryshimet mes Sicilisë ku kam lindur dhe Romës ku banoj edhe sot e kësaj dite: se antropologjia kulturore nuk është shkencë, nuk është matematikë. Ajo është poezi: është aftësia për të kuptuar poetikisht raportet mes unit dhe botëve të ndryshme të mundshme. Falë rrëfimeve të saj dhe poezive etnografike të cilave u thellohem çdo ditë e më shumë, Musineja më bën të përsias mbi arsyen e të qenit (ragion d'essere) të disiplinës të cilën e jap mësim në Universitetin e Studimeve në Mesinë, d.m.th. mbi hapjet poetike dhe etike të antropologjisë kulturore. Dhe e bën me atë mënyrën e

saj të të shkruarit, sa të thjeshtë aq edhe të pasur me motive filozofike që për mua përbëjnë një minierë orientimesh të mundshme dhe një mësim të përjetshëm metode dhe përunjësie shkencore.

Si shoqe jete, nuk mund të bëj më dot pa të. Me fuqinë e ëmbël të poezisë së saj që nga çdo lexim buron përherë e freskët,- "si ujë i rrjedhshëm" do thoshte sërish Nietzsche (1993), Musineja ma shuan etjen përditë, më kap përdore e më udhëheq; unë i flas e ajo më përgjigjet, unë i kërkoj këshilla dhe ajo më jep shpesh udhëzime, unë humbas e ajo më rigjen, më ndihmon të gjej vetveten, shpeshherë më jep edhe njëherë forcën për t'u ngritur më këmbë e për të vazhduar të eci; po të kem frikë ajo arrin gjithmonë të më japë gjithë kurajën, marrjen e njëfarë distance dhe atë ironi qiellore që për të mbijetuar janë të pazëvendësueshme. Prandaj përpiqem të mendoj e të veproj si të isha Musineja dhe nuk do pushoj kurrë së falënderuari atë Shqipëri fatale në të cilën ajo rikthehej me ngulm dhe më bën ta zbuloj çdo ditë e më shumë.

Bibliografi:

Çabej Eqrem
2002, Gli albanesi tra occidente e oriente, Lecce, Besa, (bot. or. 1938).

Ceglie Simonetta, Geraci Mauro (nën kujdesin e)
2016, Musine Kokalari. La mia vita universitaria. Memorie di una scrittrice albanese nella Roma fascista (1937-1941), me një sprovë nga V. Zhiti, Roma, Viella.

Fishta Gjergj
2006, Lahuta e malcís (Il liuto delle montagne), Shkodër, Botime françeskane, (bot. or. 1937).

Foucault Michael
2004, L'ordine del discorso. I meccanismi sociali di controlli e di esclusione della parola, Torino, Einaudi, (bot. or. 1971).

Frashëri Naim
1994, Bagëti e bujqësi. I pascoli e i campi, introduzione, edizione critica, trad. it. a cura di F. Altimari, Rende (Cosenza), Studi e testi di albanistica 4, Centro Editoriale Librario dell'Università della Calabria, (bot. or. 1886).

Geraci Mauro
2014, Prometeo in Albania. Passaggi letterari e politici di un paese balcanico, Soveria Mannelli (Catanzaro), Rubbettino.

Gjoka Behar
2011, Migjeni në pakohësi, Tiranë, West Print.

Kokalari Hamit
2008, Kujtime 1, Tiranë, Omsca-1.

Kokalari Musine
1937-38, Kolla e vdekjes. Vargje poetike dhe tregime, Tiranë, s.e.
1939, Siç më thotë nënua plakë, Tiranë, Gutenberg; risht. Prishtinë, Buzuku 1996.
1944, …Sa u tunt jeta, Tiranë, Mesagjeritë shqiptare; risht. Tiranë, Globus 1995.
1944, Reth vatrës, Tiranë, Mesagjeritë shqiptare.
2004, Vepra, me parathënie nga D. Shapllo, Prishtinë, Faik Konica.
2009, Vepra, nën kujdesin e N. Xh. Shehut, 2 vëll., Tiranë, Geer.

Koliqi Ernest
1933, Malësore me djep, in Gjurmat e stinve, Tiranë, Shkodër.
2011, Hija e maleve, nën kujdesin e L. Ndojës, Tiranë, Pakti.
2013, Tregtar flamujsh, nën kujdesin e L. Ndojës, Tiranë, Pakti.

Kuteli Mitrush (Pasko Dhimitër)
2009, Tregime të moçme shqiptare, Tiranë, Kuteli, (bot. or. 1965).

Migjeni (Millosh Gjergj Nikolla)
2006, Recital' i malsorit, në Vargjet e lira / Novelat e qytetit të veriut, Tiranë, Migjeni, (bot. or. 1936), përkth. it. Preza 2006: 229-229.

Ndoja Leka (nën kujdesin e)
2015, Bashkimi demokratik shqiptar 1946, Akte gjyqësore politike gjatë komunizmit në Shqipëri I, Tiranë, Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

Nietzsche Friedrich
1993, Su verità e menzogna in senso extramorale, Opere 1870-1881, Roma, Newton Compton, (bot. or. 1873).

Përktheu nga italishtja: Edion Petriti

Prof. Dr. Ardian Ndreca
Universiteti Urbanian - Vatikan

Musine Kokalari: provimi i jetës i nji "zemre mendimtare" Rreth librit "Jeta ime universitare"

Musine Kokalari (1917-1983) ka hy dhe ka dalë prej historisë së letrave tona në maje të gishtave.

Ka hy me vetëdijen e frakturës së dy kohnave që përshkoi jeta e saj, me mallin për të perënduemen dhe me ankthin e pafajnisë, ka dalë me nji dhimbje kozmike, e ndame dhe e tretun nga bota e saj por jo e asgjasueme.

Shkrimi në rastin e saj asht ekzaltimi i unit, shkrimja e tij e natyrshme në nji formë të zhdërvjellët e me nji gjuhë të pasun. Me anë të shkrimit ajo rindërton unin e vet, e vijon me e ba ketë gja deri në fund të jetës, e izolueme plotsisht por pa përfundue në miniaturizëm apo ma keq në karikaturë.

Musineja ka përjetue tragjikisht humbjen e familiaritetit me botën që e ka rrethue, tue e shty veten drejt nji izolimi të pashmangshëm, si e vetmja rrugë për me ruejt praninë e saj. Prizmi i kohës në të cilin ajo ka jetue, tue shpërba natyrën e dritës që e ushqente me liri dhe dije, ka trandë themelet e botës së

Musinesë. Prej asaj drite ajo ka mund me shpëtue vetëm nji rreze, atë që e lidhte me idealet rilindase, dhe shì ajo e ka ndihmue me qëndrue stoike deri në fund.[1]

Shpirti mbi letër

Jo rastësisht "Jeta ime universitare" e Musine Kokalarit ka pa dritën e botimit në origjinalin italisht tek kolana "Kujtesa e kthyeme" e shtëpisë botuese Viella.[2] Shkrimi i historisë, siç vërenin shkrimtarë antikë, asht përpjekja me krijue kujtesë, përpjekja me zotnue diçka përgjithmonë. Edhe shkrimi pothuejse ditaresk i Musine Kokalarit ban pjesë tek mundi me krijue kujtesë dhe dëshira me i mbijetue kalimtares në histori.

Për arsyena të dituna nuk kemi gjatë shekullit XX shumë zane femnore të spikatuna në jetën intelektuale, artistike, letrare tonën. Emnat e Sevasti Qiriazit, Tefta Tashko Koços, Andromaqi Zengos, Elena Gjikës, Sabiha Kasimatit, Ikbal Çikës, Selfixhe Brojës, Jolanda Kodrës mbeten meteorikë. Tash së fundi I. Kadareja ka cekë mungesën e zonjave të mëdha në letërsi tue e trajtue si nji trazim të hershëm, ai i ka përfytyrue si xixëllonja që vonojnë me ardhë.[3]

Edhe Qemal Draçini me nji shkrim të titulluem "Nji grishje", prej shtyllave të së përkohshmes Fryma, përpiqej në fillim të vitit 1944 me hulumtue arsyen e mungesës së femnave dhe vërente: "Na duhet të kemi besim në gruen shqiptare. Ajo përban gjysmen e forcave tona. (...) intelektualja jonë – n'ato sprova të paka që ka kalue – ka dëshmue se në vija të përgjithëta ka po atë zotsi mendore e po aq asnjanësi gjykimi në rrahjet e problemeve sa edhe intelektuai i ynë. (...) Psherëtima dëshirore «Ah, sikur t'isha djalë» nuk ka vend. Grueja e jonë pikërisht tue ngelë grue, duhet të kryejë barrën e vet

1 Shih: M. Kokalari, *Vepra, vëll. II*, Geer, Tiranë 2009, f. 402.

2 M. Kokalari, *La mia vita universitaria. Memorie di una scrittrice albanese nella Roma fascista* (1937-1941), a cura di Simonetta Ceglie e Mauro Geraci, con un saggio di Visar Zhiti, Viella, Roma 2016. Në vijim citohet: M. Kokalari tue pasue numri i faqes, të gjitha përkthimet këtu janë të mijat (A.N.). Shih edhe recensionin e M. Bova botue në: "Shêjzat", 2016, 3-4, f. 231-233

3 Shih. Kadare, *Mëngjeset në Kafe Rostand,* Onufri, Tiranë 2014, f. 123 vijim

shoqnore".[4] Nji libër si "Jeta ime universitare" e M. Kokalarit edhe mbas gati tetë dekadash mbasi asht shkrue, mbetë i pashoq në lpizat e bibliotekës sonë ideale. Duhet thanë se mbas lufte pati nji vrull emancipues, sadoqëi ideologjizuem dhe jo i lirë, me qindra vajza të reja studiuen në vendet e demokracive lindore, por me sa di un, nuk kemi asnji dëshmi të shkrueme të përjetimeve, mbresave, andrrave të tyne. Prej tyne, në sensin e masipërm nuk ka mbetë asgja, dhe asht nji mëkat i madh. Prej shekullit të kaluem mbetë vetëm ky shkrim femnor i Musine Kokalarit.

Takimi me modernitetin

Musine Kokalari kalon prej rrugëve me mure të nalta që rrethojnë shtëpitë-kështjella të Gjirokastrës, nepërmjet Tiranës që po shndërrohej nga nji qendër e banueme me qerpiç në nji kryeqytet, në nji metropol modern si Roma, ku ndiheshin tashma shtysat futuriste të revolucionit fashist që në 15 vjet ishte mundue me i vu vulën e vet atij qyteti.

Për Musinenë gjithçka ndodh shpejt e pa ndërmjetësime. Moderniteti përjetohet prej saj si nji traumë e shkaktueme kryesisht prej kapërcimit të përmasave të pranueshme të botës. Prej mureve të nalta e oborreve të ngushta në rrugën e gjana me ndërtesa monumentale. Dy mendësi të kundërta që kanë pjellë dy qytetnime krejt larg prej njeni-tjetrit. E gjithë kjo mund të quhet nji "salto mortale" pa rryp sigurie, që e ban të pakuptueshëm modernitetin, pikërisht pse Musinesë i mungon nji prototip i tij.

Ky konfrontim dialektik gjen shprehjen e vet në shpirtin e Musinesë e cila shfaq parehatinë e saj në dimensionin modern të shoqnisë perëndimore. Por kritika dhe mungesa e ambjentimit tek ajo nuk janë rrjedhojë e lidhjeve me nji botë tjetër, mos të harrojmë se kishte lindë me 10 shkurt 1917 në Adana të Turqisë. Mosbesimi i saj vjen prej idesë së paplotnisë së modernes, dhe asht fjala për nji distancë fillimisht instinktive që ma vonë merr trajta tjera, por

4 Q. Draçini, "Nji grishje", në "Fryma", n. 1, janar 1944, f. 15-16

ndërkaq ishte shfaqë në mënyrë të pavetëdijshme edhe në sprovat e saja të para letrare.

Në fakt nuk asht e vetmja shkrimtare e asaj kohe që kthen kryet kah e kaluemja me nji sens malli, nji Sehnsucht romantike që përmallet para pamjeve të nji bote që po perëndon tepër shpejt tue krijue zbraztina të rrezikshme, në të çamet e të cilave vetvetijshëm futen e zanë rranjë ideologjitë e forta të shekullit të shkurtë, siç e ka quejt historiani britanik Eric Hobsbawm. Ishte krijue nji lloj mode ndër shkrimtarët shqiptarë të viteve '30 me sjell sytë nga misteri i nji bote që po zhgulej me rranjë, nga etnosi, e kaluemja, mjaft me kujtue Koliqin dhe Kutelin, të dy, të shpenguem, krijojnë vizionin plastik të nji bote në perëndim e sipër.

Edhe Musine Kokalari ndjek në mënyrë origjinale ketë drejtim tek libri i saj *Siç më thotë nënua plakë* (1939).

Hans Blumenberg ka legjitimue modernitetin tue u nisë tek autonomia e tij në raport me të kaluemen, e bahet fjalë për autonominë e arsyes moderne kundrejt së vjetrës, asaj që nuk ka ma forcë shpirtnore me qindrue dhe me ushqye nji qytetnim.[5]

Musineja jeton mes dy botësh dhe ndien dis-harmoninë e modernes që ka përshpejtue kohën dhe nuk jep mundsi me mendue të tashmen dhe me përpunue të kaluemen. Koha e mbrendshme e Musinesë asht nji dimension jofizik, që bluen ngadalë e me nji kënaqësi të veçantë, pa i konsumue, eventet e jetës. Kujtojmë fjalët e plakave, që kur u kërkonte kangë popullore i gjegjeshin: "E bekuar bijë, shkon në një shkollë aq të madhe dhe mbledh e shkruan këto budallalleqe".[6]

Asht kënaqësi me u ulë në nji kand e me ndigjue, shkruen Musineja, bisedat e thjeshta të plakave, gjuhën e tyne të pasun.

Vetë kundërvumja mes shqisës së ndigjimit me shikimin, që asht tipike e bashkëkohësisë, tregon se nga anon Musineja si përshpirtni dhe si formim, në ketë sens ajo asht anti-revolucionare par excellence, tue mbetë thjesht dhe mjaftueshmënisht shkrimtare.

---

5 Shih: H. Blumenberg, C. Schmitt, *L'enigma della modernità. Epistolario 1971-1978 e altri scritti,* Laterza, Bari-Roma 2012

6 M. Kokalari, f. 130

Edhe vetë raporti delikat sentimental i saji me djalin italian që njeh në Romë, asht i shenjuem randshëm prej dialektikës mes modernes dhe primitives. Musineja akuzohet prej tij se ka mbetë mbrapa, se asht primitive[7], gjithë këto akuza që problematizojnë në mënyrë të gabueme shpirtin romantik dhe skofiar të vajzës shqiptare, e çojnë Musinenë drejt nji nihilizmi, kur shpërthen e zhgënjyeme: "Unë që nuk kam gjetë asgja të bukur në botën e ashtuquejtun perëndimore nuk kam kuptue kurrë se në çka konsiston qytetnimi, për ketë gja nuk bindesha".[8]

Ai lloj qytetnimi që mtonte me u eksportue me luftë, qytetnim kallp që digjte etapat normale të zhvillimit dhe mundësonte lindjen e nji hibridi të frikshëm siç qe komunizmi shqiptar, nuk e bindte Musinenë:

"Unë e ndieja se kisha mbetë primitive, ajo vajza e rritun në mes të njerzve të vorfën, në nji vend të vogël me rrugë të shtrembta, me kopshte të rrethueme me mure; mes kangëve që kumbojnë si ankime dhe qamjeve të grave, nën nji qiell gri. Shpirti jem kishte mbetë ashtu e nuk mund të binte dakord me nji shpirt të qytetnuem e tejet modern".[9]

Diçka të përafërt ajo e gjen në lagjet periferike e popullore të Romës, mes njerzve të thjeshtë që duket se i kanë shpëtue retorikës rrafshuese të regjimit:

"Këtu jetohet nji jetë e thjeshtë dhe e natyrshme. Këtu njerzit flasin, qeshin pa u mundue me mshehë vetveten. Askush nuk preokupohet se të tjerët po e shohin e kështu vijojnë me jetue larg zhurmave të qendrës. E gjithë kjo asht e shëmtueme, por ka bukurinë e spontaneitetit dhe të sinqeritetit".[10]

7 M. Kokalari, f. 155
8 M. Kokalari, f. 174
9 M. Kokalari, f. 187
10 M. Kokalari, f. 197

Ankthi i pafajnisë

Vitet universitare të jetës së Musine Kokalarit përshkohen prej nji ankthi ekzistencial të kuptueshëm për moshën dhe vetë strukturën e saj shpirtnore, por të pazakontë përsa i përket shtysave dhe implikimeve që ka. Tue huazua nji term të S. Kierkegaard-it mund ta quej "ankthi i pafajnisë", ai që gozhdon shpeshherë vajzën shqiptare përpara të panjohunave të botës.

Ajo vetë rrëfen sesi e vogël "shpeshherë pyesja veten nëse nana jeme më donte me të vërtetë dhe sinqerisht. Fillimisht më bezdisnin deri edhe përkujdesjet e saja dhe e shihja me dyshim".[11]

Thellësia e mbrendshme e pozicionon Musinenë në kufijtë e normalitetit, as djemtë, as shoqet, as universiteti, as zhurmat dhe zbavitjet, as madhështia kallpe perandorake e vendit ku studion nuk ia mbushin shpirtin. Ajo asht në kërkim, dhe ajo çka ka gjetë deri në at' çast asht e përshkrueme me "bojën e malinkonisë" (J. Starobinskij).

Shetitjet e saja janë të shoqnueme me shi dhe me gjeth të ramë bri çinarëve të Nomentanës, gjithkund i rrin pranë vetmia, njifarë spleeni përziem me kureshtje e mosbesim, kudo e shoqnon lirizmi i vetmisë (G. Lukács), pararendës i nji shtërngate epike që e pret në kthesen e papritun të jetës së saj.

Nuk ka asnji peshë që e mundon, por ka vetëm ankthin e humbjes së lirisë, të cilën e çmon edhe ma shumë se vetë dashninë. Misteri i qenjes së saj ruhet edhe përmes heshtjes, e mundojnë pyetjet dhe s'i pëlqen të zhvishet prej detajeve që ruen me xhelozi. E tremb banaliteti i të qenit e gatshme me komunikue me za dhe me figurë. Preferon heshtjen dhe gjykon ma domethanëse pauzat sesa fjalët boshe. Kjo gja e përplas me të "fejuemin", i cili kërkon me ngulm me ndie e me ri-ndie fjalën "të due", ndërsa për Musinenë regjistrat e shpirtit nuk mund të bahen pre e së përditshmes:

"Më dukej e çuditshme që ai të më pyeste shpesh nëse vërtetë e doja fort dhe ankohej rreth heshtjes teme rreth kësaj pike", e vijon: "Me gjithë këto e me të tjera pyetje më dukej se gati po humbja lirinë teme".[12]

11 M. Kokalari, f. 188
12 M. Kokalari, f. 155-156

Përmasat e botës – tëhuajzimi (Entäußerung)

Musine Kokalari e kujtimeve universitare asht nji e re së cilës bota i asht mbytë në hapsinat e pafunda të nji universi kompleks. Nji luftë e mbrendshme e shoqnon në çdo gja me randësi që don me ba.Vetmia asht për te streha ma e dashtun, mbas ndamjes dhe mbas zhgënjimeve që i shkaktojnë shoqet, ajo shkruen: "Vetmia më ndihmoi shumë e për herë të parë në jetë e ndiejshe veten të pamvarun dhe të lumtun" e vijon: "Nuk duhet me shikue jashtë, por mbrenda vetes. E tue u mbyllë në vetvete ndieja nji ambëlsi të paspjegueshme për shkak të heshtjes së saj që më jepte kënaqësi".[13]

Introspekcioni augustinian e mbron Musinenë nga shumësia e gjanave, heshtja kthehet në nji terapi për nji kohë kur fjalët pa vlerë të barabarta me zhurmat janë kthye në rregull jetet, në këto kushte heshtja dhe vetmia e drejtojnë tek uniciteti i qenjes.

Ajo mbetë e tëhuejun prej vendit ku jeton, e ai tëhuajzim gjeneron tek ajo nji proces ndenjash unike.Vlen për të çka asht thanë me të drejtë për bashkëkohëset e saja që patën nji fat pak a shumë të ngjashëm, si Edith Stein, Simone Weil, Etty Hillesum, Musine Kokalari ka nji zemër që mendon, që përçanson mendime që krenat racional apo instrumental që e rrethojnë, nuk i kuptojnë.

Ky shpirt i bukur ka zgjedhë rrugën heroike të vetmisë për me zbulue vetveten e për me qenë vetvetja. Ai shteg nuk ka me ia kursye vuejtjet dhe poshtnimet.Realizmi tek ajo pështjellet shpesh me nji vel nihilizmit të pafuqishëm. Vëren Musineja:

"Asgja nuk zgjat në përjetsi. Pemët lulzojnë, por jo gjithmonë. Ditët zgjaten dhe shkurtohen, ndërsa dielli shkëlqen fort e mandej në dimën zehet prej reve. Edhe hana del e re e mandej perëndon. Kështu edhe jeta e njeriut: lindet, piqet, vdes; e të tjerë vijnë mbas nesh. Çdo vit i jetës sonë që kalon nuk kthehet ma kurrë, si petalet e drandofilleve që era tretë me vete e prej tyne s'mbetë asgja veç pluhni. Vetëm natyra asht e përjetshme me format e saja të llojllojshme. Edhe eksperienca jonë nuk asht tjetër veçse ecja e botës dhe progresi i kohës".[14]

13 M. Kokalari, f. 192
14 M. Kokalari, f. 131

Duket se kemi të bajmë me nji paragraf me reminishenca sa spinoziane aq edhe nietzscheane, e tue mos qenë të sigurt që zonjusha shqiptare t'i ketë lexue ata autorë, aq ma e naltë asht stima jonë për nji shpirt që distilon mendime të këtilla, sado të papranueshme në pesimizmin e tyne.

Mbasi ka prekë me dorë vuejtjen dhe ka pa vdekjen tue i kalue pranë afër nënkrejcave të spitalit San Giacomo në Romë, ku,në pranverën e vitit 1939, shkonte me i ndejt afër kushrinit që po vdiste, Musineja shkruen: "ulesha në shkallaret e Piazza del Popolo e pyesja vetveten "çka asht jeta? Pse e gjithë kjo dëshirë me jetue? Me jetue gjithmonë? Për ketë arsye durojmë aq shumë dhimbje, edhe tue e dijtë se nji ditë kemi me vdekë njilloj?" Pyetje pa përgjegje".[15]

Homologimi universitar

Asht e dijtun se nën diktaturë sistemi arsimor dhe ai edukativ tenton në mënyrë organike me homologue mendjet dhe zemrat e njerzve, sidomos të atyne që janë të pambrojtun, pa imunitet dhe shpirt kritik. Këtë gja ka ba fashizmi, e tek ne këtë gja e ka ba me mjete edhe ma të dhunshme komunizmi. Sidomos fillimet e studimeve universitare në Romë, përbajnë për Musinenë nji vuejtje të veçantë. Ajo me intuitë ndjen mungesat kryesore të sistemit të atëhershëm: mungesën e unitetit të dijes, kaosin e organizuem në mënyrë burokratike, madhshtinë e neveritshme të profesorave dhe distancën e dijes që ata shpërndajnë prej nevojave dhe pyetjeve thelbsore të studentave që kanë përpara.

Vështirsitë me latinishten, me landët që kanë të bajnë me besimin e krishtenë, largësia e profesorave dhe indoktrinimi i tyne, ia velin ende pa nisë studimet universitare. Disa prej oroenave të M. Kokalarit rreth shkollës, edukimit universitar, të kujtojnë konferencat e vitit 1872 të F. Nietzsche-s. Shkolla synon standardizimin e mendjeve dhe ideve, mediokriteti kthehet në idhull dhe ajo që tejkalon kategoritë e pranueshme të sistemit nuk përkrahet dhe nuk mbështetet.

15 M. Kokalari, f. 140

E bukura

Atë që Musinesë nuk mbërrijnë me ia dhanë shoqet, i dashtuni, leksionet universitare, ideologjitë e shekullit XX, jeta në nji metropol të madh modern, ia fal vetëm gjurmimi i së bukurës. Bahet fjalë për të bukurën artistike dhe jo natyrore.

Në Romë, kishat, rrënojat antike, muzeumet, vorrezat monumentale kthehen në vendtakime të përhershme të Musinesë me vetveten.

Ndërsa viziton amfiteatrin Flavio, të njohtun si Koloseu, ajo vëren madhshtinë e botës romake të gërshetueme me linearitetin dhe thjeshtësinë e stilit, mediton mbi vetëdijen e atij populli për me veprue ma thellë se popujt tjerë në historidhe me fitue.[16]

Vizita në muzeun prehistorik i ndjell mendimin e rrugës që ka përshkue njerzimi, mundit që i asht dashtë me mbërrijt ku jemi. Tek arti etrusk në Villa Giulia e tërheq sarkofagu i çiftittë shtrimë në triklinium në banketin e përjetshëm. Fori romak i jep idenë e hapsinës, origjinalitetit dhe fuqisë së Romës antike. "Atje ku dikur ziente jeta politike e ndiheshin hapat e randë të ushtarëve, sot mbizotnon heshtja" – vëren studentja shqiptare. Vizita në bazilikën e Shën Pjetrit në Vatikan i len përshtypjen e madhshtisë së vendit dhe të vogëlsisë njerzore. Gjatë vizitës në Muzeumet e Vatikanit rrëfen: "Tue pa ato monumente e ato thesare që janë ma të bukurat në botë, kisha mbetë e mrekullueme e më dukej se më kishte rrëmbye nji forcë misterioze".[17]

Mandej viziton kishat Santa Maria Maggiore, Santa Costanza, Santo Stefano Rotondo, Chiesa del Gesù, ku ndien me andje organon, shqyrton me interes matroneun e kishës së Sant'Agnese, mozaikun e kybes së Santa Pudenziana.

Shkruen Musineja:

"Hyja në kishën "Santa Maria degli Angeli". Ulesha në nji kand dhe pushoja në paqë, në nji gjendje lumnije, sidomos në mbramje kur

16 M. Kokalari, f. 118
17 M. Kokalari, f. 121

kisha asht plot me hije dhe me zane skofiare të bardha që këndojnë vesprin. (...) Ndonjiherë jam ulë e vetme, gati e përhumbun në nji kand, mes kolonave. Nën dritën e zbehtë nisja me lexue. Rreshtat e cilitdo libër edhe pa randësi, marrin nji ton solemn. Në nji moment nuk kuptoja ma asgja prej asaj që lexoja, pse shpirti ishte i rrëmbyem prej mendimesh tjera ma të thella. Asht kaq bukur me qenë vetëm, vërtetë vetëm e me tretë në mendime e mos me dallue atë çka të rrethon, me ndie pa vemendje, me mbyllë sytë si me dashtë me fjetë por me qenë zgjuet... me andrrue. Çka? Nuk mund të përçansohet! Asht shpirti që përflaket prej meditimit të shembëlltyrave hyjnore e kështu sublimohet. Asht ndenja që mbizotnon e nuk mund t'i japin llogari arsyes".[18]

Shkrim grueje në histori

Kemi nevojë me pa sesi e shohin botën, jetën, artin gratë shqiptare. Jo për nji diskriminim banal pozitiv, por pse shumë shpesh ato tregojnë se janë ma të vemendshme e të ndieshme ndaj së bukurës.

Asht prilli i vitit 1939 kur trupat italiane pushtojnë Shqipninë:

"Me 7 prill kah mesdita hynë në Tiranë trupat italiane. Menjiherë qyteti u mbush mizë në kërcu. Nji gjuhë e huej ndihej nepër rrugë e hapat e ushtarëve e zhurmat e motorave dhe kamionave".[19]

Papritë, Musineja, që edhe këto rreshta i shkruen italisht, identifikohet me të gjithë ata që e ndiejnë të huej gjuhën e pushtuesit. Kundërvumja mes dy botëve ka marrë nji formë që përfshin edhe kulturën e pushtuesit. Musineja asht nji grue të cilën tallazet e jetës e kanë shkapetë pa mëshirë deri në fund. Ajo e saja mbetë nji jetë pa relacione domethanëse, megjithatë nuk asht nji jetë e bame me monologje dështimesh, asht nji soliloquium i tanë, nji dëshmi e vetvetes me vetveten, e fitores së pafuqishmes përballë forcës bruto. Musine Kokalari përfaqson mendimin filozofik të mishnuem, idealin e dëshmuem me vetëdije, për ketë arsye ajo mbetet nji figurë e veçueme në historinë tonë të shekullit XX.

18 M. Kokalari, f. 167
19 M. Kokalari, f. 141

Prof. Dr. Dhurata Shehri

Universiteti i Tiranës

Musine Kokalari: Vetëdija e shkrimit

Më 1940, pak pas botimit të vëllimit me tregime *Siç më thotë nënua plakë* Lasgush Poradeci, në revistën "Bota e re" do ta përkufizonte origjinale veprën e zonjushës Kokalari, "Zënia e jetës, kapja e saj në fond dhe në formë dhe faqja imediate, pa asnjë ndërmjetësim, me anën e artit, kjo është origjinalitet, origjinalitet letrar"[1]. Në këtë inagurim të shkrimit të reales që ka njohur pak apo aspak shkrimtarë në shqip, Lasgush Poradeci shënon piketën e parë të kënaqësisë së tekstit për t'u vetërrëfyer, sikur jeta të jetë duke ndodhur përpara syve tanë, pa subjekt shkrues. Pohojmë kështu bashkë me të, një shkrim që e vetëasgjeson subjektin, paradoksalisht duke e krijuar atë në shkallën më të lartë, jo si stil, as si gjuhë po thjeshtë e vetëm si subjekt shkrimi.

Pikërisht kjo vetëdije e shkrimit na e krijon së brendshmi subjektin e vet, Kokalarin, jo siç duket në sytë e bashkëkohësve a tanët, në kujtimet e miqve a armiqve të vet, jo siç shfaqet në dokumente a komente, po thjesht e vetëm në shkrimin e vet, në vetëdijen për shkrimin e vet që themelon identitetin e saj formal si shkrim-tare,

1 Lasgush Poradeci, në "Bota e re", nr. 1, 30 korrik 1940

por edhe moralin e ligjërimit sepse "s'ka letërsi pa moral të ligjërimit" – shkruan Barthes[2].

Ajo duket në këtë shkrim si: Themeluese e subjektit të shkrimit të vet. Zhbulimi i vetvetes në shkrim përballë tjetrit, si formë identitare e shkrim-tares myslimane përballë katolikëve (te *Jeta ime universitare*), e shkrim-tares shqiptare përballë të huajve, e shkrimtares grua përballë burrave (te *Siç më thotë nënua plakë*, *Sa u tund jeta* dhe skicat e poezitë e botuara në vitet 1937-38), e shkrim-tares së rritur përballë të vegjëlve (te *Rreth vatrës*), e shkrim-tares së fortë përballë të dobtëve (te *Si u formua Partia socialdemokrate*). Pikërisht përmes këtij procedimi Kokalari themelon identitetin formal të shkrimit të vet si themelim i vetë individit shkrim-tar, i kujtesës, i të shkuarës e i të ardhmes së vet brenda shkrimit. Në këtë mënyrë ajo i krijon, i paraqet dhe i fton të krijohen lexuesit e vet të ardhshëm duke e bërë vetë e para aktin e leximit si krijim tek studimi për Naim Frashërin, tema e saj e diplomimit në Itali. Në këtë tekst ndjehet tendencioziteti i shkrimtares politikane që e lexon Naimin më shumë si subjekt politik, mistik, edukator e fetar sesa si poet estetikisht pa të sharë. "Janë të pakta ato poezi të cilave nuk mund t'i kundërshtosh asgjë nga ana estetike"[3] – shkruan Kokalari. Udhëtimi i saj shkrimor me ndalesa historike e gjeografike që vetëm pikënisje ka jetën e veprën e Naim Frashërit është më shumë një udhëtim në viset e panjohura të vetvetes, që për t'u kryer kërkon vetminë si çlirim e si kusht. Kujtojmë se vepra është shkruar në italisht, tjetër gjuhë a "horizont". Nga ky shkrim i hershëm në gjuhë të huaj, hetojmë një tjetër përmasë të shkrimit të Kokalarit, gjurmë të "vertikalitetit" të stilit të saj:

Vetminë si liri. Gjurmët e mënyrës si e jetoi jetën e vet, si i përballoi brengat e tmerrin i gjejmë në tekstet e saj të hershme, sidomos tek autobiografia e shkruar në italisht. Në veprën *Jeta ime universitare* Kokalari shkruan: "Shpirti ka nevojë për vetminë për të qenë i lirë

2 Roland Barthes, *Aventura semiologjike*, Dukagjini, Pejë, 2008, f. 73
3 Musine Kokalari, *Vepra, Vëllimi I*, Geer, Tiranë, 2009, f. 329

e i pranishëm" [4] - duke nisur e shpallur në shkrim një udhëtim në brendësi të vetes si rast për t'u habitur e zbuluar veten e botën si pjesë e vetes. Kjo rrugë e nisur në shkrim do të vazhdojë a prodhojë lirinë si kusht e kufi të subjektit shkrues, Musine Kokalari e cila si shkrimtare jetoi dhe vdiq e lirë, lirinë që e fitoi dhe përmes shkrimit të vet: "Ne e kërkojmë lirinë jashtë vetes, ndërkohë që ajo është brenda nesh"[5] – shkruan ajo. Zbulimin e madh të vetvetes, formën e shkrimit të saj, ajo na e ofron si mundësi shpëtimi edhe neve sot për të qenë të aftë "të mjaftohemi me veten" me kushtin që ta themelojmë së pari atë.

Përmasa e shkrimit si kujtesë e sublimim zë vend të madh në ndërtimin e identitetit të saj si subjekt formal. Ajo sublimon gjithçka, por vetëm tri momente të reales nuk arrin t'i sublimojë në shkrim, pushtimin e Shqipërisë, kur ndodhej në Romë dhe shkruante *Jeta ime universitare* dhe pushkatimin e të dy vëllezërve. "Dhimja e thellë është gjithnjë e heshtur: më shumë ndjehet e më pak di ta përshkruash"[6] – na paralajmëron Kokalari që herët. Shkrimi këtu tregon vetëm prani, nuk shtyhet dot më tej, përpëlitet mes të pashprehshmes duke ia dalë vetëm të pohojë se: "Njeriu është qenie mizantrope dhe xheloz i vetvetes." Akti i njohjes së kufinjve nuk e mban peshën e dhimbjes, por na e kalon pa ndërmejtësim, për ta njohur e përtypur ne e shumë breza lexuesish më pas, ngadalë.

Shkrimi i Kokalarit nuk e kapërcen cakun e erotikës. Ajo nuk e merr përsipër ta shkruajë erotizmin, as te shkrimi autobiografik *Jeta ime universitare*, por edhe një herë na e kalon pandërmjetshëm si një copëz realiteti të sublimuar në këngë. Në librin *Sa u tund jeta*, shkruhet e përshkruhet një dasëm, një akt thellësisht intim që forcën e merr nga publikja, nga shpallja e shfaqja, nga kontrata me të huajin që do të bëhet "yti", kontratë që garantohet nga shoqëria. Por, paradoksalisht, janë të tjerët, shoqëria, kolektiviteti që e mbartin edhe erotizmin e munguar në shkrim. Kolektiviteti anonim e këndon erotizmin, si një të shkuar kolektive e anonime. Me kalimin e faqeve, lexuesi pret

4 Musine Kokalari, po aty, f. 345-6
5 Po aty, f. 423
6 Po aty, f. 416

më në fund të vijë nata para martesës, kur nëna e pregatit të bijën për natën e parë me burrin, por çuditshëm, nëna e këshillon vjazën që do të bëhet grua si të sillet me njerëzit e tjerë që do të gjejë në shtëpinë e re, me vjehrrën dhe vjehrrin, e jo me mashkullin. Kalojnë sërish faqe e ndërsa dëgjon plot këngë me erotizëm, herë të fshehur e herë të shfaqur, mungon ai, kulmi i dasmës, nata e parë e martesës. Gjithsesi, *Sa u tund jeta* mbetet dasma më e bukur e letërsisë shqipe, ndoshta sepse e fiksuar në shkrim ajo nuk do të ishte asnjëherë dasma e saj, por mbetet edhe sot dasma jonë, një dasëm kryekëput femërore. Shkrimi bëhet kështu fiksion i të shkuarës për t'u jetuar si e ardhmja e së shkuarës. Pikërisht kjo dasëm, "teatri i lojës së intimes me kolektiven", është edhe "dasma e dialektit".

Dialekti është një nga shenjat dalluese më të dukshme të shkrimit të Musine Kokalarit. Marrëdhënia e dialektit me idiolektin vërehet në kritikat e Poradecit, Kutelit, Lambercit, Rugovës etj. Letërsia e saj bëhet vend takimi i dialektit me: vendin (si provë e vështirësisë ose pamundësisë për t'u ndarë nga vendi i origjinës, por edhe si dëshmi e distancës me të); vend takim me fëmijërinë (që ndjehet sidomos te *Rreth vatrës* dhe *Siç më thotë nënua plakë*); vendtakim me shtëpinë (sidomos te *Sa u tund jeta*). Por ndjehet se sot marrëdhënia e dialektit me idiolektin në shkrimin e Kokalarit ka ndërruar status receptimi. Dikur ajo ndjehej si e natyrshmja e freskët, si gjuha e shtëpisë që i rrinte përballë të kutivuarës letrare. Sot ajo është gjuhë libri, gjuhë kulture, të paktën për lexuesit.

Roland Barthes, në veprën e tij të famshme *Kënaqësia e tekstit* dallon qartësisht tekstet e kënaqësisë nga tekstet e shijimit. I pari, teksti i kënaqësisë vjen prej kulturës dhe nuk krijon çarje me të, të kënaq e të jep eufori, ndërsa teksti për t'u shijuar të trondit sepse krijon një gjendje humbjeje, subjekti e humb vetëdijen e unit të vet. Kënaqësia është e thënëshme, e shqiptueshme, shijimi i pathënshëm, kuptohet vetëm përmes rreshtave[7]. Veprat e Musine Kokalarit i takojnë kësaj kategorisë së dytë, ku siç shprehet edhe ajo vetë, mbizotëron "e

7 Roland Barthes, *Variazioni sulla scrittura seguito da Il piacere del testo*, Biblioteca Einaudi, Torino, 1999, f. 47

pashprehshmja me fjalë, ky është parimi i vërtetë i sekretit"[8]- mes tekstit e lexuesit.

Duke ndarë këtë sekret me të, ne, lexuesit e sotëm, i japim jetë heshtjes që la pas shkrimi i saj, e gjatë dhe e rëndë, si shkrimi që e prodhoi për të ardhmen duke na mësuar, pak, aq pak sa i duhet njeriut për të jetuar me dinjitet, si Musineja:

"të jemi të aftë të mjaftohemi me veten"[9].

8 Musine Kokalari, vep. cit. f. 361
9 Po aty, f. 423

Dr. Kujtim Rrahmani

Instituti Albanologjik - Prishtinë

Musine Kokalari: hi e hir i një fustani

Zëra Fustani

E deshi fustanin orëprera. Jo po, e deshi fustani korpin dhe frymën e saj.

Fustani i Musine Kokalarit është i prerë mbi yrnekun psikofilozofik e korporal që rri mes seriozes e ceremoniales dhe ludikes, mes mendimtares e emocionales, mes sensus communis dhe personales e intimes, duke thirrur misterin, pikësëpari, dhe duke bërë çapin pastaj kah sensualja. A ishte për Musinenë shija për pëlhurën mbi trup një shqisë poetike? Po politike? Dhe, a e la nën hije e zeza e fortë e mendimit serioz ludiken e ornamentit në fustanin të saj? Ose edhe - si fliste lehtë-e-but'me jetën e me vdekjen, si mister e si sensualitet, fustani i saj? Cilat ishin trajtat antropoetike të këtij komunikimi? Në tregimin Si është jeta...!, ajo rrëfen me tone autosituate takimin e saj të fundit me Sotir Kolean, në sahat deke. Vizitës së saj shumë të dëshiruar, ai i qe përgjigjur:

"Mos më eja prapë moj zonjëzë. Nuk dua që të shikosh gjëra të këqija. Ti jo, je një lule - vetëm gjëra të bukura. Një herë mjafton - po doja të të shihja para se të vdisja".

Sotiri deshi ta kursente Musinenë veçse nuk e mposhti joshjen humane që të mbyllte sytë me pamjen e Musinesë - njeriut Musine. „Doja të të shihja para se të vdisja", i tha. E mori me vete një copë cohe nga fustani i Musinesë dhe mbylli sytë. I mjaftoi një copë Musine për ta pasur të lehtë takimin me vdekjen. Musineja ishte tablloja serioze që të evokonte përherë ludiken dhe ludikja që s'e harronte kurrë seriozen. Një amalgam, në shikim të parë, i përsosur, i këtyre polariteteve por që, po të provohet të vihen në kandar, pamja mendimtare duket sikur e bën atë paksa hijerëndë dhe ludikja mbetet vetëm fije që mund të kapet po pate shqisë ta gjesh, ndonëse ajo është gjithnjë aty, disi diskrete.

Edhe vetë vdekja e saj dhe përcjellja funerale qe e tillë. Fustani i bardhë, funeral, i dëshiruar, do t'i japë kuptim personal, ceremonial, ditës së fundit mbi dhé, por për ne do të hapë edhe dialogun e saj me botën, me jetën, me letrat shqipe e me politikën shqiptare.

E bardha me të zezë qe zgjedhja e hershme e kombinimit të misterit të petkave të saj. (Them se nuk mund të mashtrojë kushedisa për këtë fotografia bardh-e-zi). Nuri i mortit që vinte nga e zeza dhe nuri i hirtë, gracioz, që buronte nga e bardha, shkrihej në një miksturë bipolare ku e zeza mbetej tokësorja dhe e bardha qiellorja. Të tjerat vinin si dritëhije polesh. Nëse misteri i vetmisë ka për kushërirë të zezën, mendimi i Musinesë pati koloritin e të zezës, në këtë kuptim, përderisa, përvojat tjera të saj, të nxitura nga ludikja e dalë nga e bardha, dhanë fuqinë e përjetimit. Mendimi i saj i zi u shkri dhe kaulifikua në përjetime të bardha.

Teksa po lëshonte shtat, fustani i saj erdhi duke u qëndisur e strukturuar, në prerje e në ngjyrë, në linja të forta e në ornamente. Ojat e bardha e deshën fustanin e saj dhe dhanë ludiken e sensualen sado

që linjat bazike mbetën të mbitheksuara me të zezë, si kufinj frontalë. Floku i butë e i shtruar, i ndarë gati gjithnjë më dysh, i jepte fustanit të saj ton të pjekur; një çupëlinë e bukur dhe e pjekur njëkohësisht, një gocë e një zonjë e pjekur bukurisht, një format mendimtareje me shpirt poeteje.

Fustan domethënë pushtet; pushtet domethënë fustan. Ndryshe nga pantallonat që gjenerojnë sensualitet e seksualitet në rend të parë, fustani gjeneron erotikë misteri. Pushteti i misterit sundon gjatë e fort; ai i pantallonave sundon me më epshndjellje por më sipërfaqësisht; fustani ka dozim poetik më të fortë vertikal të errësirës dhe gjeneron frymë, pantallonat gjenerojnë poetikë korporale me bazë epshi; estetika e errësirës rri përballë estetikës së dritës, pa harruar zonën e tyre të ndërmjetme. Ehoja e frymës te pantallonat rrjedh më me përtesë sikur që jehona sensuale e seksuale e fustanit rrjedh dalemengadalë dhe dozohet nga pushteti i lartë i misterit. Fundja, pushteti fshehet në kindet e misterit. Tërë këtë e pohon edhe figura e Musine Kokalarit. Pushteti i fustanit të saj funeral (këndej i bardhë - përndryshe i zi) mbetet vetëm simbolik. Pushteti i fustanit të saj gjatë tërë jetës, si gocë e si zonjë, ishte fare evident. Ky pushtet nis nga misteri i erotikës korporale e psikologjike, del te erotika e mendimit e shkrimit dhe merr formë edhe si pushtet etik e politik. Gjithnjë me bazë të zezën e ornament ludik të bardhën.

Nga fotografitë e saj të hershme, deri te ajo në gjyq; nga mënyra se si i rrinte fustani, Musineja mund të quhej zonja me fustan. Edhe po të ishte pa fustan, dikur, edhe po të ishte lakuriq, ajo ishte zonja me fustan. Që në ditë të hershme, fustani për të nuk qe vetëm erosi, hiri, graciozja dhe femininiteti; ai ishte bërë me kohë edhe iluzioni i hinit, varrimit, solemnitetit final, i lidhjes me traditën, hije e mendimit. Si burim eroticiteti, mendimi, moraliteti, ornamenti a dinjiteti, ai po rrezatonte ngrohtësi feminine, poetike dhe, po ashtu, energji politike e frymë karakteri.

Kjo kapet lehtë po t'u hidhet një sy fotove të saj të hershme, si ajo me fustan a kostum të zi shoqëruar me shall e këpucë me lara, me taka, nga ditët e studimeve në Itali. Marrëdhënia e larave mbi këpucë me shallin dhe me të zezën bazike, en gros, të kostumeve dhe shtrëngimin e ngrohtë të fëmijës nga krahu jep, sa graciozen po aq edhe emocionin, për të dalë së fundit te stili i saj; te duka korporale si gjuhë e stil, po edhe si mendim, që bëhet ésprit dhe që shfaqet edhe në tekstet e saj, në përshkrime situatash e personazhesh.

Megjithatë, ajo që në staturën e veshjes së saj del si ornamentale, ta zëmë elementi i këpucëve me lara apo ai i shallit, kur kthehet në gjuhë teksti, shfaq synime të bëhet vërshuese dhe shpesh e kalon seriozen në prapavijë, si një hije që identifikohet me idetë, me mentalitetin po edhe me zhanrin. Ngjyrat e forta bazike, zi e bardh, të rrobave, të sforcuara a hijezuara nga kombinimet e larave në këpucë, në ndonjë shall apo aksesor e bizhuteri të rastit, marrin kështu nuanca ngjyrash lojcake, lozonjare, në stil shkrimi, duke u përafruar shpesh me ngjyrime gjuhe të rrëfimeve gojore që janë edhe ngjyresa multikolore nga fustanellat, xhubletat e këmishat tradicionale.

Në këtë pikë, nuk mund të mos shtrohet pyetja: a thua, ornamentalja, si element i prodhuar nga marrëdhënia e lojës me strukturat serioze psikologjike është më thellë se seriozja në veshjen e saj dhe rri si sfond që rrezaton mbi kostumin njëngjyrësh të zi a të bardhë, apo ngjyrat bazike serioze janë më të thella në stilin e shkrimit të saj sa hedhin dritë të përthyer në sipërfaqe si kombinim i ngjyrave të lehta!? Për këtë flet tregimi i saj si ide e si gjuhë, por le t'i kthehemi profilit të Musinesë në milieun e saj personal që kullohet si hapësirë fizike e poetike mes milieut të atëbotshëm shqiptar me polaritet oriental që shpesh kastron idetë dhe çorodit stilin, në njërën anë, dhe milieut oksidental që stimulon idetë dhe lajkaton apo edhe e lazdron stilin, në anë tjetër.

Shqipëria e mbuluar me ferexhe orientale e cila e reduktonte bazën emotive dhe intelektuale në një mentalitet otoman, e kishte jo të lehtë të njihte një fustan oksidental dhe një shije veshjeje që njihte thyerjet e fuqishme të disenjit të mëndafshit madje duke përfshirë në këto përthyerje prerje e elemente tradicionale, popullore, si një kombinim të modernes e popullores. Prandaj dhe u pa Musineja si një bukuri e huaj; ishte rast i rrallë kur një vashë e re, një grua, në ambiente të tilla t'ia dilte të sfidonte botën me gjuhën poetike të petkave, si kod korporal dhe individual, që jepte aq spontanisht botën e saj, të petkave që jepte sharm të zi, hijerëndë, evropian, dhe sharm koloriti lokal; që manifestonte vlera intime e publike, njëkohësisht.

Ishte kjo një botë ngjyrash që bëhej edhe erotikë e shkrimit të saj; një traditë rrëfimi dhe një rrëfim tradite, i përshkuar në hell nga një diskurs ornamental shumëngjyrësh; një ide, në shikim të parë e rudimentuar në reprezentim ambiental, por që rikualifikohet përmes gjuhës në një pikëshikim pothuaj autorial. Përmbledhur ndryshe, fustani i saj fizik e letrar jep ngjyrat diverse të Mediterranit në gjuhë letërsie, të përthyera edhe në ngjyresa dhe mimezë mentale. Është kjo pikëprerja antropoetike ku kultura bëhej stil teksti ndërsa karakteri i autores reflektonte idenë. Në të vërtetë, ishte edhe ora e qenies së Musinesë që i jepte rrobës letrare sharmin e graciozes, të pushtetshmes e njerëzores, njëkohësisht. Ishte ky fustani që dinte të fliste e të heshte, të bënte pakt e të ndante miqësi me vetminë, fuqinë dhe mrekullinë e së cilës ajo e njohu si studente në Romë.

Por sa mund të shfaqte fustani i Musinesë marrëdhënien komplekse të jetës së saj me vdekjen, të politikës me estetikën, të intimes me publiken, të erosit me thanatosin? Si rrijnë shkrimi dhe jeta në këtë marrëdhënie? Në ç'masë bëhet erotika e fustanit erotikë shkrimi dhe politika apo etika e fustanit politikë shkrimi? A reflekton e zeza e fustanit të saj ndonjëherë doktrinë?

Duket sikur ajo vetë kishte shqisë të mprehtë për këto transcendenca të petkave në tekst. Madje e nuhaste që pushteti poetik/estetik dhe ai intelektual mund të pushtonte lehtë e butë kufijtë e pushtetit politik. Megjithatë, ajo nuk e bënte këtë intencionalisht, siç do ta bënte një femme fatale. Me sa mund të kuptohet, ajo e përjetonte hirin e veshjes në vetvete dhe nuk e instrumentalizonte qëllimshëm si petk politik, sado që ky hir dhe ora e saj intelektuale-letrare i krijonin rivalë politikë, rivalë që do kthehen në armiq. Sidoqoftë, fustani i saj reflekton moralitet por jo doktrinë, ose fare pak. Doktrinariteti politik te ajo është i treur në sfondin e moralitetit ndaj dhe nuk do të mund të përfundonte kurrë në shpatë ideologjike. Përderisa Musine Kokalari nuk i kishte shpallur luftë kurrfarë grupimi politik në Shqipëri (madje kishte insistuar në koalicion antifashist) armiqësia e gjeneruar ndaj saj dhe e rritur gjer në skaj, sikur kishte burimin në mosdurimin ndaj hirit të fustanit të saj; si shprehje erotike korporale e intelektuale, si shkrim e si jetë, si mendim e si heshtje.

U pa me kohë se pushteti estetik i fustanit derivonte pushtet politik. Prandaj ky fustan nxiti aftësi mobilizuese te rivalët politikë për t'ia ngushtuar në minimum hapësirën publike e cila asaj do t'i jepte pushtet çdo ditë e më të madh, sado që gjithnjë me sfond moral nga mbrapa. Jo rastësisht, ajo veshi fustan të ri, të bardhë, në ditë të zezë, dhe vdiq solemnisht, me librin te koka. Fustani në trup, trupi në fustan, libri në dorë; libri në fustan, fustani në libër, në tekst; duart e lidhura me tel mbi libër e fustan. Me duar të lidhura, për së vdekuri, mbi fustanin e bardhë. Zëri i fustanit të saj ishte i thellë, i butë, shumëngjyrësh në bardhezi-në e vet, bas dhe alegro në të njëjtën kohë.

Vdekja i erdhi si ikje në pension. Fustani i saj dikur e kishte futur në sherr me ideologjitë politike dhe me të zezën sociale e kulturore shqiptare. Politika i ishte hakmarrë tërë jetën; kjo kishte luftuar gjithnjë dhe po i rishpallte luftë asaj sërish, duke i ndenjur karshi me

fustanin e bardhë, si një kërkesë rikualifikimi moral e estetik ndaj saj. Po vazhdonte beteja eternale e etikës e estetikës me ideologjitë politike doktrinare, brutale.

Gjithsesi, fustani i Musinesë kishte përmasa minimale ideologjike: ajo mohon fashizëm e komunizëm njëkohësisht, sado që afishon socialdemokracinë dhe idealizmën iluministe nacionaliste, gjithnjë përbrenda një common sense-i universal demokratik që, para së gjithash, ruan atribute morale.

Në ditarin e saj, tek po linte pas një idilë dashurie, ajo shkruante "Unë nisem sepse duhet të nisem; kam punë dhe nuk bëj kurrë gjërat për inat". Ky ditar jep mugullimin e mendimit të saj, mbi jetën, dashurinë, moralin, artin politikën, miqësinë dhe shfaq sythat e një mendimtareje shqiptare që pohon se "njeriu ka lindur për të jetuar vetëm". Ajo di të përjetojë çastet transcendentale të një krijueseje që shijon në vetmi "çaste lumturie të vërtetë (...) duke ecur në realitet si në një boshllëk dhe në boshllëk si në një realitet". Pa dyshim, ajo kishte njohur magjinë dhe fuqinë e vetmisë. Vetmia do t'i japë mendimit të saj shqisë letrare e kulturore. Po atë kohë ajo do të thotë: "Ende nuk është formuar kultura shqiptare", duke pasur parasysh kulturën si klasë tekstesh e dijeje; si ent mendimi që e shquan një bashkësi. Prandaj vjen edhe tundimi i saj me rolin e angazhuar të shkrimtarit në shërbim të përparimit dhe sferës konceptuale sociale, progresiste, socialiste.

Zëra Kujtese

Cila është kujtesa për Musine Kokalarin, sot?

Ajo ishte autorja e re, sythi i sapodalë letrar e mendimtar, që prirej të mendonte e të fliste, që dinte të hapte dialog me intelektualët më në zë të kohës, nga Mit'hat Frashëri e deri te shkrimtarët e politikanët po edhe komisarët politikë të partive, eksponentë të ideologjive të

ndryshme. Ajo ishte një Hannah Arendt në bërthamë, të cilën jeta nuk e la rehat në akademi, por i dha udhët dhe e përplasi nën udhë.

Ajo, me tregimet e saj të para, mbahet sot për stilistet e mira të tregimit shqiptar dhe për një autore, shkrimi i së cilës ka identitet dhe brumë letërsie. Leksiku dhe sintaksa e periudhës dhe paragrafit të saj dhanë shfaqje stili si rrallë në prozën e deriatëhershme shqipe. Edhe sot, ajo mbetet ndër autorët e zgjedhur të letrave shqipe, stili i të cilëve mendon.

Jo rastësisht, shëmbëllesën e saj stilistike-poetike dhe modelin e saj rrëfimtar e ndoqën krijues që do të bëjnë emër më vonë, ndonëse me moshë para saj: Mitrush Kuteli e Ali Asllani. Musineja e kishte botuar *Siç më thotë nënua plakë*, më 1939, Kuteli *Netë shqipëtare*, më 1938, por *Tregime te moçme shqiptare* më 1965, Ali Asllani *Hanko Halla*, më 1942. Rrjeti ndërshkëmbyes intertekstual i materjeve dhe procedurave letrare te këta autorë bëhet i tejdukshëm. Për më tepër, gjithë kultura letrare bëhet prezente si ndikim ndërkulturor e intertekstual, mënyrë rrëfimi e pikëshikim i botës e jetës, si efekt stili e rrëfimi.

Përderisa pëlhura e *Netëve Shqipëtare* të Kutelit, rrëfimet popullore i shtron brenda një konteksti të rrëfimeve pranë oxhakut, të bashkëfshatarëve e miqve, duke krijuar dy nivele rrëfimi, te Musineja kjo vërehet më rrallë; ajo rrëfen vetëm në një plan, duke e nisur dialogun mes personazheve in medias res, pa hyrje të situatës së nivelit të dytë. Megjithatë, atmosfera e rrëfimit dhe gjuha e heronjve, frazeologjizmat dhe fjalori, barten si ndikim edhe te ajo dhe pastaj nga kjo te ai, në Tregimet e tij, më vonë. Ndërkaq, te Ali Asllani, ndërtimi i karaktereve, te *Hanko Halla*, është fort i frymëzuar dhe i mbështetur mbi modelin e karaktereve të *Nënos plakë*. Madje, Hanko Halla del si mbindërtim i disa prej temave të Kokalarit, por në një zhanër tjetër, në varg.

Më 1941, ajo kishte botuar *Siç më thotë nënua plakë* që manifeston një lloj prirjeje të kthimit të mentalitetit në letërsi,

duke zënë pika nevralgjike të shikimit rrëfimtar dhe autorial. Për më tepër, Musineja, edhe në shkrimet e saj diskursive ecën drejt të kuptuarit të letërsisë si një lloj mimeze situacionale që fërkohet me disa teori të artit; edhe me doktrina sociale e politike, pa dyshim. Duke u bërë mimezë, teksti saj zhvillon edhe filozofinë e kujtesës sepse krijon strategji rigjeneruese të situatave, toneve, karaktereve, ornamenteve.

Rrëfimi i një nëne plakë, do të jetë tipik më shumë te libri *Rreth vatrës* (1944), ku nxjerr krye aty-këtu, në fillim dhe pjesërisht edhe në fund të rrëfimit, një rrëfim paralel situacional, si hyrje në përrallë. Për shembull, te përralla "Unaza e çuditëshme", në fillim të përrallës jepet rrëfimi për ngrënien e gështenjave si një lloj paragjelle që paraprin menynë kryesore narrative - rrëfimin për një unazë të mrekullueshme që e mban një djalosh nën gjuhë. Është ky model narrativ, i shkrirë mes personales e rirrëfimit të një historie popullore, që do të bëhet tipik edhe për Kutelin. Në të vërtetë, ky ishte një ndikim që në letrat shqipe po hynte nga traditat letrare romantike dhe pasromantike evropiane.

Një rrëfim tjetër, "Është një e ç'është një", përmban hyrje-dalje paralele narrative jo vetëm në fillim dhe në fund, po edhe në mes. Teto Laleja rrëfen se si e nga i kanë ardhur gjithë ato rrëfime e gjëegjëza që i di, duke krijuar kështu një minisubjekt paralel të ndërshtënë. Prandaj tregime të tilla, më shumë se rirrëfime, përbëjnë rrëfejza origjinale, në kuptimin e formës, duke ecur jo rrallë përtej rirrëfimit kutelian dhe duke e bërë magjinë e rrëfimit një lloj ilaç jete. Rrëfimi "Vajza e mbretit" është pikërisht i tillë; ai ka brenda si rrëfim hyrës një zënkë për lojën mes fëmijësh pas të cilit vjen rrëfimi përrallor si melhem kontrolli i kësaj loje, si strategji për t'i mbajtur fëmijët urtë. Kjo ndërfutje teme dhe strategji narrative ka implikime edhe në poetikën e krijimit të një subjekti të veçantë. A jep nënua plakë e disa përmbledhjeve me tregime, si filozofi e strategji rrëfimi, edhe indikacione të lojës me zhanrin

përmes reprezentimit mental, përmes dialogut ku mungon komenti narratorial, apo edhe komenteve minimaliste? A ka shenja parodie?

Mbase, por kryesisht jo. Musineja nuk dëshiron të parodizojë me atë mentalitet që jep, sa dëshiron të nxjerrë ngjyrat e tij, koloritin dhe rrjedhën; pra nuk manifeston hijezim ideologjik ndaj rrëfimit, çfarë mund të gjendet pjesërisht te rrëfimet e saj në proza të shkurtra poetike dhe në poezi. Këtu ajo dialogon me jetën - të tillë siç është, duke dashur ta njohë e ta shijojë si të tillë, pa dashur ta ndreqë atë nga distanca doktrinare. Në të vërtetë, kjo përbën hirin e koloritit të fustanit të saj estetik dhe etik. Këtu fustani i saj bëhet hir e hiri fustan; këtu bëhet fustani jetë dhe vdekje e një goce, një zonje.

Bardhezi-ja e fustanit të saj, si kolorit fundamental krijon bërthamën e dialogut të ngjyrave, të dialogut në letra e në jetë. Kësodore ajo i jep zë dialogut me vetveten në mendimin shqiptar dhe frymëzon dialogun brenda rrëfimit shqiptar, veçmas te *Nënua plakë*, ku dialogu bëhet kompozicion dhe subjekt, stil dhe rrëfim, të gjitha përnjëherësh.

Tregimtaria e Musine Kokalarit, nga dritëhijet e veta bardh-e-zi dha ngjyra të pasura me tone serioze e ludike, por për shkaqe të njohura, sado që mbeti e gulçuar brenda kornizave të një letrareje me shije të cilës nuk iu dhurua çasti i lumë që ta thotë fjalën e vet të plotë në rrëfim. Në shikim të parë, pamjet e rrëfejzave të saja situacionale, zakonisht i fusin në lojë dialogu dy personazhe, në një temë të përditshme që bëhet përhershmëri karakteri e mentaliteti, por po këtu, herë pas here nxjerrin krye shenjat e forta të ecjes drejt konsolidimit të artit rrëfimtar në tregim të shkurtër.

Tregimi i fundit i përmbledhjes *Siç më thotë nënua plakë*, me titull "Ulurima e qenit", bën hap të mirë edhe drejt ndërtimit të një strukture të qëndrueshme kompozicionale, si temë, si subjekt, si rrëfim dhe si situatë. Ndërhyrja e narratorit, përtej të folurit dialogjik të personazheve, vjen e bëhet simptomatike, madje sugjeruese.

I tillë është edhe tregimi "Budallai" i cili shkon një hap përtej në

punën me subjektin. Këtu, subjekti i dytë, përralla, është në funksion të subjektit të parë dhe jo siç ndodh zakonisht. Astritit i rrëfehet përralla që të marrë shëndetin nga sëmundja që ka, pra përralla bëhet melhem. I tërë rrëfimi interesant për një budalla dhe dy vëllezërit e tij hyn në funksion të subjektit të parë. Kështu, arti rrëfimtar evoluon brenda zhanrit, tregimi bëhet rrëfim autorial në rend të parë, rrëfimi i ndërshtënë i funksionon vetëm të parit.

Musine Kokalari kishte shkruar që herët poezi e proza poetike prej fillestareje, e prekur nga sensibilitetet sociale, shumica prej të cilave janë përmbledhur, pas vdekjes, nën titullin Kolla e vdekjes!. Po në këtë përmbledhje janë futur edhe disa tregime simpatike si "Më marrç pleshtat" dhe të tjera të këtij modeli narrativ, që dëshmojnë talentin rrëfimtar të saj. Ky tregim ndërtohet mbi poetikën e ritualit dhe, siç ndodh shpesh te Musineja, vetë gjuha e përshkrimit bëhet stil rrëfimi. Aty është dhënë rituali i vënies së veroreve në qafë, si shenjë mbrojtëse, në fund të muajit shkurt. Përveç si stil, këtu gjuha bëhet edhe shtyllë e subjektit dhe karaktereve të rrëfimit. Frazeologjizmat e lokalizmat, me gjithë ato ornamente stilistike, i japin rrëfimit jo vetëm sharmin e ludikes por bëhen linja teme e karakterizimi. Me një fjalë, gjuha zgjeron horizontin e misterit në veprën e saj.

Të tilla janë gjithë etno-rrëfimet e tjera të kësaj përmbledhjeje të cilat e transhendojnë zhanrin e mëhershëm të prozave poetike me zë autorial duke promovuar një lloj zhanri të etno-mimezës së ritualit; një lloj rrëfimi që do gjendet edhe te *Siç më thotë nënua plakë*. Gjithashtu, te tregimi "I re së mirës me këmbë" sikur edhe ai "Në shtëpi", kthimi në rrëfim ecën drejt këtij sfondi etnologjik që kthehet në rrëfim për kthimin e njeriut në të veten.

Ky sfond ndryshon te tregimi "Si është jeta...!". Këtu, fokusi i drejtpërdrejtë autobiografik, i situatave me plakun Sotir Kolea, merr ngjyrime ekspresive; një rrëfim për takimin e fundit të një vajze të re, të sapohyrë në botën e letrave dhe një bibliotekari, mësuesi të saj, i

cili donte ta shihte atë para se të vdiste. „Më gëzoi që i vajta por nuk më donte më që të veja“, qe fjalia e parafundit e tregimit, e dorës autoriale. Një rrëfim-përjetim jete e miqësie, i qëndisur me mëndafsh dhembjeje. Shikuar në përgjithësi, disa nga rrëfimet e përmbledhura nën titullin *Kolla e vdekjes*, e japin profilin më të mirë artistik të Musinesë rrëfimtare, duke e nxjerrë faqen e saj prej artisteje të lidhur fort me mimesisin e jetës. Stili i Musinesë këtu - habitshëm, krejt ndryshe prej poezive, hartimeve e prozave të saja shkollore përshkuar edhe nga elemente socrealizmi (p.sh. “Hija e djalit”) - dëfton prirje identifikimi me stilin fotografik, përderisa te Nënua plakë evoluon drejt stilit të fotografisë me lëvizje të ngadalësuar, të shkrirë në dialog. Edhe vetë pozicioni i narratorit demiurg shndërrohet nga ai i gjithëdijshëm në atë të identifikimit me folësit në dialog. Me një fjalë, vetë reprezentimi bëhet dialog dhe dialogu priret drejt reprezentimit mental. Fustani apo petka korporale bëhet petkë mentale. Drita e trupit bëhet mister i frymës.

Edhe tregimet e përmbledhjes së mëvonshme ...*sa u tunt jeta* (1944) lidhen strukturalisht me këtë kulturë narrative ku antropologjizmi letrar bëhet potencë poetike e rrëfimit. Ndërkaq rrëfimet e librit *Reth vatrës*, botuar po ashtu më 1944, janë kryesisht rirrëfime me pak elemente të dorës autoriale. Me një fjalë, zëra kujtese, karakteresh, idesh, rrëfimesh e pamjesh, gjejnë gjuhën e poezisë së librit e të jetës.

Zëra Harrese

Po të mund të shikohej jeta dhe shkrimi i Musine Kokalarit si libër, si jetëshkrim i njeriut që s’e njohu inatin, kjo do t’i jepte edhe më të plota vijat e fustanit të saj.

Thuhet ndonjëherë se ajo nuk u kujtua, u harrua. Në të vërtetë, kujtesa e vazhdueshme, inherente, intensive, e dëmton, e harxhon, e varfëron subjektin a objektin e kujtuar. Dëmi shkaktohet duke u

krijuar limitet dhe relievi i saktë i kujtesës, pa lënë imagjinaren për të farkuar zona të reja kujtese. Defokusimi i kujtesës e ndihmon kujtesën si ndërmarrje, në rrugë të gjatë. Prandaj harresa përmes sinkopave të saj krijon marrëdhënie të reja brenda aktit kujtesor. Prandaj harresa e kohëpaskohshme e pasuron kujtesën dhe e shndërron atë nga kujtesa banale në kujtesë imagjinare. Gjithnjë në këtë frymë mund të thuhet se, disi, për vite të tëra, Musine Kokalari ka qenë e bekuar nga harresa. Kjo harresë, me kohë, e ka ushqyer imagjinaren e kujtesës për të. Kujtesa e zakonshme për të ishte tepër e varfër: vajzë e bukur, e talentuar dhe me karakter të fortë. Kaq.

Fustani i Musine Kokalarit duhej harruar, si shkrimtare e si figurë publike, letrarisht e ideologjikisht. Vetë karakteri i këtij fustani përjashtonte një rend ideologjik e etik që nxirrte mentalitetin politik shqiptar për një gjysmë shekulli. Shqipëria kishte mbetur tepër fustan i ngushtë e i shëmtuar për supet e Musinesë. Prandaj një kujtesë e bukur dhe e pasur për Musinenë mund të nxjerrë krye vetëm kur të harrohen brezat që e kanë të gjallë kujtimin e saj. Fustani funeral i Musinesë jep gruan e jetës së pjekur dhe letërsisë së djegur. Të djegur në kuptimin e një pranie poetike si sensibilitet e formim fillestar por të papërfundur si tekst. E djegur dhe e avulluar, pa ia dalë të përkthehet në shkrim, jeta dhe poezia asaj iu dogjën në duar. Një pjesë nga letërsia dhe mendimi i saj potencial u avullua sikur që u tret një perspektivë e profilit të saj të pasur të shtrirë mes politikës, poetikës e filozofisë, mes socialdemokrates e shkrimtares, mes rrëfimit gojor dhe atij personal e mimetik.

Një fustan që për prerjet e veta u motivua nga poezia dhe njohja e realiteteve sociale, politike e historike; nga njohjet letrare e mistike si ajo e veprës së Naim Frashërit. Mendimi i saj për Naimin edhe sot mbetet ndër më provokativët, më kompleksët, përtej mistifikimeve e hyjnizimeve. Përmes diplomës për Naim Frashërin, ajo diplomoi në njohjen e realitetit shqiptar si histori, besim e politikë.

Me Musinenë, zonjën me fustan, mendimi shqiptar promovoi dialogun me vetveten, duke njohur bioritmin bazik të mendimit.

Nëse e zeza, estetika e misterit, përbënte gjithnjë baziken e fustanit të saj dhe e bardha rrjedh si shikimi i të zezës, fustani i saj funeral, mbetet para së gjithash manifestim i pushtetit subtil njerëzor, i dinjitetit dhe i karakterit të shkrimtares, filozofes dhe politikanes së këputur në mugullim. Ky profil i saj, shpesh të bën të ndihesh keq për atë që je dhe për atë që s'je.

Njiheni dhe pastaj harrojeni Hirin dhe Hinin e fustanit të Musine Kokalarit. Nëse mundeni!

Prof. Dr. Persida ASLLANI
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

"Nënua plakë në Romë"- aventura romane e zemrës shqiptare

"Një tip origjinal që nuk bën kurrë atë që bëjnë gjithë të tjerët..." Mbas debutimeve të para në poezi e skica letrare gjatë vitit 1937, me pseudonimin Muza, zonjushë Musine Kokalari niset në Romë për të ndjekur studimet në Letërsi pranë Universitetit "La Sapienza" më 15 janar 1938. Këtë datë mban edhe botimi i saj i fundit në faqet e gazetës "Shtypi", së bashku me përdorimin e pseudonimit Muza. Mbyllet kështu simbolikisht një faqe sprovash rinore në shkrimtarinë e saj. E përfshirë thellësisht në realizimin e ëndrrës për të ndjekur studime të larta universitare, ajo rritet së brendshmi dhe emancipohet si qenie, si grua, si shkrimtare dhe u rikthehet letrave shqipe me një vetëdije të re për shkrimin, letërsinë, gjuhën dhe botën. "E lumja ti që bredh botën me kaq lehtësi – i shkruan Lina, shoqja e saj italiane e universitetit, më 1942 – neve këndej nuk na i mban edhe aq: po në fakt e di fort mirë se ti je një tip origjinal që nuk bën kurrë atë që bëjnë gjithë të tjerët."[1]

1 Nga korrespondenca e ruajtur në AQSH, Fondi Musine Kokalari, dosja 9; letra mban datën 29 korrik, 1942 – cituar sipas: Musine Kokalari *La mia vita universitaria, Memorie di una scrittrice albanese nella Roma fascista* (1937-1941), a cura di Simonetta Ceglie e Mauro

Ndërsa publiku shqiptar do ta "zbulojë" këtë gjë gjatë vitit 1939, në botimin e përmbledhjes *Siç më thotë nënua plakë* me autore Musine Kokalarin[2]. Shënimet që na vijnë po prej saj në librin e botuar postum vetëm më 2009, *La mia vita universitaria*[3], na bëjnë me dije se kjo përmbledhje mori shtysë dhe u shkrua e gjitha gjatë verës së 1938-s, kur ajo gjendej sërish për pushimet verore në Tiranë.

"Ishte në këtë periudhë, që meqë më kishte rënë në dorë "Bulkthi në oxhak" i Dikensit, shkrova novelën time të parë dhe ia paraqita prof. Xhuvanit, të cilin kisha pasur rastin ta njihja. I pëlqeu dhe më inkurajoi të shkruaja të tjera. Dhe unë shkrova dhjetë, në dialektin e vendit tim, ku pasqyrohej jeta, mendimet, dhimbjet, bestytnitë dhe mrekullitë e këtyre njerëzve: "Gjyshja plakë" e inatosur kundër rinisë së re për idetë liberale; dy zonja që zihen në rrugë derisa lëshojnë më së fundi fjalë larë e palarë; burri që vepron shpesh si qen dhe nuk prêt shumë, mbas vdekjes së gruas së parë, rimartohet. Jeta që zhvillohet në qytetin tim ku kam kaluar fëmininë ka pamje të ndryshme. […]"[4]

Shënimet do të qëndrojnë një vit në dorëshkrim, dhe vetëm në vjeshtën e vitit 1939, kur vjen sërish me pushime në Tiranë, vendos

Geraci, ed. Viella, Roma, 2016. Shënimi me titullin italisht La mia vita universitaria do të korrespondojë në këto shënime me këtë botim. (P. A.)

2 KOKALARI, Musine, *Siç më thotë nënua plakë*, Shtypshkronja "Gutembarg", Tiranë, 1939

3 KOKALARI, Musine, *Jeta ime universitare (La mia vita universitaria)*, përmes përkthimit të Hektor Kokalarit, në: Musine Kokalari, *Vepra, vëllimi I,* përgatitur nga Novruz Shehu, f. 335-432. Shënimi me titullin në shqip *Jeta ime universitare* do të korrespondojë në këto shënime me këtë botim. (P. A.)

4 Ibid. f. 354-355; gjithashtu: "Sa më tepër shkruaja, aq më tepër më tërhiqnin ato kohë në të cilat kam jetuar të ashtu quajturën pjesë më të bukur të jetës sime: fëmijëria. Mandej vrapoja drejt nënës dhe i lexoja asaj shkrimet që të më korrigjonte aty ku dallonte një shprehje jashtë vendit ose një rregull gramatikor që shpesh herë ishte në kundërshtim me një thënie popullore. Isha e kënaqur kur më thoshte: "Kështu flitet dhe ti e di më mira se unë!" [...] Mbas kësaj pune fillova të mblidhja këngët popullore të qytetit tim dhe të tjera që i përkisnin zakoneve të Gjirokastrës. Atëhere nuk lija asnjeri në qetësi, kunatën ndërsa bënte ndonjë punë dore, ose nënën ndërsa ishte e zënë me punë. U bërë mike intime me gruan e shërbimit dhe kuvendoja me rrobalarësen. Nëse gjeja ndonjë gjë të re, menjëherë e shkruaja. Herë pas here më thonin: "Bekuar kjo vajzë; vete në një shkollë të madhe dhe vihet të shkruajë këto marrëzira. Përse të shërbejnë?" "Oh" – përgjigjesha, "duhen, si jo! A e dini se çfarë thotë dikush për ne? Që në vendin tonë nuk ka asgjë, as këngë, as vajtime, ndërsa ne kemi plot". [...] "Meqë është kështu, atëherë do të të tregoj pambarim" dhe kështu vazhdonte të më tregonte herë një këngë, herë një barcaletë, herë një përrallë… dhe unë në mbrëmje i rishikoja të gjitha shkrimet me kënaqësi. Nëse vinin vizita, atëherë zija vend në qoshe e dëgjoja të gjitha bisedat. Është shumë interesante vetëm të dëgjosh!", f. 355-356

të japë "menjëherë" për botim "librin e novelave": "Kështu, u shtrëngova të kaloja orë të tëra duke korrigjuar dorëshkrimet. Isha e paduruar që të dilte botimi dhe mbas pesëmbëdhjetë ditëve doli në shitje". [5]

Poeti Lasgush Poradeci, në rolin e kritikut letrar është ndër të parët që çmon publikisht dukurinë shkrimore të Kokalarit, duke e përkufizuar si "zënia e jetës": "Krijim origjinal? –pyet provokues poeti-kritik , - Ç'do të thotë kjo? –vijon ai,- Kjo do të thotë me fjalë të thjeshtë [...] se autoresha e këtyre skicave rastësore e ka zënë jetën mu në mesin e saj, në momentin kritik që është momenti i math i çdo manifestimi të jetës njerëzore, që përmbleth edhe çfaq, në një pikë tërësije, gjithë kuptimin e vërtetë të jetës të çfaqur rastësisht. Zënia e jetës, kapja e menjëhershme e saj në fond dhe në formë dhe çfaqja imediate, pa asnjë ndërmjetësim, me anën e artit, kjo është origjinalitet – origjinalitet letrar". [6]

Porse studentja për letërsi në Romë, zonjusha "origjinale" Musine Kokalari e përjeton ndryshe momentin e shumëpritur të botimit:

"Por, megjithatë, në çastin që librin e kisha në dorë, isha krejt indiferente. Më dukej se nuk kisha bërë asgjë të jashtëzakonshme dhe pyesja veten, se si ka mundësi, që për kaq gjë, kisha punuar aq shumë. Ndoshta do të ishte më mirë që të mos i kisha publikuar akoma novelat e mia. Kur shfletoja faqet, e ndjeja se e kisha humbur gjithë atë kënaqësinë e parë. Tashmë ai nuk ishte gjë tjetër, veçse një çështje e së kaluarës. Kishte mbetur vetëm një kujtim prozaik i ditëve me punë dhe shkrimi me makinë… Më nevojitej diçka e re".[7]

Kjo domosdo e brendshme për "diçka të re", kërkim estetik parësor, dëshmuar kthjellët në jetëshkrim, ndërthuret me rrjedhën e jetës dhe mundësitë që i ofron ajo. Takimi me Parini-n[8] në Romë

5 Ibid. f. 373
6 PORADECI, Lasgush, "Musine Kokalari: Siç më thotë nënua plakë", në "Bota e re", Nr. 1, 30 korrik, 1940, Tiranë, f. 6-7
7 *Jeta ime universitare*, Vep. cit., f. 373
8 GERACI, Mauro, në studimin hyrës të librit Musine Kokalari - *La mia vita universitaria,*

do të shërbejë si një shtysë e re për "diçka të re". "Tamam në këtë kohë mbërriti në Romë, Shkëlqesia Parini, atëhere Komisar Italian në Shqipëri, i cili, duke ditur që unë kisha shkruar novela, më kërkoi të shkruaja përshtypjet e një gruaje shqiptare në Itali. Më dukej një detyrë përtej fuqive të mia, por premtova gjithashtu të shkruaja në dialektin e vendit tim përshtypjet e të njohurave të mia, sidomos gra me një farë moshe. Dhe kështu gjyshja plakë, mbas rreth njëzet ditësh në Romë, në shoqëri me mbesën (që jam unë), kthehet në vendin e saj e mrekulluar dhe me përshtypje. Nuk harron t'u flasë komshinjve të saj për kinema (ku shikonte njerëz sikur janë të gjallë), të tregonte frikën e saj në midis radhëve të automobilave…, deri dhe për universitetin, ku një plak që e thërrasin profesor, flet, dhe shumë vetë qëndrojnë aty për dëgjim. Megjithë këto të reja e gjithë sendet e tjera të bukura që kishte parë, gjyshja, është më e lumtur në prani të nipërve të saj, që nuk ngopet kurrë duke i pasur para syve. Preferon të njohurat e saj, vendin e saj - Gjirokastrën e bukur, me të gjitha rrugët e përdredhura, shtëpitë ku ka jetuar e vuajtur dhe sapo hedh këmbën brenda, bërtet nga gëzimi: "Shtëpia ime, shtëpia ime, uroj që varri im të jetë i ëmbël si ti".[9]

Dhe kështu, gjatë vitit III universitar zë fill aventura e re e një personazhi tashmë "të vjetër", ajo e Nënos plakë gjirokastrite në Romën e përjetshme. E shkruar thuajse me një frymë, "atëhere pak studioja, - rrëfen ajo,- por, kur kisha kohë, shkruaja fashikujt e "Nënua plakë në Romë". Nganjëherë, ndërsa haja, shtypja në makinë aty për aty në tavolinë"[10], kjo prozë u botua[11] siç u konceptua, seriale, në

Vep. cit., footnote nr.69 :"Il commissario generale Parini incaricò Mussine "di scrivere I nuovi capitol del libro "I racconti della nonna", con riferimento a Roma e alla vita degli studenti albanesi in Italia" da publicarsi a puntate "dal giornale "Tomori" e compensate a parte dell"amministrazione del giornale stesso". Të dhëna nga Fondi M.K. fash. 9: letra e 2 prillit 1940 e Nicola Lorusso Attoma, drejtor i përgjithshëm për shtypin, propagandën dhe turizmin në Mbretërinë e Italisë drejtuar Musine Kokalarit.

9 *Jeta ime universitare*, vep.cit., f. 388

10 Ibid. f. 389

11 KOKALARI, Musine, *Nënua plakë në Romë*, botuar në 9 pjesë në gazetën "Tomori" nga 2 qershori deri 21 gusht 1940, Tiranë.

gazetën "Tomori" nga 2 qershori deri 21 gusht 1940, gjithsej nëntë pjesë. "Moj Musine – i drejtohet miqësisht e plot afekt Aleksandër Xhuvani në letërkëmbimin e atyre javëve -, Mirë i ke shkruar përshtypjet e nënës plakë në "Tomorri-n". Më kanë pëlqye (sado që ndokujt jo), e sidomos ajo e III-ta në "Tomorri", 9 korrik. Sa bukur e me kripë që ishte shkrue! Sa bukur ishte ajo fraza: "pastaj pse më është nisur ashtu, e kujt i tregonet...".[12]

Shumë shpejt mbas botimit në gazetë, teksa përgatitet për fillimin e vitit IV universitar, Musinesë i kërkohet prej të vëllait ta përgatisë këtë tekst për një botim integral si një libër më vete: "Herë pas here më dukej që këto ditë të trishtuara nuk do të mbaronin kurrë. Përgatitja nipin për kthimin në shtëpi dhe mendoja të nisesha bashkë me të. Marr një letër nga një vëlla që më thoshte se duhet të botoja në libër fashikujt e "Nënua plakë në Romë". Atëhere m'u desh t'i rivihem punës. Të ndryshoja disa pjesë që nuk më pëlqenin dhe të shtoja disa gjëra të tjera. Kështu vendosa të qëndroj në Romë për të punuar më mirë, aq më tepër që muaji tetor ishte i afërt dhe duhet të regjistrohesha në Universitet".[13]

Me gjasë libri do të titullohej *Nënua plakë në Romë*, do të mbante si vit botimi vitin 1940, dhe do të përbëhej nga 9 ose 10 fashikuj. Por sërish rrjedhat e jetës personale dhe studentore vendosin për momentin shtyrjen e këtij projekti: "Ulur në tavolinë, me makinën përpara dhe me fletët të shpërndara andej këtej, fillova vitin e katërt të jetës universitare. Kisha ndërmend të punoja çdo ditë, por ndihesha më e lodhur se më parë. Vazhdova kështu për rreth njëzet ditë, por më vonë, kur pashë që nuk isha e kënaqur nga puna, ndërpreva të shkruarit. Njoftova në shtëpi që kisha ndërprerë punën e librit". [14]

12 XHUVANI, Aleksandër, Letër e datuar 15 korrik, 1940, drejtuar Musine Kokalarit. Arkivi i familjes.
13 *Jeta ime universitare,* vep.cit., f. 401
14 Ibid. f. 403

E lodhur, ajo e shtyn punën dhe botimin e librit për më vonë, pa e marrë dot me mend se jo vetëm ky projekt por edhe teksti *La mia vita universitaria* në të cilin i raporton këto të dhëna gjatë vitit 1941, nuk do të mund të botoheshin më. Me një fatum deri diku të ngjashëm, e shkruar në kohë të përafërta, këto dy tekste bartin frymën e njëri-tjetrit, janë një projeksion i njërit te tjetri, janë shumësia e unit të shpërvjelë trajtave të larmishme të fiksionit. Autorja e tyre, shkrimtarja tashmë bilingue Musine Kokalari, synon me vetëdije pikëtakimet gjithnjë kërshëritëse mes antropologjikes dhe shkrimores, mes dëshmueses dhe sprovueses. Përthyerjet dhe perspektivat e qasjes ndaj botës që ndërmerr Nënua plakë dhe Studentja në Romë, mbivendosen e shtresëzohen në shkrim e në jetë, për të mbërritur sërisht, fatlumësisht, te vetvetja.

Për këtë arsye, në këtë studim do të privilegjohet një lexim i kryqëzuar mes dy teksteve, jo si lexim të dhënash të përbashkëta, por si hetim i përvijimeve të pashmangshme të Unit teksa takohet me Tjetrin. Gjithashtu, do të sillet në vëmendje edhe fryma e përgjithshme e shkrimeve të autores, në kërkim të rezonimit mes autoriales dhe tekstuales. Në mënyrë të përmbledhur, ky studim do të marrë në shqyrtim dy linja:

Udhëtimin e Nënos Plakë – në nivel të përjetimit dhe vëzhgimit;

Shkrimin e Jeta ime universitare – në nivel të përjetimit, refleksioneve dhe gjykimeve të autores, të cilat shfaqen si pjesë e së njëjtës përvojë (ose të ngjashme);

Roma e Nënos plakë

Në parathënien e *Jeta ime universitare* (1937-1941) studentja tashmë prej 4 vitesh në Romë, Musine Kokalari, rrëfen shtysën (e re) që e nxiti jo vetëm për të shkruar një tekst të natyrës biografike, por dhe faktin se ky tekst, që në zanafillë, ishte i konceptuar si libër për t'u botuar. Ajo sqaron: "[...]

Tani që po e përfundoj këtë shkollë, kam vendosur të shkruaj disa përshtypje, para se të largohem nga Italia. Ky libër është një dëshmi personale e përvojës sime jetësore, dhe edhe më tepër, dëshmi e mendimeve të mia. Është një prozë natyrale e jetës së përditshme."[15]

"Kështu, qysh në krye të herës shfaqet gjithë përshtypja e thellë njohëse që e bën Jeta ime universitare më shumë sesa një shkrim për veten dhe për intimitetin, një shkrim për ne dhe për ata, një përmbledhje sistematike "mbresash", për lëvizjet historike, kulturore dhe sentimentale që ajo i zbulon përmes ushtrimit të vazhdueshëm antropologjik të të dëgjuarit, të shikuarit, të kritikës së paanshme lidhur me atë që përjeton" [16] – na sqaron Mauro Geraci, në studimin e tij hyrës të botimit italian të veprës.

Pikërisht ky shkrim i "ne dhe ata" do të sprovohet edhe përmes një projeksioni të ri në mis en scène-t e një udhëtimi 20 ditor të Nënos plakë në Itali, ndërthurur mjeshtërisht me cilësi të rralla vëzhgimi, krahasimesh kontrastuese, zgjedhje perspektivash, finesash të gjuhës dhe përftimesh tragji-komike në situata e në ligjërim, pyetësime të pandërprera të vetes përmes botës, duke i sjellë letërsisë shqipe një nga sprovat e para të një shkrimi me kontekst antropologjik, ku tashmë nuk janë të huajt, por janë shqiptarët, dhe pikërisht ata më tradicionalët, një lloj "Shqipërie e pakohë" që i vëzhgon e i gjykon ata. Dhe për më tepër nuk janë shqiptarët që shpjegojnë etnologjikisht e kontekstualisht vetveten për të tjerët (si në rastin e *Bardha e Temalit* të Pashko Vasës), por është një identitet i fortë që rreket t'u shpjegojë të ngjashmëve të vet – "të Tjerët", jetën dhe botëkuptimin e tyre, brendashkruar kontekstit të tyre material e jetësor. Prandaj, kjo është proza më interesante e shkrimtares Musine Kokalari.

Duke zgjedhur këtë vektor të përballjes me Tjetrin, të albanizmës jashtë truallit të vet, "të albanizmës në tokën e tjetrit", autorja ka

15 Ibid, f. 335
16 GERACI, Mauro, *La mia vita universitaria*, Vep. cit., f. 17 [përkthyer për botimin shqip nga Arta Marku]

parapërcaktuar njëkohësisht lëndën dhe trajtën e këtij udhërrëfimi. Vetë ndërtimi i strukturës së kësaj vepre në 9 pjesë [Në shtëpi, Udhës, Ditën e parë, Ç'i zuri siri, Nënua në Thjatro, S'marr vesh fare, Nënua në shkollë të madhe, Nënua u duk prapë, Nënua do Gjirokastrën] do t'i përgjigjet logjikës së një rrëfim-dëshmimi interpretativ e refleksiv, duke nisur në mënyrë të pashmangshme me "kthimin". "Kthimi në shtëpi", ritakimi i një hapësirë-kohe të lëkundur prej udhëtimit, është pika ku zë fill ekskluzivisht (domosdoshmërisht) instanca e rrëfimit. Dhe është po aty ku do të përmbyllet, në Gjirokastër e në shtëpi të vet, si rigjetje e një ekuilibri të përsosur, që një udhëtim 20-ditor vetëm sa e kishte lëkundur, për të rikonfirmuar tashmë jo si "ne" por si "unë" vetveten.

Pavarësisht se udhëtimi i Nënos plakë ka një shtrirje 20 ditore në Itali, e me përjashtim të udhëtimit, thuajse vetëm në Romë, në planin e skenës së rrëfimit ai ka dy vatra kryesore: "këtu" dhe "atje". Këto vatërzime të rrëfimit, ndonëse rreken të jenë të gërshetuara përgjatë gjithë prozës, paraqesin edhe një polarizim të dukshëm në temën zotëruese të pjesëve më vete. Kështu për shembull:

Vatra "Këtu": "Në shtëpi" (pjesa I), "S'marr vesh fare" (pjesa VI) dhe "Nënua u duk prapë" (pjesa VIII) zotërohet nga një rrëfim i mjedisit dhe jetës shtëpiake gjirokastrite, ku dialogu i tipit skenik mes Nënos dhe mikeshave, fqinjave ose familjareve të saj (gjithnjë femërore) tematizon gëzimin e kthimit në shtëpi (I); shqetësimin e Nënos për vështirësitë e jetës së përditshme dhe veçanërisht moskuptimin e saj për faktin se "mbesa" (bashkë me shumë moshatare të vetat) e ka mendjen vetëm të studiojë, sidomos duke vijuar studimet jashtë vendit (në Romë) e jo të martohet (rehatohet) siç e do zakoni, refuzimin e mblesërive etj, duke e bërë Nënon të deklarojë që në titullin e pjesës (VI) se "s'marr vesh fare"; ankesat dhe gjykimet e mprehta të Nënos për vështirësinë e jetës së femrës në qytetin e saj, pamundësisë për të ndryshuar dhe përsëritjes në

çdo brez femëror të të njëjtit status gjinor të nënshtruar në pjesën e parafundit (VIII).

Vatra "Atje": "Udhës" (pjesa II), "Ditën e parë" (pjesa III), "Ç'i zuri siri" (pjesa IV), "Nënua në Thjatro" (pjesa V) dhe "Nënua në shkollë të madhe" (pjesa VII) zotërohet nga roli i Nënos në rrëfimin dhe shpjegimin e gjërave që ka parë, që e kanë habitur, herë mahnitur e herë skandalizuar, duke bërë njëkohësisht tregimtaren dhe gjykatësen e botës së huaj që tregon, përmes përqasjesh kryesisht morale. Udhëtimi në det e me tren, kafenetë e Romës, Teatri dhe kabareja, ndjekja e disa leksioneve universitare, vitrinat e dyqaneve, mënyra e të veshurit dhe jetuarit, marrëdhëniet e çlira mes vajzave e djemve, jeta e hapur dashurore, të mbajturit sqimatar të moshatareve të Nënos dhe reverancat mashkullore, janë disa prej aspekteve që ajo "përzgjedh" për të rrëfyer, me qëllim paraqitjen e një bote shumë të ndryshme e të huaj prej asaj që njohin ajo dhe bashkëbisedueset.

Ndërsa "Nënua do Gjirokastrën" (pjesa IX dhe e fundit) e përmbyll këtë polarizim të rrëfimit duke i shkrirë në një të vetëm, ku asgjë nuk është më e re në rrëfim, të gjitha janë parë e treguar. Tani hapësirën në rrëfim e zë përqasja mes dy botëve jo më përmes vëzhgimit dhe analizës racionale e etike por përmes nostalgjisë dhe emocionit, ku nga nostalgjia kulturore mbërrihet në vetëdijen identitare.

Megjithatë, kjo ndarje apo grupim i pjesëve për arsye më tepër të shqyrtimit të strukturës së brendshme të rrëfimit nuk duhet të na pengojë të vërejmë lidhjen organike mes pjesëve dhe potencimit të tyre përmes leximit në vijueshmërinë e botimit. Pjesët e zotëruara nga tematizimi i jetës shtëpiake në Gjirokastër (I, VI dhe VIII) vijnë në fakt si pasojë e një refleksiviteti mbi gjërat "e botës tjetër" që janë parë ose treguar më parë, por edhe që do të vijohen në rrëfim. Kështu për shembull, pjesa VI me titull "S'marr vesh fare" ku diskutohet rreth ndryshimeve mes të rejave dhe të moshuara në raport me detyrat e shtëpisë, ndalet gjatë edhe në shkollimin e mbesës në Romë

(dhe shoqeve të saj) duke u thelluar në studime e duke mos menduar fare për martesën dhe krijimin e një familjeje. Ajo pasohet në rrëfim nga pjesa VII me titull "Nënua në shkollë të madhe" ku ngjan se zbërthehet edhe i gjithë pyetësimi i Nënos se çfarë do të mund të mësohej kaq gjatë e me zell në shkollën e lartë. Nga ana tjetër, përtej skenave plot humor dhe përçmimit të Nënos për "çudirat e shkollës së madhe", pjesa vijohet nga "Nënua u duk prapë" (VIII), ku perpetumi i jetës së rëndë të përditshme shtëpiake tradicionale kontraston fuqishëm me pjesën pararendëse.

Teksti shfaq një zgjidhje shumë interesante edhe nga pikëpamja diskursive. Nëna plakë është ajo që zotëron ligjërimin e rrëfimit të udhëtimit të saj, por nga ana tjetër, në dheun e huaj, ajo është e privuar nga pjesëmarrja në Ligjërim. Jo vetëm nuk njeh njerëz të atij qyteti por mbi të gjitha nuk njeh gjuhën e tyre. Autorja e ka zgjidhur këtë "mungesë në ligjërim" duke e bërë Nënon të dëshmojë përjetimet përmes përvojës personale, por sidomos duke i dhënë asaj cilësitë e një vëzhgueseje të mprehtë, të aftë të lexojë gjuhën e larmishme të shenjave dhe "gjuhën e trupit" të Tjetrit.

Ndaj dhe pamjet më interesante të rrëfimit të saj lidhen me vëzhgimet e holla që ajo sjell, komenton e gjykon, të skenave jetësore përballë të cilave vendoset rastësisht dhe priret t'i kuptojë, t'i lexojë, si një semiologe e thekur, duke i kuptimësuar përmes spektrit të mentalitetit (reflektivitetit) të vet. Por, përtej të gjitha gjërave që vëzhgon, duke filluar nga aspektet teknologjike (udhëtimi me traget, tren, makina, ndërtesat e larta, ashensorët, apartamentet komode e të ngrohta, urbanizimi i nivelit të lartë etj.) e deri te aspektet e jetës së qytetit në baret, kafenetë e deri në Teatër-kabaretë dhe Universitet, prirja natyrore e Nënos është të vëzhgojë të ngjashmen e vet, domethënë jetën e femrës në përgjithësi dhe aty ku i jepet rasti atë të moshatareve të saj veçanërisht. Gra të barabarta me burrat, gra të stolisura e të mbajtura, që studiojnë e punojnë, që këndojnë

bareve e kabareve, që respektohen plot mirësjellje nga burrat, që dashurohen haptazi, që vishen më "kërcinj e llërë përjashta", gra e vajza që popullojnë qytetin modern dhe, përmes vëzhgimit të Nënos plakë, edhe galerinë femërore të këtij rrëfimi.

Natyrshëm, skena e parë e mirëfilltë që u rrëfen Nënua shoqeve të saj është pikërisht skena ku ajo, gjatë udhëtimit me tren nga Bari në Romë, mbërthen nën vëzhgim një bashkëmoshataren e saj italiane, te e cila, përveç afërsisë së moshës, do të hetojë ndryshime të forta në sjellje, thuajse të papranueshme e aspak dinjitoze:

" Atje pranë kisha një plakë. Ç'të shihje, më këndonte gazetën. U pika thaçë me vehte, ç'të lipsen ti këto. [...] Ia shtroi fjala fjalës me ca burra atje që qenë me ne. Gër si mulliri pa koqe, na kroi zorrët gjithë kohën, më shumë ajo se ata që qenë dhe burra. Moj si s'pushoi ajo çikë, e vër me duar e me këmbë, e puf cigaren, e puf cigare, nga veshët ma kërrente timin".[17]

Edhe më i fortë bëhet hetimi i ndryshimeve teksa vëren në skena të tjera pamjen e jashtme, apo siç thuhet në gjuhën e Nënos "të nisurit" e grave në moshë:

"Atje moj të keqen se mos janë vetëm të ratë që nisen. Gra në shkallën time më kishin buzët katër okë. Me çantë në dorë, hedhur dhelpra tej e tej, me thonjtë të kuqa, ruaza në qafë, me këpucë me thundra të larta. Pa le kapella me një u- fluturonte nga koka. Laçë mëntë, laçë mëntë. U pika, leni moj radhë së rave, ç'doni më akoma, nuk e dija që dhe në pleqëri tërbonet njeriu. S'di, varrit do t'ia mollois këtë që kam parë..."[18]

Dhe mund të thuhet se përmbyllet simbolikisht me praninë e një zonje të moshuar pikërisht në auditorin ku studionte mbesa, ditën që Nënua viziton "shkollën e madhe":

"Unë që s'mirja vesh vështroja andej e këtej, po ç'të të thom,

17 "Udhës", "Tomori", 9 qershor, 194
18 "Ditën e parë…", "Tomori", 3 korrik, 1940

m'një anë qe një plakë në mos në shkallën time ati këtu një soj... pastaj ku të linte të bardhët e të kuqtë që të shikoje në qe plakë apo jo, shkruante edhe ajo. Hapa sitë, thaçë me vehte, këtu është vendi i mësimit, s'kanë punë tjetër. Po ajo kallogre me këmbë në var dhe mëson akoma".[19]

Ndërsa "shthurjen totale" Nënua do ta lidhë me përvojën e saj në Teatër-Kabare, ku brendia tematike ashtu dhe paraqitja e trupave të veshur fare pak, puthjet, afërsia mes trupave femërore e mashkullorë si në skenë ashtu dhe në plate, do ta trondisin fort duke e shtyrë t'u deklarojë shoqeve se "të them të drejtën atje është maskarallëku sheshit".[20] E megjithatë, te këto gra "të shthurura" Nënua shquan mundësinë e një jete cilësisht më të mirë. Vëzhgimet e përfundimet e vazhdueshme në të cilat mbërrin ajo dhe shoqet e saj gjirokastrite për vështirësinë e patjetërsueshme të jetës së tyre femërore, të mbërthyer në varfërinë materiale por edhe në darën e tradicionales së palëvizshme, në të cilën gruaja ka një status të ulët e shërbyes në raport me burrin, lindin pikërisht përmes kësaj përballjeje me "gratë e botës" duke njohur te ato, krahas diferencës morale e botëkuptimore, ekzistencën e një jete në mos më të bukur, së paku më të lehtë femërore, me kushte e komoditete moderne, me liri e respekt të qenies dhe gjinisë. Ky konfirmim, ndonëse nuk ndryshon asgjë në jetët e tyre, i bën më të qarta ndoshta për prirjen e re në sjelljet e bijave, nuseve dhe mbesave të tyre, duke kuptuar në heshtje, perëndimin e një epoke dhe shfaqjen e një brezi të ri femëror edhe në vendin e tyre.

Në thelb, Nënos iu deshën jo më shumë se 20 ditë, të cilat i cilëson "si në ëndërr..." për të rrokur ndryshime e deri papërputhshmëri mes dy "qytetërimesh", të sajin dhe atë Roman të viteve '40. "Ndrishe rronin, ndrishe hanin, ndrishe flitnin"[21] – ky është përfundimi sintezë i kësaj përqasjeje e cila kalon e sprovohet në përvojën jetësore të

19 "Nënua në shkollë të madhe", "Tomori", 1 gusht, 1940
20 "Nënua në Thjatro", "Tomori", 17 korrik, 1940
21 "Nënua do Gjirokastrën", "Tomori", 21 gusht, 1940

vetë Nënos plakë. Ndonëse çmon cilësinë e jetës romane, pa asnjë mëdyshje ajo dëshiron të jetojë "këtu, ku jam lerë e rritur edhe në këtë baltë të tretem". Në fakt, teksa lexon pjesën e fundit me titull Nënua do Gjirokastrën (IX), kupton se Nënua plakë ka jetuar ato 20 ditë romane jo në Itali por mes dy botësh, mes Romës që po zbulonte dhe Gjirokastrës që i mungonte. "Udhës ecja, sokaqet e këtushme më kujtoheshin, pastaj kalldrëmet, muri i gremisur i bashtesë". Nga bota që i mungonte, apo më saktë për të cilën e merrte malli, Nënua kërkon peizazhet, interieret, zërat, gjestualitetet, shijet - një nostalgji e kulturës së të jetuarit e mbërthen përmes çdo detaji: "Thuaj ti, haja dot me lugë e me pirun e thikë, hahesh mishi pa një çikë lënk? Kur vija bukën në gojë, më dukesh si kashtë, kujtoja këtë të shtëpisë, vërtet më bien krahët, po është gjithë shijë".

Si përfundim, kjo kulturë të jetuari është vendimtare në të jetuarin e botës me të cilën je e lidhur me mijëra fije: "të thom, jemi mësuar kështu ne. Si ato s'bëjnë dot këtu, ashtu s'bëjmë dhe ne atje". Ndoshta më shumë se "çudirat" teknologjike e sidomos ato morale me të cilat u përball Nënua, janë cënimi i këtyre fijesh kulturore që përcaktojnë ndarjen e madhe, atë përfundimtare, ku secili do të duhej të ndjehej mirë në vendin e vet, i mbështjellë nga rrjetëzimi kulturor që e përcakton dhe e identifikon. Prandaj mund të flitet këtu për një zhvillim vendimtar në këtë pjesë të aventurës romane të nostalgjisë kulturore në një lloj nostalgjie identitare. E ku më mirë do të mund të simbolizohej kjo përveçse me shtëpinë-kështjellë gjirokastrite, pjesë arkitekturore e të cilave janë edhe vetë Nënua e shoqet e saj, me qytetin dhe jetën njerëzore e shpirtërore që ai ngërthen, shprehje e një identiteti të mirëfilltë e specifik, shenjim i marrëdhënies së njeriut me bashkësinë dhe botën e vet:

"Këto mure ku kemi rrojtur gjithë jetën, këto shtëpi me di palë shkalla, këto sokaqe të ngushta sa me zi shkon një njeri, këto udhë

thikë, këto të qara e ulurima, këto të hira e të dala, këto këngë e këto valle, këto janë për ne."[22]

Dhe kështu, në pak rreshta më tutje, përfundon (teksti) dhe aventura romane e Nënos plakë, aventura e zemrës shqiptare në Botën e madhe. Por thuajse në të njëjtën kohë, e në të njëjtin vend, një tjetër aventurë kishte zënë fill, aventura romane e një zemre shqiptare në kërkim të dijes dhe njohjes. Ajo është paradoksalisht mëma dhe mbesa e Nënos plakë: Musine Kokalari shkruante e përgatiste për botim më 1941-1942 *Jetën e saj universitare.*

Roma e Musinesë

Ky rrëfim i ri për Romën tendos fillin e rrëfimit të "Botës së Tjetrit" në dy skaje. "Vigjilenca" konservative e Nënos plakë, mbetet sprovë e dëshmi imagjinare e autores Kokalari, një lojë e rrëfimit antropologjik mes habisë, refuzimit dhe ironisë. "Një lloj niveli vëzhgimi i shoqërores – gjykon Mauro Geraci -, që e tejkalon atë të një kurioziteti të thjeshtë, vëzhgim të cilin Musineja do ta mbajë paralelisht të lartë në çdo përvojë jete edhe në tekstin autobiografik që rezulton i mbjellë me përshtypje të mprehta mbi ritme, zakone e raporte të shoqërisë romane"[23]. Për më tepër, rrëfimi i Romës së Musinesë sprovon rrëfimin personal, autobiografik, si udhëtim intelektual e shpirtëror në një botë të dijes, kulturës e mundësisë, por edhe si një sprovë e unit përmes përvojash e sfidash të panjohura, prej të cilave mëson si të njohë e të pohojë vetveten. "Mëma" dhe "mbesa" e njëkohshme e Nënos plakë, Musineja, ndërmerr udhëtimin në Romë, për t'u rikthyer, nëpër procese të thella e të holla vetëdijësimi, te "Gjirokastra" e saj simbolike, që tashmë është zgjeruar nën emërtimin dhe nocionin e "atdheut". Paralelisht, edhe

22 Ibid.
23 GERACI, Mauro, *La mia vita universitaria*, Vep. cit., f. 28

"Roma" e saj e shënimeve *Jeta ime universitare* do të pësojë zgjerim e tkurrje kuptimore në funksion të përftesës së vetëdijes së unit që e rrëfen. Teksa rritet kulturalisht së brendshmi, Roma për Musinenë është "Qyteti i përjetshëm", i madhështisë së artit, i lavdisë së të shkuarës, i shkollimit formues dhe jetës së strukturuar urbane. Teksa përballet me botëkuptime e mendësi të tjera, shpesh në kundërshti me vetveten, "Roma" e shtrin nocionin e saj në një Itali të përgjithshme, e cila, në momentet më kyçe të rrëfimit, duke lidhur fort, pazgjidhshëm, intimen dhe kolektiven, personalen dhe shtetëroren, shpërfaqet qartë edhe si një "Itali fashiste". Përballë saj Musineja rritet në vetëdijen e vet, njëkohësisht si zemër shqiptare dhe si qytetare e botës. Ky rikthim i pasuruar te vetvetja përbën pikat nevralgjike të tekstit dhe alternon nën trajtat e alteregos personazhet femërore, Nënon dhe Musinenë.

Shembujt e përzgjedhur nga Musineja për të ilustruar këto momente të rëndësishme refleksive e vetëdijesimi, shoqëruar me vëzhgime të holla antropologjike, shfaqen qysh në faqet e para të librit por, gjatë shkrimit, ato përforcohen duke u bërë pjesë thelbësore e rrëfimit dhe e ngjarjes. Ky kalim nga shembulli antropologjik (e rastësor) në fillim të shënimeve, te rrëfimi i unit dhe rigjetjes së vetvetes në përballje tashmë të vetëdijshme me Tjetrin, përbën një nga tiparet më të rëndësishme të këtij shkrimi. Në fillimet e *Jetës universitare* sprovohen intelekti dhe emocionet përmes zbulesës së botës tjetër, të huaj e të ndryshme. Përgjatë tekstit, e sidomos drejt fundit, sprovohet ndjenja e fortë e dashurisë dhe përkatësisë, njihet lënda e thellë e identitetit, bota dhe vetvetja lexohet përmes zemrës.

Një nga shembujt interesantë që i vlen Musinesë si ilustrim për sprovën e njohjes me tjetrin dhe me veten përmes tjetrit (shprehi tipike e një vëzhgimi antropologjik të botës) është "detyrimi" i saj për t'u shpjeguar besimin islam personave që e pyesin qysh në fillim të qëndrimit të saj në Romë:

"Italianët janë gjithashtu një popull i lidhur shumë me fenë e tyre. Pyetja e parë që më bëhej ishte ajo e fesë time. Kur përgjigjesha se isha myslimane, pritej me habi si një lajm. Midis atyre që njihja, disa fanatikë ekstremistë, të ekzaltuar nga besimi që kishin, me ide të bazuara në një edukatë klasike, me një akt besimi mbi pagabueshmërinë e saj, të vazhdimësisë të së kaluarës e imponuar si një shembull i pandryshueshëm, ndjenin nevojën të më shpjegonin fenë e tyre, që më ishte e panjohur si doktrinë. Dëshironin të dinin diçka edhe nga e imja. Për të qenë e saktë, deri në atë kohë, dija se isha myslimane, por kurrë nuk isha kujdesur ta thelloja këtë lëndë. Meqë besoja në fuqi të mbinatyrshme, jashtë kësaj, nuk kërkoja të mësoja më shumë. Duke parë besimin e të tjerëve, e shtyrë nga instikti, u vura për të parën herë të studioja doktrinën e fesë time. Kjo m'u duk interesante. Kur arrita të arsyetoja, kuptova përse më dukej e çuditshme se si një fe e lindur dhe e zhvilluar në mjedis oriental, vinte e interpretuar këtu nga mentaliteti oksidental".[24]

Por nuk është ky "ekzotizëm" i ndërmjetësuar përmes intelektit apo dhe skena të tjera të ngjashme ato që e përballin realisht autoren Musine Kokalari me Botën tjetër. Sprova e vërtetë kalon mes përjetimit të dashurisë për djaloshin roman P.T. Përgjigja e saj e atypëratyshme ndaj propozimit "të natyrshëm" të tij dashuror na zbulon një ndërthurje të fortë, dhe që do të mbetet e pazbërthyeshme, mes qenies dhe identitetit, pikërisht brenda e përmes qerthullit të dashurisë:

"Por unë jam shqiptare – iu përgjigja – e ndjej të kem mbetur e tillë [...].".[25]

Teksa e ka të qartë se kjo përgjigje do të donte një sqarim të plotë edhe për lexuesin e saj të mundshëm, autorja vijon me një paragraf shtjellues, i cili, ndonëse vjen si pjesë e shënimeve të "Vitit III" prek jetën e saj në Romë qysh prej fillimit:

24 *Jeta ime universitare*, Vep. cit., f. 341
25 Ibid. f. 382

"Kushtet e shtetit dhe të politikës, megjithëse ishin miqësore, shkaktonin shpesh herë në qenien tonë, ndofta pa të drejtë, interpretime pak të këndshme. Në vitin e parë, i cili nuk më harrohet, ndonjë nga italianët ka ofenduar, pa dashje, vogëlsinë e vendit tim; edhe në thellësi të zemrës kam ndjerë diçka që, nëse nuk dukej e drejtë në gjykim, prekte megjithatë ndjenjën, për më tepër që nuk mund të pretendoja ndaj nënës sime, që dashuria të më lidhte më një italian."[26]

Paralajmërim..., për veten, për lexuesin, për mikun...? Në studimin krahasues mes dorëshkrimit dhe daktiloshkrimit të *La mia vita universitaria* studiuesja dhe arkivistja Simonetta Ceglie[27] konfirmon vetëdijen e shkrimit të Musine Kokalarit edhe në hartimin e kësaj lënde dëshmuese, ku dallimet mes dy formave të tekstit janë në thelb përforcuese të stilit dhe kuptimit. Daktiloshkrimi shpreh vullnetin e plotë të autores në nivel të shprehjes por edhe të kuptimit të tekstit. Kumti i saj i përforcuar përmes qortimeve tekstore të "kopjes së dytë" është kumt i pohimit autorial se gjithçka e shkruar aty është dëshmi e gjykimit dhe refleksivitetit të pandërprerë të saj mbi jetën dhe tekstin, mbi personalen dhe personin, mbi individin, individët dhe së fundmi tërësinë e tyre – shtetin.

Historia dashurore mes Musinesë dhe P.T. zhvendoset mes pikëpyetjeve dhe pamundësive. E lidhur fort me pasionin e përbashkët për dije, me emocionin e pazëvendësueshëm të të nxënit e zbulimit,

26 Ibid.

27 "Studimi dhe analiza krahasuese mes daktiloshkrimit dhe variantit paraardhës të dorëshkrimit, që të dy autografë, të cilët sot ruhen pranë Arkivit Qendror të Shtetit në Tiranë, janë të nevojshme për të kuptuar metodologjinë e shkrimit dhe të rishikimit të tekstit, që ka përdorur autorja. Nëse shumë pjesë të tekstit duken të shkruara spontanisht, korrektimet e shumta, fshirjet, shpjegimet dhe spostimet e ngjeshura në dy dokumentet e marra në shqyrtim, provojnë se përpilimi i kujtimeve ka qenë fryt i një pune të gjatë prej murgu, me gjasë e kryer për shumë kohë, asnjëherë e përfunduar krejtësisht. Çdo modifikim, plotësim, limim që i është bërë tekstit duket i menduar mirë; sidomos, sa i përket elementeve të prishur në tekst, bëhet e qartë, sa për të dhënë një shembull, fshirja e nistoreve të emrit të një kolegeje hebreje, të hequra nga daktiloshkrimi, ndoshta për shkak të ligjeve racore dhe të deportimeve."; sipas CEGLIE, Simonetta, *La mia vita universitaria*, Vep. cit., f. 102 [përkthyer për botimin shqip nga Arta Marku]

e mbështjellë me atë libido sciendi dehjen e së cilës e shijojnë veç shpirtrat e mendjet kurioze, ajo endet hutueshëm, "albatros studentor", e thyeshme dhe efemere, në truallin e reales. Mes tyre hyn lufta, largësia, thashethemet, intrigat, e më tej gënjeshtrat e tradhtitë. Por, pikërisht, në këto momente të sprovës së thellë shpirtërore, në vetminë e zemrës së lënduar, ka vend për të përkufizuar truallin simbolik mbi ku ngrihet "e shenjuar" gjithçka:

"Atëherë kuptova që një burrë, siç shkruan letra dashurie me shumë lehtësi, pa ndjerë asgjë, ai duhet të bëjë edhe luftën! Atëherë fillova të mendoj thellësisht se çfarë është Atdheu – vendlindja, jo tokë për t'u zmadhuar. Patriotizmi është ndjenjë fanatizmi dhe krenarie. Sa më tepër të ndryshme të jenë këto ndjenja, aq më tepër bëhemi të papajtueshëm. Dhe në realitet? E kuptova më vonë."[28]

Të kuptuarit për Musine Kokalarin është një proces thellimi në përvojën e jetës dhe në mendimin shqyrtues e kritik. Në njohje me tjetrin zbulohet vetvetja. Dhe vetvetja është e patrajtueshme, e panegociueshme. Prej saj nuk mund të shkëpusësh dot më asgjë që nuk ka rënë vetë më parë. Duke shfrytëzuar një citim të shkrimtarit të mirënjohur italian Giovani Papini, i cili në një artikull të vetin shprehej se "Italia nuk kishte pushtuar veçse shtete të prapambetura, primitivë dhe gjysmë barbarë si Abisinia dhe Shqipëria" Musineja pyet nëse mos "ishte ndofta kjo, një nga arsyet e luftës së brendshme gjatë dashurisë?". Simonetta Ceglie vëren të shprehur te "narracioni i Kokalarit" të dëshmuar "gjithë aftësinë për të qëndruar brenda dramave në vetë të parë – mënjanimi, fashizmi, lufta, përjashtimi, sëmundja, vdekja – por duke ditur t'i japë edhe një paraqitje letrare që shfrytëzon kritikën e paanshme, shikimin e ëmbël dhe melankolik prej një farë distance të kujtesës verghiane."[29]

28 *Jeta ime universitare,* Vep. cit.,. f. 412
29 CEGLIE, Simonetta, *La mia vita universitaria*, Vep. cit., f. 93 [përkthyer për botimin shqip nga Arta Marku]

Duket sikur përgjigjen pyetjes sa intime aq filozofike të Kokalarit ia ka dhënë 10 vite më pas Albert Camus, duke pohuar përmes *Njeriut të revoltuar* më 1951se "Fashizmi është akt përbuzjeje. Dhe [...] çdo formë përbuzjeje, kur ndërhyn në politikë, përgatit ose vendos fashizmin."[30] . Ndërkohë, "e revoltuara" Musine Kokalari përmbyllte rrugëtimin e vet shpirtëror drejt identitares së pohuar, e strehuar përfundimisht te pjesa e patrajtueshme e vetes dhe lehtësisht e përbuzshme nga arroganca (po aq e patrajtueshme) e një bote përfundimisht të huaj:

"Unë ndjeja të kisha mbetur primitive, vajza e rritur në mes të njerëzve të varfër, në një vend të vogël, me rrugë të shtrembra, me oborre të rrethuara me mure; në mes të këngëve që janë rënkime, dhe të vajeve të grave tona, nën një qiell gri. Shpirti im ka mbetur kështu dhe nuk mund të binte dakord me një shpirt qytetar, ultramodern."[31]

Nënua plakë do ta kuptonte e përkufizonte Gjirokastrën e saj teksa jetonte nostalgjinë sëmbuese në zemër të Romës moderne: "Këto mure ku kemi rrojtur gjithë jetën, këto shtëpi me di palë shkalla, këto sokaqe të ngushta sa me zi shkon një njeri, këto udhë thikë, këto të qara e ulurima, këto të hira e të dala, këto këngë e këto valle, këto janë për ne."[32] - u thotë ajo mikeshave në mbyllje të rrëfimit. Nënua rrëfen gjithçka që pa e ndjeu në vetë të parë dhe e përfundon rrëfimin me "ne-në" kolektive identitare, si rigjetje e rikthim tek e tëra.

Për Musinenë "secili e ka një vend me kujtime e me tradita dhe një thirrje nostalgjike të tokës, edhe nëse janë shterpë, që bën të përshkojë në venat tona një ndjenjë e thellë."[33] Një ndjenjë të tillë ajo e përjeton duke iu afruar Tiranës në pranverën e vitit 1941, "e shëruar – shënon ajo -, nga kimeritë e dashurisë e të miqësisë". Këto "kimeri" mbeten simbolikisht në vendin tjetër, në vendin

30 CAMUS, Albert, *L'Homme révolté*, (1951), në Albert Camus, Œuvres complètes nga Jacqueline Lévi-Valensi, Vëllimi III, Gallimard, Paris, 2006 f. 216
31 Ibid. f. 417
32 "Nënua do Gjirokastrën", "Tomori", 21 gusht, 1940
33 *Jeta ime universitare*, Vep. cit., f. 417

e huaj, mbas zbulesës së vetvetes, në vendin e mrekullueshëm e me njerëz të dashurueshëm, por që nuk zbrisnin dot aq thellë në zemrën tashmë shqiptare të Musine Kokalarit. E vetëdijshme, ajo i pohon vetes në ditën e laureimit: "Musine, ka përfunduar për ty jeta në qytetin e madh, ku ke ardhur si e huaj dhe ku ke mbetur e tillë në mes personazh të panjohur [...]. "[34]

Ky mbetet thelbi i aventurës së përbashkët romane të Nënos Plakë dhe studentes Kokalari, një aventurë e zemrës shqiptare që rizbulon vetveten, shqiptare, një zemër e thjeshtë apo e ndërlikuar, natyrshëm "e huaj", në një vend të huaj.

34 Ibid. f. 432

Dr. Albanë Mehmetaj
Universiteti i Prishtinës

Kokalari për Kokalarin

Jeta ime universitare e Musine Kokalarit, që është objekti i studimit të këtij teksti, me vetë titullin shenjon zhanrin ose formën e shkrimit, me bazë kujtesën. Kujtimet, si shkrim personal, paraprakisht e kanë të përcaktuar destinimin dhe synojnë të sjellin informacion mbi jetën e mbi ngjarjet personale, por që natyrisht struktura e tekstit ndërlidhet edhe me rrëfimin për vendin ose vendet, kohën, situatën dhe personazhet e tjerë që lidhen me rrëfimin bazik. Do të thotë, struktura tekstore e Kujtesës së Kokalarit *Jeta ime universitare* përcaktohet nga statusi i tekstit, nga destimi e synimi. Edhe pse autobiografia është një variant i jetës së kujtuar, kujtesa si shkrim personal nuk mund të quhet autobiografi (sipas Filip Lezhen), por, si autobiografia, edhe kjo formë ka pikë esenciale identitetin e autorit dhe realizohet nëpërmjet tregimit retrospektiv mbi jetën dhe historinë e personalitetit, në një kohë të caktuar.

Jeta universitare e Musine Kokalarit rrëfehet si prozë nëpërmjet kujtimeve, si formë personale, si tekst poetik e si prodhim i dëshmive të përvojave jetësore, prandaj realizohet nëpërmjet rrëfimit në vetën e

parë e shumë të përqendruar (narracionit autobiografik), për të shquar subjektivizmin dhe për të dhënë sistemin gjurmëve e të shenjave subjektive. Kokalari rrëfen në trajtë të fragmentuar, më shumë sesa duke ndjekur kronologjinë, duke zgjedhur pjesë të rëndësishme të jetës, për t'i elaboruar në një kuptim më të thellë dhe për t'i dhënë artistikisht efektet e të vërtetës e ndodhitë reale që nganjëherë duken të pamundshme.

Kujtimet objektivojnë jetën studentore të autores, por pse zgjedh Musine Kokolari të shkruajë kujtimet e saj të rinisë në rini? Cili është motivimi? Kjo mund të diskutohet në dy mënyra: duke iu referuar hyrjes së tekstit apo vetë tekstit. Në plan të parë dalin rrëfimet për vitet e universitetit, për të theksuar zhgënjimin që ka pasur me Romën, në raport me atë se çfarë i prodhonte fantazia rinore. Në këtë plan ajo e zbulon veten në dy faqe: si vajzë të vogël që, së bashku me moshataret e saj, kanë fantazuar Romën, bukuritë e dijen e saj, pastaj veten të rritur, pas një periudhe katër vjeçare të jetës në Romë. Kokalari më konkretisht te kjo pjesë do të theksojë idenë që, pasi shfrytëzon bukuritë dhe prodhimet artistike të Romës, ato kalojnë në rëndomtësi, pasi që kërkesat e saj janë të tjera dhe fantazia e saj do gjëra të tjera. Situata e ndjesia e tillë mund të zbërthehen më së miri nëpërmjet leximit të psikobiografemave të Kokalarit që do t'i shohim më tutje.

Në planin e dytë, motivimi buron nga mjeshëtria e të rrëfyerit, pasi që Musineja në atë kohë ishte provuar si tregimtare dhe, paralelisht me studimet, shkruante e më vonë edhe e botoi përmbledhjen me novela *Siç më thotë nënua plakë* (Tiranë, Gutenberg, 1939), pas një studimi deri në imtësi të zakoneve dhe të riteve au-tentike shqiptare gjirokastrite. Edhe pse te tregimet synon të krijojë distancë me objektin, duke mos u poziciunar hapur, te kujtimet, për shkak të formës, Musineja del më ndryshe, duke theksuar subjektivitetin, por me po të njëjtin stil të prozës tregimtare trajton pjesë të jetës në format e vogla të saj ose

në miniatura, siç i emëronte Lasgush Poradeci. Kur i lexojmë krahas kujtimet dhe tregimet, konklu-dojmë se në të dy rastet, përveç pamjes që ka dhënë për një ambient të vogël e ngjarje të vogla, Kokalari ka trajtuar botën e brendshme të femrës shqiptare, psikologjinë e saj, si dhe vështirësitë e jetës femërore.

Musinesë, në njëfarë mënyre, edhe i sugjerohet të shkruajë për përshtypjet e saj në Itali, si një grua shqiptare, nga Shkëlqësia Parinu, komisionar në Shqipëri. Ajo përpiqet të shkruajë për këtë formë, e motivuar nga tregimi "Gjyshja plakë në Romë", në të cilin rrëfehet shkuarja e gjyshes në Romë te mbesa (që është vetë autorja), e që mrekullohet nga gjërat e reja që sheh aty, por përfundimisht do të vdesë në vendin e saj e në shtëpinë e saj.

Musine Kokalari, duke e dashur dhe ndjerë letërsinë deri në pafundësi, bën që diskursi i saj i kujtimeve të marrë formën e tregimit, edhe pse synon që t'i radhisë faktet. Sikurse te tregimet, edhe te kujtimet ajo ka objekt femrën, por tash si rrëfim i vetes në vetën e parë, në trajtën Kokalari për Kokalarin.

Te përmbledhja *Siç më thotë nënua plakë* Poradeci vlerësonte që "skicat" dalin si copa jete dhe të kënaqin dhe të shijojnë estetikisht, ndërsa kjo kërkesë hetohet edhe te kujtimet, duke u dhënë me po atë mjeshtri e fuqi stili, për t'i prodhuar "copëzat e jetës" ose biografemat. Në të dy format, në tregime e kujtime, autorja jep estetikisht jetën, jo në plan sociologjik, pasi që ajo do të shenjojë bukuritë e vendit dhe të zbulojë të bukurën edhe brenda të së shëmtuarës: në rrugët e papastra, në baltë, në fëmijët e veshur keq e në jetën e vështirë, si dhe në vetminë e saj (kujtimet), në të cilën gjen më së miri motivet e së bukurës. Kështu që, nga kjo optikë duhet vlerësuar edhe zgjedhja e shkrimit që thekson estetikën e tekstit, për të rrëfyer kujtimet universitare. Kjo formë shkrimi ka bërë që edhe kujtimet e saj të mund të lexohen si "skica", si pjesë "të këputura" të një jetë të gjallë e të rrëfyera artistikisht.

Tani duhet që tekstin ta lexojmë në biografema, pra nëpërmjet kujtimeve dhe rrëfimeve që bëhen shtyllat kryesore të jetës së rrëfyer të Kokolarit. Nëpër shenjimin e situatave jetësore e të përvojave vetanake, ndër më përfaqësueset të një kohe të caktuar, Kokalari e strukturon tekstin në katër kapituj që rrëfejnë katër vitet universitare të saj. Ky lloj strukturimi i tekstit kap moshën e rinisë, të jetës universitare të Kokolarit, siç është theksuar në titull *Jeta ime universitare*; e herë-herë, siç e do zhanri, kap edhe copëza përpara, nga mosha e fëmijërisë.

Biografema e parë duket që në Hyrje të tekstit dhe është me peshë për shkak të rrëfimit të vështirësive të femrës shqiptare për t'u arsimuar, si dhe për shkak të raportit të autores me ëndrrën për studimet universitare:Në qershor të vitit 1937 përfundova në Tiranë studimet e shkollës së mesme dhe pikërisht, atherë, fillova të mendoj me intensitet, për muaj e muaj të tërë, të realizojë një aspiratë të madhe e të re për ne vajzat shqiptare: studimet universitare.[1]

Dhe: Përjetimet e universitetit gjatë këtyre viteve, kanë qenë me të vërtetë të kundërta me atë çka më kishte krijuar fantazia.[2]

Në pjesën e parë, Kokalari rrëfen jetën e vet prej momentit të largimit nga shtëpia e nga Shqipëria, duke shënuar edhe muajin e vitin, ndarjen nga familja e ëndrrën për Romën e saj. Kështu, duke e ndjekur rrjedhën e rrëfimit, del se biografema esenciale e Musine Kokalarit të jetë së pari e ëndërruar. Kjo biografemë predispozon ndërtimin e biorafemës tjetër të rëndësishme të Kokalarit: atë të zhgënjimit shpirtëror, duke bërë që Kokalari të mos e njohë lumturinë, duke u familjarizuar me monotoninë. Kjo biografemë del shumë herë në tekst dhe e Orienton diskursin e autores, për të shkuar edhe drejt pyetjeve filozofike: Ç'është jeta? Pse gjithë kjo dëshirë për të jetuar? Kjo është arsyeja për të cilën durojnë shumë dhimbje, megjithëse duke e ditur se, një ditë apo tjetërën, duhet të vdesin gjithsesi? Në

1 Musine Kokalari: *Vepra - vëllimi i parë*, Geer, Tiranë, 2009, f. 335
2 Po aty

këtë mënyrë ajo nis të thurë si rrëfim formulat e saj jetësore, duke konkluduar se nga jeta nuk mbetet asgjë, përpos pluhurit, dhe se e përjetshme është vetëm natyra.

Biografemë e rëndësishme është edhe rrëfimi për dashurinë e saj, e këputur nga zhgënjimet që dashurinë e bëjnë të duket qesharake, ndërsa të dashurin komedian.

Metoda e punës dhe e studimit, me obligime shumë të mëdha, është biografemë që zbulon: idetë, pikëpamajet, botëkuptimet e Kokalarit. Në pamjen që e krijon ajo vetë për veten, del si femër me karakter të fortë kërkues e që gjithmonë mbetet e pakënaqur nga punët që i bën, pasi që gjithmonë kërkon më perfeksionimin.

Në këtë mënyrë rrëfimi i Kokalarit e ndërton edhe tekstin karakterizues e vlerësues për vetë Kokalarin, duke dhënë ndjeshmërinë e saj që ka për të afërmit e po-saçërisht nipin dhe mbesën (Karolinën dhe Hektorin).

Një informacion tjetër që del nga një tjetër biografemë e Kokolarit është paraqitja e kulturës oksidentale të Italisë në raport me atë orientale të Shqipërisë; mënyra e konceptimit të fesë së krishterë nga italianët dhe asaj myslimane nga shqiptarët, mendimi i italianëve për shqiptarët e përshkrimi i Kokalarit për italianët e për fetë.

Përmallimet e Kokalarit për familjën, vendin, gjuhën, përbëjnë një biografemë të rëndësishme të kujtimeve të saj, gjë që e bën atë të kthehet në tokën e saj, të cilën e koncepton si një vend me kujtime e tradita e më thirrje nostalgjike të tokës. Kjo vërehet më së miri kur krejt në fund Kokalari shkruan se do të kthehet në vendlindje, për të kaluar jetën në mjedisin e saj të vjetër, duke i lënë mbarapa ëndrrat dhe vendin në të cilin mbeti përherë e huaj.

Ndërsa në biografemën e fundit, në të cilën shenjohet momenti i saj i laurimit për letërsi (me tezën: "Literatura shqiptare - Naim Frashëri), përfundon rrëfimi për jetën romane të Musine Kokalarit. Pra, kemi një përkufizim të pesonalitetit të Kokalarit nga vetë Kokalari

që ndërtohet shkallë-shkallë dhe lidhet me momentet themelore të formimit të saj.

Nëse i zbërthejmë këto biografema në detaje, fitojmë pamjen e plotë të Kokalarit, e cila, në radhë të parë, ka kërkuar qetësinë shpirtërore, duke e gjetur në vetmi, do të thotë duke e kërkuar brenda qenies së saj, si dhe Kokalarin si një studente e studiuese të shkël-qyer që nuk ndalet pa e përmbushur misionin e saj.

Biografemat e jetës studentore të Kokalarit i lexojmë nga Kokalari, nga një autore që shquhet për stil rrëfimtar e që nëpërmjet kulturës së gjuhës informative dhe letrare i jep pikat kyçe të jetës. Kokalari për Kokalarin lexohet me dhemshurinë më të thellë, kur e kemi të njohur fatin e saj dhe jetën e humbur për të ruajtur aq sa mund të ruhej nga vlerat morale të shoqërisë shqiptare në një gjysmëshekull çnjërëzor të saj.

Siç më thotë nënua plakë

Libri i parë me tregime i Musine Kokalarit, *Siç më thotë nënua plakë*, kërkon një shqyrtim të veçantë, pasi që shpalos autoren në disa plane. Në radhë të parë teksti duhet vlerësuar duke pasur parasysh që buron si prozë e parë e autores së parë shqiptare, pastaj që del si rezultat i një studimi ambicioz dhe një pune të palodhshme të saj kundrejt kulturës popullore, në funksion të tekstit artistik, si dhe, ndryshe nga shkrimet autobiografike, në të cilat shohim të ndërtohet portreti i saj, *Siç më thotë nënua plakë* e forcon më shumë ikonën e autorës, kur shihet jashtë biografisë. Me një fjalë, është boshti artistik dhe tematik ai që dallon e shquan Musine Kokalarin, prandaj edhe kërkimi duhet shenjuar në këtë pikë, pasi që edhe ky tekst ka për objekt Kokalarin e tregimeve.

Në këtë pikëpamje *Siç më thotë nënua plakë* përbëhet nga dhjetë tregime, të cilat lidhen me njëra-tjetrën edhe tematikisht, edhe për nga struktura narrative, duke ndryshuar në momente të caktuara

të rrëfimit dhe të përshkrimit. Me këtë rrëfim Kokalari kërkon të ndërtojë një filozofi të vetën jetësore, përmes idiomatikës popullore, duke funksionalizuar kështu mjaft elemente gjuhësore e jetësore. Këto dy lloj elemetesh Kokalari i ndërton dhe i procedon në mënyrën e saj, me konceptet e saj artistike dhe estetike, duke u dalluar kështu për një origjinalitet të stilit.

Tregimet e Kokalarit ndjekin një vijë rrëfimi, por ndryshojnë në situata narrative dhe në tipat narrativë, për të krijuar efekt të përqendrimit në pikën esenciale. Në këtë mënyrë, narracioni është heterodiegjetik e kështu pamjet e brendshme të personazheve dhe të botës së objektivuar nga Kokalari jepen më qartë dhe më specifikisht.

Rrëfimi synon të prekë sipërfaqen psikologjike të femrës, duke hyrë në botën femërore të mbushur me probleme e telashe, e cila funksionon si një mënyrë e veçantë e të jetuarit dhe e të menduarit. Nëpërmjet shprehjeve të veta tekstuale, Kokalari krijon retorikën e tekstit, duke arritur kështu të realizojë idenë letrare dhe të krijojë emocion letrar, në rrëfimin e përpjekjeve për ekzistencë, e cila sa duket e lehtë, aq është edhe e rëndë. Do të thotë, përmes ligjërimit të Kokalarit ne e shohim gjithë jetën e femrës, e cila i përket moshave të ndryshme dhe ka karakteristika të ndryshme. Këtë kuptim e jep më së miri titulli *Siç më thotë nënua plakë* (që brenda konceptit nënua kemi -vajzën, renë, kunatën, motrën, gjyshen, por edhe një titull që sinjalizon një lloj urdhëri pë mënyrën e sjelljes: siç më thotë).

Nëpërmes rrëfimit artistik, Kokalari shenjon përjetimet e vendit të vet, për të krijuar pamjen e një kolektivitieti, por duke u distancuar intelektualisht dhe objektivisht. Këto situata jetësore dhe ky ambient përjetohen e rrëfehen si një dramë shpirtërore, duke marrë kuptimin e dramaticitetit të situatës, për t'i dhënë kështu formë shkrimit. Pra, edhe pse objekt i të gjitha tregimeve është femra, kemi një dramatikë të karaktereve lidhur me njëra-tjetrën, si dhe një përplasje të motiveve ndëmjet vete, e mbi të gjitha dramatike mbetet jeta e tyre, e cila është

e mbuluar nga fatkeqësitë që sjellin kushtet e rënda dhe rrethanat e vështira. E kjo më së miri vërehet kur shohim tregimet radhazi, p.sh te tregimi i parë, i cili ka titullin e veprës "Siç më thotë nënua plakë", objekt është nënua plakë dhe mënyra e saj e të përceptuarit të jetës. Do të thotë, kemi problemin e mosambientimit të plakës me ndryshimin sodo të vogël të të jetuarit, që është shkollimi i fëmijëve, e sidomos i vajzave. Më shkurt, kemi konfliktin dramatik midis brezave. Ky tregim merret drjetpërdrejt me çështjen e fatit të femrës shqiptare gjirokastrite, që e ilustron fatin e të gjitha femrave shqiptare të kohës.

Në tregimin "Për Mustaqet e Çelos" kemi paraqitjen artistike të pësimeve të ndryshme të femrës, që në këtë rast është martesa e kunatës me kunatin (pasi i vdes burri) dhe e gjithë kjo situatë realizohet si një grindje nga dy gra të tjera për disa gjëra koti, siç e su-gjeron vet titulli i tregimit.

Tregimi "Burri shoku qenit" rrëfen raportin e burrit dhe të gruas, po ashtu, nga perspektiva e një tjetër gruaje, duke e parë drejtëpërdrejt si problem ekzistencial të saj, pra martesën e burrit me një grua tjetër, menjëhere pas vdekjes së gruas së parë.

Shpalosja tjetër e botës së brendshme të femrës realizohet edhe nëpërmjet katëgorisë së smirës për njëra-tjetrën, që realizohet në tregimin "Paç fatin e së ligavet".

Te tregimi tjetër, "Udhën e mbarë pastë", rrëfimi jep një linjë tjetër, duke krijuar një pamje pak më të ndjeshme të të gjithë shqiptarëve dhe konkretisht të përjetimit të gruas kur burri i shkon në mërgim, duke e përcjellë me mall e me barrën e peshës së rëndë që e pret. Pra, kemi një problem të madh sa psikologjik, aq edhe social, temë kjo e përhershme e shqiptarëve.

Konkludojmë se të gjitha tregimet e *Siç më thotë nënua plakë* ngrihen mbi një logjikë të rrëfimit e të përceptimit femëror, si dhe karakterizohen nga një formë e shkurtër e shkrimit. Kështu, tregimet dalin të koncentruara për të thënë thelbësoren, duke hyrë menjëherë në temë, në zbulimin e botës shpirtërore të femrës. Ky vështrim

bëhet edhe më kompleks, duke patur parasysh që narratorja është femër dhe gjithëdijshmëria e saj krijon një raport të sigurt, por jo të identifikueshëm, pasi që autorja e ruan distancën me personazhet e saj.

Rrëfimi i fatit të keq të femrave dhe jeta e rëndë e tyre i përshkojnë krejt tekstet e Kokalarit, duke krijuar kështu një formë të jetës njëplanëshe, të njëtrajtshme e me nëndegzime të së keqës. Në këtë vijë, konfikti kryesor është i zgjidhur me vuajtje, moskënaqësi, urrejtje, shtirje, përshpëritje ose me ndonjë alegori tjetër estetike. Teknika rrëfyese ruan një afërsi emocionale dhe fizike të Kokalarit me tekstin, e kështu edhe një fokusim të brendshëm, por natyrisht duke e ruajtur objektivitetin. Kështu, diskursi i narratores prezanton një jetë të tërë, duke e zbërthyer në krejt kuptimet, nëpërmes fenomenit femër dhe pikëvështrimit femëror.

Teksti i këtyre tregimeve i ka të gjitha karakteristikat e tekstit estetik, që do të thotë se shtron probleme pa zgjidhje dhe që kurrë nuk janë për-fundimtare, por që krijon efekte estetike ose, siç vlerëson Lasgush Poradeci, të shijojnë estetikisht, pasi që kapin copa të gjalla të jetës në formë të miniaturave. Jeta e dhënë në strukturën tekstore krijon vlera nëpërmjet gjuhës, figuracionit, imazheve, simbolikës etj. Kjo përpjekje për ta njohur të bukurën në tekstin e Kokalarit arrihet duke zbuluar mjetin që e ndërton tekstin dhe që është mënyra e të shprehurit. Pra, stili i Musine Kokalarit e krijon të bukurën në tekstin e saj, duke depërtuar dhe duke u shtrirë thellë në jetën e gjallë, për të përçuar efektet.

Ky raport që ndërton vepra e Kokalarit me botën objektivon jetën e vështirë të femrës që formësohet nga problemet tipike, por e keqja e jetës së femrës shkak ka një të keqe më të rëndë që është ai i kushteve sociale, dhe mosdija, në mungesë të njohjes dhe arsimimit. Kështu, duke u rrëfyer këto probleme nga një autore që në radhë të parë edhe i ka studiuar ato dhe këtë mënyrë jetese, nga një prizëm

tjetër dhe formim tjetër, dallojmë një "refuzim estetik" (Ibrahim Rugova) një mospranim të të jeturit të tillë nëpërmjet figurës së ironisë e sarkazmit që te Kokalari del në mënyrë më të përsosur, nëpërmes një lirizmi dhe një filli të të qeshurit.

Që të shohim më qartë domethënien e refuzimit, si kategori estetike, pse dhe si ndodh ajo në letërsi, do të thotë si realizohet dhe kur, si dhe çfarë kërkesash ka, do të shohim një pjesë të teksit të Ibrahim Rugovës, i cili është esteti më i specializuar në letërsinë shqiptare, dhe që është marrë konkretisht me këtë problem, në librin e tij studimor *Refuzimi estetik*, 1987:Refuzim do të thotë të mos pranosh, të mos pranosh atë që të imponohet, e kjo varet nga qëndrimi personal dhe ai i përgjithshëm. Letërsia i ka dy forma, por refuzimi më i madje i saj është refuzim me qenien, me karakterin e saj, që ne e quajmë refuzim estetik. Refuzimi estetik realizohet në formë të drejtpërdrejtë me mjete letrare që njihen prej kohësh, siç janë satira, sarkazmi, grotesku apo ironia e angazhimit në kohën moderne, kur letërisa me vetë praninë e realitetit në vete dhe të realitetit të vet refuzon imponimin. Në një farë dore ky mund të merret si refuzim filozofik apo ontologjik, sepse me vet qenien e saj krijon kontempline dhe konotime të shumta, që përgatisin vetëdijen, shpirtin dhe mendjen njerëzore në jetë për çështje të ndryshme.[3]3

Duke e vështruar në këtë plan, del se autorja e parë shqiptare, Musine Kokalari, në punën e dijes letrare ka qenë mjaft e formuar dhe ka dalluar specifikat themelore të krijimit letrar, pra të letërsisë. Gjithashtu, duke vështruar në këtë plan (nëpërmjet tekstit të Rugovës për refuzimin estetik) duhet të theksojmë se është po ky studiues që, në vitin 1983, e prezanton Musine Kokalarin në Kosovë. E rëndësishme është se po ky estet e vlerëson Kokalarin për stilin, për krijimin artistik dhe për fenomenin gjuhë. Vlerësimi i Rugovës shkon më tej, duke e konsideruar të „folmen çame", dhënë në

3 Ibrahim Rugova: *Refuzimi estetik*, Rilindja, Prishtinë, 1987, f. 15

tekstet e Kokalarit, si tejet të rëndësishmë për gjuhëtarët tanë, si dhe për elemente të gjuhës historike, pasi që mendon se dialekti që përdor autorja përmban shumë trajta gjuhësore që i hasim të veprat e arbëreshëve. Prandaj, edhe në këtë kontekst themi se tregimet e Kokalarit mbeten më një vlerë dhe efekt të veçantë, mbesin tregime që mund të lexohen me kënaqësi në çdo kohë, me temë dhe stil që duhet të studiohen thellësisht.

Nënua plakë në Romë

Musine Kokalari, siç është parë edhe te shkrimet autobiografike, bën objekt të drejtpërdrejtë jetën e saj "romane" (kohën e studimeve në Romë), me dëshirën për të mësuar diçka të vërtetë nga jeta e saj rinore. Ndërsa, në *Nënua plakë në Romë* e shohim Kokalarin të ndarë nga autobiografia, për të shenjëzuar përshtypjet e saj në Romë nëpërmjet formës së novelës. Motivimi është i përbashkët i këtyre dy formave letrare, por tash objekt është nënua plakë, figurë e fuqishme për dashurinë ndaj tokës, vendit, etnisë e po ashtu simbol i fuqishëm kundër jetës në tokën e huaj, çfarëdo të mire të ketë ajo.

Nënua plakë në Romë është novelë e përbërë nga nëntë kapituj: "I. Në shtëpi", "II.Udhës…", "III. Ditën e parë…", "IV. Ç'i zuri siri", "V. Nënua në Thjatro", "VI. S'mar vesh fare….","VII. Nënua në shkollë të madhe", "VIII. Nënua u duk prapë…" dhe "IX. Nënua do Gjirokastrën". Kështu, vetë renditja dhe titujt e kapitujve, sugjerojnë një lexim tematik duke i ndjekur një pas një.

Siç e jep edhe titulli i novelës *Nënua plakë në Romë* ndërton temën e vendit, nëpërmjet një vendi tjetër. Rrëfimi bëhet për Romën nga Gjirokastra, i rrëfyer për shkak të kurreshtjes dhe dëshirës së të afërmëve të protagonistes për të mësuar më shumë për një qytet që prekte majat e zhvillimit kulturor, artistik dhe arkitekturor. E kështu, anasjelltas rrëfimi për Romën e zbulon Gjirokastrën e Kokalarit, si një

hapësirë të vogël dhe të banuar nga një numër i vogël personazhesh: nënua plakë, e cila është personazhi ide, si dhe rrethi i saj: nuset, vajzat, fqinjtë, nipat dhe mbesat. Edhe te kjo novelë, sikurse te skicat, rrëfimi është projektuar të ndodhë brenda shtëpisë së nënuas plakë, në dy kohë, pra nëpërmjet kthimit retrospektiv, si dhe monologut dhe dialogut. Kështu, në këtë mënyrë të thjeshtë, përveç pretendimeve të tjera, arrihet të përshkruhet më së miri jeta gjirokastrite, me të gjitha specifikat e saj.

Në këtë vështrim, nënua plakë del heroinë në dy funksione: për t'i rrëfyer përjetimet për Romën dhe për të mësuar se si duhet jetuar në Gjirokastër dhe si është Gjirokastra. E krejt këto dalin përmes një rrëfimi spontan e të pasherr të plakës, duke i dhënë shijen themelore novelës. Përmes gjuhës shpirtërore të plakës, shfaqen mendime, pamje dhe situata që i nxjerrin qartë ambientet të cilat Kokalari do t'i shenjojë (Romën e bukur dhe Gjirokastrën e dashur e të shejntë). Pra, nënua plakë, e dhënë si një qenie shumë e brishtë njerëzore, e mirë në të gjitha kuptimet e fjalës, që flet sinqerisht dhe që nuk ka shumë njohuri, është "ura" kaluese ndërmjet dy kulturave. Prandaj, në këtë kontekst, projektimi i plakës për përshtypjet në Romë bëhet në mënyrë të habitshme dhe si për një botë tjetër.

Novela në këtë mënyrë jep shpirtin e një krijuesje të veçantë që di të ndërlidhë kuptimet e jetës dhe të moshave, nëpërmjet plakës 60-vjeçe. Ajo rrëfen të mirat e jetës krejtësisht të tjera, të cilën as që i kishte ëndërruar. Pikëpamjet dalin nga mentaliteti i saj dhe në disa plane nga diskursi i fasionimit dhe i zmadhimit, do të thotë duke përshkruar e rrëfyer për gjërat e mëdha dhe të bukura, arkitekturore dhe natyrore të Romës; nga rendi dhe organizimi i jetës së Romës, që po kështu duken edhe në sytë e plakës, p.sh. se si: nata bëhej ditë nga dritat; për dyqanet e mëdha që të fluturonin trutë nga koka etj.

Plani tjetër dhe më i bukuri i novelës, i cili e bën të veçantë krejt rrëfimin, është ai i përceptimit të plakës për gjërat e shëmtuara dhe

veset e këqija të Romës, natyrisht sipas këndvështrimit të saj. Këto përshtypje dalin nëpërmjet një diskursi gazmor të Kokalarit dhe çudisë së nënës plakë: p.sh. kur vajzat dilnin të kapura me djemë dorë për dore, mënyrën e veshjes të shkurtër etj. Kjo mënyrë e të menduarit realizohet më së miri në kapitullin e pestë: "Nënua në Thjatro", kur nënua nuk arrin të dallojë shfaqjen teatrale nga jeta reale, prandaj gjërat që luhen aty për të kënaqur, për nënuan përbejnë çdo të keqe të pa parë deri atëherë: S'latë gjë pa dëftuar, ju shohein edhe burrat kështu, si u bë kjo botë, s'mbeti turp, s'mbeti të thom. Pastaj vija re ata burra që kishin ardhur me ran ë krah, se mos veshtronin atë që kishin pranë po ato që kërcenon.[4]

E bukur dhe plot humor është mënyra se si reagon nënua përballë këtyre ngjarjeve, si dhe mënyra se se si mendon dhe moralizon ajo:Më vinte turp të ngrija kokën, lanet thaçe dhe të parët. Më vinte të rihja mbesën bam e bam, sa të më ngoses dora. Kur duallme jashtë me dridhesh buza dhe ju dredha femrës. Uu - aferim i thaçë, ashkosun të qoftë, për këto ke ardhur këtu. U pika në kokë me gjithë mësim që mësoni në shkollë, në vent që t'ju mësoni në shkollë, në vent që t'ju mësojmë nasihat, ju mësojnë se si të terboheni….[5]

Ky diskurs e përcjell edhe kapitullin e shtatë "Nënua në shkollë të madhe", në të cilin nënua gjykon se mbesa nuk po merr dituri, por po njihet me rrugë jo të mira. Ajo, në këtë kapitull, edhe brengoset për të ardhmen e mbesës, për martesën e saj, sepse sheh mbesën duke biseduar me shokë të universitetit, që për nënuan nënkupton turpin më të madh. Plan tjetër, i cili, po ashtu, prodhon efekte të humorit është edhe gjykimi i plakës për mënyrën se si gratë moderne duan t'i udhëheqein burrat: "e doni burrin t'a mblidhni në grusht, të bëni si të doni, të kumandoni ju.Burri ka vendin e tij dhe gruaja vendin e saj".[6] Kjo pjesë hap pikërisht një mentalitet të vjetruar dhe të ngrysur

4 Musine Kokalari: *Nënua plakë në Romë*, revista "Tomori", 17 korrik 1940
5 Po aty
6 Po aty, qershor 1940

të grave shqiptare, të cilin, nëpërmjet shakasë, Kokalari mundohet ta ç'rrënjosë, duke e vënë përballë një kulture tjetër. Me një fjalë, Kokalari përcaktohet që problemin ta definojë edhe si faktik, edhe si problem të brezave, të cilët i ndërlidh në kontekste të ndryshme që dalin si formula të të vjetrave dhe që përsëritet: "Fëmila në kohën t'onë i hapë sitë pas 40 ditë, kurse tani me të lindur, kanë shejtanin në bark".[7]Përfundimisht, ky rrëfim, qoftë në trajtën e përshkrimit, apo në atë të dialogut, zhvillohet përmes një filli të humorit, duke bërë që ky tekst të mbetet ndër më domethënësit në krijimtarinë e Kokalarit.

Teksti për nënuan plakë po ashtu, po me këtë stil, ndërton një rrëfim të jashtëzakonshëm për dashurinë ndaj atdheut, e cila definohet në kapitullin e fundit "Nënua do Gjirokastrën". Teksti sjell paraprakisht planin tjetër të nënuas plakë, e cila po me atë naivitetin e saj, dashurinë për të mirën, në mënyrën e saj shenjëzon edhe dashurinë për Gjirokastrën e saj. Ajo do vendin e saj, aty ku hante, pinte, rrinte e flinte, donte punën e rëndë të saj dhe e bukën e vet, odën e saj, krevatin e saj, pastërtinë e kafenë shqiptare; do muret e shkallët e shtëpisë ku ka jetuar tërë jetën, sokaqet e ngushta, të qarta dhe ulurimat, këngët e vallet; ajo njëjtëson shtëpinë më kokën, prandaj nënua do Gjirokastrën.

Një temë, stil dhe sensibilitet i tillë dhënë të *Nënua plakë në Romë* shpërfaq Musine Kokalarin në një format tjetër dhe në temën për autenticitetin. Nënua plakë, protagonistja e veprës, edhe pse pothuajse huazohet nga vepra e botuar një vit më herët *Siç më thotë nënua plakë* te ky tekst bëhët më domethënëse dhe më zbuluese e idesë së Kokalarit. Nënua është po ajo qenie njerëzore, me po atë ngrohtësi dhe pak dituri, por këtu ajo ka edhe një qëllim letrar që lidhet më së miri me titullin e kapitullit të katërt të novelës "Ç'i zuri siri". Nënua pra do të rrëfejë për botën e madhe dhe të modernizuar, me syrin e saj të vogël e të ngushtuar.

7 Po aty, qershor 1940

Naim Frashëri

Teza e diplomës rreth letërsisë shqipe, "Naim Frashëri 1846-1900", e Musine Kokalarit, është monografia e parë e autores dhe mbetet projekti themelor i saj në kërkimet letrare. Ajo lexon dhe interpreton Naim Frashërin nën këndvështrimin e poetit nacional dhe nga kjo do të zbërthejë të gjitha pikat e tjera, prandaj ky vështrim del nëpërmjet metodës dyplanëshe: si kërkim biografik dhe si kërkim struktural dhe kuptimor i veprës së Naimit. Në këtë mënyrë dhe duke patur objekt Naim Frashërin, Kokalari veprën e strukturon në tri pjesë: Pjesa e parë me: "Hyrjen", "Kushtet Historike", "Mjedisi", "Jeta"; Pjesa e dytë përbëhet nga: "Mendimi", "Historia" dhe "Doktrina e Bektashinjve", "Bota Shpirtërore e Naim Frashërit"; ndërsa Pjesa e tretë nga: "Veprat", "Hyrje në veprat e Naim Frashërit", "Veprat fetare", "Veprat shkollore", "Veprat me karakter Politik", "Veprat me karakter Sentimental" dhe "Veprat me karakter të Përzier". Duket që strukturimi i menduar kështu lejon hapjen më të madhe të jetës dhe të veprës së tij, si dhe mundëson më shumë përqëndrimin e Kokalarit në pjesët që i interesojnë.

Te pjesa e parë e studimit Kokalari sjell informacione të shumta lidhur me jetën e Naim Frashërit, duke bërë kështu një lloj portreti të tij. Në fillim të tekstit, autorja bën një hyrje në planin paraqitës për të sqaruar interesimin e saj për kushtet historike, "të luftës dhe evolucionit të shpirtit shqiptar", në raport me autorin e saj. Këtu synohet të sqarohet situata e Shqipërisë në shek. XIX, si kohë e pjekurisë së saj, duke pasur luftëtarë e mendimtarë, më shumë nga të cilët është marrë Naim Frashëri. Pra, duke u nisur nga këtu, shohim se autorja kërkon që autorin e saj ta zbërthejë imtësisht që nga interesimet e para.

Në këtë rend përfshihen edhe pikëpamjet e Kokalarit për vlerësimin e Mjedisit të Naim Frashërit dhe karakteristike është

intenca e saj për të analizuar vendin ku ai ka "provuar gëzimet dhe hidhërimet e para, vendin ku ka fituar përvojat e para të jetës, si shkrimtar dhe si njeri".[8]8 Për ta ilustruar sa më shumë atë në këto dy anë, Kokalari ndalet veçanërisht edhe te Jeta e tij, duke e përshkruar atë që nga lindja, duke folur për familjen e tij, si dhe duke shenjuar poetët e tij të dashur si: Dalib-Bej, Shahin Bej dhe satirikun Baba Nasib. Pra, ky konstatim i Kokalarit, sa i përket anës artistike, si dhe ai që në teqe Naim Frashëri ka dëgjuar për herë të parë fjalën Shqipëri dhe aty ka mësuar ta dojë dhe ta nderojë vendin, specifikon çështjen e vështrimit të saj. Me këtë, ajo kërkon të lidhë karakterin e tij, botën e brendshme dhe formimin e parë me teoritë e bektashizmit.

Pos theksimit të këtyre aspekteve, i rëndësishëm konsiderohet edhe hetimi i faktit që Naimi, si lëndë studimi, kishte gjuhën franceze, të cilën e perfeksionon nëpërmjet leximit të autorëve tij të preferuar: Lamartin dhe Viktor Hugo. Kokalari, duke qenë e vetëdijshme për rëndësinë e letërsisë greke, nuk e lë pa e përmendur edhe faktin se Naimi pëlqente edhe Ezopin dhe Homerin. Në këtë plan, diskutimet e saj për jetën e Naimit shenjojnë edhe faktin që ai ndër autorët e preferuar që edhe i studioi ishin: Firdus, Haffiz dhe Saadi. Këtu ajo nënvizon se Naimi për herë të parë ka shkruar në moshën 27-vjeçare dhe gjuha e tij e përdorur ishte persiane, gjuhë me të cilën Kokalari mendon se ai ishte i dashuruar.

Pastaj, Kokalari shkruan për jetën e vështirë të Naimit, braktisjen e atdheut dhe sëmundjen e tij të përhershme, por edhe për karakterin e tij të butë, të hapur, refleksiv dhe për sjellje prindërore. Dhe, kështu, duke i prekur pothuajse të gjitha pikat më të rëndësishme të jetës së tij, në një formë që mendimet dalin shumë qartë dhe rrjedhshëm, Kokalari përmbyll tekstin për jetën e Naimit, duke menduar se me vdekjen e tij "atdheu humbi një apostull, sekti i bektashinjve idealistin e vet, dhe rinia këshilltarin."[9] Ky është edhe formulimi më domethënës

8 Musine Kokalari: *Vepra - vëllimi i parë,* Geer, Tiranë, 2009, f. 261.
9 Po aty, 271

i Musine Kokalarit për Naim Frashërin, e cila e çmon atë në rradhë të parë si shkrimtar patriot dhe çmon idenë e tij për kombin dhe shqiptarizmin, duke e parë edhe veprën e tij të dalë nga ky brum. Por, siç edhe e pamë më lart, sipas Kokalarit, Naimi mësoi për herë të parë të dojë Shqipërinë në teqe, prandaj mendon se veprat e tij përbëhen nga aspekti fetar, do të thotë mendon se ato përshkohen doktrinarisht. Mirëpo, mbi këtë mendim, ndryshe nga disa studiues të Naimit, ajo konstaton se ky aspekt fetar i veprave të tij lë një gjurmë të pamatshme në krahasim me çdo letrar tjetër bashkëkohorë. Lidhur me këtë, ajo mendon që në plan të përgjithshëm, aspekti fetar përbën botën shpirtërore të Naim Frashërit, nga mendon se pastaj rrjedhin temat politike, sentimentale, shkollore etj. Pra, konceptet e tilla të Kokalarit dalin te kreu i dytë, "Bota shpirtërore e Naim Frashërit". Këtu ajo thekson edhe aspektin politik si mjaft të rëndësishëm në gjithë veprën e tij e natyrisht, aspekt i dalë në rradhë të parë nga formimi fetar. Këtë problem Kokalari e shtron për të gjetur fillin se ku buron idealizmi politik dhe misticizmi i tij që përbëjnë esencën e veprës.

Sipas këtyre vlerësimeve, duke shqyrtuar problemin e botës së tij shpirtërore, për të bërë profilizimin e aspekteve që përbëjnë botëkuptimin e tij si shkrimtar, Kokalari e përfundon këtë pjesë duke e vlerësuar Naim Frashërin si poet tipik-mistik.

Në pjesën e tretë Kokalari bën një lloj klasifikimi të veprave të Naimit, duke i ndarë në vepra me karakter fetar, shkollor, karakter sentimental dhe veprat me karakter të përzier. Në këto klasifikime Kokalari shtron e trajton çështje dhe probleme të ndryshme, që janë përfaqësuese për veprën e Naimit, e për ndarjen e bërë. Këtë shqyrtim e realizon duke filluar nga data e viti i botimit, vendi i shtypjes e numri i faqeve, nga forma letrare, vlerat fetare, morale, sociale, gjuha, estetika, forma e shprehjes, figurativiteti etj. Kështu, ajo kërkon që ky tekst të kuptohet si udhërrëfyes i veprës së Naim Frashërit, duke menduar se:

"veprat e tij, gjithsej shtatëmbëdhjetë, trajtojnë argumente që për një vëzhgues sipërfaqësor mund të duken nga më të llojllojshmet, por që në fakt, kanë lidhje unike, një argument, do të thosha të përsëritshëm - atë edukativ, sepse qëllimi i vetëm prodhimtarisë së tij pjellore, ishte pikërisht edukim i rinisë. Pikërisht për këtë qëllim, ai i trajton të gjitha pamjet e diturisë: nga bujqësia e blegtoria tek politika, nga pedagogjia e mirfilltë tek lirizmi sentimental, nga historia tek besimi fetar."[10]

Te veprat me karakter fetar Kokalari rendit: *Fletore e Bektashinjve*, *Qerbelaja* dhe *Mësime*. Në tekstin për veprën e parë me karkater fetar ajo bën vështrimin e ideve teologjike e muslimane të Naim Frashërit. Pra, këtu ndalet te filozofia e bektashinjve, në tekst të Naimit, duke konkluduar se si themelore ky besim ka panteizmin e metapsikozën.

Në vështrimin për *Qerbelanë*, Kokalari thekson se kjo vepër duhej të ishte një poemë epike dhe ashtu kishte synuar poeti, por këtë zhanër mendon se Naim Frashëri nuk ka arritur ta realizojë, edhe pse nuk i mungon materiali historik, por natyrën rrëfimtare dhe filozofike të Naimit ajo e sheh të mangët dhe si penguese të krijimit të kësaj forme. Do të thotë, sipas saj, është sensi krijues që i ka munguar Naimit për të bërë një poemë epike dhe për këtë mendon se rol të madh ka ndikimi i letërsisë persiane, duke i dhënë veprës kështu prirje morale-teologjike. E në këtë drejtim, ajo mendon se si pasojë është stopuar hovi lirik e entuziast që është karakteristikë e krijimit epik dhe e vlerave letrare. Por, mbi të gjitha, ajo e vlerëson *Qerbelanë* për vlera morale dhe e shquan si vepër të rëndësishme për dervishët, por nuk e vlerëson letrarisht.

Në kuadër të veprave fetare të Naimit, klasifikuar nga Kokalari, kemi edhe veprën *Mësime,* në të cilën po ashtu trajtohet problemi i Zotit, morali i urtësisë njerëzore dhe Kurani trajtuar nga Naim Frashëri, duke e përmbyllur vështrimin me mendimin se kjo vepër është ndër krijimet më të mira të Naimit, sa i përket thellësisë së mendimit dhe kënaqësisë së shprehjes.

10 Po aty, 286

Po kështu, në vazhdim Kokalari flet edhe për veprat e Naim Frashërit me karakter shkollor, të cilat i veçon për vlerën e madhe nga pikëpamja edukative, dhe vlerë të ngushtuar të pikëpamjes letrare.

Vështrimi tjetër në radhë bërë nga Kokalari është për veprat me karakter politik të Naimit: *Dëshira e vërtetë e shqiptarëve*, si dhe për *Istori e Skënderbeut*. Kjo e dyta në tekstin e autores tonë del si vepra më e madhe poetike e Naimit me karakter historik dhe politik, e cila trajton bëmat e heroi kombëtar Gjergj Kastriotit. Argumentin për këtë vepër Kokalari e sheh të kompensuar nga veprat në prozë të dy shkrimtarëve francezë: Paganelli dhe Verdaine du Pleisy, të cilët thotë se kanë shkruar gjatë mbi jetën dhe veprën e heroit shqiptar. Dhe, në këtë vijë, duke folur për Skënderbeun dhe bëmat e tij, mendon se me vdekjen e Skënderbeut mbaron edhe argument i veprës bërë nga Naimi. Kështu, në aspekt të mendimeve të Kokalarit për "Istori e Skëndërbeut",shohim se ajo, ashtu siç edhe e klasifikon, niset të vlerësojë karakterin politik të tij, sepse, sa i përket pretendimit të Naimit se ka bërë për poemë epiko-heroike, nuk mendon se i plotëson kushtet. Njëjtë sikurse te vlerësimi i *Qerbelasë*, edhe këtu Kokalari mendon se autori i saj priret nga natyra liriko-sentimentale dhe përsëri mendon se sistemi i tij krijues është i lidhur me letërsinë persiane. Për më detajisht, gjykon se pathosi i Naimit është pa dinamizëm, edhe atëherë kur ka lirizëm epik.

Më tutje, Kokalari vështron veprat e Naimit, të cilat i konsideron me karakter sentimental: *Ëndërrime, Eros, Bagëtia e Bujqësia* e kjo e fundit në gjykimet e Kokalarit del si vepra me ndjesi më të mëdha e poetikisht me e bukura e tij. Vlerësimin e tillë e nxjerr në bazë të mendimit se vepra ka lirizëm të theksuar dhe se përbëhet nga një timbër i vazhdueshëm nostalgjie për gjithçka që ai ka përjetuar dhe që jeta ia ka ndaluar. Këtë vepër e konsideron të rëndësishme duke menduar se aspektet mendimtare, fetare e politike dalin si koncepte të zhytura në vijën sentimentale të poetit.

Në këtë mënyrë Kokalari e shkruan edhe kapitullin e fundit që ka për objekt veprat me karakter fetar, të cilat mendon se janë: *Parajsa*, *Vjersha* dhe *Lulet e verës*. Pasi gjen të gjitha karakteristikat fetare që i përbëjnë këto vëllime poetike, ajo bën veçmas klasifikimin e poezive me karkater fetar, shkollor, politik dhe poezitë me karakter sentimental. Te kjo e fundit Kokalari vështron më me kujdes, sepse mendon që e përbëjnë numrin më të madh të poezive të Naimit. "Ato trajtojnë argumente nga më të ndryshmet, mjaft që të prekin ndjenjat e një poeti e veçanërisht të një poeti si Naim Frashëri, që nga çdo aspekt i jetës do të nxjerrë një vibracion, një këngë, një përfundim filozofik, një lutje a këshillë".[11]Me interes më të madh e konsideron pjesën ku Naimi është sentimental e erotik nga edhe mendon se dalin elementet estetike në vepër, nëpërmes gjuhës e penës së tij "të dashuruara në të bukurën".

Kështu, mendimet kritike të Musine Kokalarit për Naim Frashërin janë dhënë me shumë qartësi dhe sidomos është manifestuar mjaft mirë përpjekja e saj që të shenjojë lidhjen e madhe të personalitetit shpirtëror të Naimit me veprën e tij letrare. Dhe, në gjithë analizën që bën për të, Kokalari vëren një lloj përputhje të këtyre dy anëve, përpos në poezinë "Uji i bekuar" (*Lulet e Verës*), në të cilën ajo e lexon më ndryshe Naimin, më "skeptik" e të "trullosur", pasi që mendon se ka kopjuar koncepte e mendime të tëra nga letërisa perse. Para së gjithash, kur analizon elementet poetike te kjo poezi, vërehet një ton negativ i Kokalarit për poezinë perse, sepse pikërisht aty e ndikimin e kësaj letërsie. Një ndikim të drejtëpërdrejtë e vëren nga Omar Khajam, të cilin e konsideron poet të dashur të Naimit. Është me rëndësi të theksohet se me këtë rast Kokalari qartëson idetë e veta, duke mos vlerësuar gjurmët letrare të Omer Khajamit e të kësaj letërsie, që objekt kanë pesimizmin dhe nevojën e vazhdueshme për të harruar dhimbjet, në gotat e mbushura në ndonjë tavernë të largët.

11 Po aty, f. 232

Përpos këtij shqyrtimi të preferencave të Naimi Frashërit, Kokalari thekson edhe "një zbulim interesant", kur po lexonte poetin e madh Rumi, të përkthyer italisht nga profesor Italo Pizzi: "Më duhet të pranoj, që çudia ime qe e madhe kur konstatova që shumë vargje të Naimit, rezultojnë identike me ato të poetit Persian".[12] Më tutje, ajo vëren edhe disa ngjashmëri të tjera të modelit të këtij në poezinë e poetit të saj e shpeshherë edhe kopjim, por mund ta arsyetojë vetëm më mendimin se Naim Frashëri ka gjetur idealet dhe ndjeshmërnë e vet te poeti Rumi. Ndërsa, përfundimisht kur është fjala për konceptin themelor të Naimit, Kokalari mendon që ai shpërthen nga veprat e tij të mëdha. Kokalari këtyre poezive të fundit u kushton vëmendje të posaçme, duke i vërejtur që nga pikëpamja estetike janë më të bukurat krijuar nga "muza frashëriane".

Në fund të tekstit, Musine Kokalari bën një „Konkluzion"për të definuar edhe një herë, në mënyrë përfundimtare pikat e saj më të rëndësishme për Naim Frashërin si njeri dhe si idealist, rreth të cilave sillet i gjithë teksti: ajo vlerëson qëllimin e tij që të theksojë idealin, atdheun; e shquan anën estetike të veprës së tij; dhe, krejt në fund, mendon e sugjeron se: "çdo shqiptar duhet të shoh tek ai një pararendës e duhet të admirojë tek vepra e tij vullnetin krijues e formues të racës tonë".[13]

Në këtë kontekst, mund të përfundojmë se Kokalari Naim Frashërit i jep një vend të rëndësishëm në letërsinë shqipe, për shkak të idealit të tij dhe anës estetike të veprës, duke e përsëritur këtë konstatim disa herë, si për të bindur më shumë. Po ashtu, duhet theksuar se ajo kishte një dashuri dhe informacion të mirë për letërsinë e Naim Frashërit dhe jetën e tij, prandaj edhe teksti i saj është shoqëruar me një sensibilitet të veçantë dhe shumë ide të saj në forma të ndryshme janë trajtuar edhe më vonë.

12 Po aty, f. 326
13 Po aty, 329

Dr. Femi Cakolli
Prishtinë

Përralla dhe teologjikja në veprën e Musine Kokalarit

Vitet e 30-ta të shekullit të kaluar, në Shqipëri, përbëjnë një periudhë të mirë e të ndërgjegjshme zhvillimi të letërsisë shqipe jo vetëm për kah pavarësia e saj por edhe për kah pjekurimi i mendimit shqiptar në përgjithësi si dhe ndërlidhjet e saja me mendimin europian jo vetëm me artet por edhe me filozofinë, edukimin, mendimin politik e kulturor. Ndërsa jemi tek kjo çështje nuk duhet anashkaluar përcaktimin e shtetit shqiptar, gjatë këtyre viteve, i cili e ka lënë të lirë, në këtë rast, letërsinë dhe artin. T'i shohim, fillimisht, ca rrethana individuale të formimit të personalitetit të Musine Kokalarit gjatë viteve të theksuara.

Musine Kokalari ishte nxënëse e Institutit "Qiriazi" në Kamëz. Ky institut quhej Qiriazi pasi ishte vazhdimësi e drejtpërdrejtë e "Shkollës së Vashave" e hapur më 23 tetor 1891 në Korçë, nga Gjerasim e Sevasti Qiriazi, kurse në vitin 1937 mbyllet me dekretin e Zogut për t'u rihapur me emrin "Nana Mbretneshë". Edukimi i vashave, apo i femrës në përgjithësi, në historinë shqiptare lidhet me këta dy emra. Musineja kishte mësuese Sevastinë e madhe, Parashqevinë, pastaj

çiftin amerikan Phineas e Violet Kenedi etj. Programi shkollor i Institutit "Qiriazi" ishte njëri nga më të avancuarit që aplikohej jo vetëm në Shqipëri por edhe në Amerikë. Me këtë kompetencë të përfituar, më pastaj, zonja Kokalari regjistrohet në Universitetin e Romës, degën e letërsisë.

Lidhur me veprën e saj do flas për dy problematika: përrallën dhe teologjiken. Pse? *Së pari,* tërë vepra e saj është botuar në dy vëllime nga shtëpia botuese Geer, viti 2009, në Tiranë, në 980 faqe materiale, e përgatitur nga Novruz Xh. Shehu, dhe kam parë bibliografinë e plotë për kompletin e veprave të M. Kokalarit, prej vitit 1937 e deri në vitin 2009, mirëpo nuk kam hasur në ndonjë autor që është marrë me përrallën dhe teologjiken e kësaj autoreje.

Së dyti, duke kërkuar diçka të veçantë nga ana letrare, por që si stil e formacion vepra e saj të jetë plotësisht atipike për letërsinë shqipe soc-realiste, nuk munda të gjeja diçka më të vyeshme e mprehëse sesa përrallën dhe teologjiken.

Së treti, edhe përralla e edhe teologjikja, pra fetarja, duke qenë vlera universale në themel përbëjnë primate epike e kundërshtimore kundrejt soc-realizmit shqiptar, andaj këto dy elemente të hasura në shkrimtarinë e Kokalarit ndërlidhin modernen me antiken dhe modernitetin me romantizmin e letërsisë sonë.

A mund, ose si mund, të bashkërendojë këtu përralla dhe teologjikja? Çfarë kanë të përbashkëta këto dy botë magjike, mistike e kerigmatike? Përralla është mit, kallëzim a narrativë, traditë, imagjinatë, aplikim, është simotrim, është tokësore etj. Teologjikja është zbulesë, vegimore, transmetim, doktrinë, interpretim, aplikim, misionim, qiellore etj. Përralla e teologjikja pranohen ashtu siç janë. Të dyja janë mistike dhe mistifikojnë po ashtu. Përralla është animiste, humaniste, natyraliste dhe civilizuese. Teologjikja është hyjnore, profetike, heretike, kodifikuese, penalizuese. Përralla është profanike kurse teologjikja është sakraliste. Përralla përfshin! Teologjikja përjashton! Përralla shëron! Teologjikja edhe vret! Përralla dhe teologjikja kanë

mision ta mundin të keqen, të ligun, intrigën, amoralen prandaj, të dyja janë kozmogonike dhe teleologjike.

Përralla nuk merr nga teologjia, kurse teologjia përmes kontekstualizimit, përkatësisht përmes bërjes së teologjisë në kulturë, ka marrë dhe merr vazhdimisht nga përralla, miti, kënga etj. Në kontekstin kulturor shqiptar përralla formon, përçon mesazhe dhe unifikon, kurse teologjia burimore prore diferencon. Përralla ka për audiencë kryesisht fëmijët, kurse teologjia ka të rriturit. Përrallën shqiptare e tregon gjyshja e që është sinonimi me profetin ose klerikun që e shpalos teologjinë ose liturgjinë. Përralla dhe teologjia janë universale. Tërë formën dhe strukturën narrative, tërë konceptin dhe sakrilegjin teologjia e ka marrë nga përralla. Personazhet e përrallave artistikisht dhe formalisht, ndodh në shumicën e rasteve, janë më të realizuara sesa figurat e teologjisë, përkatësisht të teksteve sakrale.

Është vepra *Reth Vatrës* e cila ka 12 përralla, sikurse edhe studimi i punimit tezë diplome për letërsinë shqipe "Naim Frashëri", tek pjesa e dytë, kreu i parë, kur flet për historinë dhe doktrinën e bektashinjve, kreu i dytë kur flet për "Botën shpirtërore të Naim Frashërit", pastaj tek pjesa e tretë, kreu i dytë, kur flet për "Veprat fetare" të poetit të Rilindjes Kombëtare përbën fushën ku rri ulë studimi im "Përralla dhe teologjikja në veprën e Musine Kokalarit".

Nga biografia e veprimtares Kokalari, venerohet se kur ajo ishte 10 vjeçe paska nisur mbledhjen e përrallave shqipe, dhe kështu në vitin 1944, në Tiranë, ajo kishte botuar tekstin "Rreth vatrës". Vepra ka një sistem të mbyllur. Janë zgjedhur 12 përralla që simbolizojnë motmotin. Përrallat i tregon "nënua plakë", ose gjyshja. Libri fillohet me përshkrimin apo përgatitjen e zjarrit të madh, pra të vatrës, dhe përfundon me shuarjen e tij, përkitazi me daljen e pranverës. Këtu shoh lidhjen dielli gjatë verës dhe zjarri gjatë dimrit.

Gjatë secilës përrallë të bukur zjarri është ndezur, tregohet kujdes ndaj zjarrit që mos të fiket, hidhet dru më shumë në të, e nënua plakë është ajo që rri pranë zjarrit. Zjarri në këtë vepër është më

shumë sesa metaforë, më shumë sesa një ide letrare. Ai është rituali. Ai është temjani. Ai është magjia. Ai është inspiruesi. Ai është jeta. Ai komunikon. Ai nderohet nga shtëpia. Nuk luhet me zjarrin andaj ai adhurohet nga narratorja jo ritualisht por qenësisht. Çdo përrallë fillon dhe mbaron tek zjarri. Tek këto përralla hetoj edhe një rend krijues të "1001 netëve", por edhe një lidhje, elementim, me këngët e kreshnikëve. Përkujtojmë se nëna e Mujës dhe Halilit zakonisht gjendet pranë zjarrit dhe kurrë aty nuk përshkruhet edhe ati i tyre. Mojsiut gjatë shtegtimit 40 vjeçar nëpër shkretëtirë, Zoti i dha dy shenja profetit për praninë e tij permanente dhe udhëheqëse. Natën do të përdorë zjarrin kurse ditën retë. Edhe prifti përdor temjanin për meshën a liturgjinë e tij që ta imitojë providencën hyjnore, që ta ushtrojë mistikën dhe të mrekullueshmen kundrejt berrave së grigjës së tij e po kështu kallëzimtarja e përrallave, gjyshja, përdor zjarrin e vatrës për temjan, frymëzim, lirizëm, ritual dhe ndoshta edhe adhurim të fshehtë sipas tipit të besëlidhjes "unë dhe ti e askush tjetër". Praktikisht kështu e veçoj të lidhur përrallen dhe teologjiken në veprën e Kokalarit.

Kur flasim për poetikën e kësaj vepre me përralla, sipas bindjes sime, autorja ka arritur që t'i japë gjithë letërsisë shqipe një element shumë të veçantë. Si askush deri tek botimet e saja, nuk ka sjellë një strukturë të rrëfimit të përrallave sikurse bën kjo krijuese dhe intelektuale. Përralla e Kokalarit ka forma e shtresime strukturore që përrallës i jep konotacione novele, pastaj kemi edhe këngën dhe komiken. Si askund tjetër, ndoshta, në letërsinë shqiptare, përralla, novela dhe kënga bashkohen në veprën *Reth vatrës*.

Pra, për ta rrëfyer përrallën ka një narratore, e që është gjyshja. Për ta dëgjuar përrallën ka disa fëmijë e që janë kryesisht Astriti, Haso dhe Qemali. Vendi ku tregohet përralla është vatra, pra shtëpia, dhe autorja në fakt e thotë vetë "pralla thuhen vetëm nd' anë të zjarit ... në dimër...këtu rreth vatrës"[1]. Këtu gjejmë një kolazh formal e

1 Kokalari,Musine. *Vepra – Vëllimi i dytë*, Geer, 2009, Tiranë, fq. 334

struktural. Përralla ndahet në tri pjesë. Edhe novela ka tri pjesë mes pjesëve të përrallës. Këngët janë më rrallë të ndërfutura por janë të pranishme në shumicën prej tyre.

Zakonisht autorja përshkruan shtëpinë, preokupimin e fëmijëve, dialogët e tyre, komentet, dëshirat, lutjet, këngët, kërcimet, lojërat, kujdesin ndaj lodrave, krijimin e bindjeve, korrigjimin e sjelljeve etj. Kur i ke të gjitha këto parasysh atëherë themi se Musine Kokalari para 73 vitesh kishte krijuar një teatër e shkollë për fëmijë, një studio, kino apo televizion, kompiluar me pedagogji, didaktikë, metodikë e mësimdhënie me tipare sa klasike e moderne po aq edhe postmoderne. Pra, krijimi special i ambientit ose i hapësirës, dëftimi i përrallës, përfshirja novelitare, thënia e këngës, gjetja e gjëegjëzës, futja në paralojë, komikja, demonstrimi i lojërave në këto përralla komponojnë një teatër simfonik përkah idetë dhe realizimi praktik në një shtëpi të thjeshtë gjirokastrite. Sa shumë mungon sot një ndërmarrje e këtillë nëpër familjet dhe shtëpitë bashkëkohore shqiptare. Edhe përralla e ka sakristinë e saj.

Ajo që është e njohur lidhur me karakterin dhe natyrën e përrallave të studiuara shqiptare, normalisht se nuk do i përsëris, mirëpo konteksti analogjik që autorja ka ndërtuar si një arketip, sidomos kur flasim për çështjen e numrologjisë, Musineja përdor vetëm numrin tre: tre vëllezërit, tri motrat, tri plakat, tre kusarët, tri herat, tri rastet, tri mësimet, tri provat etj. Personazhi i gjarprit është i pranishëm kudo në përrallat shqipe, por në tërë letërsinë tonë verbale ose skriptuale nuk ka pasur një relacion mes personazhit letrar mitik gjarprit si totem, si shërues e mrekullibërës dhe personazhit letrar modern me emrin Astrit, të cilit i transmetohet përralla, duke ditur se semantika e këtij emri drejtpërdrejt lidhet me gjarprin. Në këngën popullore është evidente kur plakut dhe plakës u lind foshnja gjarpër, pra kemi totemin që mishërohet në njeri, me fjalë të tjera realizohet shëmbëllimi i totemit në njeri. Përfundimisht, personazhin e gjarprit miti e ka realizuar artistikisht shumë më bukur sesa biblikja, pra edhe

një tjetër lidhje mes mitikës ose përrallës me teologjiken. Më kanë bërë përshtypje edhe elementet romantike në këtë vepër. Mesazhi përfundimtar i përrallave të Kokalarit është lloji i mbretërisë i cili vazhdon ndër ne me anë të nderit, rendit dhe ligjit.

Tek punimi i studiueses Kokalari për Naim Frashërin, pjesa e dytë, kreu i parë flet për "Historinë dhe doktrinën e bektashinjve". Ajo menjëherë konkludon se Naimi i përkiste bektashizmit, se ishte ndjekës besnik bektashian, se kështu u frymëzua për shumë vepra të tij (Libri i bektashinjve, Qerbelaja, Mësime), kodifikoi mësimet në një katekizëm të përpiktë bektashian[2].

Persiani Haxhi Bektashi, shenjtori, pasi viziton në Qerbala varrin e Hysenit shkoi edhe në Jerusalem për ta vizituar varrin e Krishtit. Këndej ai do të marrë revelata. Sulltan Orhani, në anën tjetër, kërkon prej tij që t'i bekonte armët e jeniçerëve. Shenjtori imponoi disiplinë të paparë në ushtri saqë e ndaloi edhe të folurit gjatë punës. Pas kësaj ky dërgon misionarë në Ballkan që të përhapeshin parimet doktrinale bektashiane, dhe kështu themeloi disa teqe, dhe besohet se në një lokalitet shqiptar u varros. Autorja na kujton se edhe Skënderbeu e Hamzai ishin bektashianë, dhe pastaj kemi vëllezërit Frashëri, të cilët janë udhëheqësit e Lidhjes së Prizrenit. Ky do të ishte diskursi më i thjeshtë, një skemë perfekte, e asaj çfarë e konstituon një teologji bazike. Këtu mungon vetëm ajo që quhet "libri i shenjtë", pra teksti, i cili duhet të ndiqet, prandaj Naim Frashëri sikur e përmbush atë që nuk e bëri "shenjtori", duke ofruar së paku tri tekste nga fryma bektashiane.

Nga pikëpamje fetare, Kokalari, bazën themelore të bektashizmit e sheh panteizmin dhe metempsikozinë[3]. Zoti, në bektashizëm, përkundër islamit kuranor dhe hadithor, është jo vetëm transcedental porse ai gjendet kudo sepse Zoti është universi, e rrjedhimisht edhe Shqipëria është pjesë e universit e jo e otomanisë. Përpos kësaj,

2Kokalari, Musine. *Vepra – Vëllimi i parë*, Geer, 2009, Tiranë, fq. 276
3Kokalari,Musine. *Vepra – Vëllimi i dytë*, Geer, 2009, Tiranë, fq. 279

teologjia bektashiane, para çdo sublimiteti tjetër vendos idenë e atdheut. Kjo duket sikur arrogancë, profanizëm, "bidat", heretizëm dhe hermeneutika sikur përjashtohet prej secilit argument. Sa kemi vërtet këtu teologji solide? Ku është roli i teologjikës dhe sa serioze është kjo?

Zoti është në qendër të botës fetare për bektashianët, por ai kërkohet brenda teje, ai kërkohet brenda atij që e ke pranë, aty ku jeton. Këto janë në fakt biblizma. A është ky një pragmatizëm sotereologjik apo një fe që e bëjnë shqiptarët vetëm për shqiptarët, sidomos pas islamizimit të tij?

Ideja themelore se si të shenjtërohet perëndisht atdheu i shqiptarëve, gjithmonë edhe si një projeksion i madh i Rilindjes sonë Kombëtare, sipas bektashizmit nga kampi islam po njëjtë edhe sipas protestantizmit nga kampi kristian, Zoti panteist përkatësisht Perëndia i qiellit e i tokës i mishëruar "Fjala u bë mish"[4], gjendet edhe në Shqipëri - pa pasur nevojë që të kërkohet ai diku tjetër. Teologjikja këtu flet: Zoti e ka Shqipërinë dhe Shqipëria e ka Zotin. Zoti gjendet në Shqipëri dhe Shqipëria gjendet në Zotin.

Kokalari përherë vëren se doktrina bektashiane, e shtruar nga Naimi, ka në brendësinë e saj idealet kombëtare e politike duke u shprehur: "bektashizmi mbështet idenë e një nacionalizmi të zjarrtë"[5]. Bektashizmi shtrohet më shumë si vëllazëri besimi, si vëllazëri nacionale, si vëllazëri me prirje të rrepta morale sesa një religjion që secili e përjeton dhe e praktikton si të dojë besimin e tij.

Kur monografja e Naimit flet për botën shpirtërore të idolit të saj demonstron kulturë e dije të lartë për këtë subjekt, duke shkruar: "në qëndër të botës fetare të Naimit, mbizotëron ideja e Zotit, qënia krijues edhe shtytëse e çdo dinamike tokësore apo qiellore. Ai e koncepton perëndinë me një sens panteist duke nxjerrë nga ky koncept, një bazë

4 *Bibla (Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e Re; Gjoni 1:14)*, Shoqëria Biblike e Shqipërisë, Tiranë, 2009
5 Kokalari, Musine. *Vepra – Vëllimi i dytë,* Geer, 2009, Tiranë, fq. 279

bindëse arsyetimi për të mbështetur parimin e pavdekësisë së materies që nuk shkatërrohet, por transformohet vazhdimisht. Si të gjithë mistikët ai e bazon pra konceptin e tij në një Zot, që duke qenë në fillim, do të jetë në përjetësi; në një Zot që për lavdinë e tij më të madhe, e manifestoi veten në çdo gjë dhe çdo gjë në vetvete, duke i dhënë kështu zanafillën e krijimit. Në këtë krijim, pra gjendet shpirti i përgjithshëm, që është shpirti pjellor, i mbushur me dashuri i cili depërton materien dhe metafizikën. Nga ky koncept bazal, burojnë të tjerë, me sens të menjëhershëm... Mendimi i tij fetar, gjithsesi, nuk është një mendim fideistik, dogmatik, por një mendim kritik, i vetëdijshëm dhe filozofik"[6].

Duke e parë idealizmin politik të Naimit, Kokalari në të vërtetë Naimin e sheh edhe si një mistik në veprën e tij, duke përfunduar "Naimi është një poet mistik – një nga ata mendimtarë të rrallë"[7].

Projeksioni i Rilindjes Kombëtare për ripërtëritjen e shqiptarëve dhe të Shqipërisë duke iu kthyer vetvetes, duke u bërë vëllezër të mirë, duke u lutur, folur e shkruar shqip, duke u edukuar dhe që të jenë në dritë Musine Kokalari këto ide i gjen të gjitha tek doktrina bektashiane, përkatësisht tek Naimi, andaj sot më duhet të konstatoj se është pikërisht kjo zonjë e autore e Shqipërisë që na vë apostrofimin se Naimin askush para saj dhe pas saj nuk e ka parë edhe si një teolog të lirë, pa harruar veprën e madhe të Naimit. Sigurisht se Naimi nuk është teologu ta zëmë sikurse kartagjenasit e kishin Augustinin, italianët Toma Akuinin, gjermanët Luterin, francezët Kalvinin, zviceranët Cvinglin etj.

Studiuesit pas luftës së dytë botërore jo vetëm që nuk ditën se çfarë të bëjnë me vokacionin teologjik të veprës së Naimit, por e heshtën edhe kolegen e tyre, e cila së paku kishte dhënë përgjigje për këtë çështje, madje duke ua studiuar këtyre "idhujtarëve" idhullin e tyre kur këta ndoshta ose ishin ende fëmijë ose nuk ishin ende në këtë botë.

6 Kokalari, Musine. *Vepra – Vëllimi i dytë,* Geer, 2009, Tiranë, fq. 280-281
7 Kokalari, Musine. *Vepra – Vëllimi i dytë*, Geer, 2009, Tiranë, fq. 282

Doc. Dr. Agron TUFA
Universiteti i Tiranës
Msc. Elvana ZAIMI

Kodi i ligjërimit bisedimor në prozën e Musine Kokalarit

1. Habitati natyral i zërave në narrativën letrare të Kokalarit

Musine Kokalari është e para shkrimtare femër, që në peizazhin tonë letrar afirmohet në fund të viteve '30, ndërsa në fillim të viteve '40, ajo është tashmë, ndonëse në moshë të re, një shkrimtare referenciale si për autoritetet letrare në Shqipëri, ashtu dhe për studiuesit e huaj.[1] Skicat e saj që fillojnë të botohen që më 1937 në gazetën "Shtypi", - një variant sui generis i narrativës letrare etnografike, përbëjnë një seri etydesh që ravijëzojnë me pak penelata situata ambientale përplot kolorit gjuhësor në përputhje me imazhet tipike psikomentale e psiko-emocionale të folësve, veçanërisht të femrës shqiptare.

Janë këto zëra - habitati natyral që e mbështjellin bashkë-kohësinë e shkrimtares nga mëngjesi në darkë. Janë këto zëra të

1 Kemi parasysh vlerësimet e krijimtarisë së Musine Kokalarit nga Prof. Anxhelo Leotti, prof. Karlo Mearini, prof. Karlo Tagliavini, Mitrush Kuteli, prof. Aleksandër Xhuvani, prof. Sotir Kolea, E. Koliqi, P. Marko, M. Lambertz etj.

brendshëm që çlirohen përmes rrëfimit dhe pohojnë sekretet, të vërtetat e përditshmërisë, ashtu siç përjetohet ajo me tragjikën personale, komizmin personal dhe ambientin gjuhësor personal. Janë këta zëra që përfaqësojnë instancat, funksionet dhe rolet në familje dhe shoqëri, të cilët me ngjyresën e zërit njerëzor na rrëfejnë me pëshpërimë, larg syve të botës, se çfarë i mban gjallë ata: durimin, shpresat, qëndresën, ngushëllimin në një botë që ndryshon me shpejtësi dhe thellon moskuptimin midis kohërave dhe brezave. Dhe janë këto zëra që përpiqen të çlirohen nga paraliza, e cila përndryshe sjell përkeqësimin e regjistrave dhe e fut familjen/shoqërinë në krizë.

Musine Kokalari e ka kapërcyer përvojën e rrëfimit miniaturesk që në botimet gjatë kohës së studimeve në Institutin Femëror "Nëna Mbretneshë" (1937-1938) me poezitë dhe skicat, kryesisht me tematikë sociale. Gjatë kohës që studion për letërsi në Univesitetin e Romës (1940-1942), lënda e saj letrare është riprodhimi stilistik i ligjërimit etnografik të zërave të shtëpisë, që na zbulojnë karaktere dhe situata, të cilat, përmes ritualit dhe besëtytnisë vizatojnë detajet e tablosë së përgjithshme si dëshmi autentike e përditshmërisë urbane. Këtë eksperiment me situatat ambientale dhe koloritin e zërave ajo e kurorëzon me librin e saj të parë *Siç më thotë nënua plakë* (1939), për të cilin Lasgush Poradeci shkruan: "Musine Kokalari ka një talent që meriton të vihet në dukje. Zënia e Jetës, kapja e saj në fond dhe në formë dhe shfaqja imediate, pa asnjë ndërmjetësim, ky është origjinalitet, origjinalitet letrar"[2]. Këtë nivel të narrativës miniatureske, sipas skicës letrare minimaliste etnografike Musine Kokalari e thellon më dukshëm në librin e saj të dytë ...*sa u tunt jeta* (1944), dhe tashmë, me këtë libër kemi jo vazhdimin e eksperimentit me narrativën popullore, por një projekt të qartë artistik, për çka dëshmojnë edhe 30 faqet e romanit të pambaruar *Teto Nurijeja* (1943) i mbetur në dorëshkrim. Me këtë trashëgimi të ndërprerë dhunshëm nga diktatura komuniste, Musine

2 Lasgush Poradeci, "Bota e Re", 30. 7. 1940, nr. 1

Kokalari mbetet e para shkrimtare femër në letërsinë shqipe, që spikati në peizazhin letrar të viteve '40 me zhanrin e saj origjinal të miniaturës minimaliste etnografike, në të cilën shtrohen problemet e femrës shqiptare në një konteskt shoqëror maskilist, sikundërse promovohen për herë të parë tiparet e shkrimit lerar feminist në letrsinë shqipe.

2. Narrativa minimaliste miniatureske e M. Kokalarit

Zhanrin miniaturesk të skicës e kanë përdorur në vitet '20-'30 të shek XX., edhe shkrimtarë të afirmuar para Musine Kokalarit[3], por miniaturizmi etnografik i prozës së saj synon të fiksojë një botë të tërë autentike, jo si ekzotikë lokale, por si një thurimë zërash që derdhen njëri në tjetrin në formë monologjesh a kuvendimesh, duke zbuluar në këtë akt shqetësime të brendshme, një botë të tërë dis'harmonike nën peshën e brengave dhe hareve. Shpesh kjo narrativë minimaliste është trajtuar në mënyrë të cekët, si diçka ekzotike, sipërfaqësore. Përkundrazi, ne mendojmë se ajo çfarë e bën qartësisht të dallueshme risinë e skicës miniatureske në tekstin letrar të Kokalarit, nuk është ligjërimi mimetik i zërave dhe karaktereve, por anatomia psiko-mentale e zërit të brendshëm, zërit të familjes si institut thelbësor në shoqërinë shqiptare. Në repertorin e teksteve tona letrare nuk ishte ndeshur më parë një zhanër i tillë kaq pranë folësit, me një intonacion bisedimor kaq të identifikueshëm me karakteret e përditshmërisë dhe me situata ambientale të përshkruara - të gjitha këto - të dhëna me një kopraci të ndershme dhe me një kompozim të thukët, lakonik. Musine Kokalari ka një meritë të veçantë për begatimin e letërsisë shqiptare, duke krijuar një tip të ri zhanri, të dallueshëm e origjinal dhe të pangjashëm me asnjë shkrimtar tjetër në fund të viteve '30 - fillim të viteve '40 të shekullit XX. Miniaturat etnografike si krijime ngushtësisht

3 Kemi parasysh skicat e shkurtra ndërzhanrore të Faik Konicës, Lumo Skëndos, Koliqit, Kutelit, Migjenit, Nonda Bulkës, K. Cipos etj.

letrare, përpos gjendjes së konservuar të ligjërimit popullor me interesin gjuhësor që paraqesin, na shpalosin edhe ndjeshmërinë botëkuptimore të protagonistëve si instanca përfaqësuese të shoqërisë sonë të atyre viteve, në kapërcyell të modernizmit. Shkrimtarja ka fiksuar gjendjen e shoqërisë shqiptare në fazën e kalimit të saj nga sjellja simboliko-ritualore në sjelljen e saj racionale pragmatike. Veçantinë e miniaturës etnografike me detaje minimaliste të Musine Kokalarit mund ta përcaktojmë me këto elementë konstantë:

- mungesa e syzhetit në kuptimin tradicional të termit;
- parimi i lokalizimit të veprimit;
- dëshmitë e detajuara në përshkrimin e ambienteve/vendeve, kohës dhe njerëzve;
- marrëdhënia me edukimin estetik, etik, ritualor, dhe me kushtet e protagonistëve;
- vëmendja e spikatur ndaj karakteristikave sociale të tipave dhe mjedisit;
- paraqitja e realitetit në një "prerje" sociale;
- tendenca e qartë në përzgjedhjen e dukurive të dëshiruara,
- përpjekja për të krijuar imazhe tipike.

Në një fazë më të pjekur të krijimtarisë së saj, miniatura letrare etnografike e Musine Kokalarit përfton një unitet kompozicional, duke kapërcyer fragmentarizmin e mëparshëm ishullor të librit *Siç më thotë nënua plakë*. Në librin e dytë ...*sa u tunt jeta*, nuk janë më protagonistë zërat e veçuar, karakteret, por kemi shfaqjen e një personazhi dominues, rol të cilin e luan jo njeriu, por riti. Është riti i dasmës shqiptari në variantin lokal të Gjirokastrës që përbashkon e përthyen botërat mentale, emocionet, frikërat, bestytnitë - gjithë çfarë përbën fytyrën e fatit si një kompozicion i kulmeve më domethënëse në jetën e njeriut: lindja, martesa, vdekja. Libri nis me përpjekjen për

ndërmjetësimin e lidhjes së një çifti dhë përshkon gjithë trajektoren e tij, deri në ceremonialin e dasmës, përmes një sfondi familjar të nginjur me paragjykime, intriga, pasiguri, besim, ngazëllim dhe keqardhje. Secila hallkë lidhëse në zinxhirit e rrëfimit miniaturesk është gdhendur me një përpikmëri skruploze në stilin e një gjerdani gurësh. Rituali me repertorin e gjesteve dhr ceremonive solemne shkon drejt kurorëzimit të tij simbolik, përmes një sfondi të harlisur muzikor.

3. Narrativa miniatureske si një roman etnografik titualor

Femra e këtyre miniaturave letrare na parqitet në të gjitha moshat, rolet dhe funksionet e saj në familje dhe në shoqëri. Në miniaturën e parë me titull *Siç më thotë nënua plakë*, ndeshim një monolog të dendur të mamës plakë, një zë i cili shpreh pakënaqësinë për mënyrën e sjelljes, jetesës, veshjes dhe idealeve që ka vajza, duke parë tek ajo mishërimin e një shkëputjeje dhe përjashtimi që i bëhet brezit të nënave. Monologu lakonik është njëlloj revolte për humbjen e autoritetit dhe ndikimit të saj mbi të bijën, një lloj alienimi midis dy brezave në një situatë të cilën nëna tashmë nuk e ka më nën kontroll. Toni i përgjithshëm i monologut ruan brishtësinë e naivitetit të një brezi nënash të pezmatuara, të cilat nuk ndeshin tek bijat shembëllimin e idealeve të tyre tradicionale familjare. Ky hendek midis dy botëve të lë mbresën e një buzagazi sa zbavitës, aq dhe të keqardhës. "Kulloi Odaja" - një miniaturë që riprodhon ritualin e vajtimit, duke e përqasur vdekjen e djalit të ri, të vetëm, në familje me përjetimin tragjik të prindërve pleq që lë pas; rituali i vajtimit na flet me vargje aluduese për vendin e pakompensueshëm dhe gjendjen e pangushëllueshme të prindërve të tij në prag të pleqërisë. "Ulërima e qenit" - është një etyd miniaturesk për atmosferën e ankthshme që ngjall bestytnija e një qeni që angullin përvajshëm

gjithë natën. Teto Hasieja është një plakë që s'vë gjumë në sy dhe e torturojnë parandjenjat për gjëmën që ndjell ulërima e qenit. Mendja e saj është e shpërndarë tek djali që ka larg. Ajo gdhihet e pagjumë dhe shkon të lehtësohet me një fall filxhani tek komshija e saj, teto Nefizeja. Ajo e qetëson për merakun, por në të vërtetë vdekja ndodh në orët e ditës. Shenjat paralajmëruese dalin të sakta: vdes një burrë i ri në lagje, duke lënë prapa 5 kalamaj të vegjël. Nokturni i përzishëm i vdekjes është skicuar me natyralitetin funeral. Miniaturat e vëllimit ...*sa u tunt jeta*, siç e kemi theksuar, paraqesin në vetvete një roman-etnografik ritualor, ku dasma ka funksionin e personazhit qendror. Dasma kryhet në Gjirokastër, me të gjitha ritet, zakonet, përgjegjësinë shpirtërore për t'i bërë dhe zbatuar si duhet ato. Jeta shfaqet si një teatër, me pamjet e saj imponuese, me aktorë dhe spektatorë, me këngë dhe me valle, me portrete nusërie, me këshilla nëne, me lotë ndarjeje, por me poezinë dhe gëzimin e jetës së re. Të gjithë pjesëmarrësit, zonjat e mençura, vajzat e bukura në pritje të dasmës, burra krenarë, i japin një përkryerje qytetit të gurtë. Megjithatë, vepra është endur mbi një lëndë etnografike e zakonore, brenda realitetit social, përmes analizës së disa karaktereve apo më saktë, zërave, duke skicuar një varg portretesh dhe me skena lirike të kursyera, po mjaft prekëse.

Të gjitha miniaturat minimaliste etnografike që kemi propozuar më sipër ilustrojnë virtytet më të mira artistike të prozës letrare të Musine Kokalarit. Ato paraqesin një gdhendje tepër të vështirë të karaktereve dhe imazheve, zbulojnë nëpërmjet detajesh minimaniliste peshën e një bote të gjallë, organike, me një dozë të ndjeshme verizmi, fotografimi të brendshëm të hollësive sociale e ritualore dhe të shoqëruara me një buzagaz infantil e të përmbajtur.

Msc. Blerina ROGOVA-GAXHA
Universiteti i Prishtinës

Musine Kokalari: Gruaja

Historia letrare na kujton pozitën e derivonshme të gruas në letërsi – një inspiruese, rrallë edhe krijuese. Kohërat kanë ndryshuar dhe zërat femëror janë shndërruar në zëra që i dëgjojmë – zëra të dëshirave, ëndrrave dhe ideve.

Një nga këto zëra është edhe ai i Musine Kokalarit, gruas që hyri plot pasion në letërsinë shqipe, asaj që i ra hise të kalojë nëpër purgatorë të rrnojë në ferrin e ideologjisë komuniste, e kthyer 100 vjet më vonë, e nderuar si gruaja e veçantë e historisë së letrave shqipe.

Sot flasim për autoren që shkroi në moshë të re por nuk iu përshtat njeriut dhe jetës së re, meqë ishte "e vjetër" për hartën e re të kulturës shqiptare, e 'ndotur' politikisht në kohën kur nuk kish jetë politike; shkrimtaren dhe intelektualen e etiketuar 'me njollë' e cila eci shkurt nëpër aventurën e shkrimit duke u imponuar të njohë trajtën më të egër të jetës nën diktaturë, provuar pelimin e harresës, arratisjen nga bota duke qenë brenda saj, e lënë gjallë duke u vrarë.

Kam vënë në titull të këtij leximi emrin 'gruaja' si kujtim për jetën e vrarë pandreqshëm të gruas dhe autores që shkroi për jetën e vrarë të gruas shqiptare. Një kujtim ndaj gruas që luftoi fort për lirinë

individuale dhe ishte kjo luftë që ia mori më pas tagrin mbi jetën.

I kam vënë emrin Gruaja- duke iu referuar subjektit grua si qenie njerëzore e jo si seks femëror; gruaja – duke e parë atë ekuivalente me autorët që janë burra. Ndaj, edhe në këtë kujtim për të dua të flas për botën në të cilën ajo ka rrnuar, dëshiruar e shkruar në letra- për botën e gruas.

Gruaja

Në tre titujt e biografisë letrare të Musine Kokalarit, dy nga këta, *Siç më thotë nënua plakë* (1939) dhe ...*sa u tunt jeta* (1944) vënë në qendër gruan, duke e ndjekur kështu fillin e rrugës së letrave që e kërkon universin e gruas. Duke e bërë objekt botën e saj, meqë Subjekti/autorja është femër vetë, loja e jetës luhet në këtë univers, me theksin e vënë mbi njerëzoren, mbi femrën si qenie njerëzore. Nisur e ecur në këtë udhë, letërsia e saj bëhet thirrje e qenies së gruas për gruan, por thirrje nga brenda për kuptime përtej kufinjve normativ. Emri Musine na jep emrin e shkrimtares e cila brenda natyrës së vet e afirmon letërsinë për femrën, tek jep shenja të forta të letërsisë femërore, duke e bërë këtë shenjë identitet të letrave të saj.

Ato - Protagonistet femra flasin në këtë prozë, ato janë zërat që rrëfejnë dhe kërkojnë veshë që i dëgjojnë. Ato janë zërat e humbur nëpër kohë, zërat e historive të humbura që kthehen të kumtojnë. Zëra që shkëpusin fragmente nga jeta, duke shkëputur kështu një copë historie nga historia e një qytetërimi. Po qysh duken këto karaktere e ç'fytyra kanë?

Femra e fortë, rebele, ambicioze, ajo e cila ngritet kundër normave dhe mbron veten,femra që e dinë se çka duan-, jo, të tilla nuk ka te Kokalari. Të gjitha janë të nënshtruara forcës së të tjerëve. Ato nuk janë heroina të jetës së tyre - por viktima të saj.

Personazhet e Kokalarit janë pjesë e një shoqërie patriarkale, asaj shoqërie në të cilën filozofja dhe feministja Simonede Boauvoir e gjen femrën të përceptuar si 'tjetri", e dyta pas mashkullit, që konsiderohet e trajtohet si "i pari", kategorizuar në "gjininë e përkryer' dhe 'gjininë inferiore" (The Second sex, 1949[1]).

Pa dashur të hyjmë terrenit të feminizmit, por lidhur me konceptin e femrës dhe pozitës që ajo zë në këtë tekst letrar, ekzistenca e së cilës është e varur nga seksi i parë, mashkulli, që përherë ruan primatin.

E gjithë vepra e Kokalarit i referohet një ambienti- Gjirokastrës. Duke qenë protagoniste të dala nga një ambient konkret, si pjesë e tërësisë së sociumit patriarkal shqiptar, gruaja e Musines jep ngjyrat e gruas së kohës dhe përtej. Heroinave të tregimeve, u mësohet se çfarë duhet të jenë në jetë; çfarë role guxojnë ose nuk guxojnë t'i kenë. Duke qenë e shkelur, protagonistja, është njeriu që e mëson që herët historinë personale "ashtu siç ia kanë shkruar", e mbi këtë mësim duhet të plotësojë planprogramin. Një jetë që nis e sos sipas një plani. E lidhur fort për traditën, pa guxuar ta ëndërrojë ikjen, gruaja e Musines është e mbyllur, e vrarë, mos me thanë, e vdekur e gjallë. Por kjo nuk e pengon autoren që të krijojë një letërsi në të cilën gruaja është në qendër - edhe kur vuan, edhe kur vajton, edhe kur ankon.

Rrëfimi kap situatat e gjendjet e protagonistëve - konfiguracion që di të marrë përmasa dramatike. Përplasja ndërmjet brezave apo statuseve sociale të gruas çon në zhvillime të dramave, të cilat nuk e kërkojnë efektin e tragjikes, por dalin si pamje e jetës duke prekur fondamentalisht raportet e ndërmjeve të protagonisteve. Plakat, nënat, gjyshet, mbesat, nuset, vjehrrat, kunatat e fqinjtë; breza të vjetër, breza të rinj; gra që grinden e luftojnë, dhe gra gardiane të 'faqes së bardhë' ushqehen në këtë përditshmëri, ku ushqehen edhe figurat që firmojnë kontratat legale si fejesa e martesa.

1 Shih: Simone de Beauvoir, *The Second Sex,* Translated by Constance Borde and Sheila Malovany-Chevallier, Vintage Books, New York, 2011

Duke e bërë femrën referencë fundamentale të prozës së saj, autorja na kumton se nuk mund t'i rrijë indiferente jetës nëpër të cilën ka kaluar femra shqiptare, presionit mbi të, qënien e shtypur e të traumatizuar, qenien që i vret dëshirat e veta, e përulur karshi sistemit të normave etike e morale. Nuk mund t'i rrijë indiferente fatit të saj, që gjithnjë mbajti veshur rolet sociale, pa guxuar kurrë të zhvishet e të jetë vetëm vetja. Një grua individuale është e pamjaftueshme dhe e papranueshme si e tillë.

Në këto koordinata autorja vë relacionin mes individit dhe shoqërisë, duke e hedhur shikimin nga realiteti social në Shqipëri. Dimensioni social prek prozën e saj, dhe është ky brum që e motivon. E familjarizuar me mendësinë shqiptare e njohur pushtetin e saj, me shkathtësi ia zbulon fytyrën, tek e krijon dhe rikrijon brenda faqeve. Me femrën e ndodhur në kufijtë e moralit dhe ekzistencës, autorja e letrarizon këtë univers me shkëputjen e copëzave jete nga jeta e bashkësisë; copëzat bëhen pjesë e lojës letrare qoftë si kujtesë personale, si kujtesë publike, qoftë si kujtesë nga një kohë tjetër, duke e shndërruar jetën e tyre në kujtesë artistike. Kësisoj, Kokalari lojën në letërsi e bën me fenomene që e përfaqësojnë jetën, pa e shkruar historinë e një gruaje të vetme, po nën ombrellën e kryetemës, skema e ndërtuar ruan ndjeshmërinë për të shkuarën, për të atëhershëm dhe përtej kësaj kohe, fokusuar në qenien e Asaj/Atyre, si atmosferë permanente e prozës.

Socialiteti që përshkon prozën e Musines, e bën autoren një rebele, rebele që nuk afishon por si zonjë butë thërret në emër të jetës dhe shpirtit të lirë. Një rebele që thërret për gruan e vetëmjaftueshme.

Bota psikologjike - E angazhuar në trajtimin e temës sociale, e fokusuar në shtrimin e rrëfimit në një ambient, Kokalari ngacmohet të gërmojë më thellë, kureshtare të njohë psikën e qenies që e bën objekt letrar. Nëse identiteti i gruas si gjini femërore formohet

socialisht[2], cila është intima e saj, si mendje e emocion? Ndërtimi i karaktereve në tregime dhe roman rrjedh edhe mbi shtratin e botës psikologjike. Kokalari protagonistët i zëkalimthi edhe aty në dhomën e fshehtë të mendjes. Aty ku e zë vetëm. Aty ku gruaja hedh e mbjell farat e dëshirave e të imagjinatës. E interesuar në temën sociale, autorja eksploron në ato rrethana për të zbuluar psikologjinë e saj, për t'i esencializuar karakteret, e rrnuar qoftë edhe për pak në botën që fsheh.

Në këtë botë psikologjike,[3] vështron dhe zbulon proza e Musines, për ta gjetur femrën në burgun e saj si fat, mentalitet e realitet – nëprovën e fuqishme kundër jetës së munguar dhe zhveshjes së qenies nga vlerat individuale.

Me ligjërimin krejtësisht femëror dhe konceptin origjinal të vënies së rrëfimit në shtratin real të gruas, vepra e Musines dëshmon fuqinë e reagimit ndaj përdhunimit shpirtëror e psikik të femrës si qenie njerëzore. Një poetikë e letrave që buron e sos në "seksin e dytë".

Po t'i referohemi idesë së ekzistencialistëve për lirinë individuale[4], i bie që këto protagoniste rrojnë në atë që quhet "fat i keq", nën ombrellën e të cilit qeniet lejojnë të drejtohen nga identitete të jashtme. Kësisoj, fakti i të çuarit të jetës pa fuqinë e vendimmarrjes nuk reprezenton vetjen e tyre reale. Në të kundërtën e kësaj vetjeje, përfaqësojnë vetjen e imponuar. Prandaj, kërkimi i "lirisë radikale" sipas leksikut të kësaj filozofie, është i paimagjinueshëm për gruan e Musines. Kjo grua, pjesë e një konteksti dhe një kulture, e detyruar të luajë rolet e përcaktuara nga të tjerët, e ka të vrarë sensin e lirisë dhe autenticitetin.

2 Po aty, Simone De Beauvoir nënvizon se : "Gruaja nuk lindet si e tillë, por bëhet Grua".
3 Kujtim M. Shala, *Shekulli i Letërsisë Shqipe,* Gjon Buzuku, 2006, Prishtinë, fq. 209
4 Shih Jean Paul Sartre, *Being and Nothingness -An Essay on Phenomenological Ontology,* Philolosical Library New York, 1956 si edhe Jean Paul Sartre *Being and Nothingness*, *An Essay on Phenomenological Ontology,* Philolosical Library, New York, 1956; Jean-Paul Sartre, *Essay: Existencialism is Humanism,* World Publishing Company, 1956; Martin Heidegger, *Being and Time,* A translation of Sein und Zeit, Translated from Johan Strambauch, State University of New York, 1996

Para e mbi gjithçka, ajo duhet të mësojë "qysh me rrnue me faqe të bardhë"! Fjali kjo e cila akoma zë primatin e këshillave prindërore në edukimin e femrës shqiptare.

Kjo është ideja themelore e Kokalarit në tekstet për gruan, dhe kërkesat e saj si kërkesa idesh, pretendojnë ikjen nga normat, konvencat, ikjen drejt lirisë individuale.

Në komentin autorial "Duke mbaruar", vënë pasthënie e prozës ...*sa u tunt jeta*, lidh kohën e vet me kohën e rrëfimit, duke lansuar idenë e një lidhje tjetër të femrës me botën, një marrëdhënie e re në një kohë të re, me të drejtën e lirisë si autonomi: "Gruaja sot, nga bota e perënduar e djeshme zuri udhën e saj dhe kërkon të jetë përgjegjëse për vehten e saj dhe të marrë pjesë në të gjitha ngjarjet e kohës, kërkon të dijë se ku rron e përse rron në jetë për të drejtën që ka, si pjesë e pandarë e saj që është."[5] shkruan Kokalari.

Analizë ontologjike e ekzistencës njerëzore

A ishte i saji "fat i mirë" që ajo iku rrugës së kërkimit të lirisë individuale, apo "fati i kaq" që Musine Kokalari duke qenë pjesë e një kulture të caktuar, e një kohe dhe konteksti historik thithi shumë nga liria absolute pa e matë edhe peshën e kësaj lirie. Në këtë fat të keq, ajo u ndodh përkarshi ideologjisë dhe armës politike që e goditi fort. Dhe po kaq fort ia goditi lirinë.

Musineja jetoi, provoi e shkroi shkurt në letërsi; shkroi duke njohur së brendshmi natyrën e vet si femër, me intencën e ballafaqimit të kësaj qenieje, njohjen, banimin me të dhe luftën e përbashkët në botën e vështirë.

Një zë gruaje si esencë e qenies së saj, rebelues në jetë e në letra.

5 Musine Kokalari, *Vepra, Vëllimi i dytë*, Geer 2009, Tiranë, f. 229

Simonetta Ceglie

Arkivi Shtetëror i Romës

"Një jetë e lehtë, e këndshme dhe plot ëndrra": vitet e Musine Kokalarit në "La Sapienza" mes kujtimeve dhe dokumentit

«Një jetë e lehtë, e këndshme dhe plot ëndrra». Me këto fjalë emblematike e reja Kokalari hap dhe mbyll kujtimet e saj universitare në Fakultetin e Letërsisë në "La Sapienza". Me tone melankolike dhe ngjyresa të ndryshme, ato përdoren nga shkrimtarja për të përshkruar të gjithë parabolën ekzistenciale të përjetuar prej saj gjatë katër viteve të studimit në Romë, nga ëndrra e madhe e adoleshencës te zhgënjimet e përjetuara hap pas hapi para rikthimit përfundimtar në Tiranë. «Jeta që kam bërë në këto vite universiteti ka qenë pikërisht e kundërta e asaj që kisha krijuar në mendje me fantazinë time»[1] –jo rastësisht, kjo lexohet në versionin e parë të Parathënies, të ndryshuar më pas.

Bëhet fjalë për kujtime të menduara që në fillim për t'u botuar (fjala libër përsëritet plot tri herë në Parathënie) e të vendosura gjatë viteve

1 M. Kokalari, *La mia vita universitaria*. *Memorie di una scrittrice albanese nella Roma fascista* (1937-1941), botuar nga S. Ceglie dhe M. Geraci, Romë, Viella, 2016, f. 111, shënimi nr. 3

të vështira të pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, në klimën që i parapriu Luftës së Dytë Botërore, së cilës Musineja i fikson dhe i eksploron anët e shumëfishta. Shkrimtarja e sheh Shqipërinë duke u përpjekur të kuptojë dhe të përvetësojë pikëvështrimin italian, i qaset dhe përsiat mbi "okcidentin" tonë modern me kërshërinë vëzhguese dhe introspektive të një intelektualeje eklektike, të një studiueseje të njohur; jo rastësisht në daktiloshkrim, shkrimtarja do të vihet në provë duke përdorur një gjuhë jo të sajën, italishten. Pikërisht lufta që kërcënon në horizont, një nga nyjat qendrore të *La mia vita universitaria*, jo vetëm bie rëndshëm mbi jetën e përditshme dhe universitare, amplifikon shqetësimet dhe nostalgjinë e largësisë, por karakterizon fuqishëm ndërtimin e identitetit personal të shkrimtares së re, perceptimin e unit dhe të të tjerëve, ndjenjën e dashurisë. «Rrethanat politike ndikojnë shumë mbi gjendjen shpirtërore»: këtë shkruan Musineja, e vetëdijshme se ka mbetur primitive, thellësisht e huaj karshi «frymës qytetare dhe ultramoderne»[2] të një perëndimi përherë e më agresiv e të armatosur.

La mia vita universitaria paraqet kështu një "libër në sirtar" me një vis poetica (i. e. fuqi poetike) veçanërisht me peshë dhe interesante nga shumë pikëvështrime: nga ai letrar, dokumentar, historik, filozofik dhe antropologjik.

Si historiane dhe arkiviste që jam, studimet e mia të gjata mes Romës dhe Tiranës janë përqendruar në zbulimin dhe analizën e krahasuar të burimeve historike-dokumentare në lidhje me veprën dhe autoren e saj. Kjo i përgjigjet nevojës për të nxjerrë në pah sa më shumë të jetë e mundur kontekstin, dialektikat politike, sociale dhe kulturore të kohës, si p.sh. rrjetin e gjerë të raporteve dhe pikëvështrimeve që burojnë nga narracioni për të nxjerrë në pah, mes Shqipërisë dhe Italisë, thellësinë intelektuale të Musine Kokalarit. Përmes një krahasimi të kujdesshëm mes tekstit të shtypur me makinë

2 Po aty, f. 186

dhe dokumenteve të tjera, në masë të madhe të pabotuara, të ruajtura sidomos pranë Arkivit Qendror të Shtetit në Tiranë dhe Arkivit historik të Universitetit të Studimeve "La Sapienza" i vura qëllim vetes të hetoja dhe të rindërtoja kontekstin historik-kulturor, personazhet, marrëdhëniet, ambientet studentore, skenarët intelektualë në të cilat Musinesë iu desh të jetonte dhe që na i përshkruan në këto kujtime. Në të njëjtën mënyrë, të vësh përballë daktiloshkrimin me draftin e tij të parë, të shkruar me dorë, më shërbeu për të nxjerrë në pah disa aspekte tekniko-stilistike, të metodologjisë së shkrimit dhe rishikimit të tekstit, e që kanë të bëjnë me përdorimin e italishtes së eksperimentuar prej shkrimtares, që e bëjnë *La mia vita universitaria* një vepër të vërtetë letrare. Një vepër që do të jetë, siç e thekson Musineja në Parathënie, «një dëshmi personale e vetë përvojës sime të jetës dhe - edhe më shumë - e mendimit tim»: pra, rindërtimi i një përvoje formuese (jo vetëm intelektuale) ku e reja Kokalari ripërshkon hapësira fizike dhe në të njëjtën kohë vende të brendshme, shpirtërore. Realiteti filtrohet nga drita e personalitetit të saj, nga mënyra e saj e të qenit, e shpirtit të vet. «Është një prozë e natyrshme e jetës së përditshme» - shkruan prapë autorja. Stili është i thatë, drejtvizor, por zotëron një fuqi të jashtëzakonshme shprehëse dhe empatie: mendimet e saj, përsiatjet, emocionet e saj na përfshijnë aq sa bëhen tonat, bëhen pjesë e "të qenit tonë në botë".

Përpiqem të sintetizoj në këto faqe disa bërthama tematike të kërkimit – kontekstin universitar dhe atë të marrëdhënieve njerëzore, në veçanti – duke u nisur nga një ilustrim i shkurtër i serive me dokumente me më shumë interes të gjetura në dy institutet e rëndësishme kulturore të sapopërmendura. Burim i zgjedhur arkivor ka qenë pa dyshim fondi Musine Kokalari, sot i ruajtur pranë Arkivit Qendror të Shtetit në Tiranë. Dokumentimi, me origjinë nga Ministria e Brendshme, departamenti i Sigurimit të Shtetit është depozituar në masë të madhe mes viteve 1980-1982; në vitet 2005-

2011 janë siguruar dokumentet e fundit. Renditja e fondit dhe hartimi i inventarit analitik daton që nga viti 1983: bëhet fjalë për 6822 njësi dokumentare të tipologjive të ndryshme – letra, kartolina, telegrame, fotografi, rrëfime, poezi, studime, revista, kontrata, përshëndetje, lajmërime, libra, dokumente, kujtime – të renditura në 91 fashikuj dhe të nënndara në seri tematike. Materialet, të hartuara në shqip, frëngjisht, anglisht dhe italisht, gjenden të ruajtura sipas modaliteteve të ndryshme (origjinale, kopje, mikrofilma). Objekt parësor i studimit kanë qenë daktiloshkrimi i pabotuar i *La mia vita universitaria* dhe një version i mëparshëm i saj i shkruar me dorë, që të dyja autografe, plot me shtesa, citime dhe korrigjime nga dora e autores[3], që më kanë dhënë mundësi të kryej një analizë krahasimore fryt i së cilës ishte një transkriptim besnik, sa më afër tekstit origjinal. Shkrime të tjera me rëndësi ruhen pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, në veçanti disa vepra letrare dhe tema e diplomës e Musine Kokalarit.

Mes kartave të Arkivit Historik të universitetit "La Sapienza" janë marrë veçanërisht në shqyrtim praktikat në lidhje me fakultetin, programet e leksioneve, bursat e studimit, fashikujt personalë të profesorëve dhe studentëve, vjetarët, relacionet e rektorëve. Seri të gjitha të çmuara dhe të pazëvendësueshme qoftë për rindërtimin e karrierës akademike së Kokalarit të re dhe enturazhit të saj universitar e miqësor shqiptar dhe italian, që vërtitej përreth «qytetit të ri të studimeve» inauguruar pak kohë më parë falë vullnetit të Duçes, qoftë për t'i përfshirë më mirë mënyrat e karakterin e një përshtatjeje hap pas hapi të La Sapienza-s në rolin politik të "ateneut të regjimit", po të përdorim kështu një shprehje të Filippo Turatit, në atë kohë sekretar i Partisë Nacionale Fashiste.[4] Nga shfletimi i

3 Daktiloshkrimi përbëhet nga 118 fletë të shkëputura në format A4, me numërtim origjinal dhe një Parathënie të panumërtuar; autorja ka përdorur dy makina të ndryshme shkrimi, shirita të ngjyer me bojëra ngjyrash të ndryshme (të zezë, blu) dhe material të ndryshëm shkrimi (letër, letër kalk). Një draft i parë i dorëshkruar i kujtimeve gjendet në një bllok shënimesh me katrorë, i formatit A4, i ruajtur në fletë të shkëputura, të panumërtuara; ka vija të hequra me bojë të zezë dhe blu, me korrigjime të shumta autografe në bojë të kuqe, jeshile dhe me laps

4 Me fundin e pushtetit shekullar, Universiteti i Romës, i themeluar nga Bonifaci VIII më

materialit në lidhje me karrierën universitare të shkrimtares shqiptare (1938-1941), dokumentet më interesante, si p.sh. kërkesat drejtuar «Rektorit të madhërishëm të Universitetit mbretëror të Romës» për të dhënë provime apo për marrjen e dëshmisë së provimeve të dhëna, certifikatat, bursat e studimit, libreza e anëtarësisë në kursin e diplomës, janë ato që na kanë dhënë mundësi të rindërtojmë vazhdën e studimeve në La Sapienza, të futemi brenda asaj bote universitare, të ravijëzuar në dorëshkrim, për të njohur planet e studimit, programet, lëndët, provimet, profesorët, tezat dhe notën e diplomës.[5]

Me La mia vita universitaria - siç duket qartë që nga Parathënia - Musine Kokalari ka për qëllim në radhë të parë të dëshmojë se ka realizuar «një aspiratë të madhe, të re për ne vashat shqiptare: Universitetin». Dhe shkruan prapë autorja: «Mungesa në vendin tonë e kësaj shkalle të lartë studimesh (...) na shtyn të kërkojmë jashtë dhe natyrisht në Itali mënyrën për ta kënaqur ambicien tonë».[6] Për dëshmi të kësaj, siç kujton shkrimtarja në një vepër të mëvonshme me titull *Si lindi Partia Social-Demokrate*, disa shoqe të saj të klasës në institutin femëror "Nâna Mbretneshë" në Tiranë, patën mundësi të vazhdonin

1303 dhe të dalluar qartë që nga shekulli XV me emërtimin "La Sapienza" nisi të bënte pjesë në rregullimin universitar italian, duke mbajtur pranë vetes dokumentacionin e prodhuar pas vitit 1870 - përfshirë kështu edhe atë të periudhës që na intereson - ndryshe nga dokumentet më të lashta që sot në masë të madhe kanë përfunduar në Arkivin e Shtetit në Romë. Ateneu roman zotëron një trashëgimi dokumentare me interes mjaft të madh, të ndarë mes arkivave të strukturave mësimdhënëse dhe kërkimore, dhe arkivave të administratës qendrore; kjo e fundit, e artikuluar në nënndarje, prodhon dhe konservon pjesën më të spikatur të dokumentacionit, në veçanti arkivin historik. Arkivi konsultohet me vështirësi, pasi i mungojnë mjetet dhe pajisjet e përshtatshme; veç kësaj, materialet që kanë të bëjnë me shumë fakultete, përfshi këtu edhe fashikujt e studentëve janë të stivosur në vende të ndryshme, dhe ç'është e vërteta nuk mund të shfrytëzohen. Kërkimi ka qenë vërtet i papritur: fashikulli universitar personal i Musine Kokalarit, i pasur me dokumente dhe foto të pabotuara, thjesht u nxor nga një grumbull i përzier letrash, falë ndihmës së një rojtari të vjetër, afër moshës së pensionit.

5 Në lidhje me këtë, krh. Arkivin historik të Universitetit të Studimeve «La Sapienza» (këtej e tutje, ASS), Arkivin e përgjithshëm të studentëve, verbalet e seancave të provimeve për diplomë. vëll. 44: sesioni dimëror i jashtëzakonshëm (a. a. 1940-1941), matrikulli nr. 8971, «Procesverbal i provimit të diplomës në Letërsi», 28 nëntor 1941. Në të, jepet komisioni i diplomës, që nga kreu Giuseppe Cardinali te relatori Namik Resuli dhe të gjithë pjesëtarët, nga Giuseppe Schirò jr. te Gaspare Oliverio, Mario Praz, Pietro Paolo Trompeo, Natalino Sapegno, Pietro Romanelli, Maria Ortiz, Giulio Jacopi, Salvatore Aurigemma; janë shkruar dhe titulli i tezës (Naim Frashëri), si dhe firmat e docentëve dhe vota e diplomës (110 në 110 cum laude)

6 *La mia vita universitaria*, fq. 111

studimet jashtë, duke u diplomuar në fusha të ndryshme disipline. Një pjesë e mirë e tyre, shumë herë të përmendura në kujtime, u regjistruan në La Sapienza: Musineja për Letërsi, Vera Bogdo për jurisprudencë, Agllai Harito dhe Gliqeria Koço për mësimdhënie: më në fund, Kristina Koljaka (vepër e së cilës është një portret sugjestiv me laps, që bashkë me dedikimin gjendet në një libërth të vjetër kujtimesh shkollore) që u diplomua në Akademinë e Arteve të Bukura të Romës, duke u bërë më pas një skulptore me emër. «Klasa jonë», - shënon me njëfarë krenarie Musineja - jo shumë e madhe në numër, arriti kështu numrin maksimal të universitareve».[7]

Ç'është e vërteta, në Shqipërinë e atyre viteve – me gjithë papunësinë intelektuale të përhapur në masë – ekzistonte një garë e vërtetë për t'u futur në gjimnazet-lice (të frekuentuara nga gati 80% e nxënësve) dhe më pas në universitete.[8] Në lidhje me këtë, mjaft dritë hedh një Raport mbi kushtet e rregullimit shkollor dhe organizimit rinor që Sestilio Montanelli, «ekspert italian pranë Ministrisë së Arsimit publik në Tiranë»[9] hartoi më 1937 me porosi të mbretit Zog, si dokument paraprak për një reformë të përgjithshme të legjislacionit shkollor, për t'u paraqitur në parlamentin shqiptar. Nga analiza e të dhënave rezulton një analfabetizëm i përhapur sidomos në zonat malore, një hendek i thellë mes instituteve shkollore të çorganizuara, të papërshtatshme në programe, në përgatitjen e mësuesve dhe nevojat e vërteta të vendit, si dhe mungesa e plotë e një sistemi universitar. Për të rritur e shtuar formimin e krerëve teknikë, punëtorë dhe bujqësorë, projekti që në masë të madhe mbeti në letër deri në kohën

7 M. Kokalari, *Si lindi Partia Socialdemokrate* në: *Vepra*, nën kujdesin e N. Xh. Shehut, Geer, Tiranë, 2009, II, ff. 400-401

8 Ëndrra e një fëmije të diplomuar mbetet edhe sot mjaft e pranishme në familjet shqiptare; aq sa, në vitet 2000, shqiptarët e regjistruar në universitetet italiane zënë vendin e parë ndër studentët e huaj dhe Letërsia, Artet e Filozofia janë gjithmonë ndër fakultetet më të frekuentuara. Në lidhje me këtë, krh. R. Devole, *Il ponte sul mare. L'emigrazione albanese in Italia*, Tirana, Ora, 2008

9 ASS, Archivio generale, Personale docente, Fascicolo personale docente E. Koliqi, AS 45-7: «kërkesë për marrje masash» nga Giuseppe Bottai dërguar Pietro De Francisci-t, më 6 tetor 1938. Mbi këtë temë, krh. S. Montanelli, *La scuola albanese nel crollo del regime zoghista,* në «Scuola e cultura», XVI, 5-6 (qershor 1940), f. 318-323

e pushtimit fashist të vendit, ishte përqendruar mbi themelimin e një shkolle të mesme unike dhe «një numri të madh shkollash pune» si dhe ndërkohë, në uljen drastike të numrit të «shkollave të llojit klasik» në katër lice dhe dy shkolla normale (një për meshkuj dhe një për femra); italishtja ishte e vetmja gjuhë e huaj e lejuar. Pas pushtimit musolinian të vitit 1939, në krye të shkollës së re shqiptare tashmë të rakorduar me sistemin shkollor italian u vu Ernest Koliqi, i cili u thirr të drejtonte, në po të njëjtin vit, Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe të sapoformuar pranë Universitetit të Romës, në të cilën u drejtua edhe e reja Kokalari.

Nga mesi i janarit '38, Musineja, e sapoardhur në kryeqytet, bëhej gati të regjistrohej në Fakultetin e Letërsisë në La Sapienza, në vitin akademik që tashmë kishte filluar. Po cili ishte konteksti universitar me të cilin studenteshës së huaj iu desh të përballej?

Gjatë dekadës 1930-1940 haset një rritje progresive e popullsisë studentore italiane qoftë në atenejtë, qoftë në institutet dytësore. Në veçanti, fuqizimi i La Sapienza-s mund të inkuadrohet fare mirë, siç thamë më lart, në rëndësinë e spikatur kombëtare që iu mvesh nga regjimi, në vullnetin e deklaruar politik për ta bërë Universitetin e Romës «qendrën më të lartë të studimeve në Itali», rol i nënvijëzuar nga madhështia e qytetit të ri të studimeve, me porosi të Benito Mussolinit për Marcello Piacentinin, inauguruar më 1935, që jo rastësisht përputhej me thirrjen nën armë në luftën perandorake të Etiopisë.[10] Në ato vite, Fakulteti i Letërsisë ngrihej si qendër e rëndësishme e pushtetit akademik, siç duket nga leximi i procesverbaleve të Këshillit të Fakultetit. Profesorët me detyra prestigjioze ishin përherë e më

10 «Të ndërtojmë në Romë, ama për Italinë» – kështu shkruhet në Marrëveshjen për përfundimin e veprave të rregullimit ndërtimor dhe për mobilimin e Universitetit mbretëror të Romës, e 4 prillit 1932 – dhe jo vetëm për këtë kohë nga pikëpamja arkitekturore të trazuar, por edhe për shekujt e ardhshëm: të ndërtohet për atë që është tashmë qendra më e lartë e studimeve të Mesdheut, dhe që nuk duhet të ketë ndalim në ngjitjen e saj të vazhdueshme». Ndërtesat që krijojnë planimetrinë kryesore janë dymbëdhjetë, arkitektët që i projektuan, dhjetë; që të gjithë të përzgjedhur nga Piacentini, drejtuesi i punimeve. Në veçanti arkitektit sicilian Ernesto Rapisardi i detyrohet krijimi i Fakultetit të Letërsisë dhe Filozofisë, Jurisprudencës dhe Shkencave Politike.

shumë të shënjuar nga aderimi në fashizëm dhe shumë prej docentëve ishin senatorë dhe akademikë të Italisë, si Giuseppe Cardinali, Giulio Quirino Giglioli, Francesco Ercole, që të gjithë profesorë të Musine Kokalarit. Në të njëjtën mënyrë, brenda strategjive të përvetësuara qoftë në përbërjen e katedrave, qoftë në ndërfutjen e mësimeve të reja, hynin përherë e më shumë në lojë jo vetëm motivimet shkencore ose organizative, por edhe ato ngushtësisht politike, sipas direktivave të fashizmit, që të gjitha me synimin për të forcuar raportet me regjime politikisht të ngjashme, aleate ose të nënshtruara.

Në këtë gjendje të krijuar, e prekshme ishte valenca strategjike e aktivizimit – në vitin akademik 1939-1940 – e «një mësimdhënieje të gjuhës dhe letërsisë shqipe në transformim të lektoratit të tanishëm», projekt didaktik i promovuar fuqishëm nga Ministria e Punëve të Jashtme, si në emërimin në ordinar të Ernest Koliqit (që nga 1938, lektor i gjuhës shqipe) siç e kemi parë, i emëruar që prej pak kohësh Ministër i Arsimit në Shqipërinë fashiste. «Ekzistenca e një mësimdhënieje të duhur ("vero e proprio")» – shkruhet qartë në një shënim të Giuseppe Bottait, Ministër i Arsimit Kombëtar, për Pietro De Francisci-n, rektorin e ateneut roman – «do t'i shtyjë shumë studentë shqiptarë që tani për tani frekuentojnë universitetet e huaja, t'i kryejnë studimet e tyre në Itali, me avantazh të dukshëm për propagandën e konceptimeve ideologjike dhe politike të regjimit».[11] Këto fjalë ishin në një vijë me reformën e sistemit shkollor të Shqipërisë, të ravijëzuar nga profesor Montanelli, i cili parashikonte përqendrimin në Romë të pjesës më të madhe të studentëve shqiptarë

11 ASS, Archivio generale, Personale docente, Fascicolo personale docente E. Koliqi, AS 45-7: «kërkesë për marrje masash» e datës 6 tetor 1938. Pason një shënim po i Botait, drejtuar rektorit (26 qershor 1939) në të cilën, «prof. Ernesto Koliqi emërohet ordinar i Gjuhës dhe letërsisë shqipe pranë këtij Fakulteti të Letërsisë dhe Filozofisë, me efekt nga 29 tetori 1939 – viti XVIII i erës fashiste, falë famës së lartë të aftësive të jashtëzakonshme që ka marrë në fushën e studimeve të sipërthëna». «Ndërsa bëj këtë komunikim, kam kënaqësinë të formuloj – shkruan sërish ministri – përgëzimet më të ndjera për fatin e këtij Ateneu, që rrok brenda gjirit të vet, pas ngjarjes historike të bashkimit të Shqipërisë me Mbretërinë e Italisë, mësuesin e parë shqiptar, të thirrur për të dhënë kontributin e vet në Universitetin italian. (Po aty)

që kishin dëshirë të vazhdonin studimet në universitet.[12] Qëllimi i regjimit, për të përmirësuar marrëdhëniet me vende "miq" ose "satelitë" pasqyrohej pa dyshim në rritjen e theksuar të studentëve me prejardhje nga vende ku sundonin regjimet autoritare ose fashiste: në vitet e para të luftës, grupet më të mëdha përbëheshin prej shqiptarëve, bullgarëve, gjermanëve, jugosllavëve, hungarezëve. Këtë e vërteton – po të shqyrtojmë statistikat e të regjistruarve sipas kombësisë, të dhëna nëpër vjetarët e periudhës pak para konfliktit të dytë botëror – një rënie progresive, qartazi e spikatur, e studentëve nga Shtetet e Bashkuara që shkonin nga 106 (nga 372 gjithsej) në periudhën 1935-1936, në 26 (nga 390) në vitet 1940-1941 dhe një prurje përherë e më e madhe studentore nga vende si Shqipëria, në rritje të fortë për nga numri i pranisë: nga 22 në 97 (grup universitar kryesisht i përfaqësuar në La Sapienza). Në vitin akademik 1939-1940, për shembull, siç e tregon dhe skema e mëposhtme, Shqipëria ishte kombi me më shumë të regjistruar (53), pasuar nga SHBA (45); studenteshat shqiptare (10) ishin në vend të dytë pas atyre gjermane (12).[13] Në rastin specifik, është interesante të nënvizohet se në Fakultetin e Letërsisë shqiptaret – që mungojnë në statistika deri nga gjysma e dytë e viteve '30, nisin të shfaqen pikërisht në kohën e Musinesë. [14]

12 Më pas, u zgjerua organika e kursit të ri të diplomës: vitin tjetër, Namik Ressuli u emërua profesor përgjegjës për lëndën dhe që nga 1941 Giuseppe Schirò jr. i shtoi funksionit të lektorit, docencën e lirë. Më 1957 katedra e gjuhës dhe letërsisë shqipe u ngrit në rangun e Institutit të Studimeve Shqiptare, vënë nën udhëheqjen e Ernest Koliqit deri më 1973.

13 Annuario per l'anno accademico 1939-1940, Romë, Fratelli Pallotta, s. d., ff. 960-963, tab. 7; të huajt e regjistruar në La Sapienza janë gjithsej 405 në numër (332 meshkuj dhe 73 femra). Prania më e konsiderueshme e studentëve shqiptarë ka të bëjë me fakultetin e mjekësisë dhe kirurgjisë (7), jurisprudencës (19) dhe mësuesisë (12); në këto dy rastet e fundit evidentohet një rritje e fortë e studentëve të regjistruar meshkuj, përkatësisht 18 në 19 dhe 9 në 12. Një rol të rëndësishëm në favor të ardhjes së studentëve nga jashtë luan dhe dhënia e bursave të studimit dhe lehtësi të tjera, sikundër del nga kërkesat e bëra vit për vit nga Musine Kokalari për përjashtimin nga taksat universitare, ose uljen e tyre, në cilësinë e «studentes me nënshtetësi të huaj, e që i përket një familjeje me banim jashtë shtetit», të pranishme në fashikullin e saj universitar (ASS, Archivio generale degli studenti, Fascicoli personali degli studenti, Facoltà di lettere, matrikulli nr. 8971)

14 Në vitin akademik 1937-1938 (i njëjti vit në të cilin u matrikullua edhe shkrimtarja jonë) rezulton e regjistruar në Fakultetin e Letërsisë vetëm një vajzë shqiptare dhe asnjë djalë: *Annuario per l'anno accademico* 1937-1938, f. 718-719, tab. 7

FAKULTETI	Studentë	Studente
Jurisprudencë	18	1
Shkenca politike	1	
Shkenca statistikore, demografike dhe të tanishme		
Ekonomi dhe tregti	4	
Letërsi dhe filozofi	1	3
Mësimdhënie	9	3
Mjekësi dhe kirurgji	5	2
Shkenca matematike, fizike dhe natyrore	4	
Farmaci		1
Inxhinieri civile dhe industriale		
Inxhinieri minerare	1	
Inxhinieri aeronautike		
Arkitekturë		
Kurse unike		
Totali i studentëve shqiptarë	43	10

Përsa i përket kontekstit nga ana sociale dhe e marrëdhënieve ndërpersonale, Musineja u bë menjëherë pjesë e bashkësisë së studentëve shqiptarë jashtë shtetit; madje, shpejt nisi të konsiderohej si pikë referimi për t'u integruar në ambientin e ri roman. «Brune, tërheqëse, me gjatësi mesatare shtati, me sytë ngjyrë gështenjë, të zgjuar e të thellë, me përgjigjen përherë në majë të gjuhës, e saktë dhe inteligjente»: kështu na e përshkruante Lazër Radi (në atë kohë i regjistruar për jurisprudencë) studenten karizmatike, të talentuar me «vështrimin depërtues», tashmë të njohur në Tiranë më 1937 në redaksinë e «Shtypit», gazetë në të cilën bashkëpunonin të dy. Në vitet romane, e reja Kokalari, gazetare dhe shkrimtare e sapoafirmuar, pati mundësi të lidhte marrëdhënie – përveç Radit, i cili, edhe pse bashkëmoshatar, nuk ngurron të deklarohet «nxënës dhe dishepull i saj» – me një grup të dendur universitarësh shqiptarë, jo vetëm banues në kryeqytet, edhe ata gravitues rreth botës kulturore dhe letrare; mund të përmendim, ndër të tjerë, emra si Luigj Ljarja, Vangjel Sotiri, Kolë B. Ashta, Pashko Gjeçi, që të gjithë kolegë të

Fakultetit të Letërsisë, të hasur përgjatë rrjedhës së kërkimeve, në regjistrat e studentëve që ruhen në Arkivin historik të La Sapienza-s.[15] Nga ana tjetër, Musineja – që sapo i kish mbushur 20 vjetët, ishte tashmë autore e zhdërvjellët dhe e vlerësuar, duke pasë nisur që herët të shkruajë, që përpara se të ndiqte ëndrrën universitare në Romë; e kishte sprovuar veten në zhanret e ndryshme, që nga poezitë dhe tregimet e shkurtra me sfond etnografik, te artikujt që eksploronin kontradiktat e pranishme në shoqërinë rurale shqiptare me referim të veçantë ndaj vartësisë dhe nënshtrimit të gjendjes së grave, vërtet të guximshme për një vajzë të atyre kohëve, botuar me pseudonimet Muza ose Tacita nëpër faqet e revistave dhe gazetave. Veprimtari letrare që siç mund të lexohet në mjaft vende të dorëshkrimit, u shpeshtua dora-dorës ndërsa përparonin studimet në La Sapienza, ndërsa zgjeronte synimet dhe interesat, duke përkryer zotësitë e veta, duke shfrytëzuar marrëdhëniet e reja dhe mundësitë e punësimit. Për ta mbështetur këtë hipotezë, shumë fitimprurës doli krahasimi i njoftimeve të nxjerra nga teksti me tipologji të tjera dokumentesh – korrespondencë, shënime, projekte, drafte të para veprash të ndryshme (kërkime etnografike, studime biografike dhe mbi letërsinë shqipe, kërkime gjuhësore, shkrime letrare, fabula, përkthime dhe përmbledhje të ndryshme) – të pranishme në fondin Musine Kokalari të Arkivit Qendror të Shtetit në Tiranë. Mjafton të përmendim këtu përmbledhjen me novela *Siç më thotë nënua plakë*, për redaktimin e së cilës, siç ceket dhe në kujtime, shkrimtarja i kushtoi pjesën më të madhe të verës së vitit 1938. Botimi në Tiranë i këtyre dhjetë tregimeve të shkurtra, frymëzuar nga folklori toskë dhe të hartuara në

15 Fakulteti i Letërsisë, viti akademik 1938-1939, «Gjeci, Pasquale» (sic!), «Ashta, Kole Balto»; viti akademik 1939-1940, «Ljaria, Luigi». Fakulteti i jurisprudencës, viti akademik 1939-1940, «Radi, Lazer» (ASS, Archivio generale degli studenti, Fakulteti i Letërsisë; po aty, Fakulteti i jurisprudencës: «Lista e studentëve të regjistruar»). Mes tyre, Pashko Gjeçi u bë letrar dhe përkthyes (i Dantes në veçanti) dhe Kolë B. Ashta, nxënësi i Çabejt, filologut me emër, ishte docent dhe kërkues shkencor i gjuhës shqipe në universitetin e Shkodrës, qytetin e vet të lindjes; Lazër Radi, me origjinë nga Kosova, avokat, shkrimtar, poet dhe gazetar, më 1944 u burgos nga regjimi komunist dhe u internua në kampet e punës, duke u liruar vetëm në vitin 1991

dialektin e Gjirokastrës ngjalli interes dhe i siguroi detyrën e caktuar në pranverën e vitit 1940 nga Pietro Parini, në atë kohë komisar italian në Shqipëri, «për të shkruar përshtypjet e një gruaje shqiptare në Itali»[16] me referencë të veçantë ndaj jetës së studentëve shqiptarë në Romë: bëhej fjalë për rubrikën *Nënua plakë në Romë*, botuar pjesë-pjesë në faqet e gazetës «Tomori» në verën e po atij viti.[17] Jehona e veprave të saj i dha mundësi shkrimtares, gjatë kursit të studimeve në Fakultetin e Letërsisë, të krijonte marrëdhënie e korrespondencë epistolare me gjuhëtarë dhe letrarë shqiptarë e italianë të kalibrit të Andrea Varfit, Aleksandër Xhuvanit, Lasgush Poradecit, Ali Asllanit, Ernest Koliqit, Angelo Leottit, Carlo Tagliavinit. Nga ky pikëvështrim, vërtet bujare e shprehëse rezultojnë vlerësimet e këtij glotologut të fundit, të famshëm, në atë kohë docent pranë Universitetit të Padovës, i cili me nderim i drejtohej studenteshës për të davaritur dyshime ose pasiguri interpretuese mbi «disa fjalë e fraza të paglosuara» përdorur prej saj në tekstin e novelave të sapopërmendura; ose korrespondenca e dendur, e ndërmarrë në periudhën 1940-1943 me Angelo Leottin, gjuhëtar bolonjez i cili kish ndër duar harimin e një «gramatike shqipe tërësore» e që deklarohej admirues i saj, i gatshëm të lexonte gjithë veprat që kishte botuar; ose, propozimi i bërë nga Ernest Koliqi nxënëses së sapodiplomuar në katedrën e tij, për të bashkëpunuar me revistën «Shkëndija», e përmuajshmja kulturore të cilën drejtonte.

Nëse marrim në shqyrtim kontekstin universitar roman, në fillim Musineja hasi në shumë vështirësi në qasjen me kolegë të rinj të La Sapienza-s, meqenëse nga gjuha italiane zotëronte vetëm nocione të

16 *La mia vita universitaria*, p. 160

17 Krh. Arkivi Qendror Shtetëror i Shtetit të Republikës së Shqipërisë (që këtu e më pas, AQSh), Arkivi Musine Kokalari, dosja 9: letër e 2 prillit 1940, e drejtorit të përgjithshëm të shtypit, propagandës dhe turizmit të Mbretërisë së Italisë Nicola Lorusso Attoma, drejtuar Musine Kokalarit. Për të njëjtin draft të *La mia vita universitaria*, të cilin e përmend specifikisht vetëm në një pasazh të tekstit, në lidhje me vjeshtën e vitit 1941, shkrimtares shqiptare iu desh të punonte gjatë dhe për më shumë kohë përgjatë periudhës së katër viteve romane, siç duket nga një analizë e daktiloshkrimit dhe krahasimit të tij me një version të mëparshëm të dorëshkruar. Mjafton të mendosh për ndryshimet e bëra me laps dhe me bojë ngjyrash të ndryshme, si dhe për përdorimin, gjatë redaktimit të daktiloshkrimit, të disa makinave shkrimi

natyrës shkollore; duke pasë frikë se mos bënte gabime, nuk qe në gjendje të ndërmerrte a të niste një bisedë. Përkundrazi, siç na rrëfen edhe ajo vetë: «muajt e parë nuk e hapja gojën fare». Ndihej e vetmuar, e humbur. «Nuk kisha të njohur, – shkruan sërish Musineja – por në mes të morisë së studenteshave, vura re se kishte edhe të tjera që nuk ndiheshin rehat gjatë studimeve: që kishin ardhur edhe ato vonë nga vendet e tjera të Italisë. Kjo më dha njëfarë lehtësimi; e mes tyre njoha shoqet e mia të para, që mbetën të tilla përgjatë gjithë kursit 4-vjeçar». Nga analiza krahasimore e të dhënave të nxjerra prej letërkëmbimit personal të shkrimtares shqiptare, si dhe nga listat e studentëve të regjistruar në ato vite në Fakultetin e Letërsisë në La Sapienza, u bë e mundur të identifikohen disa, ato më intimet, më të zgjedhurat. Në grup bënin pjesë Maria Barillà, Clelia dhe Laura Cecchettani, Vittoria Paolini, Lina de' Cristofaro, të gjitha studentesha të Letërsisë, gati të gjitha banuese në të njëjtën lagje me të.[18] Në veçanti me dy të fundit – Vittoria ishte nga Urbino dhe Lina nga Bari – Musineja pati që nga viti i parë i universitetit një marrëdhënie të ngrohtë epistolare, që zgjati edhe pas diplomimit dhe rikthimit të saj në Shqipëri, ku secila kish marrë tashmë udhën e vet, ishte martuar e qe bërë mësuese.

Nga shfletimi i korrespondencës së dendur me familjarë, miq dhe të njohur shqiptarë, kanë dalë në dritë informacione të shumta në lidhje me marrëdhëniet e një studenteshe të huaj, me familjen dhe vendlindjen larg; në një regjistër mjaft bisedimor, plot me ngjyresa dialektore të Gjirokastrës, çështjet më të trajtuara në letra dhe kartolina, veç përshëndetjeve dhe urimeve për ngjarje të ndryshme, vërtiten rreth kryerjes së punëve të përditshme, si shkëmbime lajmesh, paketash, librash, veshjesh, dërgesa parash, kërkesash, rekomandimesh, porosish të ndryshme për t'u kryer me urgjencë në

18 «S'arrij ta besoj – i shkruan Lina mikes shqiptare – se jam çliruar nga Universiteti dhe nga gjithë ajo botë të cilën e ndiej kaq larg meje: Roma më ka lënë një kujtim shumë të keq: studim, provime, rraskapitje, dhimbje koke dhe të tjera si këto. Njerëzit e vetëm për të cilët ndiej keqardhje, janë vajzat Cecchettani, ti dhe Maria Barillà» (AQSh, Arkivi Musine Kokalari, dosja 9: letër e 29 qershorit 1942)

Romë. Mes emrave që hasen shpesh, gjejmë pa dyshim dy nipat e vegjël Hektor dhe Karolinë (Toria dhe Lola në fjalorin familjar), shumë të pranishëm edhe në tekstin autobiografik. Vitet e fundit të studimit në La Sapienza ishin mjaft kërkues dhe të lodhshëm, edhe për shkak të ndihmës së vazhdueshme dhënë Hektorit, që i ishte besuar asaj nga i vëllai Vesimi për t'u operuar në ijë në Klinikën e re ortopedike dhe traumatologjike, një strukturë avangardë e përuruar në brendësi të qytetit universitar më 1936. Në rrëfim janë të përhershme cekjet mbi shëndetin e tij, mbi konvaleshencën e gjatë dhe të ndërlikuar, mbi përparimet e bëra me italishten, integrimin e vështirë në kolegjin «Cristo Re», në pasditet e kaluara në Villa Borghese, për të shëtitur ose për të luajtur me varka letre në brigjet e liqenit, për të parë kukullat ose "Topolinon" në kinematografin e vogël».[19] Të shumta detyrat, të tepërta përgjegjësitë që shpeshherë shohim t'i rëndojnë mbi supe një studenteshe të re, e vetme mes një mijë vështirësish në një qytet të huaj, me luftën te dera; siç del nga ky pasazh i kujtimeve ku duket qartë gjithë pafuqia e ankthshme përballë sëmundjes, ndaj frikës se nipi i vogël për të cilin i duhej të kujdesej, nuk mund t'i mbijetonte dot operacionit:

Mbeta si e gozhduar në prag të derës dhe nuk mund të merrja dot frymë. Bëra para me frikë dhe pashë Hektorin me sytë mbyllur. Sapo i kish dalë gjumi nga eteri. Më pa me sytë e ngulët dhe pështyma që gëlltiste i dukej qartë në qafën e dobët.

Mendova se ishte efekti i parë i operacionit. U ktheva e dërrmuar në shtëpi dhe nuk futa dot gjë në gojë. Pasdite u ktheva e shoqëruar nga e zonja e shtëpisë dhe nga mikja ime G. K. E kishin shtrirë Hektorin në kurriz.

19 *La mia vita universitaria*, f. 193. Nga analiza e adresave të nxjerra prej korrespondencës ose kërkesave vjetore për regjistrim (ose raste të tjera) kam pasur mundësi të ndjek zhvendosjet banesë më banesë të shkrimtares, të lokalizoj apartamentet ku ka ndenjur me qirà në vitet universitare, të gjitha në lagjen Nomentano-Italia: Viale XXI Aprile 8; Via Catania 50 int. 25; Via Garfagnana 8; Via Cremona 40 int. 22. Krh. ASS, Archivio generale degli studenti, Fascicoli personali degli studenti, Facoltà di lettere, matrikulli nr. 8971; AQSh, Arkivi Musine Kokalari, dosjet 9 dhe 81

Rrinte sërish me sytë mbyllur, kishte ethe dhe temperaturë shumë të lartë; nuk merrte dot frymë. Pata frikë se mos më vdiste kështu, para syve. U frikësova dhe thirra infermieret. Vrapuan menjëherë, e kthyen nga ana tjetër, por unë s'isha në vete, nuk e shihja dot në atë gjendje. Hidhja vështrimin nga ai dhe nga të tjerët dhe pashë të njëjtën frikë në sytë e tyre. Pa dashur, iu hodha te këmbët dhe nisa të qaj.[20]

Mbështetje dhe ngushëllim në këtë situatë dramatike, siç na rrëfen vetë shkrimtarja, i jep Gliqeria Koço (G. K.), mikeshë fëminie, shoqe banke, e trajtuar përherë si motër; e qeshur, e hapur, që s'i pushonte goja (një lloj alter egoje e së vetmuarës, fjalëpakës Musine) me të cilën ndau bashkë situatat e shumëfishta të jetës së përditshme në kryeqytet – dramat e vogla e të mëdha, kërkimin e një dhome me qirà, lodhjet e studimit, argëtimet, thashethemet, trazimet e para – si ëndrra universitare, ndërsa frekuentonte fakultetin e mësuesisë në La Sapienza. Bashkë me Elima Libohovën, një tjetër mike e ngushtë shqiptare, edhe ajo e njohur në kohën e shkollës dhe mes marrësve të letrave që hasen më shpesh në letërkëmbim, ndër personat më të përmendur nëpër letra dhe në shumë faqe të kujtimeve, duke nisur që nga mbërritja e të dyjave në Romë, në vjeshtën e vitit 1938. Në fillim të vitit pasardhës, ishte pikërisht Gliqeria ajo që i prezantoi Musinesë të riun P. T., të sapodiplomuar për Shkenca Politike, që shpejt do të bëhet dashuria "universitare" e shkrimtares; ishte sërish ajo, pak kohë më vonë që e tradhtoi miqësinë e vjetër duke e lënë këtë djalë t'i vinte rrotull, bashkë me Agllai Hariton dhe Vera Bogdon, që të gjitha kolege të institutit femëror "Nâna Mbretneshë" të Tiranës; me këtë të fundit, shkruan Musineja, «vetë nëna [e P. T:], e kishte fejuar me të birin, pas shpinës sime».

Zbulimi i së vërtetës do t'ia davaritë menjëherë të ëmblat, gënjeshtaret «kimera të dashurisë dhe miqësisë»[21] por në të njëjtën

20 *La mia vita universitaria,* f. 158-159

21 «Pasi e mora vesh të vërtetën, – përsiat Musineja – nuk u ankova për jetën time pa

kohë, do shërbejë për t'i dhënë fund asaj «lufte të brendshme mes nënës sime dhe njeriut të cilin doja, mes vendit tim të lindjes dhe Italisë» që nuk vonoi të ndërfutej në takim-përplasjen mes dy botëve të ndryshme, në një tension përherë e në rritje. Hyrja në luftë e Italisë, më 10 qershor 1940 i thelloi edhe më shumë ndasitë. I riu u thirr shpejt në frontin afrikan; marrëdhënia u bë epistolare. Konflikti i armatosur me bombardimet, përplasjet, shqetësimet, e kristalizoi nga një anë raportin ndërsa nga ana tjetër bënte të lindnin përsiatje të reja e shërbeu për t'u dhënë gjërave kuptim: tjetri u bë "i huaji", "armiku".

Kështu, epilogu i pashmangshëm i historisë së dashurisë u bë paradigma e një ndjenje progresive tjetërsimi karshi shoqërisë "okcidentale" në kompleksin e vet, përpunuar nga shkrimtarja shqiptare në harkun e katër viteve në La Sapienza: Musineja ndiente në shpirt – dhe mëtonte, në të njëjtën kohë – «se kish mbetur primitive, vajza e rritur mes njerëzish të varfër, në një vend të vogël me rrugë të shtrembra, me oborrin rrethuar me mur; mes këngëve që në të vërtetë janë vajtime, dhe mes të qarave të grave tona, në një qiell të hirtë». Tjetërsim që shprehet në një mbyllje përherë e më të madhe në vetvete, «e palëvizshme dhe e mbyllur» në mendimin e vet, siç duket nga ky pasazh, gati profetik i një vetmie të ardhshme, të vazhdueshme – jo të zgjedhur, por të imponuar nga dhuna e regjimit të Enver Hoxhës:

Isha kredhur kështu në vetvete, në vetminë më të plotë të heshtjes më absolute, duke u gjendur në botën personale, në botën individuale. I flisja lirisht dhe hapur zemrës sime, në një bisedë intime, në një monolog të brendshëm, të ëmbël. Dhe ja, isha e lirë dhe e kënaqur. Ne e kërkojmë lirinë jashtë nesh po në të vërtetë, ajo u gjendka brenda

entuziazëm e pa aspirata. Dhe vendosa të mos e ndryshoja këtë gjendje të ashtuquajtur "të përvajshme", pa ia pasur askujt zili, pasi mësova se lumturia nuk ekziston; prandaj nuk ia vlen ta kërkosh. Unë që mendoja se ish diçka e mirë të jesh e mirë dhe e dashur, rashë pa e vënë re në njëmijë prita të ngritura nga njerëz të cilët i doja me të vërtetë. Për sa i përket mikeve, thjesht i eliminova nga shoqëria ime dhe nuk u pamë më» (*La mia vita universitaria,* f. 184-185)

vetes; e kërkojmë lumturinë jashtë nesh, ndërsa – nëse ekziston – e gjejmë brenda nesh. [22]

Më pëlqen ta mbyll, njëqind vjet pas lindjes së Musine Kokalarit, me këtë fragment letre të vitit 1942, shkruar nga Vittoria Paolini, kolege e Urbinos: i dedikohet shoqes shqiptare, tashmë të largët, përtej Adriatikut. Është një fotogramë që mbaj në zemër dhe që s'pushon kurrë së më emocionuari.

Unë nuk të kam harruar. Shpeshherë mendoj: përtej detit, atij deti që në ditët e kthjellëta të pranverës shfaqet si një vazhdë e kaltërreme në horizontin e maleve të mia më të largëta, atje kam një miken time me emrin Musine; ajo ka sy të mëdhenj, të blertë dhe është vajzë shumë e mirë.[23]

Përktheu nga italishtja: Edion Petriti

22 Ibidem, f.192

23 AQSh, Arkivi Musine Kokalari, dosja 9: letër e Vittoria Paolinit, e datës 27 mars 1942. Për thellime mbi temat e trajtuara, krh. S. Ceglie, Un libro nel cassetto, në M. Kokalari, *La mia vita universitaria*. *Memorie di una scrittrice albanese nella Roma fascista* (1937-1941), f. 63-108

Portret me dedikim, realizuar nga Kristina Koljaka, shoqe e liceut, një bllok kujtimesh (AQSh).

Foto pasaporte, bashkëngjitur kërkesës
për regjistrim në vitin e parë të Universitetit (ASS)


R. UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI ROMA

Corso di LETTERE

LIBRETTO D'ISCRIZIONE

dello studente Kokalari Musine

N 8971 di matricola

Frontespic i librezës universitare të studentes Musine Kokalari (ASS).



Mat. 8971

8971

Mod. 162

R. UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI ROMA

Curriculum del laureando in LETTERE

Sig.ne Kokalari Musine (albanese) Indirizzo moderno.

UNIVERSITÀ			MATERIE D'ESAME	VOTAZIONE	
Roma	30.6.38	C	Arch. e Storia dell'arte antica	27	
	18.6.38	F	Geografia	28	
	22.6.38	C	Storia greca	28	
	22.6.38	C	Storia della musica	30	
	1.7.38	F	Storia rom. con es. di esp.	26	
	14.6.38	X	Lingua italiana	24	
	20.6.39	S	Filologia romanza	28	
	17.6.39	C	Lett. delle tradiz. popolari	28	
	1.7.39	F	Letteratura italiana	24	bene
	14.6.39	C	Storia ed istituz. musulmane	28	
	10.6.39	C	Lingua e letter. albanese	lode	
	12.6.40	S	Storia moderna	28	bene
	11.6.40	C	Storia del rinascimento	30	
	12.6.40	S	Storia dell'arte medioevale	30	
	5.6.40	C	Storia rel. dell'Oriente antico	30	
	20.2.41	F	Filosofia teoretica	lode	
	14.6.41	F	Letteratura latina	18	bene
	22.10.41	S	Storia medioevale	30	

Il Segretario

B. Belli

Kurrikul i studimeve universitare me provimet dhe notat (ASS).

Romë, Musine Kokalari me Hektorin dhe Vesimin (në plan të parë)
në Villa Borghese (foto e koleksionit privat të Hektor Kokalarit).



E dashura Musine
Të puth e të përqafoj me shumë malli.
Letrën tënde të dashun e mora, për sa më shkruan
që të mësoje e t'i bindem Mamasë, mos e ki mendjen
tek muo, se me mësime vete fare mirë. edhe
me Lolën nuk zihem kurrë, po lozim
të dy bashkë në oborr.
Musine mua dhe Lolën na ka marë malli
shumë për ti çdo ditë të kemi në gojë
dhe numerojmë ditë sa të na vish
në Shtëpi. Aneja me Mamanë të puthë
me mall. E përfundoj me dashuri

Nipi tënd i dashun Hektor

Musine,
Dje mora postalken t'ënde d. 12 këtij; [illegible]
se qysh nuk të ka mritur letra ime [illegible] që të kam
çuar si përgjegje asaj t'ende. Për ne mos bëj merak;
jemi të gjithë mirë; dua të besoj se letra do të të ketë
mritur mbassi ime e kam postuar me 9 të këtij; interesohu
e përgjegji për kartolen që të kam bërë. Shiko veçanërisht vetëm
kopija për fotografi në mund të gjesh. Të pergafoj me
shumë mall.
yt vella
Vesim

Letër e Hektorit të vogël, dërguar Musine Kokalarit,
me shënim të Vesimit, vëllait të shkrimtares (AQSh).



Soc. An. Editoriale Albanese
Decreto Luogotenenziale N. 82 del 13 Marzo 1940-XVIII
Iscritta alla Camera di Commercio di Tirana al N. 57

TOMORI
QUOTIDIANO FASCISTA

SHKËNDIJA
RIVISTA MENSILE

20

Tirana, 1/I/1942.XX.
Corso Vittorio Emanuele III

Fort e ndershmja
Zonjusha Musine Kokalari,

Në numurin qi vjen Revista "Shkëndija" dëshiron të nisë nji veprimtari të re në fushën e kulturës shqiptare, ku jo vetëm letërsija ka me qenë argument i zhvilluem porse edhe artet qofshin figurative, qofshin muzikore, qofshin dekorative.

Për t' ia arrijtun qellimit qi të zgjohet nji interesim e të thellohen sa ma tepër prirjet e ndryshme artistike e kulturore kemi vendos me i u drejtue shkrimtarëvet dhe intelektualëve të vjetër e të rij tue u caktue pak a shumë subjektet mbi të cilat do të kenë mirësin të bashkëpunojnë.

Për Zotnin e Juej kemi mendue të na shkruani 6 artikuj me subjekte të ndryshme letrare.

Artikujt nuk do të jenë ma të shkurtën se tri faqe të Rev. "Shkëndija" as ma të gjatë se pesë faqe. Secili artikull ka me u shpërblye nga 50.- fr. shq.

Do të ishim mirënjohjtës të na jepnit nji përgjigje rreth kohës qi do t' Ju nevojitet për kryemjen e këtij bashkëpunimi.

Me nderime
(Ernest Koliqi)

Letër me të cilën Ernest Koliqi i propozon Musinesë të shkruajë për të përmuajshmen kulturore «Shkëndija», drejtuar prej tij. Tiranë, 1 janar 1942 (AQSh).



La mia vita universitaria

Nel giugno dell'anno 1937 terminai gli studi della scuola media a Tirana e nel medesimo tempo pensare intensamente per mesi e mesi a una nuova aspirazione. Parecchie volte avevo sentito parlare in un modo piacevole e pieno di sogni, e di dolce bella, intorno alla vita universitaria. Siccome la facoltà nel nostro mancano, questo studio per noi ragazze albanesi era o meglio è ancora un sogno. Ecco in che consisteva il mio grande desiderio.

La vita che pensavo di svolgere durante questi anni non fu altro che il contrario di quello che aveva creata la mia fantasia.

Siccome sto per finire e non mi sono pochi mesi per laurear mi, deciso di scrivere qualche cosa, prima che io salutassi l'Italia.

Questo libro è una testimonianza personale della mia propria esperienza di vita e più del pensiero. È di una prosa quotidiana e naturale.

Le idee qui espresse sono state pensate

La mia vita universitaria. Faqja e parë e bocës së dorëshkruar (AQSh).



PREFAZIONE.

Nel giugno dell'anno 1937 completai a Tirana gli studi della scuola media e mi misi allora a pensare intensamente per mesi e mesi a una grande aspirazione, nuova per noi ragazze albanesi: l'Università. Già parecchie volte avevo sentito parlare della vita universitaria come di una vita facile, dilettevole e piena di sogni. La mancanza nel nostro paese di questo alto grado di studio, ci spinge, a noi ragazze albanesi a cercar il fuori e naturalmente in Italia ~~(la ricerca del)~~ modo di soddisfare la nostra ambizione.

~~La viva che (avevo immaginato di vivere) in questi~~ ho vissuto proprio
~~anni di università è stata il contrario di quella che~~
~~s'era creata la mia fantasia.~~

Adesso sto per finire questo corso e quindi ho deciso di scrivere qualche mia espressione, prima di lasciare l'Italia.

Questo libro è una testimonianza personale della mia propria esperienza di vita e ancora più del mio pensiero. E' una prosa naturale di vita quotidiana.

9 a/b. *La mia vita universitaria*. «Parathënia» me të cilën fillon daktiloshkrimi (AQSh).

Le idee espresse in questo mio libro non sono nuove, sono già pensate anche da altri ma esse sono diventate parte del mio essere.

Non sono erudita, e quindi le mie osservazioni potranno non apparire profondi. Ho letto molto, tutto ciò che mi è capitato sotto mano. Il mio metodo alla scuola media era sbagliata, e da qui sono derivate le difficoltà a cui sono andata incontro durante il corso universitario.

Non mancheranno le critiche sul mio libro specialmente dal punto di vista della lingua italiana, che è bella e molto ricca, ma che io non conosco alla perfezione: malgrado ciò voglio tentare di esporre i miei pensieri.

M.K.

Uran BUTKA
Instituti i Studimeve Historike "Lumo Skëndo"

Persekutimi shtetëror i Musine Kokalarit

"Unë s'jam fajtore. Unë s'jam fashiste. S'jam komuniste dhe ky nuk mund të quhet faj. Kam kulturë demokratike. Unë jam nxënëse e të ndriturit Sami Frashëri. Ju fituat në zgjedhje, por në burg nuk duhet të jem .... Me mua ju doni të dënoni Rilindjen...". këto fjalë përshkënditëse e tronditëse të Musine Kokalarit, të shqiptuara përpara xhelatëve këtu e gjysmë shekulli më parë, janë një refleks i formimit botkuptimor rilindës e demokratik të saj, opozitarizmit, pafajësisë, qëndresës dhe reagimit të saj intelektual, politik e qytetar.

Ndaj edhe regjimi diktatorial e dënoi mizorisht Musine Kokalarin.

Së pari, sepse rridhte e përfaqësonte denjësisht një familje intelektuale të Gjirokastrës, familjen Kokalari, me tradita të shquara atdhetare e kulturore. Vajzë e vetme e juristit të njohur Reshat Kokalari, motër e vëllezërve Muntaz, Vesim dhe Hamit Kokalari, veprimtarë të shquar të kulturës shqiptare, themelues të librarisë "Venus" dhe të shtëpisë botuese "Mesagjeritë shqiptare", themeluar më 1942, që botonte dhe përhapte vepra të vyera nga literatura botërore e shqipe,

si "Hamleti" e "Makbethi" të Shekspirit, "Rubairat" e O. Khajamit, "20 vjet ngatërresa ballkanike" të Durhamit, "Ivanhoe" të Skottit, "Kosova-djepi i Shqiptarizmit", të Hamit Kokalarit dhe librat e Musinesë etj.

Kryetari i komunistëve, Enver Hoxha, i cili e kishte kushërirë të dytë Musinenë, nuk e kurseu jo vetëm atë, por tërë fisin e Kokalarëve. Më 12 nëntor 1944 terrori i kuq me urdhër të tij dhe zbatuar nga Kristo Themelko, pushkatoi pa gjyq e pa faj 11 personalitete të shqura të Tiranës, ndërmjet tyre vëllezërit e saj Muntaz Kokalari dhe Vesim Kokalari. Hamiti ishte i sëmurë me tifo, se do të kishte pësuar të njëjtin fat. Syrja dhe Emin Kokalari u pushkatuan, Hivziu vdiq në burg dhe Isai në internim. Muniri vrau veten. Musineja u burgos dhe u internua. Bijtë dhe nipërit e tyre u hodhën rrugëve, u internuan dhe u persekutuan pa fund. (AQSH, F.14 d.2/a v.1944)

Arsyen e këtij persekutimi familjar na i rrëfen në një letër vëllai i Musinesë, Muntaz Kokalari, i cili shkroi këtë letër tri ditë para pushkatimit, shpjegon qartazi persekutimin e familjes Kokalari:

" Po përjetojmë ditë të vështira. Kam vendosur me brengë në zemër, të largohem nga Shqipëria ime e bukur, nga familja e dashur....Këtë vendim e mora mbasi më njoftuan disa nga miqtë e mi të besuar, se jeta ime dhe e të afërmve të mi është në rrezik nga bashtua, Enver Hoxha. Ai ka urdhëruar djajtë e kuq kundër nesh. Kjo kuptohet: thjesht për motive personale..Kjo është fatkeqësi e kombit tonë dhe e Shqipërisë së gjorë, që ka rënë në duart e një njeriu të përbindshëm, tinzar, hakmarrës, inatçi, dinak, megaloman, egoist, kumarxhi e gënjeshtar, që i do njerëzit nën vet; edhe kur qe jashtë për studime nuk dha asnjë provim, mbeti pas kabareve, kazinove etj. Ne intelektualët gjirokastritë ia dimë të gjitha sa i vlen lëkura, prandaj kërkon të na asgjësojë...[1]

1 Letër e Muntaz Kokalarit drejtuar znj. Makbule, dt.9.11.1944

Së dyti, Musineja ishte një intelektuale, që ishte ushqyer me ideologjinë kombëtare të Rilindësve tanë të mëdhenj, e quante veten nxënëse të Sami Frashërit, kishte idhull Naimin dhe Mid'hat Frashërin, ndërkohë qe kishte kulturë perëndimore, ishte kundërshtare e çdo ideilogjie totalitare dhe iu kundëvu si nazifashizmit ashtu edhe komunizmit.

"Në odën time të vogël, shkruan ajo në ditarin e saj, përballë kam vënë fotografinë e iluministit të shquar, Samiut, të poetit Naim, të patriotit Sotir Kolea, të punëtorit të gjuhës shqipe e të lëvizjes Kombëtare, Jani Vreto, të arsimtarit Koto Hoxhi, të mendimtarit Naum Veqilharxhi, të të nderuarit De Rada dhe të të urtit Aleksandër Xhuvani. Në vetminë time nuk jam vetëm, jetoj me njerëz të nderuar, të ditur e demokratë, që kanë punuar për vendin, për mëmëdhenë gjersa mbyllën sytë...

Unë jam nxënësja e tyre..."[2]

Musineja kishte studiuar në shkollat me emër, shqiptare dhe të huaja: Instituti "Nana Mbretneshë" dhe mandej "Universiteti i Romës". Qysh në bangat e shkollës Musineja shkruante poezi dhe skica letrare, që i botonte në organet e shtypit me pseudonimin "Muza"(1937), mandej vëllimin me tregime *Siç më thotë nënua plakë* (1939), veprën memoristike *Jeta ime universitar*e (1940-1942), botimet letrare *Reth vatrës* dhe *...sa u tund jeta* (1944), studimin "Naim Frashëri" (1941), me të cilin mbrojti diplomën universitare etj. Ajo ishte një nga gratë më të kulturuara dhe më të ditura të Shqipërisë: botuese, gazetare, shkrimtarja e parë shqiptare, ideali i së cilës në jetë ishte liria dhe në letërsi ishte e vërteta.

Pikërisht se ishte një intelektuale e tillë, që i bënte hije edhe diktatorit, ajo u asgjësua si gjithë intelektualët e tjerë, që përbënin elitën shqiptare.

2 Pjesë nga "Ditari" i Musine Kokalarit, dorëshkrim, ruhet në familjen Kokalari

Së treti, sepse Musine Kokalari u bë edhe një politikane socialdemokrate e njohur dhe rivale politike e PKSH. Së bashku me nacionalistin e Ballit Kombëtar, Skënder Muçon , i cili më vonë u vra nga pushtuesit gjermanë, dhe Isuf Luzin dhe Selman Rizën, ajo themeloi në tetor 1943 Partinë Socialdemokrate Shqiptare, si alternativë e Ballit Kombëtar, i cili edhe vetë kishte një program social-demokrat (Dekalogu). Themelimi i një partie social-demokrate europiane, ishte një nismë e re politike në Shqipëri, një alternativë e demokracisë sociale, një udhë mes të djathtës dhe të majtës , siç thoshte ajo dhe një mundësi më shumë pluralizmi politik demokratik në Shqipëri. Madje, në janar të vitit 1944, me ndihmesën e Nexhat Peshkëpisë, nxori edhe gazetën "Zëri i Lirisë" në gjashtë numra, ku përmbahet edhe programi thellësisht kombëtar dhe demokratik i Partisë Socialdemokrate, i ngritur mbi katër shtylla kryesore:

Ideali i vëllazërimit e i bashkimit kombëtar; luftë e gjithë forcave mbarëshqiptare kundër okupatorëve nazifashistë për çlirimin e vendit; liri politike dhe drejtësi shoqërore. [3]

Kështu, Musineja kishte thyer kryedogmën komuniste: monopolin absolut të PK në luftë dhe në pushtet, të formuluar e të nxitur nga komunistët serbo-sllavë; kishte vënë në program si parësore çështjen kombëtare, luftën për liri dhe demokraci, platformën për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe demokratizimin e vendit.

Ajo shkruante: "Mbas Mbledhjes së Mukjes kam marrë pjesë në "Ballin Kombëtar" si socialdemokrate dhe kam qenë përgjegjëse e gazetës "Zëri i Lirisë", në të cilën kam botuar artikuj ku flitet për çështjen e Kosovës në bazë të Kartës së Atlantikut ... Kriteri për të luftuar ishte jo për qëllimin e përfitimit të disa klikave, por për demokratizimin e vendit"[4]

Mbas Luftës , kur Shqipëria po vihej nën diktaturën komuniste, Musineja dhe demokratët jashtë dhe brenda Frontit NÇ reaguan dhe

3 Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, gazeta "Zëri i Lirisë", nr.1 janar 1944
4 Arkivi i MB, dosja e Musine Kokalarit

themeluan opozitën e parë antikomuniste "Bashkimi Demokratik Shqiptar", një aleancë e partisë socialdemokrate, e kryesuar nga Musine Kokalari, Fronti i Rezistencës, kryesuar nga Sami Qeribashi,Grupi monarkist, drejtuar nga Qenan Dibra dhe grupi demokrat i përjashtuar nga Fronti NÇ i drejtuar nga Gjergj Kokoshi. Shpirti i këtij bashkimi opozitar tejet demokratik, ishte Musine Kokalari. Ajo e kuptoi se duhej krijuar një opozitë e bashkuar, pavarësisht nga tendencat politike, ku secila parti të ruante identitetin e vet. Një aleancë, e cila, sipas pikëpamjeve të saj do të ishte legale dhe do të luftonte vetëm me mjetet demokratike paqësore.

Musineja hartoi programin e opozitës së bashkuar, një program thellësisht demokratik e kombëtar, ku përfshihej edhe zgjidhja e problemit te Kosovës me plebishit, sipas Kartës së Atlantikut:

Qeverisje demokratike dhe respektim it ë drejtave të njeriut. 2) Miqësi me shtetet demokratike, sidomos me vendet fqinje. 3) Zgjidhja e problemit të Kosovës, me anë të një plebishiti, ose sipas Konferencës së Paqes. 4) Respektimi it ë drejtave të pakicave. 5) Zbatimi i gjithë reformave, duke pasur parasysh dhe traditat. 6. Të luftohet çdo element fashist apo profashist dhe kriminelët e luftës. 7. Të njihet neutraliteti i Shqipërisë nga Fuqitë e Mëdha. 8.Të mbahet një fuqi e armatosur sa për sigurimin e qetësisë së brendshme.[5]

Në hetuesi, tek i kërkonin shpjegime për këtë program, Musineja depononte:

"Ky është një program demokratik...Zgjedhjet të jenë të lira dhe të marrin pjesë të gjithë. Nuk kemi pasur qëllim të rrëzojmë pushtetin me dhunë" [6]

Gjithashtu, Musineja hartoi edhe Notën drejtuar qeverive demokratike perëndimore për të mundësuar shtyrjen e zgjedhjeve dhe pjesëmarrjen e opozitës në to. Kur kryetari i gjyqit, Frederik Nosi, e pyeti Musinenë nëse ishte e vërtetë që ajo e kishte përpiluar

5 M.Kokalari "Si u krijua PSD" dhe Arkivi i MB, dosja e MK
6 Arkivi i MB, dosja e M.Kokalarit

Notën drejtuar qeverive aleate perëndimore, ajo iu përgjigj me kurajo:

"Po, është e vërtetë. Notën e bëra në emër të tre grupeve. Iu drejtova Aleatëve pët të ndërmjetësuar për zgjedhjet dhe pjesëmarrjen e opozitës në to"[7]

Ky opozitarizëm ishte i mjaftueshëm për diktaturën, që ta asgjesonte politikisht dhe fizikisht Musinenë dhe opozitën. Partia Komuniste eliminoi gjithë partitë ekzistuese, grupimet dhe individët, që ishin jashtë Frontit NÇ, edhe nëse ata vepronin me mjete demokratike apo luftonin kundër okupatorëve. Musineja e thotë hapur: "Ju po më dënoni , jo se kam bërë faj, por se ju komunistët nuk lejoni parti tjetër dhe gjeni sebep e thoni se doni të përmbysni pushtetin" [8]

Së katërti, Musine Kokalari nuk ishte dhe nuk u bë kurrë vegël e PK dhe e Enver Hoxhës. "Ç'kërkonte Enver Hoxha nga unë, -mos duhet të bëhesha agjente?" denonconte ajo. Si një demokrate, ajo kërkoi të bashkëpunonte edhe me Frontin NÇ në luftën kundër okupatorëve, por duke qënë më vete si identitet dhe program. Si nacionaliste, ajo e shihte bashkimin e gjithë faktorëve politikë, jo si një shkrirje, por si një aleancë për bashkëpunim kombëtar. "Unë e shikoja këtë jo në prizmin e një bashkimi të Ballit Kombëtar me Frontin Nacionalçlirimtar, mbi bazë aleance demokratike.

Mbi këtë bazë, kur rashë në kontakt me Nexhmije Xhuglinin dhe parashtrova intensifikimin e luftës kundër okupatorit, unë ia parashtrova që të hynim në gjirin e Frontit NÇ jo si individë të veçantë, por një grup demokratik ose më mirë si parti Socialdemokrate, që të përfaqësonte rrugën e mesme dhe të lidhte me të forcat e pakristalizuara duke u rradhitur me të në aleancë. Ajo nuk pranoi këtë tezë dhe tha se sot nuk isht nevoja e formimit të partive të tjera, por e organizimit të luftës kundër okupatorit. -E ç'të keqe ka këtu? – i thashë. Ju jeni komunistë dhe midis

7 Po aty
8 M.Kokalari, *Si u krijua PSD, Vepra II*

jush i rrihni edhe problemet shoqërore mbi parimet tuaja, ndërsa ne jemi demokratë dhe i rahim midis nesh problemet shoqërore dhe njëkohësisht i japim rëndësi në radhë të parë luftës kundër okupatorit"[9]. Siç dihet historikisht, PKSH dhe E.Hoxha i asgjësuan gjithë demokratët dhe antifashistët, që luftonin kundër pushtuesve fashistë e nazistë, por që ishin jashtë Frontit NÇ.

Së pesti, u dënua edhe si shkrimtare dhe publiciste dhe studiuese e njohur, nga që nuk u pajtua me letërsinë e partishme të realizmit socialist dhe bëri një letërsi të sajën, të lirë dhe origjinale.

Agjenti i Sigurimit të Shtetit me pseudonimin "Shkëndia" raportonte": "Në fjalët e Musinesë del qartë qëndrimi i saj ndaj letërsisë kallp të realizmit socialist, shkrimtarëve të shndëruar në vegla mekanike, që shkruajnë gjëra të paqena, duke nxjerrë në pah gjoja të vërtetën. Musineja ka pëlqyer dhe vlerësuar shkrimtarin Ismail Kadare". [10] Po ky spiun, që kishte fituar besimin e Musinesë dhe ishte futur në mendimet e saj, falë edhe faktit se ishte i persekutuar, i raportonte kështu mendimet e Musinesë për letërsinë dhe shkrimtarët e asaj kohe: "Shkrimtarëve tanë u kufizohet liria e shkrimit, e pasqyrimit të realitetit dhe këta e dinë se po të shkruajnë atë që është, pa i bërë lustrime, Partia i godet. Kështu edhe shkrimtarët janë mësuar të shkruajnë gjëra të paqena, duke nxjerrë në pah gjoja drejtësinë e shtetit, gjoja lirinë e njerëzve, kur në fakt kjo në Shqipëri nuk ekziston fare, siç thuhet e lustrohet"[11]

Gjithashtu, në një informacion tjetër flitet për takimin e saj me Bilal Xhaferrin dhe për vërejtjet për një tregim të tij.

Së fundi, sepse Musineja ishte në radhë të parë: NJERI. Ajo ishte e hapur, e ditur, jashtëzakonisht e zgjuar, e talentuar, por edhe krenare, dinjitoze e me karakter të fortë, të pathyeshëm, mishërim i aftësisë dhe ndershmërisë njerëzore. Mirëpo njerëzorja e Musinesë

9 Po aty
10 M.Kokalari, *Vepra I.* v. 2009
11 Po aty

ishte në kundërshtim me antinjerëzoren e 'njeriut të ri komunist", që ushqehej me luftë e me urrejtje, me mosbesim ndaj zotit dhe njeriut.

Ajo ishte një kundërshtare dhe një qëndrestare e vendosur, që nuk u kthye nga rruga e saj, që nuk u nënshtrua, që nuk e kërkoi falje, prandaj dhe hakmarrja dhe ndëshkimi qenë të pamëshirshëm.

Në dorëshkrimin "Mbi jetën time" Musineja shkruante: "Komunistët më varrosën për së gjalli, se nuk u kërkova falje në gjyq për aktivitetin tim. Dhe pse do kërkoja falje? ... Unë s'jam fajtore..." Edhe në gjyq kërkoi veç drejtësi.

Me persekutimin e Musinesë u morën drejtpërdrejt tre ministrat e brendshëm: Koçi Xoxe, Mehmet Shehu dhe Kadri Hazbiu dhe veglat e tyre: Nesti Kerenxhi, Nevzat Haznedari, Gjon Banushi etj.

"Hetuesit e mi ishin Nesti Kerenxhi e Gjon Banushi, Thoma Rino e Nevzat Haznedari. Unë e kisha të lehtë të mbrohesha, ata e kishin të zorshme të mbanin në këmbë akuzën.[12]

Gjatë hetuesisë ndaj saj u përdorën presione e tortura psikologjike e fizike të lemerishme. Sipas Drita Kosturit, shoqes së saj të burgut, "Xhelatët tërboheshin, nuk e duronin qendresën shpirtërore të Musinesë, e thërrisnin, e merrnin në pyetje, e provokonin, po ajo e qetë, e papërfillshme, krenare e me kulturë – nuk u jepte kurrë shkas për asgjë. Njëherë atë e veshën me dimitet tiranase, ia shtrënguan fort belin, ia lidhën këmbëzat dhe i futën brenda një mace, të cilën filluan ta godisnin.Merrni me mend tmerrin e asaj gruaje të brishtë, nën kthetrat e tërbimin e maces, gjakun që i rridhte dhe traumën që pësoi pas asaj torture çnjerëzore".[13]

Pas gjashtë muajsh hetuesie, e nxorrën në gjyq. Aktakuza e prokuror Nevzat Haznedarit, përmblidhet në këto pika:

1. Ka bashkëpunuar me krerët e Ballit e të Legalitetit.
2. Mbas çlirimit ka sabotuar pushtetin popullor.
3. Ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e fshehta që ka bërë

12 M.Kokalari, *Si u krijua PSD, Vepra II*
13 U.Butka: *Ringjallje: Perdete ogni speranca voi che entrate,* 1995

grupi Social Demokrat, grupi i rezistencës dhe ai monarkist, duke zgjedhur një Komitet të përbashkët.

4. Në bashkëpunim me krerët e këtyre grupeve kanë përgatitur nota e programe për Aleatët, duke kërkuar ndërhyrjen e tyre.

Shtoi këtyre akuzave të Haznedarit edhe akuzat e Frederik Nosit, Kryetar i Gjykatës Ushtarake, i cili akuzon Musinenë për terrorizëm: "Kjo grua zhvillon aktivitet të gjerë kriminal terrorist".[14]

Ironi e fatit! Ata që ushtronin vetë terrorizëm shtetëror, duke shkelur edhe ligjet e kohës, pikërisht ata akuzojnë Musinenë intelektuale, demokrate e paqësore për terrorizëm!

Po mbrojtja e Musinesë?

- Akuzat që me bëhen nuk i pranoj.

- Refuzoj t'u përgjigjem pyetjeve që bëhen nga ana e gjykatës.

Musineja nuk pranoi avokat. Ajo bëri një apologji të shkëlqyer që e jep qartë edhe qëndrimin e saj të plotë prej politikaneje demokrate , konsekuente dhe e papërlyer.

Ajo u dënua me 23 vjet burg, me humbjen e të drejtave civile, si dhe konfiskimin e pasurisë. Provoi burgjet e llahtarshme të Tiranës, Shkodrës, Vlorës dhe Burrelit, duke qëndruar e pathyer. Siç tregojnë bashkëvuajtësit, ajo i ndihmonte të burgosurit, sidomos moralisht, ishte kthyer në një motër-murgeshë të dhimbjes e të shërimit shpirtëror. Ajo u bë udhëheqësja shpirtërore e grave të burgosura dhe simbol i qëndresës së tyre në burgjet e diktaturës, si: Raile Luzi, Drita Kosturi, Rita Koka, Qefsere Begeja, Nurije Koculi, Hava Golemi, Lavdie Petrela, Marie Medicina, Jolanda Tafmizi etj.

Ish-e burgosura Nurie Koculli tregon: "Musineja kish një shpirt human. Kush ishte sëmurë, ajo i vinte menjëherë në ndihmë. Kush ishte i dëshpëruar, ajo ia hiqte vuajtjet dhe ndikonte qëndresën. – Ajo ishte shëmbëlltyrë e virtytit ..."[15]

14 Arkivi i MB, dosja e M.Kokalarit
15 U.Butka, *Ringjallje:* Mesazhi i M.Kokalarit, 1995

Musineja shoqërohej e bisedonte veçanërisht me Raile Luzin dhe sipas një agjenti të Sigurimit të Shtetit: " para disa ditëve e burgosura Musine Kokalari bisedonte me të burgosurën Raile Luzi të cilës i thoshte se ti duhet të qëndrosh e fortë gjithmonë dhe nuk duhet të përulesh" [16]

Lirohet nga burgu më 1961 pas 16 vjet burgu dhe internohet përjetësisht në Rrëshen, ku për 22 vjet punon në bujqësi e ndërtim si punëtore e punëtore llaçi, e përgjuar ditë e natë nga agjentët e Sigurimit të Shtetit, me pseudonimet Shkëndia,, Zampuda. Brisku, Kalaja, Çajupi, Bamja, Referati, Besniku, Piktori, Lisi, Munella, Besa, Aparati, Pëllumbi, të cilët njoftonin për lëvizjet, takimet e bisedat e saj.

Të dhënat e tyre, shpesh pa dashur, shkojnë në favor të vlerave të Musinesë, bie fjala agjenti "Besniku" raportonte: "Musineja ka thënë: Unë kam qenë dhe jam kundër vijës së Patisë. Unë jam me ide tjetër dhe do të vdes me këtë ide. E nisa këtë rrugë në mënyrë të ndërgjegjshme dhe në luftë për jetë a vdekje. Une humba dhe nuk arrita atë që ëndërroja, por prap jam kryelartë"[17].

Në Rrëshen askush nuk i afrohej, sikur të kishte murtajën. E huaj. Puna e rëndë në ndërtim dhe vegla e saj e preferuar në "zanatin e llaçit", siç e përcaktoi ajo lopatën, e lodhin, por vetmia dhe përndjekja e dërrmojnë. Megjithatë, ajo shkruan vargjet: "Të përshëndes Rrëshen/qytet i ri/të gjeta të vogël/u rrite edhe nga krahët e mi!"[18]

Pas punës, lahej e vishej me ato rroba që kish dhe shëtiste vetëm. I pëlqente të shëtiste, por më tepër të shkonte në vendin e saj të parapëlqyer: në bibliotekën e qytetit, ku gjente miqtë e saj të vërtetë, librat.

Dy vjet qëndroi me të nëna plakë, Aneja e saj e dashur. Një ditë ajo u kthye në Tiranë dhe të afërmit u habitën kur e panë: Në dy

16 Nga raportimet e sig. të shtetit, Familja Kokalari
17 M.Kokalari, *Vepra I*, v. 2009
18 M.Kokalari, V.I, v. 2009

vjet ishte shfytyruar, ishte tmerrësisht e zbehtë si një fantazmë. Vdiq ato ditë në Tiranë. Musineja, mbasi mori leje nga dega e brendshme në Rrëshen dhe u paraqit në Degën e Brendshme të Tiranës, arriti ta gjejë të pambuluar. "Ti Ane, edhe baltën do ta hidhërosh me ato që ke hequr"- i pëshpëriti Musineja kur i hodhi një dorë dhe përsipër.

E dërrmuar nga vuajtjet dhe e rraskapitur nga punët e rënda, Musineja sëmuret nga kanceri. "Ç'fat tragjik, - shkruan ajo. Më doli dhe sëmundja kundër. Të paktën të kisha pasur pak qetësi në vitet e fundit të jetës sime." [19]

E persekutuan edhe kur ishte e sëmurë rëndë. E shtruar në Onkologjik, ajo shkruante: Këtu kuptova një gjë: "Për mua jo vetëm nuk interesohen, por kanë qejf të më zvarritin".[20] Vetëm pas gjashtë muajsh u operua, kur kishte marrë fund.

Në letrat e fundit që i shkruante Platonit, shprehej vetëm me një shqetësim: "Të mos humbasin dorëshkrimet. Tjetër gjë s'dua. Unë s'i kam kurrkujt borxh dhe askujt s'i kam kërkuar as ndihmë e as lehtësi, as jam ankuar që mbeta e braktisur. Kur ata që të kanë në dorë, të varrosin për së gjalli pa të drejtë, është e kuptueshme që asnjëri nuk don të rrezikohet.

Për shëndetin tim ose për sëmundjen time s'i drejtohem kujt, aq më tepër atij personi që kishte në dorë të lehtësonte akuzën time. Tani jam nga fundi dhe sido që të jetë, ishalla kam fat të mos lëngoj. Ju përqafoj të gjithëve".[21]

Musineja ishte e vetmuar dhe në ditën e vdekjes. Dorëshkrimet ia rrëmbyen djajtë e Degës. Mbi një kamion riportabël ngarkuar me zhavorr, u mbart për te varrezat arkivoli me trupin e saj - skelet, veshur me një fustan të ri, të bardhë, të nuses së vdekur!

Po komunizmi nuk ia varrosi dot idetë dhe veprën e saj.

19 Po aty
20 Po aty
21 M.Kokalari, letër Platon Kokalarit, dorëshkrim, familja e P.Kokalarit

Dr. Dorian Koçi

Muzeu Historik Kombëtar

"Muza" e Rezistencës Antikomuniste "Të shpëtojmë sa më shumë nga vlerat morale" Musine Kokalari

Në historinë e rezistencës antikomuniste të Evropës Lindore , Shqipëria si vendi që hyri shumë shpejt se çdo vend tjetër i Evropës Lindore në procesin e sovjetizimit, nuk ka shumë histori politike për të rrëfyer pasi çdo mjet dhe akti i rezistencës u shtyp dhe u përndoq nga regjimi komunist. Udhëheqja e re komuniste që erdhi në pushtet pasi ndaloi kthimin e mbretit Zog në vend, shpalli se do të krijonte një tip demokracie popullore që do të reflektohej në kthimin e vendit në republikë dhe respektimin e disa të drejtave të njeriut. Deklarata e KANÇ-it në 24 tetor 1944 hapte shumë shpresa se pushteti i ri që po vinte në fuqi ndoshta do të mund të respektonte disa parime minimale të demokracive popullore. Sigurisht që këto shpresa përvijoheshin në njerëzit që nuk e njihnin natyrën e regjimeve komuniste dhe metodat e tyre për të dominuar në jetën politike të vendit, pasi për një pjesë të madhe të inteligjencës së kohës nuk kishte dyshim se komunistët

ashtu si dhe gjatë luftës do të përpiqeshin që të mos ndanin pushtet me asnjë fraksion tjetër politik.Mes intelektualëve shqiptarë më kurajozë për të kundërshtuar instalimin e diktaturës komuniste në Shqipëri ishte shkrimtarja e re shqiptare, Musine Kokalari, një nga zërat më të veçantë në kulturën shqiptare. Gjatë viteve 30' ajo kishte mbajtur pseudonimin letrar "Muza" për shkak të brishtësisë së prozës së saj që trajtonin tema të konservatorizmit në shoqëri, por në të njëjtën kohë janë momumente të vërteta leksikore të së folmes së Gjirokastrës dhe aeralit të gjuhës shqipe të Jugut të Shqipërisë. Kësaj radhe asaj i duhej të përballej me ashpërsinë dhe terrorin politik shumë herë më të vështirë se betejat me konservatorizmin në shkrimet e saj.

Periudha kur pushteti komunist në Shqipëri dha iluzionet që mund të pranonte edhe një pjesëmarrje të opozitës është shumë e shkurtër. Ajo zgjati nga dhjetori i vitit 1944 deri në dhjetor 1945 periudhë në të cilën ende nuk kishte mbaruar zyrtarisht Lufta e Dytë Botërore dhe ende nuk ishin ndarë zonat e influencës në Evropën Lindore. Gjatë kësaj kohe Shqipëria po sovjetizohej me hapa shumë të shpejtë nën asistencën jugosllave. Mirëpo pavarësisht hapave të shpejtë që po hidhnin në këtë drejtim, qeveria komuniste formalisht po ndiqte dhe hapat e legjitimitetit të pushtetit. Zgjedhjet e para për të formuar Asamblenë Kushtetuese që do të vendoste dhe formën e qeverisjes në Shqipëri, do të mbaheshin në datën 2 dhjetor 1945. Zhvillimi dhe mbarëvajtja e tyre ishte një nga kushtet që duhet të plotësonte qeveria shqiptare, në mënyrë që të fitonte njohjen e plotë dhe të pakushtëzuar. Masat e shpejta të komunistifikimit të shtetit dhe të qeverisjes, edhe pse P.K.SH vazhdonte të mos deklarohej hapur dhe të fshihej përmes FNÇ, kishin krijuar një klimë jo shumë të përshtatshme për gjallërimin dhe pjesëmarrjen politike të opozitës shqiptare në jetën publike e sociale të vendit. Në Shqipëri tashmë ishte vendosur një regjim komunist sipas modelit sovjetik, por në ndryshim nga "demokracitë e tjera popullore", ky proces u

zhvillua me asistencën dhe mbështetjen direkte të Jugosllavisë dhe Titos[1]. Shumë shpejt, në vlagën e korrespondencave të qeverisë së përkohshme me qeveritë e Aleatëve për të siguruar njohjen, si dhe masave për komunistifikimin e Shqipërisë, edhe perëndimorët që operonin në Shqipëri nëpërmjet misioneve të veta ushtarake dhe civile e ndjenë të nevojshme të ndihmonin dhe përkrahnin opozitën e brishtë shqiptare. Për më tepër, brenda vetë FNÇ, kishte figura dhe personalitete që nuk binin dakord me format e organizimit të ri shtetëror, si gjykatat vendore, këshillat dhe komitetet ekzekutive, forma të huazuara nga sistemi komunist sovjetik. Një pakënaqësi e madhe tjetër ishte dhe e elementëve të shpronësuar apo tregtarëve të mëdhenj, pasuria e të cilëve i ishte nënshtruar ligjit të Tatimit të Jashtëzakonshëm të Luftës.

Kontaktet e para të britanikëve me opozitën u vendosën në qershor të vitit 1945 , përmes njerëzve që punonin pranë Misionit Ushtarak Britanik, si Kiço Xhonga, Ing.Avdulla Muça, Shaban Balla, Niko Beço, Hivzi Golja, Llazi Posti etj. Intelektualët e mësipërm, të afërt me Misionin Ushtarak Britanik, siguruan komunikimin midis këtij misioni me koordinatorin e grupit të rezistencës Sami Çeribashi, me elementë të përjashtuar nga Fronti si ish ministrin e arsimit Gjergj Kokoshi dhe grupin social-demokrat të përfaqësuar nga Musine Kokalari. Gjithashtu, ata përfshinë në komitetin iniciator të krijuar në pranverë 1945 edhe Qenan Dibrën, eksponent i njohur i Partisë së Legalitetit[2]. Grupimi Social-Demokrat kryesohej nga Musine Kokalari, intelektuale dhe shkrimtare e njohur për kohën . Ky grupim ishte krijuar që gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe në të bënin pjesë figura të njohura të botës së pakët intelektuale shqiptare të kohës , si avokat Suad Asllani dhe Musa Disdari. Është interesant fakti se vazhdimisht opozita shqiptare e pas luftës është konsideruar en block

1 Hamit Kaba, Ethem Çeku. *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse 1946-1962*. Qendra e Studimeve Albanologjike. Instituti i Historisë. Tiranë: 2011, fq. 16
2 Leka Ndoja. *Zanafilla e Bashkimit Demokratik. Bashkimi Demokratik Shqiptare 1946.* Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë: 2015, fq. 9

si opozitë e mbështetur në ideologjinë e djathtë. Ky sugjerim dhe mendim duke analizuar grupimet e opozitës nuk i përgjigjet realitetit. Sipas një analize të programit të Partisë Social Demokrate, parti në të cilën Musine Kokalari ishte themeluese i përkiste spektrit të majtë të partive politike.

Grupimi social-demokrat përfaqësonte një rrymë të moderuar të së majtës shqiptare, e cila ishte për një evolucion të shoqërisë shqiptare pa qenë e nevojshme të ndërmerreshin masa ekstreme të kopjuara nga sistemi komunist në Bashkimin Sovjetik. Në nenin dy të statutit të Partisë Socialdemokrate shkruhej se, PSD është evolucioniste përsa i përket kolektivizmës ekonomike.[3] Pra, grupimi socialdemokrat kërkonte evolucion të marrëdhënieve ekonomike në Shqipëri dhe jo një kolektivizim të dhunshëm që u zbatua nga komunistët shqiptarë. Po kështu, përsa i përket problemit agrar, një nga problemet më të mëdha të shoqërisë shqiptare të asaj kohe , PSD në statutin e vet, neni tre, shënonte se ka për qëllim kryesor t'i sigurojë bujkut tokën e mjaftueshme për të punuar, të zhdukë shfrytëzimin,spekulimin dhe parazitizmin. Gjithashtu, do t'i sigurojë proletariatit bukën, banimin dhe të gjitha ndihmat e tjera për t'ia bërë jetën e këndshme. [4]Siç shikohet nga frazeologjia e përdorur PSD ishte shumë afër qëndrimeve të së majtës shqiptare që synonte një shndërrim social që t'u përgjigjej nevojave të kohës. Si qëllim të afërt dhe shpresëdhënës për të realizuar një balancë ekonomike në jetën e popullit shqiptar, PSD shikonte realizimin e një reforme agrare që do të ishte etapa e parë e ndarjes së tokës[5]. Për më tepër, në program synohej në realizimin e një sistemi sigurimi shoqëror për mbrojtjen e të gjitha klasave shoqërore[6]. Musine Kokalari dhe socialdemokratët shqiptarë ishin të ndërgjegjshëm se në Shqipëri duhet të kishte një drejtësi shoqërore në mënyrë që të kishte më shumë liri politike.

3 Musine Kokalari. *Vepra 2, Programi i Partisë Socialdemokrate,* Geer, 2009, f.435
4 Po aty, f.435
5 Po aty, f.436
6 Po aty, f.436

Edhe në aspektin e politikës së jashtme PSD ishte në mbështetje të një ideje për realizmin sa më parë të një konfederate ballkanike,[7] duke qenë një hap më parë se dhe vet komunistët shqiptarë që nuk guxonin ta shprehin hapur në asnjë program të tyre këtë qëllim. Mirëpo, pavarësisht këtyre qëndrimeve shumë të ngjashme me komunistët shqiptarë, sërish qëndrimet e tyre u quajtën të rrezikshme për monopolin e pushtetit që dëshironin të arrinin komunistët sepse sociademokratët ishin për një jetë aktive parlamentare dhe egzistencën e opozitës në jetën politike të vendit. përfshinte të tre organizatat.

Gjithsesi edhe Misioni Ushtarak Britanik që ishte më aktivi në takimet dhe konsultimet me opozitën shqiptare nuk ndiqte preferenca partiake. Ata ishin të interesuar për të pasur një opozitë të bashkuar në mënyrë të tillë që jeta politike në Shqipëri të mos monopolizohej nga Partia Komuniste Shqiptare.

Në takimet e dendura të shefit të Misionit Ushtarak Britani, Palmerit dhe anëtarëve të këtij msioni, majorëve Smith, Arnot dhe Leon me komitetin iniciator të përbërë nga të ri grupimet ishte nënvizuar nevoja për krijimin e një opozite të bashkuar që do ti përfshinte të tre organizatat. Pas takimeve të shumta me britanikët, u ra dakord që në mbledhjen e parë të përbashkët të tre grupeve dhe me praninë e Gjergj Kokoshit, në datën 17 nëntor 1945 të krijohej një Komitet Nacional i organizatës Bashkimi Demokratik. Në këtë takim u shtrua për shqyrtim edhe çështja e pamundësisë së pjesëmarrjes në zgjedhje pasi kishte mbaruar afati ligjor, afat që sipas ligjit shkonte të paktën 40 ditë para datës zyrtare të zgjedhjeve. Në këtë kontekst, duke mos pasur mundësinë nga ana ligjore për të marrë pjesë në zgjedhje, u shqyrtua versioni i kërkesës për shtyerjen e datës së zgjedhjeve. Për këtë arsye ata vendosën t'i drejtoheshin me një memorandum aleatëve ku do të shpreheshin qartë kërkesat e tyre, përfshi dhe mundësinë e shtyrjes së zgjedhjeve të 2 dhjetorit.

7 Po aty, f.436

Kësaj radhe mbledhjen e datës 20 nëntor që u organizua në shtëpinë e Shaban Ballës, me profesion gjeometër dhe shofer pranë Misionit Ushtarak Britanik, e kryesoi Gjergj Kokoshi. Për këtë rol udhëheqës të Gjergj Kokoshit, mesa duket ka luajtur rol, kredencialet e dhëna nga anglezët por edhe autoriteti i tij i padiskutueshëm si ish Ministër i Arsimit dhe Kulturës Popullore dhe ish anëtar i kryesisë së Frontit Demokratik. Në mbledhjen e dytë të opozitës Gjergj Kokoshi ra në mosmarëveshje me Musine Kokalarin për pikat e hartimit të Memorandumit dhe krerët e grupeve. Musineja kërkonte të përfshihej në Memorandum kërkesa për zhvillimin e një plebishiti në Kosovë për vetëvendosje. [8]Këtë qëndrim Musine Kokalari e mbështeste jo vetëm në formimin e vet kombëtar nën frymën e Rilindjes Kombëtare por edhe në nenet e statutit dhe frymën që kishin ndërmarrë intelektualët që kishin themeluar Partinë Socialdemokrate. Në nenin VI të statutit të PSD shkruhet: partia ka për qëllim të luftojë kundër çdo okupatori për indipedencën e një Shqipërie të unjisur brenda kufijve të saj etnikë [9]

Duket se nën arsyetimin e sigurimit të mbështetjes britanike ndaj opozitës dhe aktivitetit të saj, ky moment i mos rënies dakord mes grupeve për çështjen e Kosovës, u kapërcye dhe, në datën 22 nëntor, u organizua mbledhja e tretë në shtëpinë e Ali Kavajës, anëtar i Grupit të Rezistencës, nëpunës tatimor para pushtimit dhe gjatë kohës së luftës. Në këtë mbledhje u hartua Memorandumi në frëngjisht nga Musine Kokalari dhe Qenan Dibra, i cili iu dorëzua misioneve anglo-amerikane prej Qenan Dibrës, Shaban Ballës dhe Sami Qeribashit.[10] Ndërkohë, një notë tjetër i ishte dorëzuar Misionit Ushtarak Britanik më parë nga Komiteti Inisiator i Opozitës dhe programi prej 13 faqesh i hartuar nga Kiço Xhonga, e përkthyer në anglisht nga Emin Bakalli, nëpunës në Ministrinë Botore. Nota iu dorëzua Nënkolonelit Palmer nga Lari Posti në datën 5 nëntor. Ky i fundit do të udhëtonte

8 Leka Ndoja. *Vep. Cit*. fq. 11
9 Musine Kokalari. *Vep. Cit,* fq. 436
10 Leka Ndoja. *Vep. Cit*. fq. 12

po atë mbrëmje për në Kazerta ku ndodhej Shtabi i Forcave Aleate të Mesdheut. Në këtë mënyrë britanikët do të njiheshin drejtë për së drejtë me kërkesat dhe programin e opozitës së brishtë shqiptare. Mirëpo, për fat të keq kishte një mospërputhje midis vullnetit dhe zellit antikomunist të Palmer-it dhe oficerëve të tjerë britanikë të misionit dhe kalkulimeve të kujdeshme të Londrës zyrtare për të mos u përfshirë në një mbështetje të hapur apo planifikuar një zbarkim të mundshëm në Shqipëri. Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se qoftë Palmer-it dhe më vonë Hoxhsonit, Londra zyrtare i ka tërhequr vëmendje për ndërhyrje në punët e brendshme të qeverisë shqiptare me argumentin se fundi, fundit Qeveria e Përkoshme e dominuar nga komunistët, kishte ardhur në fuqi me vullnetin e plotë të popullit shqiptar e se nuk ishte imponuar nga jashtë. Në deponimet në gjyq të anëtarëve të Bashkimit Demokrat, dëshmohet se ka një devijim nga ajo, çka Londra u kish komunikuar oficerëve britanikë për mbështetjen e opozitës dhe mundësinë e zbarkimit në Shqipëri. Palmeri kishte nënvizuar faktin se nuk ishte pranuar kërkesa për ndërhyrjen angleze për ndryshimin e regjimit në Shqipëri pasi edhe Anglia ishte në pamundësi të zbarkimit të forcave ushtarake pasi ishin okupuar në Greqi. Palmeri ishte shprehur me anëtarë të opozitës"nuk mund të vëmë në rrezik jetën e asnjë ushtari anglez dhe se smund të nisim luftën e tretë botërore për shkak të Shqipërisë. Ky qendrim i britanikëve rezultoi tëishte fatal për shpresat e opozitës antikomuniste shqiptare.

Për fat të keq të historisë së parlamentarizmit në Shqipëri, zgjedhjet nuk u shtynë dhe u zhvilluan në datën e përcaktuar më parë në 2 dhjetor 1945. Fronti Demokratik fitoi shumicën e vendeve në Asamblenë Kushtetuese prej 70 vendesh dhe asnjë kandidat jashtë listave të Frontit, nuk fitoi. Misioni Ushtarak Britanik dhe Misioni Civil Amerikan i ndoqën zgjedhjet nga afër, por u zhgënjyen nga rezultati i tyre. Triumfi në zgjedhjet e 2 dhjetorit nga Fronti Demokratik dhe P.K.SH që qëndronte në prapaskenë, u dha komunistëve shqiptarë

një vetëbesim për të ecur më tej në projektin e tyre për instalimin e regjimit të tyre. Modeli, mbi të cilin ata bazoheshin ishte modeli sovjetik, që në Shqipëri po instalohej me asistencën e drejtë për së drejtë të jugosllavëve. Modeli sovjetik ishte një sistem totalitar i bazuar në një parti të vetme. Si i tillë, në procesin e funksionimit të shtetit, në të mungojnë ato organizma që shërbejnë si kundërpeshë ndaj pushtetit, që e kontrollojnë dhe e kufizojnë atë nga ndërrmarrja e veprimeve arbitrare. Kundërshtarët ideologjikë të komunistëve gjatë luftës "Balli Kombëtar" dhe "Lëvizja e Legalitetit", me mospërfshirjen e tyre në luftime të drejtë për së drejta kundër forcave të Boshtit, e kishin humbur legjitimitetin për të ushtruar opozitë në Shqipëri, aq më tepër, që shumica e udhëheqësve të tyre ishin në emigrim politik, jashtë Shqipërisë dhe nuk kishin asnjë mundësi për të ndikuar në ngjarjet në Shqipëri. Në këtë kontekst, të vetmit që mund të krijonin probleme në instalimin e regjimit komunist në Shqipëri ishte opozita e Bashkimit Demokrat, ndaj për këtë arsye, menjëherë pas zgjedhjeve, qeveria e Enver Hoxhës vendosi të marrë masa respresive ndaj tyre. Mjet kryesor në ushtrimin e pushtetit të regjimeve totalitare është tiranizimi. Ai është në vetë përmbajtjejn e totalitarizmit, të sundimit total nga një parti e vetme e udhëheqësi i saj, të nënshtrimit të individit në kuadrin e komb-shtetit.[11] Një numër i madh i eksponentëve të opozitës shqiptare kishin mbajtur kontakte shumë të ngushta me oficerë të Misionit Ushtarak Britanik, si Nënkolonelin Palmer, Kapitenin Smith dhe Togerin Arnot. Të arrestuarit ishin pothuajse të gjithë eksponentët e Bashkimit Demokrat duke filluar nga Gjergj Kokoshi, Musine Kokalari, Sami Qeribashi, Ali Kavaja, Qenan Dibra etj. Rezultoi që pjesa më e madhe e tyre kishte qenë prej kohësh nën survejimin e agjentëve të Mbrotjes së Popullit dhe ndaj tyre u ushtrua një proces hetimor i dhunshëm dhe i egër. Akuzat kryesore drejtoheshin ndaj bashkëpunimeve të

11 Llambro Filo. *Sistemet politike bashkëkohore*. Botimet "Ideart", Tiranë, fq. 358

tyre me të ashtëquajturit kriminelët e luftës ose të arratisurit në male dhe përpjekje për të rrëzuar me dhunë pushtetin në fuqi. Në këtë proces u përfshinë 75 persona prej të cilëve 9 veta morën dënime kapitale dhe të tjerët u dënuan me burgime të gjata. Procesi hetimor edhe me vonë ai gjyqësor hodhën bazat e sistemit të eliminimit të elitave jokomuniste dhe të kundërshtarëve politikë që do të vazhdonte për pothuajse gjithë periudhën e sundimit komunist në Shqipëri. Ky gjyq i parë ndaj opozitës shqiptare nuk ishte i rastësishëm. E veçantë për mjetin e eliminimit komunist nuk ishte vetëm numri i madh i të eliminuarve, por mënyra e përzgjedhjes së atyre që ekzekutoheshin. Iu dha fund gjykimit në bazë të fajësisë vetiake apo përgjegjësisë vetiake. Dënimi nuk bëhej mbi bazën e akuzës për krime vetiake, por mbi bazën e prejardhjes sociale të të dënuarit dhe të thashethemeve për të. [12]

Mbi Musine Kokalarin u zbatua e njëjta strategji për ta denigruar dhe burgosur. Qëndrimi i saj në gjyq ishte një shuplakë ndaj regjimit komunist dhe dëshmi e forcës morale që intiligjenca shqiptare po tregonte përkundrejt totalitarizmit. Me ndërgjegje të plotë ajo kish braktisur muzën e krijimtarisë Kalipso dhe përmes guximit të saj intelektual po hynte në histori duke u shndrruar në muzën e historisë Klio. Në gjyq ajo do të shprehej me një guxim të pashoq intelektual e njerëzor se "Unë nuk kam nevojë të jem komuniste të dua vendin tim. E dua vendin tim edhe pse nuk jam komuniste. Unë e dua përparimin e saj. Ju mburremi se keni fituar luftën, dhe tani ju jeni fituesi që doni të shuani ata që ju i quani kundërshtarë politikë. Unë mendoj ndryshe nga ju, por unë e dua vendin tim. Ju jeni duke më ndëshkuar për idealet e mia!" Me arrestimin dhe dënimin e Musine Kokalarit u shuan shpresat se regjimi komunist në Shqipëri do të ndiqte një rrugë të moderuar drejt konsilidimit të pushtetit të tij dhe me veprimet e tij arbitrare po shuante rezistencën dhe mendimin ndryshe.

12 Po aty, fq. 358-359

Brunilda DASHI
Universiteti "La Sapienza" - Roma IV
Instituti i Studimeve Shqiptare

Veçori gjuhësore në veprat letrare të Musine Kokalarit

Në vitin 1948, kur Musine Kokalari dergjej padrejtësisht burgjeve të regjimit, jashtë Atdheut, albanologu austriak Maximilian Lambertz e rendit si të vetmen shkrimtare shqiptare në mes të një aradhe të tërë autorësh, që fillon me Buzukun e mbyllet me Migjenin. Fragmentet e zgjedhura nga veprat shqip të autorëve shqiptarë e arbëreshë, të përkthyera dhe gjermanisht, i shërbejnë Lambertzit si tekste leximi për Gramatikën e vet përshkruese të gjuhës shqipe, botuar në të njëjtin vëllim. Kokalarit i boton katër tregime nga libri Siç më thotë nënua plakë [Lambertz1 I: 328-339]. Një dhjetëvjeçar më pas, ai e këqyr me imtësi gjuhën e shkrimtares, veçanërisht veprat Siç më thotë nënua plakë e ...sa u tund jeta (sic), duke e njëjtësuar me dialektin e Gjirokastrës [Lambertz2: 85]. Njësimi bëhet a priori, nuk ka hulumtime krahasuese. Pak vite më vonë, në 1966, gjuhëtari Menella Totoni, pas vjeljes së materialit gjuhësor in loco, boton një studim të gjerë rreth së folmes së Gjirokastrës. Totoni pohon se e ka parë shkrimin e albanologut, por nuk e pranon si pasqyrë të dialektit gjirokastrit, sepse "Materiali" ku është mbështetur (dy veprat e

Kokalarit), "nuk reflekton besnikërisht" atë të folme [Totoni: 80].

Të dy gjuhëtarët arrijnë në përfundimet përkatëse, duke vëzhguar, njëri, vetëm veprën letrare, tjetri, kryesisht traditën gojore. Ky studim synon të përqasë veprën me traditën për të qëmtuar elementet gjuhësore që vërtetojnë përkimet dhe mospërputhjet mes tyre dhe realizohet me analizën e tri veprave letrare të Autores: Siç më thotë nënua plakë [SM], Reth vatrës [RV] e ...sa u tund jeta [ST].

Kundrimi i prurjeve të penës së Kokalarit do të rezultonte i pjesshëm dhe aspak përfaqësues i personalitetit të saj të spikatur, nëse këqyrja e lentimit të mirëfilltë letrar në SM, RV e ST (teksti narrativ) nuk do të shoqërohej e ndërthurej me shqyrtimin e karakteristikave gjuhësore të artikujve të fjalorit në SM [F1] e në ST [F2] (teksti informues) dhe të pasthënies [P] Duke mbaruar... në ST (teksti argumentues) [për terninologjinë tekstuale khs. Lala: 1491]. Pikërisht vëzhgimi gjithëpërfshirës i kësaj larmie tipologjike tekstuale orienton në përkufizimin e secilit variant gjuhësor të përdorur dhe në përcaktimin e lidhjes së ndërsjellë midis tyre, pra ndërmjet dialektit gjirokastrit dhe idiolektit letrar të Autores.

Fenomenet fonetike (ndonjëherë dhe morfonolologjike) në veprat SM, RV e ST analizohen në këtë trajtesë të krahasuara me të dhënat e Altasit dialektologjik [AD] e me studimin e lartpërmendur të Totonit. Tradita gojore e regjistruar në këto vepra nuk është hulumtuar këtu, sepse shumë këngë janë variante të këngëve të botuara më parë te Visaret e Kombit (khs. III: 66 Kur hyn nusja te dhëndëri me ST 196; 67 Moj unaza rreth flori me ST 145-146; 76 Nusja prindve me ST 179; IV: 259 Mineja rëzës së malit me ST 123), prandaj për to nevojitet një klasifikim e studim më vete.

Vokalizmi. Sistemi zanor i veprave të analizuara, pra teksti narrativ, informues dhe argumentues, përbëhet nga të shtatë tingujt e shqipes letrare. Delabializimi i zanores së lartë të përparme y në gjegjësen i është fenomen fonetik i gjithmbarshëm në tekstin narrativ, tipik i dialektit gjirokastrit, saqë AD e jep me 6 zanore [AD, I: 86].

Regjistrohet te emrat: SM 40 birekun, RV 105 birekut, ST 8 diqane, 12 fitin, SM 6 të hira, 64 të dija, 19 të dizetat; te mbiemri pronor: SM 25 it 'yt' (nuk trajtohet në kategorinë e përemrit sepse shoqëron një emër, nuk e zëvendëson e nuk del në formën e shquar); te përemrat vetorë: SM 12 ti, 26 atire; te foljet: SM 3, 26 lipsen, 18 thihet, RV 93, 127 friu, ST 27 pështiu, 16 shtipi; dhe te numërorët: RV 93, ST 7 dizet, 7 diqint.

Shpesh kjo dukuri nuk ka vazhdimësi për kategori të ndryshme gramatikore të cilat kanë dhe një variant gjegjës që nuk kryen ndërrimin fonetik y→i në P ose në F1 e F2: emri ST 18 frima shënohet në P 299 frymë; mbiemri prejnumëror i emërzuar SM 3 të ditin del pranë P 298 e dyta e F2 XXVII e dytë, mbiemri prejfoljor i emërzuar SM 73 i përmbisuri krahas F2 XXXIII përmbysu; folja SM 9 hin bashkë me P 299, 301 hyn, e folja SM 19 mbillur krahas F2 XX mbyllur; ndajfolja SM 18, ST 5, 9 ati pranë F2 XXXVI aty; numërori SM 7, ST 5 di bashkë me P 299 e F2 XV dy.

Nuk është vështirë të kuptohet se idiolekti influencon dialektin; si rrjedhim kufiri ndarës nuk është i prerë. Si shembull mund të sillet emri sy që del në SM 5, kronologjikisht vepra e parë e studiuar, me formën sitë. Në F1 9, Autorja regjistron variantin sytë dhe e konfirmon këtë përzgjedhje fonetike në veprën e dytë, RV, që është vetëm krijim letrar (pa fjalor e pasthënie): khs. RV 84, 87, 99 sytë. Vetëm se fenomeni nuk është i vijueshëm, sepse në tekstin narrativ të ST, vepra e tretë, dalin sërish të dyja format: 6, 141 sitë e 203 sytë. Në F2 trajta e përgjithësuar është sytë (khs. VII sytë te zëri çarçaf). Tjetër shembull luhatjeje është shkrimi i variantit të dyfishtë të leksemës SM 11, 45, ST 82, 268 grikë dhe RV 109 grykë, dhe epërsia e formës mbidialektore grykë në F2 VI. Po kështu nga SM 69 diert, ST 232 diertë kalohet në RV 34 e, më tej, në F2 VII dyertë. Përfshihet në këtë dukuri dhe mbiemri/përemri pronor i vetës së tretë shumës: SM 35, 80 e tire, variant i përgjithësuar, krahas formës tjetër në RV 27 e tyre, 108 të tyre, që del në ST 5, 29 e ture, e vetmja

formë e regjistruar, për t'u ndërruar akoma në F2 XXXVI të tyret. Alternimi fonetik y→u, që AD e jep si karakteristik të së folmes së Gjirokastrës [khs. ature AD, I: 150], këtu nuk është i përgjithësuar. Pra, inkoherenca ndeshet në tekstin narrativ, sepse Kokalari vetë në tekstin informues e argumentues përdor format mbizotëruese në gjuhë, ato që po çonin në hullinë e krijimit të një koineje.

Ndërrimi i zanores së lartë ndodh edhe brenda diftogut -ye- tek folja SM 3 kthie dhe mbiemri prejfoljor SM 50 E shqierë. Folja pyes del vetëm dy herë me variantin SM 43 piet, 19 pietja (sic) krahas formës së përgjithësuar me j: SM 21 pjeta, RV 115 pjesin, ST 7, 27 pjeti, SM 58 pjetur me ndryshim dhe të theksit të fjalës. Nuk mungon dhe trajta jokarakteristike dialektore: RV 78 Pyete, 95 pyeti, që përsëritet në P 299 pyet. Dilet nga ambienti dialektor me format foljore: P 297 thyen, 302 u-thyen. Këmbimi i kundërt fonetik i→y haset tek përemri ai që shënohet vazhdimisht ay në RV 11, 12, 39 dhe në F1 15 e P 299, d.m.th. epërsi e plotë e formës dialektore.

Përdorimi i zanores së mesme të shurdhët ë para bashkëtingëlloreve hundore [AD, I: 136, 137 e 139] është i përgjithësuar tek emrat: SM 3 fëmërat, SM 55, RV 28, ST 32 zëmër, SM 23 vënt, 19 të ënjten, ST 30 e ënjte; te folja: SM 28 u-gjënt, 32 gjëndet; dhe te ndajfolja o parafjala: SM 9, 16, 62, RV 21, 53, ST 5, 6, 13 brënda. Sporadike është ndonjë trajtë emërore me të mesmen e përparme e, si SM 55 zemrën, RV 27, ST 50 zemër. Në të gjitha rastet P ruan ë para hundores: 297, 298 vëndin, 297 zëmrat, 299 të ënjten, po kështu edhe F1 12 e F2 XXXIV vënt. Dialekti është mbizotërues.

Nuk është i rregullt zëvendësimi i zanores qendrore së mesme ë me të mesmen e përparme e [AD, I: 133] te folja lë: SM 3, RV 17, ST 22 Lermë, SM 51, ST 122 lereni, SM 64 ta lemë shkruhet krahas SM 11, 77 kam lënë, SM 6, 30 do të lënë, RV 57 ka lënë, ST 11 t' i lëmë. Fenomeni i kundërt regjistrohet me foljen ngre: RV 40 U ngrë bashkë me ST 9 u-ngre, e me foljen fle: RV 21, ST 151 flë krahas ST 45 do të fleç. P 300 e F2 XII përdorin flë e F2 X kanë lënë. Këtu mund të

trajtohet edhe ndërrimi fonetik te ndajfolja e kohës atëherë: SM 10, RV 11, ST 60 atëhere krahas SM 46, ST 66 atëherë; dhe te përemri i pacaktuar njëra: SM 6, RV 6, ST 43, 75 njera bashkë me SM 73, RV 67 (vetëm një herë) njëra. Në ST 264 del trajta Njëra që qortohet në errata corrige XLVI me Njera. P 298, 300 ka vetëm njera.

Këmbimi tingullit zanor të lartë i me të mesmin qendror ë [Totoni: 86] është i rregullt tek emri SM 4, RV 141, ST 45 gjëlpërë. P 300 ruan të njëjtin tingull. Po ashtu edhe fenomeni i kundërt, i përgjithësuar tek leksema SM 5, 75 qindizma, RV 134 të qindisur, ST 57 qindiste, ndërsa për foljen përpij varianti me i shënohet vetëm një herë në të tria veprat: SM 5 të pirpijë, pra dukuria nuk është emblematike. Luhatje grafike paraqet ndajfolja e kohës gjithnjë: SM 6, 52, 68 gjëthënjë e 7, 20, 49 gjithënjë. Në RV 11, 33, ST 7, 50, 82 gjithënjë del e përgjithësuar, si në F1 67, 69, P 297 e F2 III.

Ndeshen njëkohësisht të dyja variantet e foljes dëftej/dëftoj me alternimin e zanores së temës: SM 54 Dëftehej krahas 12 dëfton, RV 74 u dëfteu bashkë me 33 dëfton, 99 u-dëftoi, 136 dëftoi. Në ST del vetëm dëftoj, 68 dëfton, 131 t'u dëftonte. Kokalari zgjedh temën në -o: F2 III dëfton. Tipik dialektor toskë [AD, I: 325] është ndërrimi i zanores së temës e me o te folja them: SM 4, 25, 59, RV 41, ST 13 thom, 27, do t'ju thom, 38 do të thomi, 31 të thom, 39 të thomi, 15 të thom, trajtë e përgjithësuar. Bën përjashtim: SM 66 do t' ja them (që del vetëm një herë), RV 60 them, 113 do të them (dy herë). Në F2 VI, XXV dhe në tekstet e këngëve (ST 75, 169) haset vetëm Them. Autorja nuk e ka në idiolekt.

Ndërrimi i zanores së mesme të përparme e te SM 49 tjetrit, 74 tjetrin, 73 tjetrën, 80 tjetra me të ulëtën a te SM 20 tjatri, ST 31 tjatër, nuk regjistrohet në RV. Kokalari e përdor në F1 71 tjatrën, por është një shembull i izoluar, sepse varianti me e është i përgjithësuar në RV 54, ST 69 tjetra, RV 68, ST 31 tjetri dhe në P 298 tjetra, F2 XXI tjetri. Fenomeni i kundërt, edhe ky i kufizuar, del te emri RV 69 hardhisë, 69 hardhija, që shënohet bashkë me variantin dialektor ST 5 erdhi,

289 e erdhisë. Mbiemri cilësor i prejardhur nga F2 XXII ergjënd shkruhet vetëm me e nistore: ST 31 e ergjëntë.

Këmbimi i ë-së së temës me të lartën u [Totoni: 85] haset në RV 78, 104 pullumba, 62 ulurinte. Luhatje regjistrohet te trajta e emrit RV 99 kushurinjtë, ST 33 Kushurinj, 33 kushurirat, krahas variantit të përgjithësuar 49 kushërirat. Autorja i ka të dyja variantet: F2 XIV kushërinj e XXXVI kushurinjtë. E paqëndrueshme është grafia e foljes numëroj: RV 95 mos nëmëro, ST 82 nëmëronte, dhe RV 100 Do numuroj, ST 264 numuronte, krahas RV 100 numëronte, ST 67 numërojti.

Jo shpesh ndeshet rënia e zanores pastheksore të lartë -u- në RV 91 kukllat, 111 kuklla, megjithëse dukuria nuk është e përgjithësuar: SM 70 shpatulla, 75 kumbulla, ST 53 vetullat. I përhapur është fenomeni i rënies së zanores së mesme -ë- paratheksore: RV 24 thrimet, 6 dbora, 109 do ta dbojmë, SM 77, RV 11 thret. Emri dërrasë regjistrohet me të njëjtën formë drasa(t) në RV 51, ST 10 dhe në P 297 e F2 X; po kështu fojla ndërroj del në ST 155 Ndroi dhe në P 300 ndrohet, F2 III duke ndruar. Përkundrazi, ruhet e mesmja e pazëshme paratheksore te vëllai, në SM 27, RV 72, ST 186 dhe në F2 XXXVII vëllajt. Nuk bie pastheksorja te emri dhëndëri në RV 141, ST 164 e P 299 dhe te mbiemri (i emërzuar) e ngaherëshmja në ST 27 dhe e ngaherëshme në P 300. Ritmi i shpejtë që rrjedhon nga tkurrja e leksemave nuk është tipik e toskërishtes, e cila rëndom e ruan ë-në në të gjitha pozicionet.

Konsonantizmi. Përsa i përket sistemit të bashkëtingëlloreve, një ndër fenomenet fonetike më të përhapura në toskërishte, pra dhe në të folmen e Gjirokastrës, është ai i zëvendësimit të bashkëtingëllores së lëngët polivibrante rr me monovibranten r [AD, I: 90]. Për Totonin, dridhësja rr nuk bën pjesë në sistemin fonetik të së folmes gjirokastrite [Totoni: 91]. Vërtet ajo humb intensitetin në tekstin narrativ te emrat: SM 3 zorët, 7 vjehra, 25 qura, 28 zjarin, RV 33, ST 18 ëndër, RV 131 furës, 61 kokra, 93 kraba, 103 robat; te mbiemrat:

ST 24 e reme, 5 çjerë (sic); te foljet: SM 32 rëmbien, RV 60 rëmbeu, 76 roj, ST 5 rethojnë; e te ndajfolja RV 95, ST 8 kurë, dhe në idiolekt te emrat: F1 7 vjehrat, P 297 rënjë, rezet, 299 barë, ferë, 300 ëndra, F2 XXVI të rënqethur, te mbiemri F2 XV i rumbullaktë; te foljet: P 297 rjedh, 299 ruhet; e te ndajfolja F2 IV rallë. Por kjo s'do të thotë se dridhësja intensive nuk haset. Me të dyja variantet shkruhen emrat rrëzë, përrallë e burrë: SM 16, RV 103 rëzë krahas SM 8 rrëzave, 57 rrëzë; RV 17 prallat, 36 pralla bashkë me 6, 38 prrallën; RV 37, ST 15 bura, 7 burave krahas SM 14 burrin, RV 36, ST 186 burrat. Zëri rrëzë del vetëm me monovibrante në RV e ST dhe ruhet i tillë në P 298 rëzë e në F2 XV rëza. SM ka vetëm burrë me polivibrante e, me gjithë luhatjet në RV e ST, Kokalari e përdor: F1 44, P 298 burrë, F2 VI burrit. Pra nuk është një zgjedhje e vijueshme.

Lëkunden trajtat e foljeve marr, harroj e rri: SM 3, RV 12 mer, RV 21, 44 marin, SM 43 do të marë, 11 pa marë bashkë me variantet: SM 3, 11 merr, 5 do të marrë, RV 130 të marrim, 72 t'i marrim; SM 31, ST 24 haron, RV 37 harove krahas trajtave: SM 22 harroi, 57 u-harrove, RV 141 harroj; SM 10, RV 5 rinë, 32 ri, 56 të rimë, ST 45 rinte krahas RV 18 rrinte, 50 Rrinin, 70, 71 Rri. Ndajfolja e parafjala rreth regjistrohet në SM 7, RV 39, ST 86 reth por edhe SM 40, RV 62 rreth. Ndërsa në SM e RV përdoren të dyja variantet, në ST mungon forma me polivibrante. Në të kundërt, grafia me dridhësen intensive rreth do të jetë e vetmja në P 297 e F2 XII. Në kopertinën e pasme në RV shënohet titulli Reth vatrës, por në kopertinën e pasme të ST, ky titull është korrigjuar me Rreth vatrës. Orientimi i Autores është i qartë, megjithëse nuk mungon ndonjë rast jokoherent në idiolektin e saj: P 302 të rojë bashkë me 302 rron; P 302 mer krahas 299 të marrin; F2 XII ri e X rri, XI kurë pranë XIII kurrë.

Teksti narrativ ruan anësoren l në vend të shtegores qiellzore j [AD, I: 196] tek emrat e parmë: SM 8 falin, 7 fëmilë, 3, 35, ST 9 malë, SM 5 pala, 24 shilën, 12 murtala, ST 104 valin. Luhatje paraqet emri gojë, që regjistrohet në SM 9, 31, ST 14, 18, 21 golë, bashkë me F1

35 e 80 gojë, e më tej P 300, F2 XXXIII gojën. Me një përjashtim të RV 19 gola, zërat dalin me qiellzoren mbidialektore në RV: 132 vajin, 38 fëmijë. Ky është dhe varianti i Kokalarit në F2 XXI fëmijë, P 298 maja, F2 X majë, P 300 paja, F2 XVI pajë. Dukuria haset dhe te numërori ST 7 një milë që shkruhet i palatalizuar në P 298 një mijë. Megjithëse është një fenomen morfofonologjik, mund të radhisin në këtë grup emrat e prejardhur me prapashtesën -lë (-je): ST 19 sëmundlën, 43 plasëlë, 292 vdekëlat. Ndeshet një rast i vetëm ku anësorja grykore ll i korrespondon një shtegoreje qiellzore j: ST 44, 157, 191 rëmullë, formë e përgjithësuar në ST, krahas F1 53 rëmujë [Çabej VI: 326]. Edhe një herë Autorja shënon formën që përceptohet si mbidialektore.

Mëdyshja në përdorimin e anësores alveolare l në SM 7, ST 7 avlija, SM 62, ST 24 mëhaleja, SM 11 mëhalesë, ose të grykores ll në SM 11 avllinë, 53 mëhalla, 76 mëhallë tregon se diktohet nga idiolekti.

Fenomenet fonetike të alternimit të bashkëtingëlloreve mbylltore/shtegore nuk janë fort të përhapura. Bashkëtingëllorja mbylltore dybuzore e shurdhët p zëvendëson shtegoren buzodhëmbore gjegjëse f në leksemën kapshatë në SM 77, por SM 12 regjistron në mënyrë inkoherente kafshatën. Këmbimi bëhet rregullisht në ST: 19, 278 kapshata. Vetë Kokalari nuk e përdor këtë variant: në F2 XI del të kafshuar dhe kafshoi. I njëjti tingull mbylltor p i temës në RV 6, 70 kopshtit, që është e vetmja formë e shënuar në RV, bjerret në ST: 5, 289 kosht, 202 koshtit, formë e përgjithësuar.

Shtegorja buzodhëmbore e zëshme v zëvëndëson dybuzoren b në ST 133 e çorvës. Po kështu ndërrimi b→v në SM 10 torvën e në RV 69, ST 48 torvë është i vijueshëm. Por Autorja, që në F1 43 ka torbën, në mënyrë inkoherente në P 297 shkruan prapë torvë. Luhatje në idiolektin e Kokalarit, dhe jo në tekstin narrativ, haset te leksema vrimë: RV 35, 106 vrimë, ST 12 vrima, formë e përgjithësuar, krahas F2 VIII brima e XX vrimë.

Ndërrimi i shtegores ndërdhëmbore dh me mbylltoren dhëmbore d del te leksema çardhakut në SM 3. Dukuria është përgjithësuar me zërin perde në ST: 23 perdhe, 291 perdhen. Variantin perdhe e ka Kokalari në P 299. Ndërkohë, në veprën kronologjikisht në mes, RV, shkruhet vetëm trajta me dhëmbore: 65 perden, 133 perdet.

I veçantë paraqitet përdorimi i afrikateve. Është fare pak i përhapur fenomeni fonetik i ndërrimit të afrikates së shurdhët postalveolare ç me shtegoren gjegjëse sh, si te SM 60 çilte, ST 14 çiltenë. Leotti e ka shilte. I vijueshëm është zëvendësimi i afrikates së shurdhët ç me të zëshmen xh në SM e ST: SM 44, ST 265 xhurape, 5 xhurapet. Dukuria nuk haset në RV, ku shënohet 84 çarape. Në F2 VII, XIX e XXIV del gjithnjë çarape. Edhe këtu trajta dialektore është e kërkuar. Leksema emërore me funksion ndajfoljor çurg 'curril' regjistrohet Xhur (lotët) në SM 51, ST 12, pra e bjerr tingullin bashkëtingëllor fundor. Nuk mungon dhe zëri me afrikate të pandryshuar: RV 109 Çur çur (lotët). Edhe një herë konfirmohet ideja e mosrealizimit të këtij fenomeni fonetik në veprën letrare të ndërmjetme, RV.

Për alternim afrikatesh alveolare, e shurdhëta c me të zëshmen x, bëhet fjalë te folja kërcej që del kërxier në SM 43. RV e ST e kanë vetëm me c: RV 76 kërceu, ST 12 kërcente. Po kështu për foljen kapërcej, që shkruhet kapërxier në SM 68, grafia me të shurdhëtën në RV e ST është e përgjithësuar: RV 72 Kapërcyen, 13 do ta kapërcejmë, ST 186 kapërceu, 111 kapërce. Kësaj radhe është Kokalari vetë që lëkundet: P 298 i kapërcimit, 300 kapërcen por edhe 302 për të kapërxyer (formë e vetme), si SM. Fenomeni fonetik nuk është i rregullt e karakterizues.

Sporadik është rasti i emrit llucë që regjistrohet në RV 138 lluçë. Mëdyshje paraqet leksema mace: trajta e përgjithësuar në SM 27, ST 6, 9, 276 maçja, ST 42 maçe, del në RV vetëm me variantin 27 macen, 133 macja. Kronologjikisht fenomeni nuk verifikohet vetëm në RV. Trajta me afrikate alveolare përzgjidhet në F2 XV e maces.

Një ndërrim margjinal e jokarakteristik për dialektin gjirokastrit [AD, II: 149] është zëvendësimi i shtegores s me afrikaten c: RV 71,

78 laraska, 77 e laraskës dhe RV 71, 85 larackë. Duket qartë se për ndërrimet fonetike të afrikateve, RV paraqet tekstin narrativ më afër së folmes mbidialektore.

Tjetër dukuri fonetike e gjithmbarshme në toskërishte është shurdhimi i tingullit bashkëtingëllor fundor [AD, I: 112]. Vëzhgimi i tij i kujdesshëm tregon se ndërrimi i tingujve në veprat e Kokalarit bëhet edhe në prani të morfemave trajtëformuese e/o fjalëformuese. Shurdhimi i bashkëtingëllores mbylltore grykore të zëshme g ndeshet kryesisht te emrat. Del me mbylltore të shurdhët emri prag: SM 34, ST 5, 104 praku, RV 106 prak, 111 prakut. Në P 300, pra jashtë tesktit narrativ, shënohet trajta Pragu. Me dy variante registrohet emri zog: ST 115, 257 zok, formë mbizotëruese, dhe RV 47, 133 zog, e vetmja formë e regjistruar. Trajta e mbiemrit të prejardhur nga emri dhogë me prapashtesën -të këmben tingullin mbylltor g→k: F2 XXIII e dhoktë. Folja djeg del SM 16 djektë (dëshirore) krahas SM 68 djegtë. Kokalari në F2 XXI ka djeg. Fenomeni haset te kategoria e ndajfoljes: ndajfolja e vendit ST 59, 203 lark, vërejtur vetëm një herë, shënohet bashkë me 98 larg, që përfaqëson idiolektin e Autores: P 300 larg. Ndajfolja e mënyrës shkruhet vetëm me të shurdhëtën: SM 34, 54, ST 215 liksht.

Alternimi i tingullit shtegor alveolar të zëshëm z me gjegjësin e shurdhët s vërehet te emrat: SM 57, ST 201 bres krahas RV 81 brezi, ST 195 brezin; ST 5 kafase dhe 217 kafazeve; ST 32 gas dhe 276 gaz, 22 gazi. Lëkundet teksti informues: F2 X bres bashkë me XIII brez, XIX kafas dhe XIII gazi. Kjo gjë tregon se shurdhimi fundor nuk ka të bëjë gjithmonë me pashquarsinë. Fenomeni i kundërt i sonorizimit të tingullit fundor shtegor del te zëri mëngjes, formë e përgjithësuar në gjuhë shqipe: SM 11, 70, RV 8, 71, ST 5, 30 mëngjes, RV 71, ST 69 mëngjesit bashkë me SM 74, ST 151 e mëngjezit, RV 31 mëngjez. Kokalari nuk e ka: P 298, F2 XXIII mëngjes. Për leksema në shumës me morfemën në zanore mund të citohet ST 161 qiparis pranë 10 qiparizet. Domethënës është shurdhimi te shumësi i parregullt i

emrit njeri: SM 70, 238 njerës bashkë me SM 67, RV 73, ST 12 njerëz. Edhe një herë Autorja është në mëdyshje: F2 XX njerës pranë F1 51 njerëzit, F2 XXIV njerëz. Nuk ndeshen format e pashquara të fjalëve pus e qeros, por ato të shquarat regjistrohen vetëm me tingullin e zëshëm: ST 5, 45 puzi, 271 e puzit, dhe RV 133, 138 Qerozi. E zëshme është nistorja e leksemës sorkadhe: ST 14 zorkadhe. Rregulla fonetike mbidialektore akoma nuk është stabilizuar.

Ndër çiftet e tjera shtegore këmbehen shpesh ndërdhëmboret dh→th, në pozicion fundor. Kjo ndodh te kategoria e mbiemrit: SM 21, RV 32, ST 18, 32 (i, e) math së bashku me SM 60, RV 72, ST 50 (i, e) madh. Autorja nuk e shurdhon tingullin e zëshëm në P 297, F2 VI, XV (i, të) madh. Tek emri asnjanës prejmbiemëror shkruhen të dyja variantet vetëm në ST 233, 287 me të math krahas 150, 153 me të madh. Grafia me të madh është mbizotëruese në RV 47, 89 e në F2 XIX, XXVIII. Format e tjera të emërzuara të shquara dalin me të zëshmen: SM 3, ST 148 i madhi, SM 68 të madhin, RV 72 të madhit.

Fenomeni është më i përhapur te foljet kryesisht në pozicion fundor dhe, më rrallë, përkrah morfemave trajtëformuese, vetëm në SM: 21 heth, 46 u-hoth, 30 mbleth, 58 rrjeth, 36 rrjethtë krahas formave me të zëshme: 45 u-hodh, 28 hedh, 29 do të mbledhç. RV e ST nuk e regjistrojnë sepse leksemat e kësaj tipologjie (me -dh fundore) i nënshtrohen një ndërrimi tjetër fonetik: shtegorja dh zëvendësohet nga anësorja ll [AD, I: 91]: RV 26 holle 'hodhe', ST 68 holli, 63 hillnin, 64 hill, RV 89 të shurllonin, që nuk realizohet në SM. Nuk mungon dhe grafia me shtegore në RV 83 hodhi e ST 22 hidhte, sepse forma është përgjithësuar, si e shënon dhe P 300, F2 VIII hedh, P 299, F2 XIII hidhet (nuk haset e pakryera). Këtu shtohet edhe mbiemri të drellura në ST 160 (rast i vetëm) bashkë me 155 të dredhura, trajtë e stabilizuar. Kjo dukuri duhet të ketë qenë parësore në krahasim me shurdhimin dh→th, se nuk ka raste të alternimit th→ll.

Sporadik është ndonjë shembull emëror, si ST 61 llogë krahas 271 dhoga e ST 12, 13 perlletë 'perdet' bashkë me 12, 13 perdhetë. Nëse në rastin e parë, leksema dhogë është italianizëm 'doga' i ndërmjetësuar në shqipe nga gr. e re 'δόγα' [Meyer: 87], pra tingulli nistor është burimor; në rastin e dytë, huazimi turk perde nga 'perde' [Dizdari] këmben mbylltoren dhëmbore d me shtegoren ndërdhëmbore dh brenda gjuhës shqipe dhe, vetëm pas përfundimit së këtij fenomeni fonetik, ndërrohet akoma në anësore grykore ll. Në RV, vepra në mes, del vetëm 65 perden, 133 perdet, por Kokalari përdor vetëm perdhe në P 299. Në këtë grup radhitet folja ndez e mbiemri prejfoljor i,e ndezur: ST 62 qe llezur, 103 e llezur krahas ST 6 dhez, 100 e dhezur. Trajta dhez, e të njëjtit burim i.e. me ndez, është forma "e vjetër e primare e fjalës", mbizotëruese "në dialektet anësore të truallit shqiptar" [Çabej IV: 30] krahasuar me ndez, që pati epërsi në shqipe. Pra, leksema ndez perceptohet si një trajtë më moderne. Ndërrimi fonetik është i kufizuar vetëm në ST. SM (73 u-ndez) e RV (72 ndezim, ndezën) nuk e kanë. Autorja shënon vetëm trajtën ndez: P 299 të ndezura, F2 XXIV e ndezur. Domethënës në F2 XI është shpjegimi i leksemës dhez me variantin ndez.

Këmbimi i kundërt ll→dh është i pranishëm në foljen mbyll: ST 22, 276 mbidhte, 23 mbidhi, dhe në mbiemrin prejfoljor gjegjës: ST 20 të mbidhur. Khs. dhe ST 21 të mbadhoste, fjalë e tekstit narrativ që regjistrohet për t'u shpjeguar në F2 XXV, sigurisht pa dashje, me variantin ll: "Mballos (greq): arnoj". Statistikisht është zhvillim fonetik me kah të kundërt krahasuar me të folmen gjirokastrite.

Grupi bashkëtingëllor fundor -nd del në kategorinë e emrit, në trajtën e shquar: SM 7 vëndi, RV 65 vëndin dhe në numrin shumës: SM 23, ST 11, 19 vënde. Shurdhimi i dhëmbores në formën e pashquar, si në SM 23, ST 6 vënt, nuk është përgjithësuar, khs. SM 26, RV 15 vënd. Vetë Kokalari i përdor të dyja: F1 12 vënt e F2 XX vënd. Po kështu, SM 80, ST 11 funt bashkë me SM 68 (e) fundit, ST 12 fundi, siç duket qartë kur të dyja format regjistrohen

në të njëjtin togfjalësh: SM 15 në funt të fundit. Autorja ka vetëm F2 IV, VIII, XI fund. Fenomeni i shurdhimit ndodh në kartegorinë e foljes. Regjistrohet vetëm pozicion fundor absolut: SM 28, ST 22 u-gjënt; janë sonore format e tjera me mbaresë: SM 32 gjëndet, ST 156 gjënden, a me prapashtesë: SM 23 gjëndur. Të dyja variantet dalin te folja servile ST 263 munt e F2 XXVII mund, kjo e fundit është e idiolektit. Numërorët përgjithësisht e shurdhojnë dhëmboren e grupit në pozicion fundor absolut: SM 8 njëqint, 19 pesëqint, ST 7 diqint, 18 një qint. Ndeshen dy grafitë në SM 19, ST 156 nëntë e në RV 75, ST 56 nëndë. Në errata corrige në ST zëri nëndë (69) qortohet me formën nëntë (XLIV). Kokalari shënon nëntë në F2 XXVI. Këtu shtohet edhe ndajfolja sonde në RV 38 e sonte në ST 13, 104 e në tekstet e këngëve.

Qiellzorëzimi gj i grupit gl- [AD, I, 191], karakteristik toskë, vërehet tek emri gisht: RV 53, ST 18 gjisht, RV 19 gjishtin. Trajta ST 111 gisht qortohet me gjisht në errata corrige (XLV). F2 luhatet: regjistron në IV, XIII gjisht dhe në VIII: "gjashtë gishtre mëndafsh e katër gjishtre li". Citimi "Një gisht firë" në F2 XIII, marrë nga ST 35, është i gabuar, sepse teksti narrativ ka: një gjisht firë. Pra, mëdyshjet e realizimit të fjalës janë të Autores, jo të formës që përdorej rëndom.

Grupi -lk- në temën e fjalës nuk palatalizohet në -jk-: ST 27 ulkut, 49 ulku.

Dukuria e zhvillimit të tingullit homorganik -b- pas hundores dybuzore m te mbiemri i madh: RV 9, ST 79 e mbëdha, 157 të mbëdhenj, nuk është i pranishëm në veprën e parë, SM (15 të mëdhenj). Të dyja format shkruhen vetëm në RV (khs. 92, 104 e mëdhenj), ndërsa ST ka gjithmonë tingullin e shtuar. Vetë Kokalari ndjek grafinë mbidialektore të SM-së: P 297 e mëdha, 298 të mëdhenjtë. Konfirmon rregullën e RV-së, grafia e zërit 87 shtama, 88 shtamë krahas 85 shtamba.

Epentezën e një hundoreje e gjejmë në RV 25, ST 52 cingar për cigare. E ka dhe F2 XXVII cingar.

Bashkëtingëllorja shtegore faringale h del me epentezë te përemri vetvetor vete: SM 5, RV 35, ST 16, 19, 57 vehte dhe përdoret edhe nga Kokalari në F1 55 vehte, F2 XIV, vehten. Duhet thënë se në ST është po aq e përhapur edhe trajta pa epentezë: 6, 44, 191 vete. Nuk është e përgjithësuar prosteza e shtegores te folja arrij: RV 73 harritën, ST 52 hariti, e te emri F2 X hunazën. AD e jep "të rrëgjuar" [AD, I: 183] shqiptimin e shtegores faringale te folja shoh në të folmen gjirokastrite. Bjerrja e tingullit del në RV 26 Shi e në ST 14, 21, 26 she në pozicion fundor, por ndeshet dhe përkrah morfemës trajtëformuese (të vetës): ST 31, 189, 282 Shinin. Fenomeni nuk haset në SM (4, 14 sheh, 6 shihnim). Nuk mungojnë dhe format e plota në RV 40, 86 sheh, 67 shihni e në ST 160 shihnin. P 299 e F2 III kanë sheh: ky variant është mbizotërues.

Emri ahur është regjistruar vetëm me formën me metatezë: SM 7, ST 62 haur, RV 33 hauret, ST 28 haurit. Kështu mund të interpretohet trajta e ndajfoljes së vendit gjekët në SM 12, RV 40, ST 18, krahas formës mbizotëruese në toskërishte gjetkë [Çabej II: 22, IV: 324].

Së fundi, qoftë në tekstin narrativ qoftë në atë informues e argumentues ndeshen disa veçori fonetike, edhe pse jo të qenësishme, që dalin nga kuadri dialektor toskë. Përsa i përket vokalizmit, dihet se hundoret nuk ekzistojnë në toskërishte [AD, I: 88]. Dallimi themelor dhe i përgjithësuar i dy dialekteve kryesore, gegë e toskë, është prania e zanores a hundore të gegërishtes, së cilës i korrespondon e mesmja ë në toskërishte. Emri trëndafil (me ë etimologjike) i toskërishtes del Trandafilet në ST 15 e disa herë te këngët, e përdoret nga Kokalari: F2 XVI e trandafiles. Dhe leksema ëndje regjistrohet në SM 24, ST 15 Ta k' anda. Folja ënjt del F2 XIX qenë ajtur; mbiemri prejfoljor i ënjtur shënohet nga Autorja me trajtën pa nazalizim: F1 29 e ëjtur krahas trajtën me hundore: F2 XIV të ajtura. Folja ha paraqet tingullin a të formës përfaqësuese: SM 11 hangre, ST 21 hangri. Forma është përgjithësuar në F2:

XXXII hangri. Po kështu edhe folja (j)ap në ST 271 Nam (një çikë) për nëm 'jepmë', "urdhërore sekundare ndaj amë e ëmë/ëm" [Çabej II: 55].

Tjetër fenomen tipik gegë është ndërrimi i zanores ë në i te nyja joshquese: SM 61, 72, ST 5, 18 nji në krahasim me formën e përgjithësuar një në SM, RV e ST. Në RV nji nuk del.

Këmbimi i zanores së lartë i me y, dukuri tipike e gegërishtes [AD, I: 147] ndeshet në RV: 112 bylbil, 136 rryp, 140 rrypin, që konfirmon statusin e RV më afër një forme gjuhësore mbidialektore.

Fenomeni i rotacizmit [AD, I: 197] nuk respektohet nga Kokalari në shkrimin e emrit të qytetit Gjirokastër (khs. F2 VIII) që shënohet edhe me formën gege Gjinokastër (khs. F2 III, X, XX, XXXVII), pra zëvendësim i ndërgjegjshëm. Po kështu në F1 57 të tëhullunit (nga folja tëholl).

Reduktimi i grupit bashkëtingëllor mb→m regjistrohet në ST për foljen tremb: ST 272 tremte, 277 trëmte, dhe foljen dhemb: RV 5, ST 80 dhimte, 261 u-dhimnin. Dukuria nuk verifikohet në RV për foljen tremb (59, 107 u-tremb) dhe nuk i përket idiolektit të Autores: P 299 trëmbin, F2 XXVIII trembet; XXIII, XXXIX dhëmb. Ndërsa reduktimi i grupit nd→n te mbiemri i pakufishëm (sepse shoqëron një emër) nonjë në ST 45 për ndonjë, duhet interpretuar si gabim shtypi, nuk mund të jetë e tillë leksema: (për) kryeshënoshë, që del në F1 64 në vend të kryeshëndoshë. Ndajfolja ngadalë në SM 47, RV 34, ST 16, formë e vijueshme, shënohet krahas kadalë në SM 16, ST 22, tipike e gegërishtes.

Shembulli i fundit që e projekton menjëherë idiolektin drejt një forme mbidialektore janë variantet lidhëzore me dy sibilante -ss-, sipas traditës së konsoliduar grafike që fillon me Bardhin [Çabej VI: 148], F2 XXVII mbassi, e gegërishtes dhe XXXI passi, e toskërishtes.

Leksiku. Aspekti tjetër që i bën pa dyshim të vyera veprat e Kokalarit është pasuria e rrallë leksikore. Që në titullin e veprës Siç më thotë nënua plakë ndeshet një përdorim i veçantë i emrave të

farefisnisë, saqë Lambertzi, i lëkundur, e përkthen në dy mënyra togfjalëshin nënua plakë: alte Mutter 'nënë e vjetër' [Lambertz1 II: 267] e alte Grossmutter 'gjyshe e vjetër' [Lambertzi2: 85]. AD për Gjirokastrën jep gjyshe (sic) 'nëna e babait' [AD, II: 234]. Në tekstin narrativ togfjalëshi shkruhet ndaras e njësh, për të treguar kohezionin e nocionit të shprehur: RV 27 nënua plakë, 49 nënua-plakë, derisa sa e redukton ndajshtimin: RV 25, ST 24 nënua, RV 38 nënon, 88 e nënos, pra është leksemë e mjaftueshme për të treguar gjyshen. Morfema fundore -o e dallon qartë nga nëna 'mamaja': SM 23, RV 18, ST 6 nëna. Haset dhe zëri sinonimik: SM 21 nën-dajkua, RV 51 Nën-dajko, 56 Nëndajkua 'nëna e nënës' [ibid.: 238]. Gjyshja ndërkohë është dhe zonja e shtëpisë, në ST 136, 273 e madhja e në P 301 e madhja e shtëpisë; për nuset është SM 57, ST 198 katënxhika 'vjehrra'. Të rejat që hyjnë në shtëpinë e burrit, më shumë se një emër, kanë një rol. Quhen: RV 16 nuse-madhe, 26 Nuse madhe ose RV 66 Nuse-vogël; mungojnë format e shquara.

Për nipër e mbesa, gjyshi është RV 25, 36 baba-madhi, ST 24 baba-madh dhe pa vizë lidhëse: 206 e babamadhit. AD për Gjirokastrën jep gjish (sic) 'babai i babait' [ibid.: 236]. Nusja i nderon burrat e shtëpisë duke përdorur fjalën ST 276 çelo para emrit të përveçëm. Gruaja vetë burrin nuk e thërret: SM 25 erdhi ki 'burri', 65 i thashë dhe këtij 'burrit'. Familjarët e tjerë janë: SM 14 vëllesha 'e shoqja e vëllait'; SM 65, ST 9 xhiko, 49 xhikua e madhe, 232 Xhikua e re 'motra e burrit për nusen'; SM 22 xhaxhesha e RV 68, ST 135 teto 'gruaja e xhaxhait'; SM 36 Kanakar e RV 90 kanakaren 'djalë a vajzë e vetme, e përkëdhelur'; ST 275 motërmaja 'shoqja e ngushtë'. Si të familjes janë: ST 25 krushqarja 'shkuesja', që del me të njëjtën formë në P 298, dhe SM 6 bulla 'gruaja që shoqëron nusen te burri', që regjistrohet edhe në P 300. Vlerësime për zonjën e shtëpisë janë ST 5 Nikoqirja e SM 43, RV 42 kapetane 'grua e fortë'. Por cilësimet për femrat janë të shumëllojshme, nga ndjenja e keqardhjes për fatkeqësitë e kaluara deri te përçmimi e sharja: SM 78 buzë-plasur, ST 61 korba,

27 dit-shkurtër, 7 fatpadala, 26 golë-shtrëmbëta, SM 20 golëhapët, 11 qelbashe, morrashe, ST 29 zëmër-ngushtat, 235 bina-dala, SM 32 gomarja, 26 bushtër. Më i rrallë është përdorimi i figurshëm: ST 264 Si (sic) pëlqeu hanëmes. d.m.th. 'asaj që mbahej si zonjë' ose SM 7 zonjë-mëdha 'ato që e mbajnë veten si të tilla, kur janë shtatzënë'. Për meshkujt sharjet janë të kursyera: SM 9 zabërhan 'rrugaç', 62 Shtëpi-prishur, 75 Burrë-ziu 'jo i mirë', ST 129 turi der … Ogursuz. Duket qartë se gjithë këta apelativë krijojnë mjedisin gjirokastrit. Leksiku është vjelë gjerësisht prej tij.

Ndër leksemat tipike popullore të tekstit narrativ, që do të zëvendësohen më vonë në gjuhë nga lentime të reja, mund të përmendet latinizmi gaz: RV 125 Astrit gazi 'gëzimi që i jep ai', ST 20 për gaze 'gëzime, ngjarje të shënuara'. Kryesisht popullor është përdorimi i greqizmit komb: ST 28 një komb ujë 'një pikë' dhe 272 Një komb … në grikë 'një shtrëngim'. Po kështu, emrat kolektivë në vend të shumësit: ST 12 Burërija 'burrat', 24 graria, 202 Djelmuria. Janë sinonimike: ST 28, 75 njerëzia dhe SM 6, 16 bota 'njerëzit'. Kjo e fundit ndeshet me të njëjtin kuptim në P 300 (botës).

Ndonjë leksemë shpreh kuptimin origjinar, sot përgjithësisht i humbur. Kjo ndodh me fjalën jeta që del që në titullin e veprës ...sa u-tunt jeta (dhe në tekstin narrativ: ST 293) me kuptimin 'toka'. Më parë e ka shënuar De Rada te Këngët e Milosaos: Lis jeta kishë ndërruar. Në idiolekt Kokalari ka 'jetë' me kuptimin modern 'ekzistencë; jetesë' (khs. P 301 e F2 XXXIX). Një sqarim të shkurtër meriton titulli në ST, që fillon me të vogël: ...sa u-tunt jeta. Nuk është gabim shtypi. Kur «Revista letrare» [Tiranë, 14-2-1944: 7] lajmëron daljen së shpejti në qarkullim të librit, titulli i regjistruar është Dasma, vetëm më vonë, Autorja e ka ndryshuar atë, duke lënë edhe shkronjën e vogël nistore (...sa). Po kështu, leksema qelq del me kuptimin e hershëm gotë: RV 57 Qelqin, ST 15 qelq me ujë, ose përdoret si mbiemër cilësor '(mot) i kthjellët': ST 9 U-bë qelq, 10 grika e Tepelenës, qelq.

Teksti informues i shpjegon krahinorizmat e huazimet lokale me leksema mbidialektore. Janë të gjuhës së folur përcaktimet e harqeve kohore konvencionale, si emërtimet e muajve. Shënohet nga tradita bizantine: ST 58 të shëmitrit për F2 XXXIII tetor; ST 37 të allonarit për F2 III korrik; dhe nga ajo arabe: ST 97 zelikade shpjeguar në F2 XXXIX 'një nga muajtë e vjetit arab'. Dialektor është emërtimi i ditëve: SM 28 Njënatcaj (sic) për F1 28 parmbrëmë, SM 70, ST 49 Një ditëzaj për F2 X pardje, dhe i orëve të saj: ST 46, 69 Në nëndë të ditës për F2 XXVI ora tri mbas dreke. Këtu shtohet dhe koha e ngrënies: SM 70 bukë-darka, 77 bukë-drekën, RV 99 bukë darkën (ndaras).

Për kategorinë e mbiemrit vlen të përmenden mbiemrat e prejardhur me prapashtesat -të: ST 19 të dhoktë, 32 të xhevahirtë, 66 të kallamboqtë, dhe -or(e): 264 beharore, të cilët zëvendësojnë emrat nga janë formuar. I veçantë është cilësori ST 14 grumbullore, që shpjegohet në F2 XV e rrumbullaktë. Mbiemri i bardhë përdoret në tekstin narrativ kryesisht me kuptim karakteristik të ngjyrës, por edhe me atë të figurshëm 'i lumtur, fatmirë': SM 24 ditë të bardhë, ST 15 derë-bardhë. Emrat shkumë e zborë 'dëborë', kur e shoqërojnë, marrin kuptimin ndajfoljor 'shumë' dhe formojnë shkallën sipërore absolute: ST 195 e bardhë shkumë, 270 e bardha zborë. Mbiemri i zi del me kuptimin e figurshëm 'i shkretë': SM 45, 55 nëna e zezë, ST 24 Ajo e zezë, 48 fukaraja e zezë. Kur mbiemri shoqërohet nga emri pisë, ky i fundit ka kuptimin ndajfoljor 'shumë': SM 72 pisë i zi, ST 47 (leshrat) e zeza pisë. Kuptim të figurshëm kanë dhe mbiemra të tjerë: SM 34 kunata e ngarkuar 'shtatzënë', ST 234 si të qepura 'të mbyllur (nga gjumi)', SM 11, ST 267 derë e parë 'familje e mirë', ST 7 koll' e ligë 'tuberkuloz', 30 odan' e mirë 'dhoma e pritjes'.

Janë karakteristike dialektore foljet: ST 15 e pikëllon 'i hedh yndyrë', SM 40 qe goditur, ST 45 është goditur 'ujdisur (për gatesën)', ST 277 kish kulluar 'dobësuar', SM 28, RV 31, ST 11 kreu 'nxori', ST 8 na ndërto një filxhan kafe, 8 ndërtoi kafenë 'bëri kafenë', SM

5, 23 Ngreje nga mëndja 'hiqe', ST 61 ta lips 'ta dëboj'. Folja qëroj regjistrohet me kuptimin 'hap': ST 280 Grika e Tepelenës u-qërua, 9 Qielli u-qërua. Foljet gëzoj e qeveris i përdor dhe Kokalari me të njëjtin kuptim të tekstit narrativ: RV 56 I gëzoi leshrat, 112 i gëzoi flokët dhe P 301 ta gëzojë 'ta përkëdhelë, ta ledhatojë'; ST 7 dhe P 298 për të qeverisur 'për t'u kujdesur'. Folja vij, sipas kontekstit, tregon afrim te folësi: RV 15 erdhi përposh 'zbriti, i shkoi pranë', ose mbërritje në një vend larg folësit: RV 13 Kur erdhi tek dera, 13 Vjen edhe djali, ST 33 Erdhën 'shkuan, arritën atje'.

Për kategorinë e ndajfoljes mund të përmendet keq, në ST 27 Duhen keq, që del me kuptimin 'shumë'. Leksikalizim i pasthirrmës hë ndeshet në shprehjen ST 20 hë për hë, që përdoret me kuptim ndajfoljor 'tani për tani', ose në RV 100 hëni shpejt se erdha me kuptim foljor: 'lëvizni'.

Ndryshimi thelbësor tipologjik i tekstit narrativ me testin informues e argumentues e bën pothuajse të pamundur krahasimin leksikor, sepse funksioni i njësive leksikore nuk është i njëjtë. Megjithatë mund të vërehet si Kokalari në tekstin informues largohet nga gjuha e folur: ST 14 surat, fjalë e përgjithësuar në tekstin narrativ, regjistrohet fytyrën në F2 III; ST 156 llastikën shpjegohet me huazimin frëng biberon në F2 XXIV. Gjinia asnjanëse e tektit narrativ ST 10 të rit nuk përdoret nga Kokalari dhe shpjegohet me emrin kolektiv rininë në F2 XVII. Mbidialektor është shpjegimi huazimit turk ST 197 okllai me Petës, tërhollës (sic) në F2 XXVII. Ndonjëherë vetë Autorja ka vështirësi të përshkruajë, p.sh. shtrojën ose rrasat prej guri të hajateve, që i përkufizon F2 X me drasa prej guri, pra dhe dërrasë dhe gur, materiale që e përjashtojnë njëri-tjetrin (o dërrasë o gur). Në perceptimin e saj dërrasa kishte formë shtresore (pavarësisht lëndës përbërëse).

Fenomeni është më i dukshëm te huazimet. Lambertzi [Lambertz2: 103-7] përmend huazimet e shumta greke e turke në studimin e tij e, aty-këtu, ato italiane. Italishtja nuk ka ndikuar ndjeshëm të folmen

gjirokastrite. Shumë nga italianizmat, përgjithësisht të hershme, që dalin në tekstin narrativ të Kokalarit, janë regjistruar më parë nëpër fjalorë, artikuj revistash, vepra letrare, etj. [khs. Dashi] e në shumicën e rasteve kanë plotësuar mungesa leksikore të shqipes. Janë emërtime bimësh: ST 9 patate 'patata', 15 manxuranë 'maggiorana', 31 rizin 'riso'; pijesh: SM 47 kafe 'caffè'; sendesh të jetës së përditshme: ST 19, 155 bocë 'bozza' (venec.), 110 magje 'madia', RV 26, ST 20 kartë 'carta (lettera)', 8 i kartrave 'carte (da gioco)', RV 131 stivë 'stiva' (venec.), ST 264 mostër 'mostra'; petkash: SM 47, RV 134 fanellën, ST 5 fanella 'fanela' (venec.), 49 copë 'zopa' (venec.), RV 114 pecetë 'pezzetto', ST 94 cipun 'zipon' (venec.); njësish monetare (përdorur edhe për stoli): RV 118 lirat 'lira', ST 126 frangë, 263 franga 'franco', 137 kollonata 'colonnato', 204 ergjënd 'argento' [Çabej II: formë e rindërtuar nga latinizmi rgjand]; instrumentesh muzikore: ST 206 gërnetën 'cornetta', e aktivitetesh të tjera: SM 34 magji (fig.) 'magia', ST 109 muzika 'musica' 11 ta paguaje 'pagare'. Mënyra veshjes: ST 41 allafrënga (qepur), dhe e interpretimit të orës: 209 allaturka (sahati di i natës), kanë si element të parë alla- nga it. 'alla' nëpërmjet turq. ala. Interesant është lentimi i ri nga joli a dhjoli 'violino', huazim italian, me prapashtesën turke -xhi 'ai që ushtron një zeje': ST 206 jolixhinjtë 'ahengxhinjtë'.

Vetëm në idiolektin e Kokalarit, pra në tekstin informues e argumentues, ndeshen barbarizma italiane për mjedisin e banesës: F2 XXVI kuzinë 'cusina' (venec.); gatesat: F2 XIX biskote 'biscoto' (venec.), XXIX makarona 'macaron' (venec.); petkat e materialet: F2 VII napë 'nappa', XXXV i pantallonave 'pantalone'; V kastor 'castoro'; njësi matjeje: F2 IX metër 'metro', XXVI ora 'ora'; terminologji e aspekte të jetës shoqërore: F2 XXVII ekonomi 'economia', XXV model 'modello', P 301 fanatizmit 'fanatismo', 299 kontrate 'contratto', F1 63 intriga 'intrigo', P 302 familja 'famiglia', P 301 sakrificave 'sacrificio'. Mbiemrat: P 301 oriental 'orientale' e F2 XXIX elegant 'elegante'; folja: F2 XVII sakrifikoi 'sacrificare'.

Huazimet italiane që regjistrohen për herë të parë në tekstin narrativ janë ST 195 kalcat 'calza' dhe 122 dupje 'dopia' (venec.) Po kështu, futen së pari në tekstin informues: F2 XVIII asonancë 'assonanza' e XVI petales 'petalo'. Këto 4 leksema shënohen dhjetë vjet më vonë në FGJSH.

Shpesh huazimi italian, më i njohur, përdoret në tekstin informues për të shpjeguar një huazim grek a turk të tekstit narrativ: ST 86 skami (gr.) në F2 XXXII sqarohet me leksemën karrigë 'carega' o 'cariega' (venec.); ST 167 Texhara (turq.) në F2 XXXV me operator (kirurg) 'operatore'; SM 59, ST 24 hatëre (turq.) në F1 59 e F2 VIII me vizita 'visita'. Shpjegimet e zërave ST 49 sapima me stofë 'stoffa', në F2 XXXII, dhe ST 264 Samur (turq.) me peliçe 'pelliccia', në F2 V, bëhen me dy italianizma që Autorja fut për herë të parë në shqipe.

Në një rast të vetëm italianizmi i tekstit argumentues zëvendëson huazimin grek të tekstit narrativ: Kokalari zgjedh huazimin e hershëm venecian P 300 Rruga 'ruga' në vend të greqizmit ST 5 udhë. Ndërsa trajta ST 22 lejmon 'λεμόνι', 170 lejmua, formë e përgjithësuar në tekstin narrativ, nuk zëvendësohet me limon 'limone', që nuk del fare në vepër. Në ST 19 venecianizmi bocë shpjegohet me turqizmin shishe në F2 V, i përgjithësuar e mbizotërues në gjuhë.

Të rralla janë kalket nga italishtja. Tre i përkasin dialektit: RV 14 (nga) ndënë shkalla 'sottoscala'; 12 mos më humbasësh 'non perdermi' (folja humbas nuk përdoret me trajtë të shkurtër të përemrit vetor në shqipe) dhe SM 8 arritnë qiellin me dorë 'toccare il cielo con un dito'; dhe i fundit, i vetëm, është i idiolektit të Kokalarit: P 297 Duke mbaruar 'concludendo'.

Si përfundim, veprat e Musine Kokalarit i kalojnë pa dyshim caqet e një krijimi thjesht letrar, sepse përbëjnë një makrostrukturë të artikuluar në tri mikrostruktura: teksti narrativ, teksti informues dhe teksti argumentues. Veçantia qëndron në faktin se hartimi i këtyre tri teksteve është bërë në dy variante gjuhësore: teksti narrativ në gjuhën-dialekt, teksti informues e argumentues në gjuhën-idiolekt.

Rrugëtimi është nga idiolekti te dialekti, jo e kundërta. Arsyeja është autobiografike. Idiolekti i Kokalarit ka për bazë të folmen gjirokastrite, gjuhën e nënës. Kur botohen përmbledhjet me tregime, gjuha e nënës, pa u zvetënuar, ishte lëvruar e pasuruar natyrshëm në bankat e shkollës në Tiranë, me leximet personale e gjatë studimeve universitare jashtë shtetit dhe ishte shndërruar në një variant gjuhësor mbidialektor, pra idiolekt letrar erudit. Kokalari zgjedh ta 'mbështjellë' gjuhën e vet të përpunuar me veshjen dialektore gjirokastrite, si e dinte dhe si e kujtonte, për ta rrëfyer qytetin e lindjes në mënyrë më të efektshme e të besueshme. Kjo ka bërë që shpesh idiolekti mbidialektor t'i mbivendoset pavetëdijshëm artificit gjuhësor gjirokastrit që Autorja vetë kishte krijuar.

Ky qëndrim gjuhësor 'jobesnik' i Kokalarit i jep së folmes gjirokastrite statusin e gjuhës së shkruar, pra mundëson kalimin nga tradita gojore te teksti letrar i përpunuar. Dhe me të vërtetë, ky hulumtim krahasues i veprës letrare të Shkrimtares me traditën gjuhësore gjirokastrite, krahas karakteristikave fonetike të përbashkëta, ka nxjerrë në pah dukuri të veçanta që nuk regjistrohen në Atlasin dialektologjik e në studimin e Totonit. Tipologjia tekstuale narrative i jep dorë Autores të kridhet në leksikun dialektor, por nuk mungojnë dhe shembujt e bjerrjes së krahinorizmave, falë përdorimit të lentimeve moderne dhe të huazimeve të nevojshme mbarëgjuhësore.

Idiolekti letrar erudit i Musine Kokalarit, me tiparet gjuhësore të përgjithësuara, edhe pse jo të qëndrueshme për shkak të ndërndikimeve përgjithësisht fonetike e morfologjike, por edhe sintaksore e leksikore të të folmeve dialektore, është dëshmi e modernizimit të gjuhës shqipe dhe e letrarishtes që po kristalizohej në kapërcyell të viteve '40.

Bibliografi, shkurtime e shkurtesa

AD = Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe, I-II, Akad. e Shkencave e Shqipërisë, Napoli 2007 (I), 2008 (II).

Çabej = Çabej E., Studime etimologjike në fushë të shqipes, Tiranë, II/1976; IV/1996; VI/2002.

Dashi B., Italianismi nella lingua albanese, Roma 2013.

Dizdari T. N., Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Tiranë 2005.

F1 = Kokalari M., Fjalor te Siç më thotë nënua plakë.

F2 = Kokalari M., Fjalor' i librit te ...sa u tund jeta.

FGJSH = Fjalor i gjuhës shqipe, Instituti i Shkencavet, Sekcioni i Gjuhës e i Letërsisë, Tiranë 1954.

Lala L., Tipi di testo, Il Vocabolario Treccani. Enciclopedia dell'italiano, II, Roma 2011: 1490-1495.

Lambertz1 M., Grammatik und albanische Texte, I-II, Leipzig 1948. Botohen: Mos qofshin vjehrat e zeza, Kulloi odaja, Për mustaqet e Çelos, Ulurima e qenit, I: 328-39 (shqip); II: 254-71 (gjermanisht).

Lambertz2 M., Zur albanischen Umgangssprache, «Lingua Posnaniensis», VII, 1958: 85-144.

Leotti A., Dizionario albanese-italiano, Istituto per l'Europa Orientale, Roma 1937.

Meyer G., Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache, Strassburg 1891.

P = Kokalari M., Duke mbaruar..., Pasthënie në ...sa u tund jeta.

RV = Kokalari M., Reth vatrës, Tiranë 1944.

SM = Kokalari M., Siç më thotë nënua plakë, Tiranë 1939.

ST = Kokalari M., ...sa u tund jeta, Tiranë 1944.

Totoni M., Vëzhgime rreth së folmes së qytetit të Gjirokastrës, «Studime filologjike», 1, Tiranë 1966: 77-119.

Visaret e Kombit, III-IV, Tiranë 1937-1939.

Abstract

This study aims to compare the literary work of Musine Kokalari with the way of speaking of Gjirokastër. The phonetic phenomena and the lexicon analyzed highlight the concordances and differences between the written language and oral tradition. The dialect and idiolect are conditioned by the Author's intellectual stature.

Prof. As. Mimoza Zekaj
Universiteti i Gjirokastrës

Vlera e leksikut dialektor e krahinor në krijimtarinë e Musine Kokalarit

Vepra e Musine Kokalarit shpalos vlera të rëndësishme letrare, etnografike, por edhe vlera të mirëfillta gjuhësore. Ajo është shkruar në një toskërishte me tipare dalluese të së folmes së qytetit të saj, Gjirokastrës. Dallohet për një gjuhë të qartë, të rrjedhshme, pa ngarkesa e ndërlikime, një gjuhë e thjeshtë dhe e kuptueshme e bisedave të përditshme, që ngjan si e regjistruar nga subjekte konkrete. Autorja është bartëse dhe njohëse e shkëlqyer e kësaj idiome, prandaj dhe ka ditur ta përdorë atë bukur në vepër. Personazhet e saj ngjajnë mjaft të natyrshme, prandaj dhe gjuha e tyre është natyrore. Zgjedhja e gjuhës natyrore ishte një hap i guximshëm, sepse kërkonte shumë aftësi për ta shprehur atë[1].

Thithja e leksikut dialektor të nevojshëm në gjuhën e shkruar, në variantet letrare me bazë dialektore, në gjuhën letrare kombëtare dhe në letërsinë artistike kanë qenë një proces gjithnjë i gjallë[2].

1 Dhima, Th., "Veçori sintaksore në veprën e Musine Kokalarit", në *Çështje të sintaksës së gjuhës shqipe, Infbotues*, Tiranë, 2013, f. 202
2 Thomai, J., *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Pegi, Tiranë, 2001, f. 165

Dialektalizmat dhe krahinorizmat kanë shërbyer jo vetëm si mjete tipizuese, por na ndihmojnë edhe për karakterizimin e stilit të autorit.

Në larminë e strukturave leksikore që zgjedh dhe përdor shkrimtarja, vërejmë se larminë më të madhe në përdorim e kanë dialektalizmat e krahinorizmat. Nga pikëpamja sasiore, vërejmë se dialektalizmat e krahinorizmat shfaqen më së shumti në vëllimin *Siç më thotë nënua plakë* dhe në vëllimin …*sa u tunt jeta*, ndërsa te përmbledhja me përralla *Reth vatrës*, të cilën e ka shkruar me regjistrin e toskërishtes letrare, ky numër është më i vogël. Përdorimi mjeshtëror i tyre ka krijuar ngjyresën krahinore të Toskërishtes jugore, veçanërisht, të trevave të Gjirokastrës.

Dialektalizmat, krahinorizmat, fjalët e pafundme të përdorimit të përditshëm, kanë mundësuar jo vetëm pasqyrimin me vërtetësi e mjeshtëri të realitetit, por paraqesin edhe vlerësimet emocionale të përdorura nga shkrimtarja, pra, përmbajnë vlera njohëse, përshkruese, vlerësuese, diferencuese. Dialektalizmat e krahinorizmat, pavarësisht nëse janë njësi leksikore apo trajta fjalësh, mbajnë peshën e tyre në profilizimin e veprës së autores. Në studimet e sotme gjuhësore, duke iu afruar gurrës dialektore, janë bërë shtresëzime të ndryshme të këtij leksiku. Duke u mbështetur në këtë këndvështrim, pasurinë leksikore të prozës së Musine Kokalarit mund ta grupojmë:

1. Fjalë që përdoren vetëm në dialektin e toskërishtes apo në të folmen e Gjirokastrës, si: mëhallë, kosë, skupë, pisus, nisël, ballgam, kucur, frangale, hudhim, gavo, frito, godo, kahar, Babazot, nëndivan, barbadho, bus, brobodho, agojat, cukunidhë, çapar, katënxhikë, rokan, patiqe, kokallë, dhams, feks, nakar, gërnjë, pocaqi, sufra, tartakut, xurxull, xhiva etj[3].

2. Fjalë që edhe në shqipen e sotme janë dialektore, si: kumbisem, anavas, torvë, qollopite, mbodhisem, kësodh, hashari, drënjë, munxë,

3 Shembujt e përdorur në këtë punim i kemi marrë nga tri veprat origjinale të autores, si: *Siç më thotë nënua plakë*, Gutenberg, Tiranë, 1939; *...sa u- tunt jeta*, Mesagjeritë Shqiptare, 1944; *Reth vatrës*, Mesagjeritë Shqiptare, 1944

pilivri, skupë, xarbë, peronë, okllai, avlëmënt, tumane, mënoj, këna, avli, dhokan, beden, dhogë etj.

3. Fjalë dialektore të cilat autorja i ka zgjedhur dhe i përdor për karakterizimin e personazheve, identifikimin gjuhësor të tyre, për lokalizimin dhe aktualizimin e ngjarjeve. Në rrjedhën e këtij klasifikimi duhen veçuar dialektalizmat kuptimorë, të cilët, duke u përdorur me mjeshtëri nga autorja, i japin prozës ngjyresa stilistiko-gjuhësore të dukshme. Ana semantike e tyre shfaqet në kontekstin e përdorur. Po rendisim disa dialektalizma kuptimorë që janë përdorur në përmbledhjen *Siç më thotë nënua plakë*: mos më shkul zorët (mos më mërzit); ju prishmë hundën (ju ulëm krenarinë); ngreje nga mëndja (haroje); veçse të palastriteç me të vegjëlit (të zihesh me të vegjëlit); se si do t'i qeverisi nuk e di (se si do të kujdeset); pas mortjes u-ngul fare (pas fatkeqësisë nuk lëviz fare); fut fite andej fut fite këndej (trazojnë të gjithë); thiej gjishtëret (nxitohu); është një grua e leshtë (grua me zakone) etj.

Dialektalizma kuptimorë autorja ka përdorur edhe te përmbledhja …*sa u-tunt jeta*, por edhe këtu të markuara me ngjyresë stilistiko-gjuhësore të madhe. Ja disa prej tyre: Teto Qibrua maçalisi fjalën (e vonoi përgjigjen); shkretëtirat, që bëjnë munxur nga të gjitha anët (pulat që bëjnë pis…); vajzën e zuri mirë (e fejoi mirë); e madhja bëri jashtëlinat (punët jashtë shtëpisë); qe prerë nga surati (ishte shqetësuar); i shkulën që të rinin për darkë (i mbajtën për darkë me shumë dëshirë); i pi të gjalla po ti gjejë një çikë në dritare (i ndëshkon); sarajn me djelm e mbulofç (sa më shumë djem) etj.

Me vlerë stilistikore të theksuar autorja ka përdorur disa dialektalizma kuptimorë edhe te përmbledhja me përralla *Reth vatrës,* si: I gëzoi leshrat dhe e uli në pëqitë e saj (e ledhatoi); qelqin e parë, ashtu edhe të ditin (gotën e rakisë); e preu fjalën teto Lalea se u lodh (ndaloi) etj.

Autorja ka treguar kujdes në përzgjedhjen e fondit leksikor, që t'i shkojë për shtat qëllimit të zgjedhur prej saj. Si rrugë kryesore

ka zgjedhur riaktivizimin e fjalëve që kishin një status nga tradita vendase apo e huaj. Të marra nga sfera të ndryshme të jetës e të mendimit fjalët dalin shumëvalente, si pasojë e lidhjeve të reja që krijojnë, duke u përdorur në kontekste të ndryshme, sepse forca e fjalës…nuk qëndron në kuptimin e drejtpërdrejtë leksikor të tyre, por në ato marrëdhënie asociative ose tek aureola emocionale që u jep atyre konteksti në të cilin përdoren[4].

Të gjitha subjektet e prozave të Musinesë zhvillohen brenda katër mureve të shtëpisë, në dhomën e zjarrit, në oda, në avlli dhe më rrallë në sokakun e shtëpisë. Institucioni më i rëndësishëm në të cilin zhvillohen shumica e ngjarjeve është shtëpia dhe familja,.... njerëzit që jetojnë në të, pra shtëpia dhe nënua janë shndërruar në dy kulme që organizojnë prozën e saj. Të gjitha këto rrethana e të tjera kanë kushtëzuar në mënyra të ndryshme mbështetjen e madhe të autores te e folmja e qytetit të saj, në mbushjen e leksikut të përdorur me fjalë e shprehje popullore, ku vendin kryesor e zë leksiku dialektor i toskërishtes jugore.

Duke kundruar leksikun dialektor e krahinor të përdorur nga autorja, i cili dhe nga pikëpamja sasiore zë vendin më të madh, dallojmë disa klasa e grupe fjalësh, të cilat na zbulojnë të gjitha veçoritë e leksikut të shkrimtares.

1. Në leksikun dialektor të prozës së M. Kokalarit hyjnë shumë fjalë që i takojnë ligjërimit bisedor, ligjërimit të thjeshtë të qytetit, ligjërimit të përditshëm. Duke u nisur nga prania ose mosprania e tyre në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, dallojmë këto shtresëzime:

a. shtresa e emrave, mbiemrave, emërtimeve të tjera që përdoren në ligjërimin bisedor, si: haber, i kselhasur, fukara, anagulë, hoshaf, jaurt, kallaballëk, kusur, sepete, sokakak, prokopi, rezil, tabiat, honeps, i limaksur, avaz, palo, hashari, sevda, tabiat, protare.

b. shtresa e emrave dhe mbiemrave që përdoren në ligjërimin e

4 Bulo, J., *Tipologjia e lirikës së Naim Frashërit*, Shkenca, Tiranë, 1999, f. 108

thjeshtë, si: zullape, azate, axhami, berdu, bus, dhams e feks, pingël, pilivri e tërë, bulla, nisëlë, zabërhan, gavo, tëllësëm, barballo, zuskë.

c. shtresa e emrave dhe mbiemrave të vjetëruar, si: nigjah, mexhite, jaran, tertip, sarëk, mekam, heqim, selam, xherah, saraj, agojat, pataja, shart, xhore, hashari.

d. shtresa e emërtimeve të tjera që kanë hyrë te përdorimet më të përgjithshme, si: uratë, sufra, imam, aga, effendi, haste, jongar, kabuni, anteri, dollma, hapës, mazi, merxhane, hejbe.

e. shtresa e emrave, mbiemrave, emërtimeve të tjera që janë të pranishme në të folmen e Gjirokastrës, si: gjidi, hergjele, fildikoz, hasube, but, elbeze, isqi, imza, hyqmet, kadimi, juk, meqeme, kulupi, kail, kahar, samur, pirpiri, shart, sade, shamaturë, zhiva, tapaxha, taraba.

2. Nga pikëpamja sasiore, më të shumtë në numër janë dialektalizmat emërorë, pastaj ata foljorë dhe më pak ata mbiemërorë.

a. Te dialektalizmat emërorë që janë më të shumtë në numër, mbisundojnë fjalët e thjeshta, disa fjalë të prejardhura, shumica me prapashtesim, disa fjalë të përbëra, të cilat, më shpesh, kanë karakter të përgjithshëm. Ja disa prej dialektalizmave emërorë, pavarësisht strukturës së tyre: nikoqirllëqe, babamadhi, nisël, tëllësimi, zabërhan, gavo, torvën, mëhalesë, kahar, mësallë, buqicë, haps, turitë, luhare, shamata, anteri, toze, fiti, hajli, koqinall, sqafill, gjulaki, dhiple, kombolizon, cimbill, stanero, fanero, qifqi, davet, sufra-beze etj.

b. Dialektalizmat mbiemërorë, megjithëse më të paktë në numër se dialektalizmat e tjerë, kanë po ato veçori që kanë edhe mbiemrat në gjuhën standarde dhe dalin të nyjshëm apo të panyjshëm. Shumica prej tyre janë fjalë të thjeshta, më pak të prejardhura dhe një pjesë e vogël e tyre dalin kompozita. Shumica e mbiemrave dalin të markuar nga ana stilistikore në përdorime të caktuara. Ja disa prej tyre: nikoqire, gjuhustër, qelbashe, morrashe, e fisme, budalluçkë, i xhindosur, lajkurizma-madhja, e pakallur, verkollaka, kapetane, kacidhjare, godo, reçka, xhamalle, gajtanesë, perishanesë, e kselhasur,

gojëmjaltë, derëbardhë etj. Një pjesë e vogël e tyre në disa përdorime dalin edhe si emra, si: verkollaka, kacidhjare, kapetane, thatime.

c. Dialektalizmat foljorë dalin të paktë në numër. Duke u nisur nga struktura e tyre, shumica prej tyre janë fjalë të thjeshta dhe një numër i vogël janë fjalë të prejardhura, si: mbars, ndes, palastrit, dëfto, shahtis, vuvos, pleks, daramatis, qeveris, çqit, çirn, lips, mënoj, feks, rresht, shtip, sëmboi, nxiros, lukuris, munxos, hamuli, prëhem, xërmo, karkallos, damllos, asdis, katandis, ngos, kumbis, nasqiris, maçalis, mballos, tiliks, potis, ormiz, mollois, çakërdis etj.

Në këtë drejtim, rol ka luajtur edhe frazeologjia, por më të dukshme ato njësi që kanë origjinë dialektore, sepse në të më shumë se në fjalët e veçanta shfaqet veçoria kombëtare e gjuhës, historia e zhvillimit të saj[5]. Frazeologjia, e jashtëzakonshme dhe e admirueshme në numër, është ajo që përfundimisht e ngjyros "gjirokastritisht" ligjërimin artistik të veprës së M. Kokalarit[6]. Këto njësi autorja i ka përdorur me shumë mjeshtëri, duke i parë si një pasuri e pazëvendësueshme, të cilat ia ka dhuruar jo vetëm e folmja e Gjirokastrës, por edhe qëllimi që i ka vënë vetes për ta bërë krijimtarinë e saj pasqyruese të gurës së pashtershme popullore. Në këtë vështrim, kemi vënë re se autorja ka përdorur edhe njësi frazeologjike me përbërje leksikore tërësisht nga e folmja e Gjirokastrës dhe më gjerë nga e folmja e toskërishtes jugore, madje edhe elemente arkaike, si: mësallë me di faqe; e kanë mënden malë fikut; më rokanis kokën; ngreje nga mëndja; s'më hiri gjim në sy; i flet gola para mëndes; është xhuxhullja; e gjeta odën citë; i flin fati në kamare; ju bë kismet etj. Të gjitha njësitë frazeologjike dhe më shumë kjo shtresë, janë pasqyruese edhe të anës historike, sociolinguistike, psikolinguistike, etnolinguistike të shoqërisë shqiptare të asaj periudhe në përgjithësi dhe të komunitetit gjirokastrit në veçanti.

5 Thomai, J., *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe,* Akademia e Shkencave e RSH, Tiranë, 1981, f. 274

6 Memisha, V., *"Veçori të shenjimit gjuhësor urban në veprën e Musine Kokalarit"*, në "Studime për fjalën shqipe", Botart, Tiranë, 2011, f. 244

Duke vërejtur përdorimin e leksikut dialektor në prozën e shkrimtares, vëmë re se ky leksik është përdorur jo vetëm me funksione stilistike, por edhe me funksione shënuese, si leksik asnjanës. Fjalët që emërtojnë fushat konceptore, veçanërisht fushën etnografike, megjithëse stilistikisht janë asnjanëse, marrin një vlerë të veçantë, sepse na përforcojnë vendin ku autorja ka vendosur ngjarjet. Mendojmë që ky përdorim ka ndikuar edhe në zvogëlimin e madh të dallimit midis gjuhës së personazheve dhe gjuhës së autores, sepse të dy palët e përdorin gjerësisht leksikun dialektor, madje edhe të njëjtat fjalë dialektore.

Duke u nisur nga fushat konceptore, më e pasur me dialektalizma është fusha e etnografisë dhe në mënyrë të individualizuar janë:

- fusha konceptore e fjalëve që emërtojnë veshjet, veçanërisht veshjet e dhëndrit dhe të nuses, si dhe mjetet e përdorura nga nusja dhe dhëndri, si: duvak, bezelik, boshta, ferexhe, futa, jemeni, pazen, pallto, koqinall, sade, unazë, tantellë, sqafill, benevrek, dizbai, fanellë, xhamadan, qostek, gajtan, fërmëlë etj.

- fusha konceptore e fjalëve që emërtojnë gatimet në përgjithësi dhe ato që bëhen në dasmë: karkanaqe, bakllava, byrek, muhalebi, petë, sherbet, llokume, meze, çorbë etj.

- fusha konceptore e fjalëve që emërtojnë mjetet që përdoren për gatim, si: sahan tepsi, lugë, tenxhere, okllai, qeret, luhare, tepsi, sini etj.

- fusha konceptore e fjalëve që emërtojnë shtresat që përdoren në ditët e zakonshme dhe në ditët e festave, si: mësallë, minder, makat, çilte, sufrabeze, meslë, çulle etj.

- fusha konceptore e fjalëve që emërtojnë mjedisin e jashtëm: portë, sokak, parmak, portë me dy sufa, prag, avlli etj.

- fusha konceptore e fjalëve që emërton mjedisin e brendshëm, veçanërisht mjedisin ku zhvillohet dasma: oda e burrave, oda e grave, oda e zjarrit, oda e krushkave, kreu i shkallës, kreu i odasë, nëndivani, pati, skami, shkallët etj.

Nga ana tjetër përdorimi i dialektalizmave si nga shkrimtarja dhe nga personazhet, ka shërbyer më shumë për lokalizimin vendor e kohor, sesa për karakterizimin e gjuhës së personazheve[7]. Në këtë drejtim rol ka luajtur edhe sintaksa popullore. P.sh.: "Lermë Ruho të sos fjalën" dhe i ra në kraha. "Është një vajzë, për kokë të vajzës. Njeri s'e ka. Ç'ta shoç, si drita. Ka di kosa nga prapa, ashër e pisë të zeza…Surat grumbullore. Ka di të shkreta faqe, që s'i shuhen. E bardh' e kuqe. Punon, se nëna s'i ka dhënë ditë të bardhë. I ha mishtë. Hullon e pikëllon (bën byreqe) si një plakë…Me palë e me roba që, sa të rojë, nuk do ti bëç gjë. Sepetet për t'i vënë gjunë…" dhe zuri të dilte…(S'ja., f.15).

Pasuria leksikore është e lidhur jo vetëm me rrethanat shoqërore, jetësore e gjeografike të vendlindjes së prindërve të autores, por në prozën e saj Musineja ndjek udhën e disa tregimtarëve të tjerë shqiptarë, të cilët e përshkruajnë botën shpirtërore, zakonet, prirjet, veprimtarinë e personazheve, pra gjithçka, duke u mbështetur te e folmja krahinore e dialektore.

Për të karakterizuar modelin ligjërimor të M. Kokalarit, mund të heqim një paralele midis gjuhës së M. Kutelit, karakterizuar shumë drejt nga akademiku J. Bulo dhe gjuhës së M. Kokalarit. Në bashkëjetesën e gjatë të gjuhës bisedore dhe të prozës popullore me fjalën e kultivuar, kjo e fundit u gjend më afër se kurrë me të parën në rrëfenjat e Kutelit, i cili rigjallëroi dhe riaktivizoi gjithë arsenalin dhe potencialin e shqipes popullore, jo thjesht dhe jo vetëm pasurinë leksikore dhe frazeologjike ose variantet idiomatike, por në radhë të parë shpirtin dhe frymën e saj, lehtësinë e ndërtimeve të çlirëta dhe të shpenguara, thjeshtësinë e ligjërimit dhe lehtësinë e kalimit nga rrafshi përshkrimor-tregimtar në rrafshin dialogjik, muzikalitetin dhe larminë e toneve të thjeshtëligjërimit popullor…Për të mos u shtyrë më tej në autorë të tjerë, mund të thuhet se modeli ligjërimor i prozës

7 Thomai, J., *vepër e cituar*, f. 143

së tyre nuk është dialekti, në kuptimin e ngushtë të fjalës, por gjallëria e gjuhës së folur[8].

M. Kokalari është njohëse dhe lëvruese e talentuar e leksikut popullor, veçanërisht e të folmes vendore së Gjrokastrës, duke u bërë një nga përfaqësueset më dinjitoze të kësaj të folmeje, madje edhe duke e patur si qëllim në vetvete. Krijimtaria e saj, kryesisht proza me tregime dhe skica të shkurtra, mbart vlera origjinale, të ngarkuara me mesazhe të drejtpërdrejta, më shumë në gjuhën e personazheve, që në disa raste e ndërthurur me gjuhën e saj, del si organizuese kryesore e rrëfimit.

8 Bulo, J.., "Tipi i ligjërimit popullor në prozën shqipe dhe idioma dialektore", në *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, Dituria, Tiranë, 1998, f. 37

KONTRIBUTE TË TJERA

PËR FIGURËN E MUSINE KOKALARIT

Parid Teferiçi

Kuraja e arsyes

Çfarë tha kjo grua e re dhe e bukur? Dhe çfarë na thotë sot kjo foto e saj pas mikrofonit? Nuk është një këngëtare apo aktore: publiku e ndjek pas shpine, i tëri i krekosur në uniformat e veta të reja dhe i gatshëm, pas çdo fjalie të saj, të çohet me çirrmat "Në litar!". Një vit e ca pas luftës gjendemi në një gjyq ushtarak. "Drejtësia ushtarake ka lidhje me drejtësinë po aq sa muzika ushtarake me muzikën" thotë Marksi. Jo Karli, por Grouço i vëllezërve Marks. Ajo është shkrimtarja e parë shqiptare, përballë trupit gjykues.Vetëm njëzet e tetë vjeçe, ajo është më e shkolluara në atë sallë, njeh disa gjuhë të huaja, di të pikturojë dhe të luajë në piano, ka themeluar një parti, ka botuar tre libra, ka shkruar të tjerë dhe ka lexuar më shumë se të gjithë të pranishmit bashkë. Madje e njeh marksizmin më mirë sesa komunistët që kanë vendosur ta dënojnë. Shkurt, ajo është shëmbëlltyrë e qytetërimit dhe e pasionit për të qytetëruar. Faji i saj? Mendon ndryshe nga komunistët. Sepse ajo mendon vetë dhe thotë vetëm ato që mendon. Skandaloze! Për të mos rrezikuar të mendonin ndryshe nga Partia, 'trimat' shqiptarë zgjodhën të mos mendojnë. Sepse trimat janë të marrë dhe kuraja nuk ka lidhje me arsyen. Sepse mendja peshon dhe trimat duhet ta mbajnë 'kokën lart'. Sepse trimat 'marrin gjak në vetull' por nuk duan kokëçarje. Sepse trimat "therin djalën kur japin fjalën", ndaj e kyçin gojën. Sepse trimat 'kanë fëmijë për të rritur' dhe nuk duan telashe me qeverinë. Ky është "banaliteti i së keqes" sonë, që e bëri këtë popull, i cili strehoi dezertorët italianë pas kapitullimit dhe nuk dorëzoi asnjë hebre tek nazistët, t'i vërsulej më pas mizorisht çdo shqiptari që dyshohej se mendonte ndryshe.

Nuk jemi çliruar nga ai banalitet. Jo, nuk na bëri të tillë Enveri; por meqë jemi të tillë ne ndjekim Enverët dhe përndjekim Musinetë. Duhet të ndryshojmë. Duhet të mendojmë. Gjendemi ende në atë sallë, prapa krahëve të saj, dhe nga ai mikrofon na buçasin, sot më fort se kurrë, fjalë mbi dinjitetin dhe kurajën, kurajën e arsyes. Nuk i dëgjon?

BOTA E RE

iti i I-rë — Nr. 1. || E përjavëshme politike e letrare — Drejtor: **Nebil Çika** || 30 Korrik 1940-XVIII

Musine Kokalari:

Siç më thotë nënua plakë

Është një dhuratë e thjeshtë që na jep zonjusha Kokolari, sapo e dalë pothuajse nga bankat e Institutit të Tiranës. Sapo e dalë. Sepse vepra në vetëvete paraqitet jo si një provë shkollore e klasave të larta, jo si një shëmbëll zotësije, si një hartim që ka fituar çmimin e parë, — ajo përmban së-kundrazi mê pak dhe mê shumë se kaq. Mê pak sepse ka mungesat e veta, të papranuarshme në një konkurs letrar të nxënëseve të shkollës së mesme; mê shumë, sepse na çfaqet, me këtë përjashtim, nënë kushtin e domosdoshmë të artit që domethënë krijim.

Librëza e z-shës Kokolari është pra një krijim origjinal, dhe si i tillë meriton të heqë për një shënim vërrejtjen t'onë.

Krijim origjinal? Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë me fjalë të thjeshtë, të pangatërruar, me fjalë drjet për drejt siç është jeta vetë, se autoresha e këtyre skicave rastore e ka zënë jetën mu në mezin e saj, në momentin kritik që është momenti i math i çdo manifestimi të jetës njerëzore, që përmbleth edhe çfaq, në një pikë tërësije, gjithë kuptimin e vërtetë të jetës të çfaqur rastësisht. Zënia e jetës, kapja e menjëherëshme e saj në fond dhe në formë dhe çfaqja imediate, pa asnjë ndërmjetësim, me anën e artit, kjo është origjinalitet — origjinalitet letrar. Nënë mprojtjen e kësaj cilësije, që është cilësija e parë e çdo vepre shkrimi për të dëfryer shpirtin, qëndron siç thamë libra e shkrimtares s'onë. Ky karakter, cilësija e origjinalitetit të kapur shpejtazi dhe mu në thelb të zhvillimit psikologjik të jetës, sjell me vete dhe pikë-së-pari të metën e vet, si drita që sjell pás hijen. Përshtypja e efektit kryesor i ka mënjanuar hollësirat rrethonjëse, që janë siç kuptohet vetvetiu hollësira forme, çështje trajtimi të përjashtëm. kujdes me durim i gjithë atyre ndërtimeve, drejtpeshimeve dhe kundërpeshimeve të fjalës dhe të frazës, të cilave nuk i-a-u vuri dhe aq shumë veshin në shkollë, për hir të punës kryesore: origjinalitetit.

Dhe kështu vijmë tashi në gjënë që na intereson mê shumë për këtë shënim, në meritat artistike të shkrimtares së re shqiptare. Ato janë një virtut i pamohuarshëm i saj, ku mund të kënaqet me të vërtet nevoja jonë për një shijim estetik të plotshëm, ku gjejmë, si në bërthamë, premtimin e heshtur të shvillimit të mêpastajmë të atyreve që ajo mundet të na japë në kohën e duhur. Me sa vërrejtje të përpiktë, plot gjallësi dhe plot freskësi, janë zënë këto miniatura të Musine Kokolares! Të thuash, si të kish këputur një copë të gjallë të jetës, një pjesë që rron me vetëvete gjithë jetën e organizmit shoqëror, një fragment që përfaqëson origjinalin dyke e përmbledhur. Janë skica këto, me një intuim psikologjik të math. Ato s'venë, siç do t'i detyronte lloji i tyre, rrugës në gjërësi. Nuk çikin, nuk prekin vetëm. Nuk i afrohen sipërfaqes vetëm, për t'a relevuar me një ngjyrë të lehtë, me një efekt pamjeje të çasit. Nuk përdorin frymën, as humorin, as ironinë ose sarkazmin e tharbët, të shkurtër, të një lloji letrar me qëllim dhe ekspresivitet të përcipshëm siç janë skicat nga natura e tyre. Nuk mbajnë, me fjalë të tjera, distancën subiektive të autorit kundrejt motivit që tratojnë. Musine Kokolari hyn në thellësi drejtpërdrejt në thelbin psikologjik. Me-një-herë, ajo bashkëjeton me atë që na rrëfen. Nuk tall as nuk qesh përciptas, nuk vajton dyke spiritëzuar. Situacioni komik i saj përmban një tragjedi, një tragjedizmë me të vërtetë për të ardhur keq mi karakterin ose mi fatin, që është d e s t i n i i njeriut, veçanërisht i njeriut-g r u a. Gruaja e l a g j ë s — e dyerve dhe e portave, vizitonjësja e vatrës dhe oborit, fjalamania tradicionale që përfaqëson tipin e përbashkët dhe të përditshëm të intrigonjëses, të intrigantes, të asaj që bën intriga, që fut fitila, që shtje spica, që shan dhe theth në sherr dhe shtyn në ndarje — kjo: m ë h a l l a x h e s h a shqiptare e pavdekur për gjithë herën dhe për gjithë kohën, përbën fondin e inspirimit të librës S i ç m ë t h o t ë n ë n u a p l a k ë. Epigon Mefistofeli femëror, Meduzë me gjërpinj të gati, ajo e ka për gjaku, prandaj di dhe përmbush mirë mjeshtërinë e saj. Ç'bën ajo? — Atë që pat bërë, atë që do të bëjë: «Fut fite andej, fut fite këndej, bjer e shpjer fjalë». Nga ato zënkat, zëniet, zihjet që përsëriten gjithnjë: «Nga to e ma ta to», siç e ka fiksuar mirë me shprehjen e përshtatur zonjusha Musine Kokolari.

Dhe të gjitha këto në një stil origjinal, në një stil të saj, të çfaqur për së pari me kaq përmbledhje në letrat t'ona. Cilësija e tij është natura e tij. Dyke trajtuar një motiv çkëlqimërisht popullor, ay mban, përmban me paramendim, me paravendim, këtë karakter që është karakteri primordial i vet: popullosija. Sikundër janë marë, desha të them janë rrëmbyer, nga zemra popullore motivet e këtyre skicave kaq të shijëshme, ashtu është marë dhe rrëmbyer nga goja popullore fjala që i vesh, robja e paraqitjes së tyre përpara lëçitësit. Vetëm origjinalitet, vetëm popullorësi. Janë fjalë ekspresive, fjalë të urta, proverbe të vendosura, shprehje popullore, mënyra thënieje dhe faljeje, përgëzime, përvajtime, mallkime, urime, gjithë një thesar frazeologjije së gjallë, të marë drejt për drejt, si të këputur, si të çkëputur nga fryma dhe krahărori i atij që flet dhe të cilat përbëjnë kësisoj gjuhën dhe stilin e Kokalares. Një përshkrim i gjallë, realist, dhe një rrëfim i freskët, plot ngjyrë, plot shije, i nxjerë krejt dhe befas nga momenti natural i burimit të tij: «Në këtë kohë dolli te porta teto Shekua, plakë cite mënt, e urtë që nuk ka shoqe, q'e dëgjojnë të mëdhenj e të vegjël: ju preftë Zoti ditën! si s'keni turp fare nga bota! moj nuk shikoni se si janë mbledhur dhe ju dëgjojnë se ç'thoni» (P ë r m u s t a q e t e Ç e l o s, f. 15). «Më duket akoma në si [1]), sikur e gjej përpara të shkretën plakë; dhe kur e pyetja se ku vente: ja, thoshte, vete një çikë tek Mukadesi, se kam ditë pa parë, i shpie dhe një çikë gjë se s'na zihet t'a hamë vetë si mua ashtu dhe plakut; me zi e kemi, atë vështrojmë në si «(B u r r i s h o k u q e n i t, f. 19). («Ajo moj Aishe, ajo që s't'a zë sinë [2]). Është thingjill i mbuluar, mësallë me di [3]) faqe, shpon ndënë dhé. Pa... pa, s'ke parë bushtër si ajo, nuk ka shoqe. Moj të keqen, se ku i gjen gjithë ato rema nuk di, pastaj se si i ndreq e i thotë... aqë të bën t'i besoç një-me-një. Gjë s'lë pa trazuar, vënd s'lë pa futur turitë. Dal, kthehem në darkë — na! Kështu e gjej sepetin [të trazuar]. S'lë haps e buqice [4]) pa ndrequr». «Në të mbaruar e sipër më heth një herë sitë [5]) si e ka zakon, dhe më thotë: ej, hë! m'i vure dorë djalit sot? u bëre dhe ti të na kreç inatet kështu? e di ç'të bëj? që të këput kokën — trak, si të pulës! që të marr shpirtin të gjallë! që të marr frimën mu atje ku je!» (E s h t ë e t h e l l ë, f. 26, 29). «Ç'e do, kush m'a prishi punën e vajzës s'ime mos pastë h a i r në shtëpi, i rëntë së mirës me këmbë, mos e trettë balta, i plastë buza e i rrjethtë gjak, e gjeftë nga mos e pandeftë» (P a ç f a t i n e s ë l i g a v e t, f. 26). «Po atë kohë as mua nuk m'u mbajtën lotët, që me zi më dalin. Bir, i thotë, më paç udhën e mbarë, vafç e arthç shëndoshë, të dëgjofça mirë, qofsh sa malet dhe i dërgofç shtëpisë një milë të mira» (U d h ë n e m b a r ë p a s t ë, f. 45).

Ç'duhet përfunduar prej kësaj vepëze pa pretendime, prej kësaj prove shkrimi femëror shqiptar? Art domethënë realizim dhe ne nxjerim përfundimin e realizimeve të shkrimtares. Dyke lënë mënjanë të metat, pa rëndësi, të limosjes së gjuhës dhe të frazës, të cilat ajo, si k l a s i k e që janë, i pat lënë një-herë e përgjithnjë në k l a s ë n e shkollës, ne i falemi nderit me gjith zemër për paraqitjen letrare të këtyre subiekteve të neveritura, veçanërisht për stilin e ri, substancial, që i-u ka përshtatur me aq vërrejtje shpirtërore dhe që është në gjithë kuptimin e fjalës shënja e një talenti të pamohuarshëm. Vazhdimi në këtë drejtim duhet të na japë masën e përsosjes së saj.

LASGUSH PORADECI

[1]) sy.
[2]) synë.
[3]) dy.
[4]) bravë.
[5]) sytë.

Lasgush Poradeci

Musine Kokalari: Siç më thotë nënua plakë

Është një dhuratë e thjeshtë që na jep zonjusha Kokolari, sapo e dalë pothuajse nga bankat e Institutit të Tiranës. Sapo e dalë. Sepse vepra në vetëvete paraqitet jo si një provë shkollore e klasave të larta, jo si një shëmbëll zotësije, si një hartim që ka fituar çmimin e parë, — ajo përmban së-kundrazi më pak dhe më shumë se kaq. Më pak sepse ka mungesat e veta, të papranuarshme në një konkurs letrar të nxënëseve të shkollës së mesme; më shumë, sepse na çfaqet, me këtë përjashtim, nënë kushtin e domosdoshmë të artit që domethënë krijim.

Librëza e z-shës Kokolari është pra një krijim origjinal, dhe si i tillë meriton të heqë për një shënim vërrejtjen t'onë.

Krijim origjinal ? Ç'do të thotë kjo ? Kjo do të thotë me fjalë të thjeshtë, të pangatërruar, me fjalë drjet për drejt siç është jeta vetë, se autoresha e këtyre skicave rastore e ka zënë jetën mu në mezin e saj, në momentin kritik që është momenti i math i çdo manifestimi të jetës njerëzore, që përmbleth edhe çfaq, në një pikë tërësije, gjithë kuptimin e vërtetë të jetës të çfaqur rastësisht. Zënia e jetës, kapja e menjëherëshme e saj në fond dhe në formë dhe çfaqja imediate, pa asnjë ndërmjetësim, me anën e artit, kjo është origjinalitet — origjinalitet letrar. Nënë mprojtjen e kësaj cilësije, që është cilësija e parë e çdo vepre shkrimi për të dëfryer shpirtin, qëndron siç thamë libra e shkrimtares s'onë. Ky karakter, cilësija e origjinalitetit të kapur shpejtazi dhe mu në thelb të zhvillimit psikologjik të jetës, sjell me vete dhe pikë-së-pari të metën e vet, si drita që sjell pás hijen. Përshtypja e efektit kryesor i ka mënjanuar hollësirat rrethonjëse, që janë siç kuptohet vetvetiu hollësira forme, çështje trajtimi të përjashtëm,

kujdes me durim i gjithë atyre ndërtimeve, drejtpeshimeve dhe kundërpeshimeve të fjalës dhe të frazës, të cilave nuk i-a-u vuri dhe aq shumë veshin në shkollë, për hir të punës kryesore: origjinalitetit.

Dhe kështu vijmë tashi në gjënë që na intereson mê shumë për këtë shënim, në meritat artistike të shkrimtares së re shqiptare. Ato janë një virtut i pamohuarshëm i saj, ku mund të kënaqet me të vërtet nevoja jonë për një shijim estetik të plotshëm, ku gjejmë, sin në bërthamë, premtimin e heshtur të shvillimit të mêpastajmë të atyreve që ajo mundet të na japë në kohën e duhur. Me sa vërrejtje të përpiktë, plot gjallësi dhe plot freskësi, janë zënë këto miniatura të Musine Kokolares ! Të thuash, sit të kish këputur një copë të gjallë të jetës, një pjesë që rron më vetëvete gjithë jeten e organizmit shoqëror, një fragment që përfaqëson origjinalin dyke e përmbledhur. Janë skica këto, me një intuim psikologjik të math. Ato s'venë, siç do t'i detyronte lloji i tyre, rrugës në gjërësi. Nuk çikin, nuk prekin vetëm. Nuk i afrohen sipërfaqes vetëm, për t'a relevuar me një ngjyrë të lehtë, me një efekt pamjeje të çasit. Nuk përdorin frymën, as humorin, as ironinë ose sarkazmin e tharbët, të shkurtër, të një lloji letrar me qëllim dhe ekspresivitet të përcipshëm siç janë skicat nga natura e tyre. Nuk mbajnë, me fjalë të tjera, distancën subiektive të autorit kundrejt motivit që trajtojnë. Musine Kokolari hyn në thellësi drejtpërdrejt në thelbin psikologjik. Me-një-herë, ajo bashkëjeton me atë që na rrëfen. Nuk tall as nuk qesh përciptas, nuk vajton dyke spiritëzuar. Situacioni komik i saj përmban një tragjedi, një tragjedizmë me të vërtetë për të ardhur keq mi karakterin ose mi fatin, që është d e s t i n i i njeriut, veçanërisht i njeriut – g r u a. Gruaja e l a g j ë s — e dyerve dhe e portave, vizitonjësja e vatrës dhe oborit, fjalamania tradicionale që përfaqëson tipin e përbashkët dhe të përditshëm të intrigonjëses, të intrigantes, të asaj që bën intriga, që fut fitila, që shtje spica, që shan dhe theth në sherr dhe shtyn në ndarje — kjo : m ë h a l l a x h e s h a shqiptare e pavdekur për gjithë herën dhe për gjithë kohën, përbën fondin e inspirimit të librës S i ç m ë t h o t ë n ë n u a p l a k ë.

Epigon Mefistofeli femëror, Meduzë me gjërpinjtë gati, ajo e ka për gjaku, prandaj di dhe përmbush mirë mjeshtërinë e saj. Ç'bën ajo? — Atë që pat bërë, atë që do të bëjë : «Fut fite andej, fut fite këndej, bjer e shpjer fjalë» Nga ato zënkat, zëniet, zihjet që përsëriten gjithnjë : «Nga to e ma ta to», siç e ka fiksuar mirë me shprehjen e përshtatur zonjusha Musine Kokolari.

Dhe të gjitha këto në një stil original, në një stil të saj, të çfaqur për së pari me kaq përmbledhje në letrat t'ona. Cilësija e tij është natura e tij. Dyke trajtuar një motiv çkëlqimërisht popullor, ay mban, përmban me paramendim, me paravendim, këtë karakter që është karakteri primordial i vet : popullosija. Sikundër janë marë, desha të them janë rrëmbyer, nga zemra popullore motivet e këtyre skicave kaq të shijëshme, ashtu është marë dhe rrëmbyer nga goja popullore fjala që i vesh, robja e paraqitjes së tyre përpara lëçitësit. Vetëm origjinalitet, vetëm popullorësi. Janë fjalë ekspresive, fjalë të urta, proverbe të vendosura, shprehje popullore, mënyra thënieje dhe faljeje, përgëzime, përvajtime, mallkime, urime, gjithë një thesar frazeologjije së gjallë, të marë drejt për drejt, si të këputur, si të çkëputur nga fryma dhe kraharori i atij që flet dhe të cilat përbëjnë kësisoj gjuhën dhe stilin e Kokalares. Një përshkrim i gjallë, realist, dhe një rrëfim i freskët, plot ngjyrë, plot shije, i nxjerë krejt dhe befas nga momenti natural i burimit të tij : «Në këtë kohë dolli te porta teto Shekua, plakë cite mënt, e urtë që nuk ka shoqe, q'e dëgjojnë të mëdhenj e të vegjël : ju preftë Zoti ditën ! si s'keni turp fare nga bota! moj nuk shikoni se si janë mbledhur dhe ju dëgjojnë se ç'thoni» (P ë r m u s t a q e t e Ç e l o s, f.15). «Më duket akoma në si[1]), sikur e gjej përpara të shkretën plakë; dhe kur e pyetja se ku vente : ja, thoshte, vete një çikë tek Mukadesi, se kam ditë pa parë, i shpie dhe një çikë gjë se s'na zihet t'a hamë vetë si mua ashtu dhe plakut; me zi e kemi, atë vështrojmë në si « (B u r r i s h o k u q e n i t, f.19). («Ajo moj

1 sy.

Aishe, ajo që s't'a zë sinë[2]). Është thingjill i mbuluar, mësallë me di[3]) faqe, shpon ndënë dhé. Pa… pa, s'ke parë bushtër si ajo, nuk ka shoqe. Moj të keqen, se ku i gjen gjithë ato rema nuk di, pastaj se si i ndreq e i thotë… aqë të bën t'i besoç një-me-një. Gjë s'lë pa trazuar, vënd s'lë pa futur turitë. Dal, kthehem në darkë — na ! Kështu e gjej sepetin [të trazuar]. S'lë haps e huqice[4]) pa ndrequr». «Në të mbaruar e sipër më heth një herë sitë[5]), si e ka zakon, dhe më thotë: ej, hë ! m'i vure dorë djalit sot ? u bëre dhe ti të na kreç inatet kështu ? e di ç'të bëj ? që të këput kokën — trak, si të pulës ! që të marr shpirtin të gjallë ! që të marr frimën mu atje ku je!» (Është e thellë, f.26, 29). «Ç'e do, kush m'a prishi punën e vajzës s'ime mos pastë hair në shtëpi, i rëntë së mirës me këmbë, mos e trettë balta, i plastë buza e i rrjethtë gjak, e gjeftë nga mos e pandeftë» (Paç fatin e së ligavet, f. 26). «Po atë kohë as mua nuk m' u mbajtën lotët, që me zi më dalin. Bir, i thotë, më paç udhën e mbarë, vafç e arthç shëndoshë, të dëgjofça mirë, qofsh sa malet dhe i dërgofç shtëpisë një milë të mira» (Udhën e mbarë pastë, f.45).

Ç'duhet përfunduar prej kësaj veprëze pa pretendime, prej kësaj prove shkrimi femëror shqiptar ? Art domethënë realizim dhe ne nxjerim përfundimin e realizimeve të shkrimtares. Dyke lënë mënjanë të metat, pa rëndësi, të limosjes së gjuhës dhe të frazës, të cilat ajo, si klasike që janë, i pat lënë njëherë e përgjithnjë në klasën e shkollës, ne i falemi nderit me gjith zemër për paraqitjen letrare të këtyre subjekteve të neveritura, veçanërisht për stilin e ri, substancial, që i-u ka përshtatur me aq vërrejtje shpirtërore dhe që është në gjithë kuptimin e fjalës shënja e një talenti të pamohuarshëm. Vazhdimi në këtë drejtim duhet të na japë masën e përsosjes së saj.

Botuar në *Bota e re***, Nr. 1, 30 korrik, 1940**

2 synë
3 dy.
4 bravë
5 sytë

Nexhat Haki

Talentet femrore

[...] Vetëm tri emëra femërore shihen më dëndur nëpër të përkohëshmet: një prozatore dhe dy poetesha: M u s i n e K o k a l a r i, K o l o m b i a dhe L u x S e c r e t a. M u s i n e K o k a l a r i ka një talent që meriton të vihet në dukje. Libri "Si ç'më thotë nënua plakë" është dëshmija e prodhimit letrar që ka me të vërtetë një vlerë folkloristike. Themi një vlerë folkloristike sepse dialekti i Gjirokastrës, me shprehjet e me orthografin karakteristike, shton një material të veçantë për pasurimin e fjalëvet që gjer më sot nuk ishin parë të shkruara. Në këtë veprë M u s i n e K o k o l a r i ka edhe një vleftë artistike të një shkrimtares që fillon të prodhojë, me dashuri e pasion, diçka të mirë e të vlefëshme për letrat t'ona. Me gjithë se shtjellimi i copavet të ndara me tituj nuk është edhe aqë interesant, sepse mbulohet mê shumë nga dukja e shprehjeve të grave të mëhallës, prapë se prapë i mjafton autores për një studim të nesërmë që eventualisht do t'a përdorë për vepëra të tjera me vleftë letrare: si novela humoristike, komedira e të tjera. Themi novela humoristike dhe komedira sepse zakonisht shprehjet dhe zëniet e gravet, sado tragjike të jenë, provokojnë pa dashur një qeshje dhe më vonë një malllëngjim. Aty shohim tipe grash të vëndit t'onë, të cilat mund të miren e të studjohen veçanërisht për vepëra mê me rëndësi artistike. Goldoni, një nga shkrimtarët më të mirë të 700-ës duke vërejtur jetën femërore të Italis së atëherëshme, nxori tipin e gruas M i r a n d o l i n a në komedin e tij më të bukur "La Locandiera". Është e natyrëshme që gjithë ai material i veprës "Si ç'më thotë nënua plakë" të derdhet nëpër kallëpet e komedis shqiptare, dhe këtë punë mund t'a bëjë vet autorja sepse e njeh më mirë atë jetë dhe kaprirje për të bërë një veprë me kujdes artistik e letrar. Do t'i sugjeronim autores së ré që

të marë për model edhe shkrimtaren e famëshme A d a N e g r i, e cila përmes shkrimeve të saja ka mundur të skalisë tipin e gruas italiane dhe të dhurojë fragmente e novela që kanë me të vërtetë një vlerë të madhe, kaqë sa e nderuan për të hyrë në Akademinë e Italis. Në Shqipëri nuk mund të dalë dot një mashkull për të përshkruar ashtu siç duhet botën t'onë femërore: një vajzë do të ishte më e përshtatëshme se ndjen më mirë dhe i di të gjitha të fshehtat e zëmërës së vajzës shqiptare që ndjen nevojën t'ekspozohet edhe në botën e artit: Autorja e ré duhet të na falë sidomos veprën "Ç'më thotë shoqja ime" dhe këtë punë mund t'a kryejë fare mirë sepse nuk i mungon as talenti as dashuria dhe as pasioni për të vazhduar rrugën e letravet.

Fragment nga rubrika "Talentet femërore",
botuar në *Vatra shqiptare*, 1941, nr. 20,
me pseudonimin Ndërvala

Nexhat Haki

Me rasën e librit “Rreth Vatrës” të M. Kokalarit

Dikur ankoheshim për mentalitetin t’onë të ndryshkët që të parët t’anë kanë patur rreth femërës. Pengesa dhe mundime të mëdhaja do të kishte një femërë po të hynte në punët e monopolizuara të mashkullit ky mentalitet prapanik gjer diku i ka penguar me të vertetë femërat t’ona të cilat sot përfaqësojnë me të vërtetë shumicën plot etje për veprimtarira në botën t’onë të mendimit e të ndjenjës.

Mirëpo sot pak a shumë zakonet prapanike janë thyer: Shohim femërën të dalë në skenë, të bëhet mësuese, profesoreshë, doktoreshë, gjinekologe e të marë pjesë nëpër veprimtarira që gjer dje ishin të caktuara prej të parëvet t’anë si mjeshtërira dhe punë vetëm për meshkujt!

Ky evolusion me gjithë se në dimesione të vogëla për femërën shqiptare ka hapur shtigje orizontesh të ra mendimi dhe ndjenje. Me gjithëse shumica e femëravet mbyllin librin me marjen e dipllomës së një shkolleje të mesme apo universiteti dhe se nuk kujdesen më për kulturën por për modën a për fëmijën (detyrën kryesore të tyre), prapë se prapë mbetemi të gëzuar sepse kanë arritur shkallën e pjekurisë mendore që nesër t’i bëhen shoqërisë ose familjes të vlerëshme dhe t’ë paraqiten me dinjitet e të formuara n’elitën t’onë intelektuale.

Është jeta dhe fati që u destinon më vonë vazhdimin e thellimin e kulturës së tyre, sepse femëra, duke qënë para së gjithash nënë është shumë e zorshme të zhvillojë edhe veprimtarira të tjera që pengojnë detyrën e amësisë. – Por ky shkak gjer diku mund të pranohet i ligjshëm dhe i natyrshëm, pse nuk mund të harojmë për një çast kohën dhe mundësitë që paraqiten herë pas here për një nënë të lëçisë e të mësojë atë që nuk di: faktori kryesor i kohës

për vullnetin e mirë dhe për pasionin e femërës-nënë nuk mund të influencojë kurrë për lëçitien, veçse mund të ndalojë apo të pengojë për një kohë me intervale një program apo një sistem që femëra i ka parashtruar vet-vetes.

Femëra-nënë mund të pengohet për të qënë zyrtare, politikane, me një fjalë për punë që shtërngohet të braktisë fëminë por jo kurrësesi e penguar për zgjerimin e kulturës së vet e për ushtrimin e një mjeshtrije që lyp talent apo pasion: fjala vjen mund të jetë një piktoreshë, një skulroreshë, një muzikante, një shkrimtare (qoftë vajzë a nënë), punë këto që nuk e pengojnë as pak për të fituar kënaqësin e shpirtit të vet e për t'i kontribuar artit.

Me gjithë shkaqet shoqërore psikologjike dhe natyrore prapë se prapë ne sot për sot nuk duhet të kërkojmë shumë gjëra prej një femëre që akoma ndesh pengesa në familjen e saj injorante por fisnike në shpirt. Sot femëra, ajo që është e lirë, ka gjetur përkrahjen nga të gjithë, kaqë është e vërtetë sa ne e shohim të punojë kudo, edhe në punëra të vështirëshme që i përkasin mashkullit. Në rasë se ato ankohen pse nuk bëhen deputete, ministra e në të tjera vënde zyrtare, duhet të mos pretendojnë misione dhe detyra të rënda që janë kaqë të pakta dhe kaqë delikate sa që edhe vet meshkujvet u është prerë rruga. Sepse të tilla pozita janë bërë, si kudo, të privilegjuara e të përshtatura sipas nevojavet e kërkesavet të shoqërisë s'onë.

E vetmja rrugë e lirë për 'to dhe që s'është monopol i askujt është kultura, është arti, është shkenca. Po të tregojnë aftësinë në këto, imponohen vet-vetiu dhe përkrahen nga kushdo, dhe kjo përkrahje është dëshmuar sepse sot shohim që femëra shqiptare të jetë artiste dhe shkrimtare të cilat, me gjithë se talente, premtojnë mjaftë për t'arthmen. Dhe pikërisht është libri i Musine Kokalarit që na dha shkak të hapnim këtë parantes në fillim të këtij artikulli për femërën shqiptare dhe për veprimtarin e sajë. Vëndi i ynë dikur i ka dhënë botës një shkrimtare të njohur, Dora D'Istria-n, me të cilën vërtetohet raca e jonë se ka brum e frymëzim për të lindur

edhe shkirmtare. Prandaj ne gëzohemi kur shohim femëra të miren me shkrime dhe të botojnë një dy dhe më vonë të tjera vepra me një vlerë relative për bibliothekën t'onë që paraqitet shumë e varfër në raftin e autores shqiptare.

Para disa vjetëvet kishim mjaftë talente femërore që punonin e premtonin shumë për letrat t'ona. Tani s'para i shohim të vazhdojnë punën e tyre me rregullë e me kriter të vazhduarshëm. Nga të gjitha këto femëra-shkrimtare vetëm Musine Kokalari na ka dhënë provën se i ka parashtruar një pllan punimi vetes së sajë. Libri i parë "Siç më thot Nënua plakë" dhe libri i ri "Rreth Vatrës", që qarkulloi këto ditë, janë prova të një talenti të shëndoshë e të preagtitun për vepra më të mira në t'arthmen.

Dy librat që na ka dhënë gjer më sot janë interesante dhe të dobishme për studjonjësin e ardhshëm. Material folkloristik që paraqitet në dy libra, i mbledhur me kujdes dhe i shkruar në një gjuhë të pastër. Në të parin me dialektin e gjirokastrës dhe në të dytin në një toskërishte të kulluar. Kushdo, e sidomos femërat, mund t'i quajnë punë të lehta, mbledhje përrallash e fjalë e fraziologji dialekti të Gjirokastrës, që nuk kanë ndonjë interesim letrar, por ne që e dimë mjeshtërinë e mbledhjes dhe mënyrën e shprehjes së tyre na duken punë të rënda dhe të rëndësishme për folklorën t'onë. Musine Kokalari jep një material të krehur mirë e bukur dhe ja u fal shkrimtarëvet, ose vetes, më vonë, për t'u frymëzuar për vepra artistike. Dy librat e saja janë dy thesare që ndihmojnë në burimin e pashteruar të folklorës, ku duhet të frymëzohen të gjithë shkrimtarët për të formuar atë letërsi kombtare për të cilën e kemi theksuar kaqë herë nga shtyllat e kësaj Fletoreje.Shkrimtarët t'anë dhe shkrimtaret nuk duhen të kërkojnë që në fillim të punës së tyre vepra dhe kryevepra të mëdhaja mjafton të na japin vepra të thjeshta e të kontrolluara mirë e të mos imitojnë njërin apo tjetrin shkrimtar të huaj. Kjo ksenomani edhe në letrat t'ona na ka shkatëruar jo vetëm lëndën por edhe formën, kaqë sa shumë shkrimtarë përdorin një gjuhë me

fraziologji e strukturë të huaj dhe me subjekte t'importuara e të pa përshtatura për vëndin to'në.

Ne, prej këtyre talentevet, qofshin meshkuj o femëra, nuk kërkojmë gjë tjetër, veçse vepra si ato të Musine Kokalarit, dhe kur t'a ndjejnë veten të zotë në bazë të një autokritike objektive le të fillojnë edhe vepra më të plota.

Fusha e artit është e hapët dhe e lirë, nuk ka monopolizime as edhe pengesa për mbarrëvajtjen e sajë. Sidomos femërat e kanë fare të hapur këtë rrugë ku të drejtat dhe detyrat janë ashtu siç duan ato: të njëjta me të meshkujvet.

Në rasë se pretendojnë gjëra që edhe meshkujvet vet u është zënë rruga, do të mbeten gjithëmon anakronike dhe do të pendohen në një kohë kur nuk do të jenë të zonjat as edhe për detyrën e nënës.

Sot çdo gjë primitive dhe në kundërshtim me evolusionin ka pernduar: librat janë aty, presin të shfletohen edhe nga femërat.

Kur ne kërkojmë punë prej tyre, me një herë na dalin ankime dhe vërsulen me frazat e zakonshme se gjoja bota shqiptare nuk e ka kuptuar akoma rolin e femërës në fushën e veprimtarive të ndryshme të intelektit e të zemrës. Por të gjitha këto pretekse mund t'ishin dikur, kurse sot femëra është e lirë, vetëm se aktiviteti që ajo tregon, mvaret nga vullneti i saj dhe nga pregatitja e sajë kulturore, sidomos në fushën e letrave, ku duhet para së gjithash talent, kulturë dhe punë të vazhduarshme e me kriter siç paraqitet Musine Kokalari, e vetmja femërë gjer më sot që punon për letërsinë shqipe.

Botuar në *Bashkimi i kombit*, 1944,
9 korrik, me pseudonimin Ali Dërvella

DILO, L.

"Siç më thotë nënua plakë"

Me volumin e ri të titulluar: "SIÇ ME THOTË NËNUA PLAK', zojusha universitare Musine R. Kokalari, e cila njihet për shkrimet e saj të nënëshkruara me pseudonymin "Muza", ka dhënë që në krye shenja se zotëron një talent për të çfaqur në mënyrë artistike ato çka shef rrotull saj dhe pr' anë saj. Syrit të saj shqyrtuës nuk i shpëton asgjë: Musine Kokalari, si një shkrimtare e ré e nderon për së tepri seksin e saj; është me kulturë dhe di të shkruajë. Prozës së saj i ka dhënë një veshje shqipëtare, jo pse ka pikturuar kaq bukur jetën e Gjirokastrës, por sepse në të dhjetë novelat folkloristike ka ditur t'u japi, me mjeshtëri të rallë, gjallëri përshkrimevet, të folurit të grave, mentalitetit të tyre edhe zakonevet të tyre.

Në qoftë se Ali Asllani ka përshkruar mir' e bukur, Hanko Hallën në të gjitha paraqitjet e saj, Musine Kokalari, nga ana tjetër është në prozë, një alter ego e Ali Asllanit. Në qoftë se poezija e Asllanit na paraqet jetën dhe mëndësin e Hanko Hallës, e cila pasqyron, në të folurit e saj, grupin e vet dhe shoqet e saj, Musine Kokalari nga ana tjetër, ka mundur me plot sukses të harijë qëllimin, që i kish caktuar vehtes. "Siç më thotë nënua plakë" shkon krah më krah me "Hanko Hallën". Që të dyja shkrimet, i pari në prozë e i dyti në poezi gjallërojnë jetën e mentalitetin e gruas së shkuar nga mosha, e cila kritikon dhe çuditet me jetën e re që po bëjnë vajzat e tyre në ditët e sotme.

Por vlera kryesore dhe merita e veprës së vogël, shkruar nga zonjushia Musine Kokalari qëndron në seleksionimin q'ajo ka bërë për të paraqitur pikërisht dhe me lezet opinionin që kanë plakat mbi jetën e mbi nuset e tyre. Rëndësia e folklorës duket se e ka preokupuar më shumë nga të gjitha autoren e kësaj libre, që këndohet që nga

kreu e gjer në fund me interes të veçantë e me dobi për atë që do të ndriçohet mbi dialektin e kësaj ane të Shqipërisë.

Novelat janë të sgjedhura sikundër edhe këngët e dasmës që këndohen në këto raste. Aktualiteti dhe të folurit krejtsisht popullor janë gjëra që bien me një herë në sy.

Për këto novela, që meritojnë me të vërtetë një interes e studim të veçantë, do të flas edhe në numërin që vjen, duke vënë në dukje rëndësin që kanë të tilla shkrime si për filologun, si për letrarin ashtu edhe për atë që do të mësojë fjalët e ralla shqiptare dhe ekspresionet e bukura popullore që sot për sot janë lënë pas dore. Z-shes Musine Kokalari, që paraqiti jo më mirë më skenat e jetës së këtyre anëve, duke i shoqëruar këto bisedime me ngjyrat më realiste, lavdërimet më të nxehta për punën e saj të vlefshme.

Botuar në gazetën *7 prill*, 1939, 8 tetor 1939

DILO, LEFTER L.

Musine Kokalari dhe XHEXHE FROSUA

Ne nje numur te me-parshem te kesaj gazete fola per mbivleren e posaçme folkloristike, qe prezanton libri i zojushes Musine Kokalari : "Siç me thote Nenua plake".

Premtova se do kthehesha perseri mbi kete botim. Ne nje bisede qe pata me

Xhexhe-Froson, nje plake me fytyren rrudha rudha se ciles nuk i kish mbetur veçse nje dhemb ne goje, kuptova fare mire se ç'pershtypje te bukur i ka bere kesaj plake dhe shoqeve te saj hartimi i ketij libri dhe dialoget e persosura, qe shvillohen nemes te grarise gjirokastrite. Xhexhe Frosua, qe ishte kurioze te dinte se si e kish titullin ky liber me tha: "Pa t'i marim punet shtruar, bir-o, po kjo fjala "siç" nuk me bie mir ne vesh, me duket sikur nuk vete mire keshtu, mbase do te jete ndonje fjale allafranga, po le t'a leme". Plaka e shkrete donte te thoshte per titullin e librit se nuk shkon mire dhe e verteta eshte se populli thote nga hera "si me thua" dhe jo "siç me thua".

Verejtja e Xhexhe Frosos me duket e goditur e me vend.

- o -

Kostandin Kristoforidhi, qe te rrembente pikerisht nga goj'e popullit shprehjet e sakta te tij, shkonte fshat me fshat e shume here, duke kaluar dere me dere, e per t'u nxjere ketyre fjale, grindesh me to, keshtu qe t'i shtrengonte te shpreheshin ne menyre popullore. Shembellen e tij ka ndjekur dhe zojusha Kokalari, e cila ka paraqitur me ngjyrat me te gjalla gjuhen e grave gjirokastrite.

Shum gje e bukur do kish dale, sikur autoria me vlere te kish vene ne gojet e plakave te novelave te saj, fjale te huaja te shtremberuara nga shqipetaret e shkuara nga mosha. Duke ndjekur aty-ketu edhe menyren e shkrimit te Rem Voglit do dilte nje pune m'e bukur e me

interesante. Fjalet e huaja, te deformuara dalin te lezeçme dhe i japin nje hijeshi shkrimevet. Me gjith ate vepra e zojushes universitare Musine R. Kokalari, vlen te kendohet nga te gjithe, sepse permban novela interesante dhe qe kane lidhje drejt per drejt me jeten t'one.

Botuar në gazetën *7 prill*, 31 tetor 1939

Prof. Dr. Persida ASLLANI
Universiteti i Tiranës

Identitetet femërore si ligjërim në prozën e Musine Kokalarit[1]

Si për shumë shkrimtarë të tjerë bashkëkombës, edhe vepra e Musine Kokalarit u përball me dy kohë leximesh krejt të ndryshme nga njëra-tjetra: e para, ajo e natyrshmja, ku vepra ndërton së pari marrëdhënien e vet me botën letrare ku hyn, me lexuesin që synon dhe me kritikën që e vëren dhe e shqyrton; e dyta, ajo e rikthimit të vonë, mbas-dhune, gjysmë shekulli më pas, ku vepra ndërton një marrëdhënie të dytë, më pak të natyrshme dhe më të ndërlikuar, teksa kërkon një lexim të ri, të cilit, përveç atypëratyshmërisë së tij, i duhet të mbajë parasysh ose të rindërtojë edhe leximin e saj të parë. Madje shpesh, ky lexim i dytë rrezikon të varfërohet e ta tjetërsojë veprën nëse nuk ia del të ushqehet së brendshmi edhe me leximin e parë. Rrugëtimi ideologjik, tematik por edhe formal, i letrave shqipe deri

1 Meqenëse ky botim përbën edhe përmbledhjen e parë shkencore kushtuar veprës letrare të Musine Kokalarit, me qëllim përdorimin sa më praktik e të gjerë nga studentët, po bashkëlidhim këtu edhe një studim nga ana e autores Persida Asllani e me kërkesë të saj, me titull "Identitetet femërore si ligjërim në prozën e Musine Kokalarit", paraqitur në konferencën shkencore "Letërsia dhe identiteti" të Seminari XXXII të Albanologjisë në Prishtinë 2013, botuar për herë të parë në aktet e saj. Me përjashtim të analizës kushtuar veprës *Nënua plakë në Romë*, rizbuluar në variantin e plotë po prej saj vetëm më 2017, shkrimi botohet pa ndryshime. Falenderojmë redaksinë e Seminarit për lejen e botimit.

në ’90-n ia kanë zbehur mundësinë këtyre teksteve të rindërtojnë natyrshëm lidhjen e tyre të hershme me botën, problematikat, shijet, sfidat ideore dhe letrare në të cilat u shfaqën, u ndikuan dhe ndikuan. Nga kjo largësi rrezikon të anashkalohet dhe një prej dukurive dhe përbërësve të brendshëm më specifikë të teksteve të Kokalarit: ndërtimi i identiteteve femërore ekskluzivisht përmes ligjërimit, e ngritur në veprën e saj në nivelet e një metodologjie të pagabueshme. Përmes kësaj metodologjie të shkrimit letrar, Musine Kokalari ia doli të sjellë në letrat moderne shqipe një dukuri të re, të pahetuar më parë në prozatorët e mirënjohur të epokës, si Koliqi, Kuteli, Spasse, Migjeni e madje as te Stërmilli[2].

Bota e ndërtuar nga Musine Kokalari është një botë tërësisht femërore. Ky identitet ndërtohet në tematikë dhe fokus, në subjekte e në personazhe, në narratorë e rrëfimtarë dhe sidomos, ekskluzivisht në dy nivelet e ligjërimit: 1) atij që i jepet ose fiton të drejtën e ligjërimit; 2) në natyrën ekskluzivisht femërore të këtij ligjërimi. Pikërisht këtu Musine Kokalari është e para dhe e vetmja e epokës së saj letrare.

Prandaj dhe ky punim rreket të gjurmojë ndërtimin e identiteteve femërore në prozën e shkrimtares së parë shqiptare Musine Kokalari[3]. Të shkruarit ishte për zonjushën e laureuar në Romë për

2 Për shkak të kufizimit të hapësirës analiza jonë do të ndalet më pas vetëm te vepra e Haki Stërmillit *Sikur të isha djalë*.

3 Tashmë dy historishkrime të letërsisë shqipe moderne e pohojnë faktin se Musine Kokalari është shkrimtarja e parë në letrat shqipe: Sabri Hamiti, në kapitullin «Letërsia e viteve ’40-‘45 », botuar në *Letërsia Moderne*, Tiranë, 1998, Prishtinë 2002, e më pas në *Letërsia moderne shqipe*, UET/Press Tiranë 2009 shkruan ndër të tjera se «Në këto vite shfaqet një fenomen letrar, madje në gjininë e prozës. Musine Kokalari (1917-1983), bijë e familjes së njohur Kokalari, e shkolluar në Tiranë e në Itali, që në rini të hershme shpalon talentin e jashtëzakonshëm letrar. Musineja është femra e parë që bëhet autore e njohur dhe e respektuar në letrat shqipe”, f. 428; në të njëjtën kohë edhe Robert Elsie pohon në *Historia e Letërsisë Shqiptare*, Shtëpia botuese “Dukagjini”, Tiranë-Pejë, 1997 se “Kokalari ka qenë e para shkrimtare femër në Shqipëri, dhe e vetmja deri në vitet 1960[...]; në moshën njëzet e katër vjeç, kishte botuar tashmë një përmbledhje të parë 80 faqesh me dhjetë rrëfime rinore në prozë, të shkruara në dialektin e vendlindjes Gjirokastër: *Siç më thotë nënua plakë*, Tiranë 1941. Kjo përmbledhje historike, e frymëzuar fuqishëm nga folklori toskë dhe nga mundimet e përditshme të grave në Gjirokastër, mendohet se është e para vepër letrare e shkruar dhe e botuar nga një grua në Shqipëri”, f. 241. Ndërkaq, bie në sy heshtja e plotë ndaj personalitetit dhe veprës së Musine Kokalarit në një prej veprave të pakta kushtuar personazheve femërore në letrat shqipe, me titullin domethënës *Femina Litterarum*, me autore Prof. Dr. Resmije Kryeziu, botimi Institutit Albanologjik të Prishtinës, 2008. Në padijeni të plotë për ekzistencën e personazheve nga më specifiket femërore në veprën e M. Kokalari, po

Naim Frashërin vlera e vërtetë e botës lëndore, kuptimi i fshehtë i ekzistencës. Më 1943 ajo i rrëfehej (ankohej?) shoqes së saj Afërdita Asllani me fjalët "Dua të shkruaj, të shkruaj, e vetëm të shkruaj dhe të mos kem të bëj fare me politikë"[4]. Dëshirë apo ankim? Pohim a mohim? Sot është e vështirë të përcaktohet. Ajo humbi politikisht jetët e vëllezërve të saj, lirinë e vet. Mori pjesë po politikisht në grupimin e parë opozitar antikomunist "Bashkimi Demokratik Shqiptar". Vetëm shkrimet e saj letrare mund t'u kthejnë kuptimin e bukur këtyre fjalëve. Vetëm te shkrimet e saj letrare i-ja e butë gjirokastrite, tematika enciklopedike e botës që strehon qeniet femërore, frazeologjia vërshuese në ligjërimet e tyre, elementët e një etnologjie të bukurshkruar, ritmi marramendës dhe statika e pashkatërrueshme e marrëdhënieve në familje, enigma e madhe e jetës…, jetohen "për t'u shkruar", për t'u risjellë në trajtë gjuhe, estetikisht të dëshirueshme e të dëshmueshme, duke ndërtuar përmes tyre identitetet femërore të qenieve njerëzore që janë njëkohësisht zanafilla e tyre por edhe të përkufizueshme prej tyre.

Në të gjitha veprat e botuara prej saj, *Siç më thotë nënua plakë* (1939), *Nënua plakë në Romë* (me pjesë, te gazeta "Tomorri" më 1940), *Rreth vatrës* (1944) dhe *...sa u tund jeta* (1944), akti ligjërimor zotërohet plotësisht nga zërat femërorë, tematikat dhe problematikat femërore si dhe gjuha tipizuese e femrës, konkretisht asaj qytetare gjirokastrite. Ndërtohen skena tipike teatrore ku të drejtën e qenies në skenë si dhe të mise en scène-s e kanë vetëm ato që ligjërojnë, pra vetë gratë dhe vetëm gratë. Në dhjetë prozat që ndërtojnë vëllimin debutues *Siç më thotë nënua plakë*, këto skena përftohen me një mjeshtri të rrallë vetëm përmes ligjërimit dialogues, mes dy grash, të cilat, teksa dialogojnë me njëra-tjetrën ndërtojnë skenën e botës në të cilën jetojnë, flasin, aktrojnë. (Personazhet aktore të vëllimit janë në dialogët e tyre

shkrimtare femër, ky tekst studimor, i shkruar po nga një femër, nuk e përmend as një herë të vetme!

4 MANDIA, Eglantina, *Sonata e hënës* (Rrëfim për një jetë), botimet Globus R, Tiranë 1995, f. 152.

përkatës: Merushja dhe Havaja, teto Ferideja dhe Nexhmija, Aishja dhe Bedo, Firuzja dhe Behija, nusja me vjehrrën, teto Hana dhe Medihaja, Xhevroja dhe Rozoja, Durija dhe Nelija, Hasiseja dhe Nafizeja. Ndërsa në fokus vihen aspekte të forta të jetës dhe paralel ndërtohen gjykime botëkuptimore mbi to: lehtësia e grindjes mes grave, pabesia e shpejtë dhe jo-etike e burrit të ve ndaj bashkëshortes së vdekur, fati i gruas duke krahasuar bashkëshortët, ceremoniali tërësisht mes femrash i ikjes në kurbet të djalit të vetëm, ceremonia mortore e djalit të vetëm, sherri mes dy mikeshash, sherri mes nuses e vjehrrës, parandjenjat e rënda dhe bestytnitë te të cilat besojnë fort personazhet gra etj). Të gjitha aspektet ceremoniale, dialogët, gjendjet emotive, përshkrimet e ceremonive, interierëve, kulinarisë dhe aktivitetit shtëpiak, gjuha por edhe formulimet botëkuptimore i përkasin ekskluzivisht botës së grave. Një identitet i fortë femëror ndërtohet metodologjikisht gjatë 10 prozave të kësaj përmbledhjeje.

Në nëntë pjesët e *Nënua plakë në Romë* rrëfehet udhëtimi i po të njëjtës "nëno-gjirokastrite" në Romë, te mbesa, botuar gjatë verës së 1940 në gazetën Tomorri: Në shtëpi, Udhës, Ditën e parë, Ç'i zuri siri, Nënua në Thjatro, S'marr vesh fare, Nënua në shkollë të madhe, Nënua u duk prapë, Nënua do Gjirokastrën; duke privilegjuar edhe këtu ekskluzivisht vetëm zërin e Nënos plakë. Teksti shfaq një zgjidhje shumë interesante nga pikëpamja diskursive. Nëna plakë është ajo që zotëron ligjërimin e rrëfimit të udhëtimit të saj, ndonëse paradoksalisht, në dheun e huaj, ajo është e privuar nga pjesëmarrja në Ligjërim. Jo vetëm nuk njihet me njerëzit e atij qyteti por mbi të gjitha nuk njeh gjuhën e tyre. Autorja e ka zgjidhur këtë "mungesë në ligjërim" duke e bërë Nënon t'u dëshmojë shoqeve të veta në Gjirokastër përjetimet përmes përvojës personale, por sidomos duke i dhënë asaj cilësitë e një vëzhgueseje të mprehtë, të aftë të lexojë gjuhën e larmishme të shenjave dhe "gjuhën e trupit" të Tjetrit. Ndaj dhe pamjet më interesante të rrëfimit të saj lidhen me vëzhgimet e holla që ajo sjell, komenton e gjykon, të skenave jetësore përballë

të cilave vendoset rastësisht dhe priret t'i kuptojë, t'i lexojë, si një semiologe e thekur, duke i kuptimësuar përmes spektrit të mentalitetit (reflektivitetit) të vet. Por përtej të gjitha gjërave që vëzhgon, duke filluar nga aspektet teknologjike (udhëtimi me traget, tren, makina, ndërtesat e larta, ashensoret, apartamentet komode e të ngrohta, urbanizimi i nivelit të lartë etj.) e deri te aspektet e jetës së qytetit në baret, kafenetë e deri në Teatër-kabaretë dhe Universitet, prirja natyrore e Nënos është të vëzhgojë të ngjashmen e vet, domethënë jetën e femrës në përgjithësi dhe aty ku i jepet rasti atë të moshatareve të saj veçanërisht. Gra të barabarta me burrat, gra të stolisura e të mbajtura, që studiojnë e punojnë, që këndojnë bareve e kabareve, që respektohen plot mirësjellje nga burrat, që dashurohen haptazi, që vishen më "kërcinj e llërë përjashta", gra e vajza që popullojnë qytetin modern dhe, përmes vëzhgimit të Nënos plakë, edhe galerinë femërore të këtij rrëfimi.

Ky identitet femëror ndërtohet edhe më i fuqishëm në përmbledhjen ...*Sa u tunt jeta*, ku tashmë jetët e personazheve femërore ndërthuren me njëra-tjetrën në strukturën e një romani që rrok harkun kohor dhe thellësisht ceremonial nga vendimi për të martuar një vajzë deri te martesa e saj, duke kaluar imtësisht përmes të gjitha shestimeve, procedimeve, kodeve, simbolikave, ceremonialeve tipike që do të çojnë në kurorëzimin e plotë të këtij plani. "Dasma – një sintezë e teatrit të jetës" e përkufizon në parathënien e tij të pasur Dallan Shapllo përmbledhjen ...*Sa u tunt jeta*[5]. Gjithçka i takon edhe këtu botës femërore, aktivitetit ekskluziv të femrës në familje e brenda mureve të shtëpisë (në të cilën mungon tërësisht prania mashkullore si qenie njerëzore, por vetëm si pushtet mashkullor i druar ligsht), punët rropatëse të shtëpisë dhe ekonomisë patriarkale, përgatitjes së pajës, pritjes dhe përcjelljes së vizitoreve, përgatitjeve marramendëse të fejesës dhe sidomos dasmës. Vajza që do të martohet, Xhemilja,

5 SHAPLLO, Dalan, « Vrojtuese e hollë e jetës », në Musine Kokalari, *Vepra*, Shtëpia botuese "Faik Konica", Prishtinë, 2004, f. 18

vetëm pëson si një marionetë vendimet dhe veprimet e kolektivitetit mbi vete, ashtu si dhe burri i saj i ardhshëm Nexhipi, për të cilin nuk kemi as një portretizim të vetëm. Janë dy vjehrrat e ardhshme dhe krushka mes tyre që zotërojnë linjat vepruese të romanit si edhe të drejtën kryesore të ligjërimit. Të fuqishme si tri Mojra mitike, në endjen e fatit të bijve të tyre, ato janë krejtësisht të pafuqishme dhe madje të trembura nga burrat, gjithnjë të papranishëm në veprim e në ligjërim, por thellësisht të frikshëm, sikur të mbajnë në heshtjen e tyre të drejtën e jetës. Një gjuhë ekskluzivisht femërore ndërton edhe këtu krejt rrëfimin e romanit dhe thellohet edhe më tej te zërat ligjërimore gjatë ceremonive të dasmës, ku sillen thuajse vetëm këngët ceremoniale të grave, këngë që shoqërojnë etapa të ndryshme të përgatitjes dhe realizimit të dasmës[6].

Në të trija përmbledhjet, përmes penës së Musine Kokalarit ndërtohet gruaja si amësi dhe gjuhë: amësi e një identiteti të thellë e gati mistik, prej të cilit nuk iket kurrë, i dhënë një herë e përgjithmonë, realiteti i gjuhës amtare. Bota magjepsëse e Musine Kokalarit është pikërisht kjo lëndë gjuhësore femërore. Do të varfërohej leximi ynë sot nëse rrekemi ta lexojmë këtë prozë si simotrat e veta etnografike, sepse, ndonëse e ngjizur me një lëndë të përbashkët me to, proza letrare e Musine Kokalarit ka pasur një finalitet letrar e estetik të qartë, jo thjeshtë dokumentues e admirues si në një tekst përshkrues etnografik, por pikërisht si prozë që ndërton një botë, dhe ku elementëve përbërës të kësaj proze u është dhënë një funksion i caktuar letrar dhe botëkuptimor, strukturor dhe etik, pra një funksion i plotë estetik.

Për ta kuptuar më mirë këtë funksion të fortë estetik të shkrimeve të saj, pra atë pikëtakim mes përftimit të së bukurës dhe etikes, mund të na vijë në ndihmë po vetë mendimi kritik i autores. Në një nga

6 Ndonëse në thelb një përmbledhje me përralla të rishkruara e të riinskenuara, edhe vëllimi *Rreth vatrës* karakterizohet nga një ekskluzivitet femëror në nivelin e të drejtës së ligjërimit. Përrallat tregohen për fëmijët kryesisht nga Nënua-plakë (pra, gjyshja e shtëpisë).

sprovat e saj kritike shkruar po rreth viteve '40, ajo shprehej fare qartë se si letërsia shqipe vuante nga "Mungesa e vetëbesimit kombëtar. Por kjo e metë është edhe në letërsinë që s'kemi bërë gjë tjetër veçse ta marrim nga të huajt, ta kopjojmë nga të huajt, ta përshtasim si të huajt. Mungon me të vërtetë, si në prozë, po edhe në poezi psikologjia kombëtare. Ndjenja kombëtare e poezisë së lehtë ose më mirë të vjershës që ka mbushur revista të shumta nuk pasqyron shoqërinë shqiptare, po ndjenjën, nuk është fryti i psikologjisë, ngjarjeve e tronditjeve të shpirtit të shqiptarit, po ëndrra që ushqente. Kjo varfëri duket më tepër në prozë. Novela e varfër nuk pasqyron tipin shqiptar. Romanci mungon fare. Ende nuk është formuar kultura shqiptare"[7].

Është psikologjia e thellë, është lëvizja e fortë e ngjarjeve dhe tronditjeve të shpirtit shqiptar që rreket të ndërtojë edhe proza e Musine Kokalarit, por në një trajtë krejt autentike, përmes një identiteti gjuhësor e psikologjik konkret, atë të gruas shqiptare në një gjendje thuajse a-historike. "Tregimet (e saj) mund të quhen edhe tregime etnike" na sugjeron me një argumentim të ngjashëm studiuesi dhe poeti Sabri Hamiti[8]. E ka kuptuar mjaft qartë këtë dukuri, në bashkëkohësi, edhe poeti Lasgush Poradeci në rolin e kritikut letrar për përmbledhjen *Siç më thotë nënua plakë.* Ai e cilëson dukurinë shkrimore të Kokalarit me përkufizimin poetik "zënia e jetës"[9].

"Krijim origjinal? –pyet në mënyrë provokuese poeti-kritik , - Ç'do të thotë kjo? –vijon ai,- Kjo do të thotë me fjalë të thjeshtë [...] se autoresha e këtyre skicave rastësore e ka zënë jetën mu në mesin e saj, në momentin kritik që është momenti i math i çdo manifestimi të jetës njerëzore, që përmbleth edhe çfaq, në një pikë tërësije, gjithë kuptimin e vërtetë të jetës të çfaqur rastësisht. Zënia e jetës, kapja e menjëhershme e saj në fond dhe në formë dhe çfaqja imediate,

7 Gazeta "STANDARD", Nr. 1347, 23 tetor, 2009, f. 18-19

8 « sepse kanë synim edhe të rikrijojnë zakone të jetës së vendit, që janë të gjalla; poashtu rikrijojnë botën e përrallave që marrin ngjyrime të veçanta të aplikimit, sepse sillen në situatën e rrëfimit të tyre të gjallë", HAMITI, Sabri, Vepra e cituar, f. 42

9 PORADECI, Lasgush, "Musine Kokalari: Siç më thotë nënua plakë", në "Bota e re", Nr. 1, 30 korrik, 1940, Tiranë, f. 6-7

pa asnjë ndërmjetësim, me anën e artit, kjo është origjinalitet – origjinalitet letrar".

Gjithashtu Poradecit i takon merita e përkufizimit si miniatura të këtyre shkrimeve, duke i nxjerrë ato nga "leximi sipërfaqësor i një skice" dhe duke shkuar drejt kondensimit, thelbit: "Me sa vërejtje të përpiktë, plot gjallësi dhe plot freski janë zënë këto miniatura të Musine Kokalares! Të thuash, si të kish këputur një copë të gjallë të jetës, një pjesë që rron më vetvete gjithë jetën e organizmit njerëzor, një fragment që përfaqëson origjinalin dyke e përmbledhur"[10].

Dhe i takon në kaq pak reshta merita sistemike po Lasgush Poradecit, i cili rreket të bëjë edhe një përkufizim të shpejtë por shumë të rëndësishëm nga pikëpamja e Historisë së Letërsisë, duke e veçuar aktin shkrimor të M. Kokalarit si "shkrim femëror shqiptar"[11].

Në shkrimet e Musine Kokalarit ngjizej e mbruhej jetë, siç ngjizet dhe mbruhet gjuhë. Zënia e jetës është pra në prozën e saj identike me zënien apo mbrujtjen e fjalës. Bota magjepsëse e Musine Kokalarit është kjo lëndë femërore. Pikërisht aty mund t'i lexosh sot, në leximin e saj të dytë, të gjitha, habinë e jetës, të bukurën femërore, tragjicitetin ekzsitencial të qenies: me këtë lëndë ajo i ngjiz figurinat e saj, i vesh e i mbath si zonja të rënda, u laton trupat e u lëmon fytyrën, i bën të heshtin e të mendohen, i bën të sjellin qark tërë botën, të japin urdhra apo të zihen, të bëhen shoqe dhe pastaj të rrihen. Kërkojnë nuse, martojnë vajzat, iu binden burrave por edhe i bëjnë t'u binden. Të bëjnë dasëm, një dasëm të madhe, sa e gjithë bota të thotë e mahnitur se u bë dasëm "…sa u tund jeta". Prandaj dhe libri i saj më i mirë mban këtë titull, shqiptimin e një ëndrre. Kjo botë e shqiptuar prej saj "si një ëndërr" ngjan sikur ka qenë gjithnjë kështu. Dhe mbi të gjitha, sikur gratë-personazhe kanë folur gjithnjë ashtu. Shkrimtarja e parë shqiptare e bëri femrën dhe botën e saj gjuhë.

10 Ibid.
11 Ibid.

Vetëm kështu ajo i bënte të dukshme dhe të përjetshme. Musine Kokalari hynte kështu edhe vetë në letrat shqipe.

Në historinë e tij të *Letërsisë moderne shqipe*, Sabri Hamiti e cilëson që në rreshtat e parë prozën e saj "një fenomen letrar, madje në gjininë e prozës", ku "Muza shqiptare, siç u paraqit në fillim me pseudonim, krijon një tip tregimi të veçantë, ku zotëron rrëfimi popullor dhe një ndieshmëri për ambientin e një emocion i krahasueshëm me emocionin poetik. Musine Kokalari në këto vepra kultivon një stil të vetin, i cili megjithatë shkon në hullinë e tregimtarisë më të hershme të Kutelit, jo vetëm për një hije përmallimi për të shkuarën, por edhe për mënyrën e strukturimit të rrëfimit popullor në rrëfimin artistik. Autorja sjell në letërsinë e vet një gjuhë të folur, të gjallë, nëpërmjet të cilës sjell atmosferën e situatës dhe të karakterit"[12].

Të lexosh sot Musine Kokalarin do të thotë të humbasësh në dashurinë e fjalës, ashtu siç të ka ndodhur më parë duke lexuar Kutelin. Do të thotë të ritakosh Kako Pinon e përjetshme, me po ato huqe, po ato çudira stolish nusërimi, me të pathënat e mëdha, siç e ke takuar më parë kur lexoje Gjirokastrën e përjetshme të Kadaresë. Do të thotë të mos e shkosh lehtë ndër mend se pas magjisë së kësaj fjale ka pasuar ligjërimi i angazhuar i shkrimtares Kokalari për botët që perëndojnë dhe femrën e re shqiptare që lindte atypari. "Gruaja sot, nga bota e perënduar e djeshme […] kërkon të jetë përgjegjëse për vehten e saj dhe të marrë pjesë në të gjitha ngjarjet e kohës". Kështu shkruante shkrimtarja Musine Kokalari në fjalinë e saj të fundit[13]. Dhe papritur kujtohesh se ky libërth i 1944-s paskësh dashur të thotë diçka më shumë se një përshkrim sendesh dhe jetësh. Pikërisht duke ditur të mos e thotë, duke e fshehur pas shkëlqimit të fjalës, duke mbërthyer të thjeshtën e papërsëritshme, duke e tretur aty ku buçet fort jeta. Jeta është e vërteta e saj. Musineja dinte ta kthente në gjuhë.

12 HAMITI, Sabri, Vepra e cituar, f.428
13 KOKALARI, Musine, *...sa u tund jeta*, në *Vepra*, Shtëpia botuese "Faik Konica", Prishtinë, 2004

Jeta që ajo vetë mundi ta jetojë në shkrimet e saj më mirë se botën që pasoi shumë shpejt pas botimit të këtij libri.

Dhe pikërisht vetëm në fund të kësaj "ngjizjeje" marramendëse të jetës dhe të fjalës, në pikën thuajse të pakthim të përftimit të një daljeje nga koha, të një a-historizmi shembullor, shkrimtarja 27 vjeçare Musine Kokalari e kthen shkrimin e saj dhe lexuesin e vet te Historia, te angazhimi dhe veprimi konkret i shkrimtarit në të tashmen e epokës së vet.

Pjesë përbërëse dhe përmbyllëse e vëllimit të saj ...sa u tund jeta, pikërisht mbasi ka paralajmëruar mbylljen e ngjarjeve të treguara në këtë prozë-rrëfim me strukturë romanore, imponohet pjesa e fundit me titull "Duke mbaruar"[14]. Përtej shpjegimit disi poetik të lidhjes së njeriut dhe shkrimtares me vendlindjen (Gjirokastrën) dhe sqarimeve më prozaike të rrugëtimit të një martese, te ky shkrim spikasin fuqishëm dy paragrafë programatikë, të cilët nuk janë vetëm sqarues, por rijapin një çelës të ri leximi të të gjithë librit. Me një projeksion të përkundërt, bota e krijuar përmes ligjërimit femëror shndërrohet në një akuzë të hidhur, e cila përfton aty-për-aty një identitet denoncues të qartë femëror, e pse jo tashmë edhe "feminist":

"...Sa u tunt jeta", pasqyrë e një bote të perënduar, shtegu i kapërcimit na vajzëria, në mes të këngëve, në nusëri, për ta hedhur gruan prapë në vargonjtë e rëndë të robërisë së fanatizmit"[15]

Si edhe paragrafi përmbyllës:

"Nga bota e besimeve të kota, të zakoneve, mbeturinave të fanatizmit oriental, pas shumë brezash, pas shumë sakrificave, pas shumë të rejave të varrosura së gjalli nga ndryshku i jetës, prangat e forta të robërisë së kohës së shkuar me mundime të mëdha më në fund u thyen. U thyen për të lindur jeta e re, jeta e vërtetë me hidhërime e gëzime ku gruaja merr pjesë vetë, është e ndërgjegjshme për atë që bën dh e kërkon të rojë krah për krah me burrin e saj, jo

14 Ibid.
15 Ibid. f. 402

e robëruar si një herë po shoqe e vuajtjeve të përbashkëta, të lidhur ngushtë me njeri-tjetrin, për të kapërcyer shtigjet e ashpra të jetës, duke kërkuar ngrehjen e familjes së mbështetur në ndjenjë e dashuri.

Gruaja sot, nga bota e perënduar e djeshme zuri udhën e saj dhe kërkon të jetë përgjegjëse për veten e saj dhe të marrë pjesë në të gjitha ngjarjet e kohës, kërkon të dijë se ku rron e përse rron në jetë për të drejtën që ka, si pjesë e pandarë e saj që është"[16].

Po përmes këtij projeksioni mund të kujtohemi se edhe "miniatura" e parë që hap vëllimin e saj të parë, e cila i ka dhënë edhe vetë titullin përmbledhjes *Siç më thotë nënua plakë* është një prozë me vlerë konkrete parathënore (prefative), e cila, jo vetëm jep një çelës të rëndësishëm në leximin e të gjitha prozave që vijojnë dhe ka peshë të veçantë strukturore në përmbledhje, por edhe merr vlerë programatike nga pikëpamja ideologjike, duke vënë përballë njëra-tjetrës dy botë që ndonëse duhen nga pikëpamja afektive si filiacion, refuzohen dhe nuk e pranojnë më dot njëra-tjetrën[17].

"Oh, kohë e shkretë, se si u kthie kjo botë përmbis. S'merr vesh i pari të ditin, nuk njihet i madh në i vogli. U bënë të gjithë si këmbët e dhisë? Ç'na panë sitë e ç'na panë sitë, që më mirë t'ishim verbuar e shurdhuar, se sa arritmë këtë ditë". [...][18]

"Gjithë ditën e ditës se ç'bën, s'mar vesh. Shkruan, këndon, bën xixo-gavo, zë miza e u kren sitë. S'di, më thonë se do të bëneç mësonjëse. U! Pika në kokë, gjithënjë një dhoi, në diell."[19]

"Nuk të shoh dot përpara, ikmë këtej, se m'u bënë sitë miza-miza. Ikmë të keqen e mos më bjer në qafë se s'të kam ngenë. Nuk

16 Ibid. ff. 405-406

17 Duke u rrekur të ndërtojë një kontekst letrar të epokës që mund të ketë ndikuar qoftë edhe tërthorazi në përzgjedhje të tilla tematike të Musine Kokalarit, Dalan Shapllo na kujton në parathënien e tij se ajo u mor « me këto tema, me kontradiktat në familje, sidomos me grindjet nuse-vjehër, etj, nën ndikimin e letërsisë shqipe të viteve '30, kur shkruhej gjerësisht për këto probleme, edhe përmes një stili satirik e humoristik, po edhe duke i dënuar zakonet e vjetra. Kështu p.sh. atëherë ishte botuar *Hanko Halla* e Ali Asllanit, skica të Nonda Bulkës, poezi satirike të Kristaq Cipës (Kapa) […]», në Vepra e cituar, f. 9

18 KOKALARI, Musine, *Siç më thotë nënua plakë*, në *Vepra*, Shtëpia botuese "Faik Konica", Prishtinë, 2004, f. 33

19 Ibid.

të hin në punë se si rronim, ju shini t'uajat. Mënjanu këtej, se kur më del përpara kështu nuk dua të të shoh për njëqint vjet"[20]

Një lexim më i afërt me spektrin "feminist" do të nxirrte në pah sot një qëndrim të brendshëm kritik dhe në mos denoncues së paku "diskreditues" ndaj thelbit të deformuar të marrëdhënies së burrit me qenien femërore, qoftë kjo gruaja, motra apo bija. Le të kujtojmë miniaturën "Burri shoku qenit", një titull frazeologjik që e fsheh fare pak qëndrimin e vet tallës e diskreditues. Dialogu mes dy kunatave, Feridesë dhe Nexhmijes në lidhje me martesën e dytë e disi të shpejtë të një burri të ve përvijohet mes formulimesh tipike gjuhësore femërore, që luhaten mes ankesës dhe përkufizimit absolut, kategorizues: "Sa i zihet besë gjarprit, aqë i zihet dhe burrit"; "Mirë thoshin të parët, flori e kishin fjalën: burri shoku qenit"[21] etj.

Edhe më interesant shfaqet ky procedim "gender" në pjesët e *Nënua plakë në Romë*. Pavarësisht se udhëtimi i Nënos plakë ka një shtrirje 20 ditore në Itali, thuajse vetëm në Romë, në planin e skenës së rrëfimit Nënua jeton mes dy botëve të ndryshme, "këtu" dhe "atje", ku femrat dhe meshkujt nuk ndryshojnë vetëm nga pamja, por sidomos nga botëkuptimi për jetën, nga mundësitë e liritë që shoqëria u njeh. Kështu për shembull, pjesët S'marr vesh fare (pjesa VI) dhe Nënua u duk prapë (pjesa VIII) në dialog mes Nënos dhe mikeshave, tematizojnë vështirësitë e jetës së femrës në qytetin e tyre, Gjirokastrën, pamundësisë për të ndryshuar dhe përsëritjes në çdo brez femëror të së njëjtit status gjinor të nënshtruar dhe veçanërisht moskuptimin e tyre për faktin se vajzat e reja e kanë mendjen vetëm të studiojë, sidomos duke vijuar studimet jashtë vendit (në Romë) e jo të martohen (rehatohen) siç e do zakoni, refuzimin e mblesërive etj. Ndërsa në pjesët me fokus jetën në Romë, si për shembull Udhës (pjesa II), Ditën e parë (pjesa III), Ç'i zuri siri (pjesa IV), Nënua në Thjatro (pjesa V) dhe Nënua në shkollë të madhe (pjesa VII),

20 Ibid. f. 35
21 Ibid. f. 42

Nënua plakë shndërrohet në tregimtare dhe gjykatëse e botës së huaj që tregon, përmes përqasjesh kryesisht morale. Mënyra e të veshurit dhe jetuarit, marrëdhëniet e çlira mes vajzave e djemve, jeta e hapur dashurore, të mbajturit sqimatar të moshatareve të Nënos dhe reverancat mashkullore, janë disa prej aspekteve që ajo "përzgjedh" për të rrëfyer, me qëllim paraqitjen e një botë shumë të ndryshme e të huaj prej asaj që njohin ajo dhe bashkëbisedueset. Ndërsa përvoja e "shthurjes totale" në Teatër-Kabare e ka tronditur aq fort sa t'u deklarojë shoqeve se "atje është maskarallëku sheshit".[22]

E megjithatë, te këto gra "të shthurura" Nënua shquan mundësinë e një jete cilësisht më të mirë. Vëzhgimet e përfundimet e vazhdueshme në të cilat mbërrin ajo dhe shoqet e saj gjirokastrite për vështirësinë e patjetërsueshme të jetës së tyre femërore, të mbërthyer në varfërinë materiale por edhe në darën e tradicionales së palëvizshme, në të cilën gruaja ka një status të ulët e shërbyes në raport me burrin, lindin pikërisht përmes kësaj përballjeje me "gratë e botës" duke njohur te ato, krahas diferencës morale e botëkuptimore, ekzistencën e një jete në mos më të bukur, së paku më të lehtë femërore, me kushte e komoditete moderne, me liri e respekt të qenies dhe gjinisë. Ky konfirmim, ndonëse nuk ndryshon asgjë në jetët e tyre, i bën më të qarta ndoshta për prirjen e re në sjelljet e bijave, nuseve dhe mbesave të tyre, duke kuptuar në heshtje, perëndimin e një epoke dhe shfaqjen e një brezi të ri femëror edhe në vendin e tyre.

Ndërsa një prej personazheve kryesore të ...*sa u tund jeta*, vetë mblesa e krushqisë së re, teto Haxhua, mediton në trajtën e një monologu, gjykon rëndë dhe mallkon bashkëshortin e saj si të qe martesa me të gjëja më e keqe që i kishte ndodhur në jetë: "U përmbistë, se i kishte marrë shpirtin gjithë jetës. I kishte ngrënë kokën. E kishte plasur me gërnjë. Hodhi të rit e saj për të. Gjithë natën e natës e kish shkuar jashtë. Pinte, sa i dilte na hundët, lonte sa linte dhe këmishën

22 "Nënua në Thjatro", [Nënua plakë në Romë], në "Tomori", 17 korrik, 1940

e krahave. Të gjitha taksirate ishin për gruan e zezë! Pikërënës!"[23]

Edhe më e rëndë është atmosfera e përgjithshme e frikës së thellë që mbretëron në jetët e të gjitha grave, një psikologji dhune të pashprehur që tipizon si një kod thuajse gjenetik të gjitha personazhet femërore, gra bashkëshorte, motra, bija.

Vetëm disa vite më parë në letërsinë shqipe ishte botuar romani tematik *Sikur të isha djalë* i shkrimtarit Haki Stërmilli. Nën një tjetër trajtë dhe sidomos përmes një tjetër tipi shkrimor kishte ardhur te lexuesi shqiptar tabloja e dhunës së fanatizmit ndaj gruas në një familje qytetare myslimane shqiptare. Në ribotimin e dytë të tij, viti 1938, botuesi dhe autori u kujdesën të vendosin në trajtë teksti prefativ një dosje të pasur me rreth 15 artikuj nga shtypi kulturor por edhe letra lexuesish e intelektualësh të ndryshëm, që të gjitha në funksion të aktit solidarizues pro lirisë së femrës dhe sidomos të aktit denoncues të këtij romani duke shndërruar në publike, pra duke pohuar publikisht, diçka që ndodhte çdo ditë, pafundësisht në shoqërinë shqiptare. Bien në sy në këtë dosje letrat e tri grave të dërguara në adresë të autorit:

Njëra është e zonjës Emine Toptani, si nënkryetare e Qendrës së shoqatës "Gruaja shqiptare" e cila e cilëson sjelljen zakonore të mbylljes dhe keqtrajtimit pa asnjë të drejtë vetëvendosjeje të gruas si "zakone shtëpiake dhe shoqënore të dâmshme, si rezultat i sundimit të huaj shekullor, të cilat na pengojnë të hyjmë në rrugë të përparimit dhe të qytetërimit"[24];

Letra me pseudonimin "Flaka", dërguar nga një zonjushë Dibrane, e cila shprehet me një formulim jo pak feminist se: "Do të vijë dita që na, pa qenë nevoja të bërtasim "sikur t'isha djalë", të bashkueme nën flamurin e "Lirisë" do ta gjemë "vetë" rrugën e drejtë: rrugën e shpëtimit"[25]; si edhe "Shqipnija do të qëndronte nalt, shumë mâ nalt,

23 KOKALARI, Musine, *...sa u tund jeta,* në *Vepra*, Shtëpia botuese "Faik Konica", Prishtinë, 2004, f. 169
24 STËRMILLI, Haki, *Sikur të isha djalë*, Shtëpia botuese "LETRAT", Tiranë, 2002, f. 18
25 Ibid. f. 22

sikur poeti mos t'i këndonte fluturës e qiriut; sikur shkrimtari mos të çonte kohën tue përshkrue "kokonën e pazarit", por me pendat e tyne të coptojshin, të hedhshin poshtë maskat e zeza; të zbulojshin zânat e burgosuna, t'i këndojshin "njeriut-qiri" që tretet atje brenda; (etj)"[26];

Letra me pseudonimin "Kolombja", dërguar nga një zonjushë gjirokastrite në të cilin stili denoncues i afrohet po ashtu ligjërimit feminist, në kuptimin e një ligjërimi diferencues nga pikëpamja "gender": "Le të zgjohet dikush, në mos disa prej atyre që përbëjnë elitën shoqnore dhe le të trondisij me zërin e tij të lartë turmën e injorantëve fanatikë" [...]; "Të gjithë na përbuzin, disa dhe na urrejnë, por na i gjetnë rastin, kur ne s'u kemi ngenë as t'i kundërshtojmë! Goja jonë është e mbyllur, e puthitur, e s'mund të flasë... Duart janë të lidhura shtrënguar, me vargonj të pakëputshëm, e s'mund të lëvizin... Durojmë në heshtje çthurrjen e jetës sonë mizore e njëkohësisht shkatërrimtare që lohet mbi kurriz tonë prej turmave të fuqishme të seksit mashkullor". [27] Në fakt, "Kolombja" është pseudonimi i shoqes së ngushtë të Musine Kokalarit, Selfixhe Ciu, edhe ajo debutuese në mesin e viteve '30 si shkrimtare në faqet e shtypit të kohës.

I sollëm këtu këta shembuj për të rrokur me të shpejtë ndjeshmërinë sociale të një problematike të mprehtë e aspak sporadike në Shqipërinë e viteve '30. Kujtojmë këtu edhe dekretin po atyre viteve të qeverisë së Mbretit Zog për heqjen e ferexheve dhe shkollarizmin e vajzave. Por edhe më domethënëse janë vetë skicat publicistike që Musine Kokalari botonte menjëherë mbas maturës, në vjeshtën e vitit 1937, në të përditshmen "Shtypi", duke na dokumentuar tashmë ndjeshmërinë dhe prirjen e saj të shpallur ndaj çështjeve "gjinore/gender" edhe përpara se të botonte veprat e veta. Në këto shkrime, të cilat, deri diku sentimentale, nuk e kanë forcën e penës së shkrimtares së ardhshme, spikat gjykimi i fortë, denoncimi,

26 Ibid. f. 23
27 Ibid. f. 12-13

por edhe paralajmërimi, i vendosur në trajtë mbititulli - "Kur sundon zakoni"- për të dyja ciklet e skicave, 22-26 tetor, dhe 4-18 nëntor 1937. Në ciklin e parë, përmes rrëfimit (në vetë III) për tjetrën ndiqet fati i një vajze qysh me ndërprerjen e shkollimit të saj, mbylljes dhe izolimit fizik e shpirtëror brenda mureve të shtëpisë deri në ndjesinë e skllavërisë, te vendimi për fejesë dhe urimet e pakuptueshme, te martesa e përjetuar si "largesë", mpirje emocionale dhe "varrosje prej së gjalli" prej heroinës dhe tregimtares, mbërrihet në pjesën e fundit me titullin "Koha" te një shkrim me natyrë programatike, ku kohës i besohet ndryshimi progresiv i shoqërisë dhe jetës së individit.

"Ne jemi, ne dimë, thërritnin prindërit. Janë të paditur, axhaminj nga mendja, shanin të rinjtë që vazhdonin shkollën. Dolli turpija sheshit, s'lanë gjë pa bërë vajzat e zbuluara, oshtinte shpirti i fanatikut" [...] "Koha, ndryshonjësia e çdo e çdo gjëje, nuk la mangut zbutjen e shpirtrave të disa prindërve më të ndjeshëm nga jeta. Ata i lanë mënjanë zakonet, idet e mykura, thashethemet. Kuptuan vlerën e mësimit, nevojën e shkollës, lartësimin e femrës". [...] "E quajtën dhe ata gruan jo më të ulët kundrejt burrit por të barabartë. I lanë të lira dhe sot shumica e vajzave ndjekin me qejf shkollën... për të mësuar, për të patur një diplomë në dorë për kohën e ardhshme"[28].

Cikli i dytë, ndonëse trajton një heroinë të ngjashme e me fat të ngjashëm zhvillon rrëfimin e unit (në vetën I) femëror si dëshmim e denoncim i drejtpërdrejtë i heroinës për tragjicitetin e jetës femërore thuajse duke ecur nëpër të njëjtat cilke të përmbyllura jetësore: fëmijëria e përbuzur, pavlefshmëria e të lindurit vajzë e jo djalë, shkollimi i pjesshëm, izolimi, vendosja e ferexhesë, planet për fejesë e martesë, përgatitja sfilitëse e pajës, moskuptimi nga ana e nënës, pohimi paralajmërues i një "martese burg". Por ai ka një strukturë të përmbysur, nuk mbaron por fillon më një shkrim programatik duke shpallur përmes shumësit "ne" femëror ndryshimet e pakthyeshme

28 KOKALARI, Musine, "Koha", në "Shtypi", 1937, nr.133, 26 tetor, f.2./ Aut : Muza (pseud.)

mes dy brezave dhe thuajse dy botëve:

"Ja dhe ne arritëm të shohim me sytë tona ndryshimet e mëdha që solli koha, mënyrën e jetesës, rritjen e këtij brezi të ri. [...] "Tashti edhe ne me lotë në sy, kujtojmë ato kohë t'atëhershme që kemi kaluar brenda katër mureve t'errëta, në frikën e prindërve t'egër... dhe sot rinia argëtohet me një mijë mënyra të ndryshme." [...] "Kjo ishte jeta jonë... e vajzave të reja, dhe sot? [...] Krejt e kundërta. Në atë kohë, kur ne kishim filluar punët e shtëpisë, vajzat e sotme ndjekin shkollën fillore. Ne qëndronim të mbyllura kurse sot ndjekin shkollat e mesme. Ne bëheshim nëna, sot quhen akoma të vogla dhe ne kur plakeshim, sot martohen..."[29]

Pavarësisht tipave të ndryshëm të shkrimit, nuk është e vështirë të lexohen ideologjemat e përbashkëta mes këtyre skicave dhe shkrimeve letrare që do të pasojnë shumë shpejt në shkrimtarinë e Musine Kokalarit.

Përmbledhja *Siç më thotë nënua plakë* shkruhet vetëm një vit më pas dhe botohet më 1939, duke vënë në kontrast dy botë të papërputhshme, por tashmë edhe të mbivendosura. Koha e "nënos plakë" ka perënduar dhe i ngjan një teatri të madh jete, plot kërshëri, ngjyresa, frazeologji por edhe shumë mizori, skenën e të cilit mund ta risjellë tashmë pranë publikut vetëm Letërsia. Është e qartë se ky është në thelb një qëndrim i vullnetshëm i zonjushës Kokalari, e cila ka vendosur ta zbresë përmes penës së saj këtë botë, ndonëse paralele me të dhe botën e saj, në të shkuarën historike të vendit të vet. Por përmes shkrimit a-historik më të cilën e ndërton këtë botë "të perënduar" ajo i jep zërin e fortë të së tashmes së epokës së vet. "Liria e grave kalon përmes gjuhë-ligjërimit" ["La libération des femmes passe par le langage"] shkruane në vitet '60 ideologia dhe shkrimtarja feministe Hélène Cixous. Liria e grave të Musine Kokalarit po vinte dalëngadalë përmes gjuhë-ligjërimit, duke profiluar

29 KOKALARI, Musine, "Ahere dhe sot", në "Shtypi", 1937, nr.141, 4 nëntor, f.2./ Aut : Muza (pseud.)

së pari një identitet gjuhësor e etno-kulturor të tyre.

Duke iu rikthyer nga kjo pikëpamje romanit *Sikur të isha djalë* të Stërmillit, kuptojmë se sa e vështirë është të gjendet në të një përvijim, qoftë edhe si imitim pasiv i ligjërimit dhe gjuhës femërore. Ligjërimi i Dijes nuk përkon me nivelin e saj të shkollimit dhe shkëmbimit kulturor, por mbi të gjitha (po në emër të së vërtedukshmes aristoteliane), nuk shtjellohet përmes trajtave të ligjërimit femëror, duke na dhënë vetëm gjininë gramatikore të shqipes në femërore por jo nuancat dhe ndryshimet qoftë psiko-gjuhësore e qoftë ligjërimore. Me fjalë të tjera, Dija flet e shkruan si një burrë! Madje ky aspekt nuk ka përbërë as shqetësimin e vetë shkrimtarit i cili as nuk diferencon ligjërimin e tij si rrëfimtar, nga ai i Dijes, shoqes, atit, njerkës e madje as të Shpendit të saj.

"Kush mundet me më sigurue se nuk ka mijëra femna që, tue kundrue mbas kafazit të dritares ose nëpërmjet perçes së hollë, nuk shprazin nga goja mija e mija tubëza vjershash për ata që u kalojnë pranë pa ditë se kanë plagosë randë disa zemra të strukuni brenda disa krijesave të dënueme me burgim të përjetshëm? Sa e sa sy vajzash, nga plasa e dyerve ose ngabirat e kafazeve, ndjekin e përcjellin kalimtarë të rinj me rrafje të forta të zemrave që s'kanë liri e të drejtë shfrimi dashunimi, megjithëqë natyra edhe ato, sikundërse meshkujt dhe ndoshta edhe ma shumë se ata, i ka pajue me ndjesitë e dashunisë". [30]

Ky është një fragment nga shkrimi (pra diskursi) i Dijes, ndërsa ka raste kur vetë ligjërimi i Shpendit ngjan me femëror e sentimental se vetë ai i Dijes:

"Pse ta mshef, o shpirti im, dëshpërimi që ndjej më duket se do ta tradhëtojë vullnetin tim për të mos e shkelë vendimin e dhanë që ta duroj këtë fatkeqësi. Shumë herë më mposht dëshpërimi dhe zhgrehem në vaj. Qaj si foshnjë për ëngjellushkën time që ma grabitën, qaj për zemrën time e tanden që u dënuan me vdekje dhe qaj për ato orë të pakta lumnie që nuk mund të përsëriten ma." [31]

30 STËRMILLI, Haki, Vepra e cituar, f. 28
31 Ibid. f. 164

Këto pak shembuj i sjellim këtu vetëm për të vënë në dukje gjetjen metodike të shkrimtarisë së Musine Kokalarit në sfidë për ndërtimin e një identiteti ligjërimor femëror e përmes tij edhe të një identiteti njerëzor, i cili kërkon tashmë dinjitet njerëzor e barazi gjinore për të jetuar e për t'u zhvilluar. "Musine Kokalari hyn në thellësi drejtpërdrejti në thelbin psikologjik. Menjëherë, ajo bashkëjeton me atë që na rrëfen. Nuk tall as nuk qesh përciptas, nuk vajton dyke spiritëzuar. Situacioni komik i saj përmban një tragjedi, një tragjedizmë me të vërtetë për të ardhur keq mi karakterin ose mi fatin, që është destini i njeriut, veçanërisht i njeriut-grua" – shkruan bashkëkohësi Lazgush Poradeci[32].

Ndaj tekstet e saj ngjajnë të reja e të moçme si vetë gjuha. Musine Kokalari diti të krijojë pasqyrën ku mund të shiheshin të gjithë: vajza e plaka, burra e gra, motra e vëllezër, nëna e baballarë. Shihuni, ju jeni kështu, ju jeni aty, në palat e pajës, në enigmat e ligjërimit, në hijen e rëndë të burrave, në fshehtësinë e padepërtueshme të odave, në absurdin e patjetërsueshëm të mblesërive, në marramendjen e martesave, në ecejaket e përjetshme të fqinjave, në vetullngrysjen e pozës mashkullore, në puthadorën ceremoniale, në fjalët me ojne të grave, në botën e heshtur të burrave. Të gjesh diçka nga vetja, madje edhe atë që ke braktisur, ke shmangur, ke luftuar, e ke mundur a të ka mundur. Nuk ia hoqi mundësinë askujt të shihej në të, të gjente copëzën e vet të jetës, i mrekulluar, i çuditur, i bezdisur, i zemëruar, i fyer, i përkëdhelur. Çdokujt një vezullim të së vërtetës së jetës. Arti i saj ishte kjo derë bujare që ftonte me modesti secilin dhe secilën, të hynte në hapësirën e letërsisë për të dashur më shumë, për të njohur më mirë, për të kuptuar lirinë e vetes dhe të tjetrit. Ajo i ftoi qytetarët e vendit të vet, të rriteshin, të njerëzoheshin, të bëheshin më të bukur. Ia doli mbanë aty ku shumë shkrimtarë të tjerë shqiptarë ende ngurronin. Dhe e bëri me elegancën e papërsëritshme femërore....

32 PORADECI, Lasgush, artikulli i cituar, f. 6-7

Po mbyllim këtë kumtim duke kujtuar edhe një herë entuziazmin e merituar që shkrimtarja e re Kokalari ndezi në shqisën e mprehtë kritike të poetit më modern shqiptar të bashkohësisë së saj: "Ç'duhet përfunduar prej kësaj veprëze pa pretendime, prej kësaj prove shkrimi femëror shqiptar? Art, domethënë realizim [...]" Ne i falemi nderit – vijon ai, me gjithë zemër për paraqitjen letrare të këtyre subjekteve të neveritura, veçanërisht për stilin e ri, substancial (etj)".[33]

Vetëm diku ajo heshti, nuk mundi a nuk diti si të shkruajë. Heshti po aty ku edhe të tjerët deri atëherë patën heshtur. Copëza që mungon thërret më shumë se të tjerat. Nata e parë martesore e bën penën e saj të çlodhet. Se ç'ndodh përtej kësaj porte nuk ka ç'ju duhet. E kush do të guxonte asaj Shqipërie t'i rrëfente shqip ato gjëra të pathëna...?!

33Ibid.

Prof. Dr. Mimoza KARAGJOZI KORE
Universiteti i Tiranës

Vepra e Musine Kokalarit, dëshmi etnolinguistike e Gjirokastrës së viteve '30, memuar i çmuar i ditëve të sotme

Gjirokastra është një nga ato qytete të vendit tonë që ka pasur fatin të bëhet e njohur jo vetëm për veçoritë arkitektonike te saj, për të cilat ka pasur vlerësime nga të huaj e vendas, por të përmendet edhe për penat e fuqishme që lindën në këtë qytet si: Eqrem Çabej, Ismail Kadare e Musine Kokalari.

I pari u mor në mënyrë ballore me problemet më të thekshme linguistike, por edhe pse një gjuhëtar i madh, krahasimin e parë të etimologjisë së çdo fjale e nisi nga vendlindja me shprehjen "në të folët e mi i thonë…"

Ismail Kadareja na ka lënë krijimtari në të cilat qyteti i lindjes është bërë fabula artistike e veprave të spikatuara e të vlerësuara tashmë nga të gjithë. Ai e shndërroi në një personazh të madh e të çudishtëm Gjirokastrën, në të cilin thyhen jo vetëm ligjet e urbanistikës, por shpesh edhe rregullat më të përgjithshme e të zakonshme të një shoqërie. Kjo e bën të veçantë këtë qytet e njerëzit e tij, të cilët zhvillohen e gjëllijnë në veprën e shkrimtarit sipas ligjeve dhe rregullave të veta.

I mbërthyer faqes së malit, i gurtë e gati prehistorik si prej luspash gjigande, ky qytet ka ruajtur ashtu siç e shpreh aq bukur Kadare në romanin *Kronikë në gur* "mishin e butë të jetës". Nën korracën luspore, kacavjerrur Malit të Gjerë, jeta është kapur fort me të hidhurën e bukurinë e saj. Të gjitha këto përshkruhen në gojën e gruas gjirokastrite, dhënë mjeshtërisht në veprën e Musine Kokalarit.

M. Kokalari, edhe pse mjaft e re e pa përvojë të gjatë, mbetet shkrimtarja e parë e vendit tonë, kurse vepra e saj pasqyrë e gjallë e etnografisë së komunikimit të grave gjirokastrite. Brenda këtij modeli etnografik të foluri përvijohen edhe një varg dukurish gjuhësore, disa prej të cilave gjenden edhe sot në këtë qytet, e disa të tjera janë zhdukur apo kanë evoluar në forma të reja. Për këtë arsye, diferencimi kulturor e kohor midis gjuhës së këtij grupi shoqëror, siç janë gratë, dhe asaj të sotmes, bën që vepra të marrë vlerën e relikteve të rralla gjuhësore ku mund të gjejnë lëndë studimi lëmitë letrare e gjuhësore.

Pse Musineja i nisi shkrimet e saj të para të prozës artistike me motivin e qytetit të saj?

Ne, përgjigjen e gjejmë në fjalët e autores: "Vendi ku ke lerë e je rritur / është dashuria e parë / që hedh rrënjë në zemrat tona".

Brumi gjuhësor i të folmes së vendlindjes përbën tharmin e kësaj vepre. Kanë qenë shumë shkrimtarë shqiptarë që janë përpjekur të ngrenë në shkallën e gjuhës së shkruar fjalë dhe shprehje të gjuhës së vendlindjes. Kështu kishin bërë më parë disa prej rilindësve tanë. Këtë bëri edhe autorja jonë e cila thoshte për rilindësit, si: S. Frashëri, N. Frashëri, S. Kolea, J. Vreto, De Rada e deri te A. Xhuvani "Unë jam nxënësja e tyre". Në këtë hulli ecën më vonë edhe J. Xoxa, A. Pashku, D. Agolli etj.

Me veprën e saj *Siç më thotë nënua plakë* (1939), u njohën edhe albanologë si A. Leoti, K. Mearini e C. Tagliavini. Ky i fundit, pasi e lexoi me vëmendje libërthin, i bëri një recension ku shkruan[1]: "Autorja

1 Letra ruhet në Arkivin e Shtetit Shqiptar, fondi M. Kokalari (nr, 437, dosja 81, f. 73)

shumë e re …na dhuron një libërth, i cili përveç vlerës letrare dhe sensit të humorit, ka rëndësi të konsiderueshme si një dokument gjuhësor. Në fakt ai është shkruar në dialektin e Gjirokastrës (madje në dialektin e shtresave më të ulëta) e është kështu për ne një nga fondet më të mira për të njohur dialektin e asaj qendre të rajonit toskë meridional".

Një tjetër albanolog i huaj prej botës gjermanike, Maximilian Lambertz-i njihet me vepën e Musinesë. Ai është nga ata studiues që nuk është përqëndruar vetëm në një fushë të dijes, por me një shumësi tematike rroku dhe trajtoi probleme të gramatikës (diakronike dhe sinkronike), sintaksës së gjuhës shqipe, të historisë së letërsisë. Në mënyrë të veçantë i kushtoi vëmendje të pandërprerë literaturës popullore, etnografisë e folklorit. Ky hulumtim i gjerë bëri që të hynte thellë në mendimin dhe trashëgiminë gojore e letrare të shqiptarëve, ta vështronte kulturën shqiptare si një tërësi, si një trashëgimi të vyer e organike në të gjitha trojet e ngulimet e mëdha ku jetonin shqiptarë. Është kjo arsyeja që objekt i punës së tij shkencore u bë "Eposi i Kreshnikëve", përrallat e tekstet nga folklori shqiptar, por edhe të folme të veçanta.

Në vitin 1957 Maximilian Lambertz-i rivjen në vendin tonë dhe më 1958 paraqiti një punim të gjerë shkencor i cili ende në shqipe nuk është i përkthyer, titulluar: "Shqipja e ligjërimit bisedor (Gjirokastra)" në revistën "Lingua Posnanienss", VII, 1958, (f.85 – f.144).

M. Lambertz-i është mbështetur për këtë punim, siç shpjegon edhe vetë, në prozën e Zihni Sakos dhe në veprën e Musine Kokalarit, "e sidomos,- thotë autori, - në librin e saj ...*sa u tund jeta* (1946) me vlera nga ana gjuhësore dhe folklorike". Është për t'u habitur fakti se si Lambertz-i ra në kontakt me këtë vepër, sepse edhe pse ndodhej në Shqipëri (1957), Musineja ishte ndërkohë e burgosur dhe librat e saj të paarritshme nga lexuesi apo studiuesi, qoftë ai dhe i huaj.

Nga shqyrtimi i punimit,[2] ne vumë re se shumë pak shembuj janë sjellë nga autori i parë, prandaj mund të themi se Lambertz-i është mbështetur plotësisht te M. Kokalari, duke shfrytëzuar pikërisht veprën ku përshkruhen më tepër se në veprat e tjera të saj, ritet dhe zakonet e dasmës gjirokastrite, e cila është njëkohësisht edhe pasqyrë e gjallë e etnografisë së komunikimit të grave të këtij qyteti.

Ajo përmban njësi leksikore e veçori fonetike e gramatikore të vjetra e tipologjike për këtë rajon toskë. Është kjo arsyeja që Lambertz-i, pasi ka studiuar të folme të trevave të Veriut të Shqipërisë, nisur nga vepra e Musinesë, befasohet me veçoritë e toskërishtes e cila është po aq e pasur e me tipare të dallueshme e prandaj dhe punimin e nis me fjalinë: Gjuha shqipe është plot jetë (:85).

Vepra e M. Kokalarit është një trashëgimi e vyer për të folmen e qytetit të Gjirokastrës, e duke qenë në prozë, tiparet e kësaj të folmeje dalin më të plota. Nga vëzhgimi që i kemi bërë veprës së saj vihet re se në të gjenden trajta arkaike e kjo rrjedh nga fakti se gjuha e veprës është gjuha e grave gjirokastrite, të cilat, të paarsimuara dhe të padala nga vendlindja, i kanë ruajtur më mirë e të papërziera këto tipare. Mjafton të përmendim se te kjo autore gjejmë trajta të hershme fjalësh, të krahasueshme edhe me librin e parë të gegërishtes, duke na provuar edhe një herë se në skajet e shqipes ruhen ende tiparet konvergjente, të cilat sot kanë humbur. Nga morfologjia e eptimit mund të përmendim formën e lashtë të mbaresës së rrjedhores –shit, një zgjerim të mbaresës -sh, refleks i indoevropianishtes –su e cila del në shprehjen e figurshme: më dolli hundshit. ...se ku të futem na ajo pastaj, ma kren hundshit. (*Siç më thotë …,* f. 46). (khs. te Gj. Buzuku:..ashtu edhe u vepërashit së këqijash (Mesh. 161/a); .. ņ pleqshit gjukatës (Mesh.165/a)

Lexuesi i veprës së Musinesë e gjen veten gjeografikisht në arealin

2 M. Kore, "Veçori gjuhësore të qytetit të Gjirokastrës në veprën e Maximilian Lambertz-it" në Konferencën Ndërkombëtare "Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht" organizuar nga Akademia e Shkencave e Kosovës, Prishtinë, 25 tetor, 2017

e bashkësisë gjirokastrite, sepse tiparet e të folmes së këtij qyteti spikatin dukshëm në të. Ndër studiuesit (V. Memishaj, 2011:238) ka lindur edhe pyetja në se autorja në mënyrë të vetëdijshme shkruan në këta regjistra gjuhësorë? Përkatësia dialektore gjirokastrite a i kufizon të shprehurit?

Musineja ishte vajzë e shkolluar e si e tillë ishte larguar disi nga e folmja e qytetit të saj, prandaj përdorimi i kësaj të folmeje në vepër është përgjithësisht i qëllimshëm. Themi përgjithësisht dhe jo plotësisht, se gjuha e veprës nuk është në tërësinë e saj e folmja e qytetit të Gjirokastrës. Kemi vënë re se, vërtet autorja ka përdorur një gjuhë dialektore, por ajo është e përpunuar dhe herë-herë e përzier me elemente të normës letrare. E themi këtë, edhe sepse duke qenë vajzë e arsimuar, shpesh në veprën e saj gjejmë trajta të letrarishtes së kohës, të cilat dalin si variante të formave origjinare të vendlindjes: Ishin shumë të varfër. (në Gjirok. qenë); …sa herë që punonte (në Gjirok. punon); Vajti në shtëpi (në Gjirok. vate); Ay që vinte na pas… (në Gjirok. ai që vin); … na vëllezërit s'don të dinte (në Gjirok. z'don) etj.

Në tiparet e shqipes së ligjërimit popullor është karakteristikë urdhërorja si kohë tregimore, e cila nga vëzhgimet e studiuesve[3] del edhe si tipar ballkanik (shqip-sllavisht-rumanisht). Në veprën e Musinesë vihet re një imperativ pa sufikse, që tregon një veprim të gjallë e përfaqëson kohën tregimore të së shkuarës: fol njëri e fol tjetri; largohu kjo e mbillu një portë; ha e këndo; hir e dil e qesh; këndo krushkat e këndo të shtëpisë.

Në Gjirokastër ende sot, sikurse në veprën e shkrimtares sonë, gjen pjesore të tashme të tipit: Dielli mbuluar dhenë; kënga vente shtruar (khs. me Veriun: mustakun derdhë n dy dega.)

E folmja e vendlindjes shfaqet më mirë në vepër, në momentet

3 Victor A. Friedman, "Urdhërorja treguese në gjuhët ballkanike" në *SHQIPJA DHE GJUHËT E BALLKANIT ALBANIAN AND BALKAN LANGUAGES*, Prishtinë 2012

e përshkrimeve të mjedisit familjar, bisedave të grave e zakoneve të qytetit. Kjo bën që veprës së saj studiuesi t'i qaset edhe në planin sociolinguistik. Personazhet e veprës së Musinesë, të cilat individualizohen edhe nëpërmjet gjuhës, janë gratë e vajzat e qytetit. Karakteristikë e të folmes së tyre janë së pari shprehjet frazeologjike, të cilat Musineja i ka vërejtur me kujdes dhe i ka pasqyruar gjerësisht në veprën e saj. Shumë nga këto shprehje përdoren edhe sot nga ky grup shoqëror. Ato në vepër dalin në variantin fonetik të së folmes së autores. si: lihet shtëpija në ditën e kujos, s'tunden nga vëndi, na merrnin këmbët, ua hoqi atë çikë mënde ua bëri fiu, s'na vë veshin, arritnë qellin me dorë, m'u bënë sitë miza - miza, unë as kokën nuk të kthej, nuk ta var torvën, nuk të ka njeri në mënde, s'të kam gjetur ndonjëherë anën, s'të ndezi në grikë, si s't'u bë helm, na i fshive nga faqe e dheut, s'e kam për fis, jam nga derë e parë, të mbenë vajzat brenda, mbeftë nënë e shuat etj.

Në veprën e kësaj autoreje gjejmë njësi leksikore të cilat nuk janë pasqyruar nëpër fjalorë, por që janë të gjalla ende në këtë të folme. Kështu gratë gjirokastrite janë mjeshtre për cilësimin e tipareve, prandaj në gjuhën e tyre gjejmë mjaft mbiemra: përçmakë, e mbetura brenda, suratpllaçko, shastizmeno, golështrëmbëta, zemërngushtat, haçko-hiçkë "grua që s'di të mbahet", berdu " e përdalë", gjuhustër, e vdekur e pakallur, pilivri " fig. e lëvizur" etj.

Është i njohur fakti midis gjuhëtarëve që në Jug të vendit nuk dallohet mirë kategoria e gjinisë, ndryshe nga gegërishtja. Te Musineja gjenden forma të emërores e thirrores ku vajza thirret bir ose biro dhe e ilustron me vargjet e këngës popullore: bir, vetullat e holla!

Edhe pse gra të pashkolluara, përshkrimin e bukurisë apo hireve të një vajze atyre do t'ua kishte zili edhe një shkrimtar. Në këtë rast janë dorëlëshuara dhe gjetjet e tyre janë nga më të bukurat: "Është vajzë, për kokën e vajzës. Ç'ta shoç, si drita. Ka di kosa na prapa, ashpër

e pisë të zeza. Ka një si e një vetull që të pret. Surat grumbullore. Ka di të shkreta faqe, që s'i shuhen. E bardh e kuqe. Ka një qafë si zorkadhe, me një shtat barjak. S'të hiqen sitë tek hin e del. E mirë e njerëz të mirë. E çapit dhe e vrapit e gërshërës e gjëlpërës. Ç'i sheh siri ja bën dora.Gojë ka e gojë s'ka. S'i dëgjonet zëri kallogresë" ("S'ja gjen çiftin", *Vepra*, Prishtinë, 2004:172).

Krakteristikë tjetër e këtij grupi shoqëror janë edhe përdorimi i eufemizmave të cilat sipas përkufizimit të Çabejt "…konsistojnë në këtë që një frymor, një send, një koncept, një figurë e besimit popullor, një sëmundje në disa rrethana evitohet të quhet me emrin që ka …por mbulohet me një tjetër".[4] Gratë për nga natyra u tremben më shumë forcave natyrore, sëmundjeve, vdekjes etj, prandaj edhe i përdorin shumë ato: e nxiruan, e shkretuan, e përmbisnë, mbeftë nënë e shuat. Nga ana tjetër eufemizmat përdoren nga gratë edhe në rastet kur kanë droje, madje gratë gjirokastrite edhe fjalën turp e përdorin me sqimë: i vinte ashtu na babai.

Ndryshe nga burrat, gratë përdorin shumë pasthirrma e tingullimitime dhe në thjeshtligjërimin e grave gjirokastrite ato ndihen shumë edhe në ditët e sotme. Kjo bën që e folmja e Gjirokastrës, në veprën e Musinesë, të ndihet e gjallë, sepse ajo ka ditur të dallojë bukurinë e kësaj të folmeje edhe te përditshmëria: u, u kijameti, u..pika, hë...de, gëk!, ah...i djegtë zoti! uh moj korbë, çu- çu- çu-ra, fësht i shkoi një gjë, u...pika në kokë!

Gratë sipas Fisherit kanë një përulje më të dukshme, një përzgjedhje më të kujdesshme ndaj stilit. Pikërisht, kjo përulje e shoqëruar deri-diku me ndjenjën e turpit ka bërë që gratë gjirokastrite të mos i drejtohen të shoqit asnjëherë me emrin e tij. Një sjellje e tillë mund të vërehet ende sot në brezin e grave të moshuara të këtij qyteti. Kështu në vepër gjejmë: i thaçë edhe këtij (burrit), pa efendinë që flinte, pastaj agai do të ngrihesh, kafeja për të bërë,

4 E.Çabej, "Disa eufemizma te shqipes", *Studime gjuhësore*, Prishtinë, 1977, f.17-25

Gratë janë më të ndjeshme se burrat ndaj modeleve të prestigjit. Në këtë hulli mund të vështrohen edhe shprehjet apo fjalët që tregojnë respekt e mirësjellje e që te gratë janë më të shpeshta. Këto shprehje të njohura në gjuhësi me termin "hipokrizia gjuhësore" apo në etnolinguistikë si "kortezia gjuhësore" mund të shkallëzohen edhe sipas moshës së folëseve. Kështu, nuset e reja i përdorin më tepër ato kundrejt të moshuarave, si: Urdhëro brënda, xhiko Haxho; Veshi atë që deshi katënxhika. Shprehje të tilla i gjen shumë herë në fillim të bisedës, apo në atë që gratë në Gjirokastër e quajnë "të pietemi". Në këtë moment si përgjigje për ata për të cilët pyet bashkëbiseduesja vjen përgjigjja: Mirë, të marrin dorën! apo U ngre në këmbë, vate te nënua e i zuri dorën.

Vepra e Musinesë përmban edhe fjalë të huazuara nga greqishtja e turqishtja (më pak nga greqishtja dhe pak më shumë nga turqishtja, që është e kuptueshme edhe nga prejardhja e saj prej një nga familjet myslimane të qytetit). Huazimet e pakta në vepër shpjegohen jo aq me faktin se autorja është vajzë e shkolluar e me vetëdije nuk i përdor ato. Ne mendojmë se arsyeja duhet kërkuar tek gjuha autentike e grave të qytetit, të cilën e ka pasur si lëndën e parë autorja.

Në të gjithë Ballkanin e kësaj periudhe, e padyshim edhe në Gjirokastër, gjendja shoqërore i caktonte gruas vetëm detyra familjare dhe shtëpiake. Roli i saj ekonomik i dorës së dytë, kundrejt burrit, e linte atë pa arsim dhe jashtë jetës shoqërore aktive. Është e qartë, thotë ballkanologia Petja Asenova[5] se në botën dygjuhësore të Ballkanit, monoling do të ishte gruaja. Monolinguizmi i saj mbante bilinguizmin në Ballkan dhe në këtë mënyrë ndihmoi interferencën midis gjuhëve ballkanike, përfundon ajo. Veprimi ekonomik i burrit, puna jashtë shtëpisë, shkolla, marrëdhëniet tregtare me fqinjët e detyronte atë të komunikonte me dy, madje më shumë gjuhë, kurse gratë flisnin vetëm gjuhën amtare.

5 P. Asenova, "Gruaja monolinge në Ballkanin biling", në *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare*, 25/1, Prishtinë, 2006, f.106

Ngjarjet familjare më të rëndësishme ku roli i gruas është mjaft i spikatur janë, padyshim, lindja e një fëmije, fejesa, martesa e vdekja. Këto janë momente kulmore të jetës, të cilat L. Poradeci, që shkruante rrallë për veprën e dikujt i vlerëson kështu: "Autoresha e këtyre skicave rastësore e ka zënë jetën mu në mezin e saj, në momentin kritik që është momenti i math i çdo manifestimi të jetës njerëzore, që përmbleth dhe çfaq si një pikë tërësie gjithë kuptimin e vërtetë të jetës të çfaqur rastësisht. Zënia e jetës, kapja e menjëhershme e saj në fond dhe në formë dhe çfaqja imediate, pa asnjë ndërmjetësim, me anë të artit, kjo është origjinale - origjinalitet letrar... Origjinalitet i kapur shpejtazi dhe mu në thelb të zhvillimit psikologjik të jetës..„

Gratë janë shumë të përpikta në zbatimin e riteve në këto raste, aq sa mënyra se si i kryejnë ato bëhet shpesh burim vërejtjesh apo vlerësimesh. Si për çdo qytet e krahinë edhe Gjirokastra ka traditat e saj e shprehjet gjuhësore në këto raste. Kako Pinua i mori vetullën. Pastaj i bëri suratin me raki. I pjek lëkurën. I vuri koqinadhin, i shkojti hollë hollë sqafillin... Ja të thom prapë të shtatat nuk vete, nuk kam zëmër...na u kalp barku së gjithave...Të gjitha ishin bërë meit, s'i mbeti njeriut pa i ardhur keq për atë djalë, si të thaçë, kulloi odaja, atje qoftë.

Gratë gjirokastrite janë të përmendura si punëtore e të pastra, prandaj në vepër përshkrimet për punët që bëjnë gjatë ditës janë të shumta e me këtë rast edhe fjalësi për to paraqet gjuhësisht mjaft interes: Dindivani këmbë-këmbë tani vetëtinte na të larët. Nikoqirja vate në qilar e lau enët e darkës. Tenxheret i fërkoi e i fërkoi me hi sa i ranë gjishtret. I vuri gjërat nëpër vende dhe fshiu dëndivanin. Me fshesë dolli gjer te porta. Si fshiu vërat e guxhëvërat , lau duar e faqe.

Të gjitha veçoritë që vumë në dukje më sipër janë rezultat i vrojtimit të hollë të Musine Kokalarit. Si vajzë e shkolluar që ka parë edhe ambiente të ndryshme nga ai ku u rrit, si vëzhguese e hollë, ajo e kuptoi vlerën e pasurisë që fshihte qyteti i saj, e veçanërisht ajo pjesë e shoqërisë së kohës, siç qenë gratë.

Shumë nga karakteristikat e të folmes së grave të Gjirokastrës sot janë zhdukur. Ndryshimet në mentalitet e veçanërisht shkollimi i tyre kanë qenë faktorë që kanë ndikuar mbi këtë të folme, prandaj vepra e kësaj vajze të re duhet çmuar jo vetëm si arritje artistike, por mbi të gjitha si një relikt i vyer i ndërgjegjes së këtij grupi shoqëror, i materializuar edhe në gjuhë.

Msc. Meliza Krasniqi
Instituti Albanologjik - Prishtinë

Musine Kokalari përballë Migjenit

Vitet '30 do të kridhen në një dekadë që mund të karakterizohet nga depresioni ekonomik dhe rritja e ideologjive autoritare në Itali, Gjermani, Spanjë dhe padyshim më vonë edhe në Shqipëri. Qytetërimi perëndimor nuk ishte shëruar plotësisht nga Lufta e Parë Botërore dhe në këto rrethana çfarë mund të ishte roli i shkrimtarëve në një ambient të kthyer kokë poshtë? Si do të duhej një shkrimtar t'i përgjigjej varfërisë dhe urisë, në kohën e ngritjes së Hitlerit në Gjermani dhe Luftës Civile spanjolle? Shkrimtarët në Shqipëri, në këtë udhëkryq, zgjodhën shumëllojshmërinë e rrugëve perëndimore në aspektin e ideve filozofike, sociale, kulturore e letrare. Shtypi luante rol tejet të rëndësishëm, andaj edhe në Shqipëri u shtua numri i botimit të revistave, gazetave por edhe librave si botim më vete me karakter politik, fetar, letrar e shoqëror ("Minerva", "Ora", "Illyria", "Drita", "Zani i Naltë", "Demokracia", "Hylli i dritës", "Leka", "Tomori", "Bashkimi i Kombit", "Fryma", "Fashizmi", "Tomori i vogël", "Bota e re", "Përpjekja shqiptare", "Dielli", "Kombi", "Albania", "Drita")[1].

1 Kryeziu, R. (2008). *Nga Lindja në Perëndim*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.

Kjo periudhë kohore e quajtur edhe "iluministe" nuk mund të ishte ndryshe sepse shquhet nga emrat më të mëdhenj të letrave shqip: Mehdi Frashëri, Gjergj Fishta, Mit'hat Frashëri, Krist Maloki, Mitrush Kuteli, Anton Harapi, Branko Merxhani, Vangjel Koça, Tajar Zavalani, Nebil Çika, Ernest Koliqi, Lasgush Poradeci, Ndre Mjeda, Asdreni, Fan. S. Noli, Faik Konica, Stefan Morava, Arshi Pipa, Eqrem Çabej, Lasgush Poradeci, Namik Resuli, Kudret Kokoshi, Nonda Bulka, Dhimitër Shuteriqi etj. Krahas tyre, padyshim, edhe Migjeni por edhe Musine Kokalari, si shkrimtarja e parë shqiptare.

Patjetër që Migjeni me jetën dhe me veprën e tij do të bëhet një nga zërat më të dallueshëm në letërsinë shqipe të viteve '30. Vepra e tij është analizuar, interpretuar nga dhjetëra studiues e kritikë shqiptarë në shumë pikëpamje, fillimisht duke u nisur nga premisat biografike, sociologjike, psikologjike, filozofike e më vonë edhe qasje kritike-letrare të mirëfilltë. Figura letrare e Migjenit ka ngjallur jo pak interes, debate herë duke u glorifikuar e herë duke u anatemuar. Por ne do t'i kthehemi Migjenit këtu për të kërkuar dhe për të provuar një krahasim të veprës së tij poetike dhe poezive të Musine Kokalarit, sepse për të parin thuhet se solli një alternativë të re, të quajtur edhe poetikë migjeniane.

Vërtetë është mjaft e lehtë për të dalluar veprën letrare të Migjenit me atë të bashkëkohësve të tij. Në anën tjetër edhe Musine Kokalari bën të njëjtin rrugëtim, nis krijimtarinë e saj letrare me poezi, proza poetike e skica letrare.

Megjithatë, është e pamundur të kuptohet veprimtaria e kësaj periudhe në formë të plotë pa pasur njohuri mbi poetikën e atyre viteve të trazuara të fillim shekullit njëzetë.

Karakteristikat fiksionale dhe veçantitë me anë të së cilave duhet të gjykohet suksesi i veprave të Migjenit qëndron në aftësinë e tij për të shkruar mbi një "ambient të realitetit," ose një "iluzioni të jetës." Migjeni por edhe Musine Kokalari, si shumë shkrimtarë të

tjerë evropian të kohës, përqafuan një estetikë të realizmit, e cila vlerësonte pakursyeshëm, paraqitjet e sakta të realitetit psikologjik dhe material të jetës shqiptare. Herë –herë si shkrimtarë realistë e ekspresionistë, pra realist që u interesonte eksplorimi i problemeve të pabarazisë ekonomike dhe kapja e saktë e përvojës së jetës urbane që për çdo ditë ndryshonte Shqipërinë e viteve '30. Herëve të tjera, si realistë psikologjik, që shqetësoheshin në gërmimin ndër sipërfaqen e jetës shoqërore për të hetuar motivet komplekse dhe dëshirat e pavetëdijshme që formësojnë perceptimin e personazheve të tyre. Angazhimi i tyre për dokumentimin e realiteteve të jetës së përditshme në Shqipëri, njëlloj si realist, ekspresionist e realist psikologjik, ofrojnë një depërtim zhbirues në represionin, paqëndrueshmërinë dhe pabarazinë që strukturonte shoqërinë shqiptare të shekullit të kaluar.

Këta autorë iu përkushtuan eksplorimit dhe paraqitjes së ndikimit të klasës shoqërore në jetën shqiptare, duke zhvilluar teknika letrare të projektuara asisoj për t'i dhënë shkrimeve të tyre pamje të realitetit objektiv dhe vërtetësi psikologjike. Migjeni dhe Musine, si realistë dhe ekspresionistë, shkruajnë për të protestuar pabarazitë dhe shfrytëzimin që karakterizonte vendin. Vepra e tyre jep tablonë e problemeve sociale, duke përfshirë shtypjen e grave, paragjykimet, diskriminimin, varfërinë, mjerimin, punën. Ata tashmë, edhe kohësisht, ishin larg Romantizmit të vonë dhe përpiqen, secili në mënyrën e vet, të lidhen me alternativa ndryshe në këtë idiomë poetike.

Poetët, Migjeni dhe Musine shkruan poezi/vepra të ndryshme nga pararendësit, ishin modernë në realizmin dhe ekspresionizmin e tyre. Deri në vitet '30 poezia duhej të ishte konform disa rregullave të vendosura për rimë, ritëm, metër dhe përmbajtje. Poezitë e Migjenit sjellin një revolucion në botën letrare shqiptare sa i përket formës, temave dhe, natyrisht, diskursit. Këtë frymë ndjek edhe Musine Kokalari me vëllimin e saj të parë poetik që përmban 20 poezi por

të cilat, çuditërisht, janë lënë në hije. Poezia e autorëve tanë ndjek karakteristikat e poetikës moderne realiste dhe ekspresioniste që afërsisht do të mund të përmblidheshin në këto pika:

1- Liria e formës. Migjeni dhe Musine dalin nga konvenca, nuk përdorin strofën, rimën, metrin apo kufizime tjera formale.

2- Poetët më shumë i tërheq dhe i udhëheq mendja/intelekti sesa emocioni, siç ishte rasti me poetët romantik.

3- Ata shpesh shkruajnë në rrjedhën e diskursit apo mënyrës së vetëdijshme; duke lëshuar subkoshiencën të luajë rol të rëndësishëm, me raste. Duke pasur lidhje logjike mes mendimeve dhe ndjenjave.

4- Temat e tyre shpesh janë: njeriu i ditës, qyteti, revolta ndaj varfërisë dhe mjerimit dhe shqetësime të tjera të kohës që shprehnin neveri.

Millosh Gjergj Nikolla – Migjeni dhe Musine Kokalari jo rastësisht u quajtën uragan, i pari nga Ismail Kadare si "Uragan i pandërprerë" dhe e dyta "Vajza Uragan" nga Novruz Shehu. Jeta e tyre letrare prej uragani, e shpejtë dhe e furishme por e shkurtër do të ketë ngjashmëri me veprën e me njëri-tjetrin.

Boris Tomashevsky thotë se biografia që është e dobishme për historianët e letërsisë nuk është CV-ja e autorit apo vlerësim i hulumtuesve të jetës së tij. Historianëve të letërsisë u nevojitet një legjendë biografike e krijuar nga vetë autori. Një shkrim i tillë do të ishte fakt letrar[2]. Mbi bazë të kësaj kujtojmë se as Migjeni as Kokalari nuk kanë lënë ndonjë autobiografi me shkrim pa çka se vepra e tyre jo rrallë është lexuar e interpretuar duke u nisur nga kjo premisë. Migjeni dhe Kokalari mund të dalin autobiografik në poezi/lirikë dhe në prozë/tregim/novelë, por vepra e tyre shtrihet përtej këtyre formave.

Për shkak të fatit të tyre, vepra letrare e autorëve tanë do të lexohet e interpretohet duke pasë për kriter jetë-shkurtësinë e veprimit duke

2 Cituar sipas *Russian Formalist Criticism: Four Essays by Victor Shklovsky, Boris Tomashevsky, Boris Eichenbaum,* University of Nebraska Press (1965)

u paragjykuar e keqkuptuar. Si fakt jashtë-letrar le të sjellim ndër mend se Migjeni lind në Shkodër më 1911, Musine Kokalari pak vite më vonë në Adana më 1917; pas përfundimit të shkollimit, Migjeni emërohet nga Ministria e Arsimit më 1933 mësues në Vrakë, në anën tjetër Musine shkollohet në Tiranë dhe më 1937-38 fillon punën si mësuese në Institutin "Nëna Mbretëreshë." Migjeni boton poezinë e parë "Shpirtënt Shtegtar" në "Illyria" me pseudonimin Migjeni më 1934; Musine, më 1937, boton poezinë "Kolla e vdekjes!" në gazetën "Shtypi" me pseudonimin "Tacita". Migjeni do të shuhet përjetësisht më 1938, në moshën 26 vjeçare, përderisa vdekja letrare e Musine Kokalarit ndodh në moshën 28 vjeçare, sepse ajo do të arrestohet dhe dënohet me 30 vjet burgim, fizikisht ndahet nga jeta më 1983. Jeta e tyre letrare mbyllet dhe konsiston në pak vite shkrim.

Marrëdhënia e Migjenit me ekzistencializmin, ekspresionizmin e surrealizmin në fillimet e tij është kontradiktore. Me gjithë qëndrimet e përgjithshme të tyre të ndryshme rreth situatës politike/sociale në vend, të dy autorët kanë shprehur një indinjatë morale ndaj vuajtjes së njeriut që e shihnin dhe që e provonin, përmes poezisë së tyre, ata u përpoqën t'i japin zë varfërisë, mjerimit, dëshpërimit, nënklasës. Besoj se ngjashmëritë dhe dallimet midis tyre ndihmojnë në zbulimin e trajtave formale e tematike në thelb të dy poetëve. Këtë kërkim dhe krahasim e fillojmë duke theksuar se vëllimi poetik i Migjenit u botua më 1936 i cili u pezullua për t'u ribotuar i plotësuar me *Kangën e fundit* pas tetë vitesh, pra, më 1944, pas vdekjes. Vargjet poetike të Kokalarit janë shkruar në periudhën 1937-1938 për t'u botuar si vëllim i veçantë pas vdekjes gjithashtu.

Migjeni do të strukturojë librin e tij sipas një rendi logjik e tematik duke emërtuar secilin cikël në këngë, përderisa poezitë dhe skicat e Kokalarit të botuara nëpër shtypin e kohës qëndrojnë indiferente ndaj strukturimit mbi principin e temave, janë "të lira". Karakteristikë e poezisë së tyre është se qëndrojnë larg strukturës formale e tematike të letërsisë shqipe para tyre. *Referencialiteti vihet së*

pari me jetën e jo me letrën; as me oralitetin[3]. Tema dhe motive atdhetare në poezitë e tyre zëvendësohen me temat aktuale, shoqërore, me realitetin, me konfliktin e njeriut me veten dhe mbi një të ardhme të projektuar. Ne do të trajtojmë marrëdhëniet formale poetike të dy autorëve tanë, dhe do të zgjedhim poezitë e para të tyre për arsye se ata shkruajnë pothuajse në të njëjtën kohë, dhe pikërisht me këto vjersha fillon karriera e tyre e shkurtër letrare. Migjeni dhe Kokalari përdorin vargun e lirë, shmangin rimën, poetika e tyre ka ritmin e të folurit emocional sipas stilit të gjuhës bisedore[4] (Lloshi, 2005), ndërsa poetika e tematikës së tyre kap trajtat reale që jepen me një realizëm deri në asht.

*Shpirtnet shtegtar*ë në ciklin *Kangët e përendimit* është poezia e parë e Migjenit ku ai i këndon një "lirie të ëndërruar tjetërkund" një idealizimi, ndërsa poezia *Kolla e vdekjes*! është vjersha e parë e Kokalarit ku jepet në vargje një situatë në miniaturë, një tragjedi që lexohet si shprehje e realitetit duke përshkruar vdekjen ngadalë.

Mbramë një erë e ftohtë acar fryni nga ana e maleve,
i shkundi shpirtënt tonë – bashkë me gjethë të kësaj vjeshte
i muer andej kah dielli hijën si të përgjakët ua lëshon zalleve
- në Përndim, ku shtret e shkimet drita në pamundësinë e vet.

Shpirtnet shtegtarë **Migjeni**[5]

Era fryn, fryn me tërbim.
Pikat e shiut goditin xhamat e penxhereve,
kurrizin e të veshurve
të të braktisurve që enden rrugës.
Kolla e vdekjes! **Musine Kokalari**[6]

3 Shala, K. (2011). *Prolepsa*. Prishtinë: AIKD-99
4 Lloshi, X. (2005). *Stilistika e gjuhës shqipe*. Tiranë: Albas.
5 Migjeni. (2002). *Vepra*. Slloveni: GorenjskiTisk
6 Kokalari, M. (2009). *Vepra*. Tiranë: Geer

Krahasimi mbahet vetëm në nivelin formal e figuracional, tema ngelet dhe del e ngjashme në disa poezi të tjera të Migjenit. Vargu i parë i autorit *Mbramë një erë e ftohtë acar fryni nga ana e maleve* dhe vargu *Era fryn, fryn me tërbim* kanë të përbashkët simbolin e *Erës* që përfaqëson lirinë e lëvizjes, frymën, qëndrimin mendje-hapur, një ndjenjë shkujdesjeje. *Era* e Migjenit dhe Kokalarit mund të lidhet edhe me simbolin e ndryshimit, sjelljen e diçkasë së re duke fshirë të vjetrën. Sado i ndryshëm që është përcaktimi tematik i tyre në këto dy vjersha, ato përmbajnë në vete një ndjeshmëri të thellë, prandaj aty ku përfundon vargu i parë migjenian *Mbramë një erë e ftohtë acar fryni nga ana e maleve lirishit* mund të nis vargu i parë *Era fryn, fryn me tërbim* e Kokalarit.

Te *Kolla e vdekjes* Kokalari vendos gruan si personazh qendror, vendos një të mjerë që vuan nga sëmundja e mushkërive dhe nuk rresht së kolluri, që e braktisur në rrugë, pa iu dhimbsur askujt, vdes. Sëmundja triumfon, kolla ndalet ndërsa shiu *vazhdon të bjerë dhe vadit atë kufomë pa kujdesin më të vogël.*" Figurat e pakëta në fund të vjershës sugjerojnë një lexim alegorik të ri. Shiu që bie i referohet një gjendje të mjerë që krijon dramë, është aspekt natyror që sjell gëzim dhe trishtim. Vaditja në anën tjetër është proces artificial i ujitjes së tokës, bimëve etj. por jo i njerëzve, aq më pak i kufomave. Hapja e mundësisë së leximit alegorik të poezisë *Kolla e vdekjes*! na bën ta shohim një sistem figurash, ku gruaja që lëngon merr konotacion të dyfishtë, përveç si grua, ajo do të simbolizojë vendin të prekur nga sëmundja e pashërueshme e kohës. Në çdo gjuhë kolla kërkon shërim dhe kthen vëmendjen.

Ndërsa poeti me *Shpirtnet shtegtarë* kërkon një dalje të re, një të ardhme duke ndërtuar një besim të ri. Bën endjen e shpirtnave nëpër vise të Perëndimit për t'u kthyer si shtegtarë të mërguar në origjinë. Shpirtërat nuk shtegtojnë por zogjtë, shtegtimi i shpirtit në besime e kultura të shumta kalon nga një trup në tjetrin, njerëzor, shtazor,

apo të pajetë. Gjetja është interesante se, sikur fenomeni i zogjve, edhe shpirti e di se do të kthehet pavarësisht se i do ato vende me një dashuri tragjike.

Krahasimi i radhës është ai i emërtimit të poezive në këngë. Në ballë të secilit cikël poetik të Migjenit është emërtimi kangë për poezinë, përderisa Kokalari ka vetëm një poezi të titulluar me këtë emërtim *Këngë e vërtetë*. Rexhep Qosja e dallon fenomenin e quajtur këngë kur thotë: *Prej fillimeve të Rilindjes Kombëtare shqiptare e gjer në fillim të Luftës së Dytë Botërore, pjesa më e madhe e poetëve shqiptarë kanë kënduar një këngë të posaçme: këngën e flijimit për hir të popullit, këngën e pakënaqësisë me realitetin historik dhe shoqëror dhe këngën e besimit për të ardhmen*[7]. Këtu kujtojmë *Këngët e Milosaos* të De Radës, e më vonë edhe Ali Asllani *Këngë të dashurisë*, Nexhat Hakiu *Këngët e Zambares*, Petro Marko me *Këngë e re*, *Kënga e valës* etj, të cilët shkruan poezi lirike e që burojnë nga këngët popullore të punës, të djepit, të vajit e nga këngët rituale.

Poezia lirike artistike i ka rrënjët te lirika popullore. Për një kohë të gjatë poezia lirike ruajti karakterin e një kënge që shprehte ndjenja kolektive, si p.sh. në himnet luftarake e qytetare të poetëve të vjetër grekë Tirteu e Simonidi[8]. Poetët modernë i qëndrojnë besnikë këtij konceptimi të *poezisë* lirike. Dhe sot, është absurde të pretendohet se *Kënga* në vetvete ka më pak vlerë sesa poezia, megjithatë *Kënga* jo lehtë në kuptimin kulturor merr titullin e rafinuar të poezisë. Kjo sepse në letërsi poezia supozohet të jetë "më serioze", e cila shkruhet në atë formë që pasqyron zotërim të dukshëm të manivereve letrare (qoftë formale, si rima ose gjuha metrike). Duket se Migjeni dhe Kokalari si njohës të poezisë së kohës e kishin bërë këtë emërtim qëllimisht duke ditur se poezitë janë *letrare* ndërsa *këngët* në anën tjetër janë më *popullore*, meqë ato shkruhen me gjuhën e njerëzve të rëndomtë dhe kuptohen më lehtë. Në fakt, dallimi më i rëndësishëm dhe më me interes midis këngës dhe poezisë janë

7 Qosja, R. (1998). *Panteoni i rralluar*. Tiranë: Naim Frashëri
8 Leka, F. (2013). *Fjalor i termave të letërsisë*. Tiranë: Infbotues

fjalët në poezi që zënë vend kundër kontekstit të heshtjes, ndërkohë *vargjet e këngës* mbahen në kontekst të informacionit muzikor: melodisë, ritmit, instrumenteve etj. Pa këto vargjet nuk funksionojnë. Refreni, përsëritja, komunikohet në mënyra të ndryshme në *këngë* e ndryshe në poezi.

Këngë e vërtetë (*Musine Kokalari*)

Vajtime ndëgjoheshin
psherëtima më dilnin
prej thellësirës së krahrorit.
...

Vajtime ndëgjoheshin
Psherëtime dilnin prej thellsirës së krahrorit.
Kish humbur shpresa
Qe çdukur vet-besimi[9].

Dhe më vonë, diku tek strofa e gjashtë dhe e tetë, shohim një përsëritje në formë refreni në fillim të vargut të parë prapë:

Është kënga, kënga e vërtetë
Lindi ngadalë
...
Është kënga e vërtetë
që ndëgjohet dhe oshtin nga të gjitha anët,

Kokalari përdor strofën e përzier, por ai që dominon është shtatvargëshi me rimë të organizmit të ndryshëm. Gjuha e poezisë së Kokalarit duket shumë e thjeshtë, shumë e drejtpërdrejtë, gati-gati jo-poetike. Kjo poezi, por edhe poezitë tjera të Kokalarit, nuk përfshijnë shumë figura a metafora të mbyllura ose frazelogji poetike, ritëm të

9 Kokalari, M. (2009). *Vepra*. Tiranë: Geer

rregullt dhe efekte të tjera retorike që i atribuohen poezisë. Edhe pse rendi i fjalëve përsëritet në vargun e parë e të dytë të strofës së parë dhe të dytë, do të mund të gaboheshim për një version të dikujt që flet, dikujt që joformalisht komenton *kohën e keqe që shtypte njerëzit*.

Në anën tjetër libri i Migjenit i ndarë në gjashtë Këngë, të Ringjalljes, Mjerimit, Përendimit, në Vete, të Rinisë dhe të Fundit përmbajnë edhe nëntë poezi të tjera me këtë emërtim dhe përafërsisht të gjitha njëlloj përsëritjen/refrenin e kanë poetikë të brendshme.

Kangët e pakëndueme (*Migjeni*)
Thellë në veten teme flejnë kangët e pakëndueme
të cilat ende vuejtja as gëzimi s'i nxori
...

Thellë në veten teme kangët e mia jesin...
e unë jam vullkan që fle i fashitun,
...
Ose*:*
Kanga e rinis *(Migjeni)*

Rini, thueja kangës ma të bukur që di!
...
Thueja kangës, rini, pash syt e tu...
...
Rini, thueja kangës dhe qeshu si fëmi![10]

Dy poezitë e Migjenit hyjnë te *Cikli i Këngëve të Ringjalljes*, kjo e fundit apo *Kanga e Rinis* është një himn e një thirrje për rininë, për lindjen e një kënge që do të zgjojë Botën e tyre të re. Vargu i fundit *Qeshu, rini! Qeshu! Bota asht e jote* e ka bërë këtë poezi të pavdekshme dhe të famshme. Ndërsa poezia duket relativisht e drejtpërdrejtë, ka

10 Migjeni. (2002). *Vepra*. Slloveni: Gorenjski Tisk

ambiguitet krahas strukturës së sonetit me 14 vargje të ndara në dy katërshe dhe dy treshe, me rimë aabb/aabb, ndërsa tercinat aca/cdd. Kjo poezi ka një ton optimist dhe ndjeshmëri hareje, emocioni dhe energjie.

Musine Kokalari në përmbledhjen *Kolla e vdekjes*, shkruan 20 poezi, 6 proza poetike dhe 29 skica e tregime të lidhura. Në të gjitha këto poezi zotëron një frymë pesimizmi, një konfuzion politik e artistik që sillte një perspektivë bardhë e zi dhe prosede i tyre ishte përshkrimi i reales. Migjeni kishte botëkuptim ndryshe, vizioni artistik i tij ishte autonom, por edhe kahja politike ishte e papërputhshme me Musinen. Në përmbledhjen *Vargjet e lira* ka 43 poema të cilat frymojnë me pesimizëm gjithashtu, sidomos *Poema e mjerimit* ku përshkruhen në formë mjaft reale, lypësit, laviret, të papunët, pijanecët etj. Poezia e Migjenit ka edhe prirje groteske, ka mjaft shembuj ku përballemi me situata e personazhe të tilla.

Ky krahasim mund të duket i thjeshtë, sepse ne krahasojmë gjatë gjithë kohës, vërejmë ngjashmëritë dhe dallimet në disa vepra letrare. Ka pra mënyra në të cilat dy autorët janë të ngjashëm, por ata gjithashtu kanë dallime. Të gjitha poezitë e Kokalarit kanë subjekt, dhe ky subjekt zakonisht paraqitet në strofën e parë, vargun e dytë e të tretë si një mendim a si një formë shpjegimi. Ka raste kur vargu i parë i strofës (pesëshe, shtatëshe etj.) është më i zgjatur dhe lëviz shkarazi, madje jo sipas ndonjë rregulli, ka veprime nga njëri në tjetrin.

Përse ke lindur?

Një grumbull fëmi lozin në rrugë
Rendin vajzat pas topit,
qeshin, kërcejnë dhe s'rrinë të qeta.

Ose:

Ti

Shpesh herë mendohesh,
pyet vehten t'ënde dhe e do,
jo, më vonë e urren deri në vdekje.

Si shumë vargje moderne të Migjenit, poezitë e Kokalarit orvaten për një rëndomësi të caktuar dhe natyralitet gjuhësor, duke evokuar modele të të folurit të përditshëm dhe duke shprehur në të njëjtën kohë diskurs poetik. Ndoshta kjo është arsyeja pse poezitë e Kokalarit nuk na befasojnë, pasi të gjitha vargjet e kanë në vete një lidhje të rregullt për jetën që vazhdon. Sensi i këtij kombinimi të veçantë merr kuptim kur e përditshmja dhe e shquara kombinohen në një skemë rime komplekse dhe të parregullt.

Vdekje...
Ja mjerimi!
Ja vdekja!
Vdekja shpirtërore!
Vdekja për së gjalli!...

Mbretëresha e tropeve, metafora, është bazament për gjuhën poetike dhe ajo përdoret dendur në formë hiperbolike dhe ekscentrike në poezinë e Migjenit. Përderisa Musine përdorë metaforën shpjeguese dhe ilustrative, gati gati e bën figurë të krahasimit, meqë disikursi i saj poetik priret të jetë më realist dhe stili i saj shkon më shumë nga ai diskursiv, pra metaforat nuk i ka të tipit të konstrasteve të thella (*unë isha e varfër nga xhepi, ata të varfër nga shpirti*). Edhe Migjeni shprehet në diskursin e të folurit emocional sipas stilit të gjuhës bisedore[11], por

11 Lloshi, Xh. (2005). *Stilistika e gjuhës shqipe*. Tiranë: Albas

metaforat e tij janë gërshetim i figurimit metaforik dhe metonimik andaj ndërtimi i tyre del të jetë më i fortë (Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi).

Figura të tjetra që përdoren mjaft shpesh në veprat e autorëve janë figurat e shqiptimit poetik ose siç quhen diku edhe figurat e heshtjes, ku ndër tjera hyjnë: elipsa, pyetja retorike, retiçenca (heshtja), pretericioni (tejkalimi) etj.

Elipsa është *mungesë e përmbledhjes, mungesë e pushimit përshkrues*[12] Është e rëndësishme të theksohet efekti i elipsës apo lënia jashtë e fjalëve te MusineKokalari dhe te Migjeni. Seria e elipsave të tyre nuk ka ndonjë rregull, ato zakonisht shënohen me tri pika, të vëna në fillim, në mes ose në fund të vargut/tekstit. Kokalari përdor dendur këtë mënyrë të shprehjes a mos-shprehjes qoftë në titull të poezive:

(Rreth pjatës...; Vdekje...; Koha shkon...; Shi...; Si ishe dhe si je...; Goja...; Ja unë...), qoftë brenda vargjeve (dhe sytë ngadalë i mbylli...; ...Ngadalë, ngadalë, ndëgjohet shiu; Për këtë ke lindur...; mosknaqsia...; dhe me mëshirë pret më përtacët...; Të gjithë thërresin sikur t'isha...; dhe më së fundi e gjeta...; burrë ose grua... e di, por s'ka gjë; një lule isha dhe jo njeri...; dhe shikon jashtë... qesh; jo, më vonë e urren deri në vdekje...; Një melodi...së largu ndëgjohet; dhe përsëri largohet...; asgjë s'e pengon dhe ajo ëmbël ndëgjohet...; u tregon rrugën atyre dhe ata vazhdojnë, ata këndojnë...; dhe kënaqen që të gjithë...; tund kokn..., që tingëllojnë mbi tryeza...; s'ka njeri të mendohet për 'ta...; Gjen atë...si ishe dhe si je...; i doje, i lije...; i kujtoje, i harroje përsëri...; por tepër vonë...; *në mëshirën e fatit...; sot e vajton. Harrove se ato q'i kërkon për të tjerë...; Tashi e lë vehten në mëshirën e fatit...; harron se ku, harron përse...; i sinqertë, i drejtë. I lumtë, kështu thotë një palë...; ajo flet kur duhet... i mat, i peshon; po vdes thotë...dicka për të ngrënë; ajo ushqehet, ajo njeri s'kënaq...; vehten dëmton...; të krusur prej vjetve të pleqërisë...; mëma mori lajmin e zi..., lindi vajzë; nuk e lënë të marrë frymë...; mendon shumë, çuditet...aq, kaq...ku, përse; lozin...*

12 Genette, G. (1983). *Narrative Discourse: An Essay in Method*. Ithaca, New York: Cornell University Press

kthehen në shtëpi...; dhe fillon druri...; e shtyjnë...ju tregon se ç'duhet; e zënë prej veshit...; të mijat...ishte moskuptimit; vritesha...gjat s'pushonja...ishte fillimi i dëshpërimit; përpara por, përsëri u ngrita...ishte guximi i parë; pëlqente...ishte varfëria e padukur; këmbën e paditur shkela mizat e dheut...ishte trimëria e ime; m'i forti...ishte shoqëria e parë; ay që ësht i madh dhe i di të gjitha...ishte padituria e ime.)

dhe në skica e tregime: (*Në jetë...; Zjarri...; Vallja e jetës...; Punë...; Ahere dhe sot...; Shkolla gjysmake...; Në shtëpi...; Ferexhea...; Netët e fundit...; Fejesa...; Martesa...; Skllavëri...; Largesa...; Me jetën...; Nën e bir...; Një zë...; Një hije...; Sot...; Kështu e thotë libri...; Më març pleshtat...*).

Ekzistojnë mbi 70 trepikësha apo elipsa e retiçenca të inkorporuara në librin *Kolla e vdekjes*! së Kokalarit. Këto përftohen duke lënë jashtë një fjalë, një frazë, a një varg që shprehet me tri pika (...) që nganjëherë paraprihen ose pasohen me pika të tjera (...) ose shenja tjera të pikësimit. Kjo shenjë pikësimi në këto poezi del edhe si pezullim, si figurë elipse ose periudhë elipsë. Nga shembujt e mësipërm vepra e Kokalarit zhvillon trepikëshin në tri mënyra:

a) Elipsën e përdorur kryesisht për të treguar një lëshim. Kjo jepet si mundësi e një mosveprimi të qëllimshëm, sikur kur dëshiron të përdor një citat, por kalon mbi pjesë të saj.

b) Elipsën e përdor për të dhënë vargun ngurrues apo të ndërprerë, jep poezinë e pambaruar, dhe

c) Gjithashtu, elipsën e përdor për të shënjuar një pushim apo një mendim të papërfunduar. Përfundimisht, elipsa më e shpeshtë që haset në fund të titullit a të vargut të Kokalarit përfaqëson tërheqje në heshtje.

Edhe Migjeni nuk lë mangut përdorimin e një dyzine elipsash e retiçencash (mbi 70 gjithashtu) që marrin formë të veçantë figuruese e poetike jo të zakonshme.

Autori përdor elipsën për shumë arsye, ngjashëm me mënyrën e larmishme në tekste tjera p. sh. në tregimet e tij (*Dikush trokiti ne dere ... - Kush a ? - A po na fal ndoj send zoje? - Zoti te dhashte ! - Na fal ndaj send , te dhashte zoti shendet ... - Hajt ! Zoti te dhashte... - Zoti te dhashte*).

a) Migjeni heqjen e tekstit apo fjalët e panevojshme i shpreh me elipsë.

b) Ligjërimi i tij dramatik fut në funksion elipsën për të ndërtuar një tension dhe,

c) Shenjat e dhimbjes së subjektit apo narratorit jepen me elipsë për të shënjuar diçka të lënë përgjysmë, të papërfunduar a të pashprehur.

Dhe me fitue...; dhe në marrzi duhej shum shtrejtë t'u paguhej...; Ndër lahuta të këndohet Jeta e Re...; me zjarrin tënd, rini...Dhe të na mbysi dallga; Thelltë në veten teme kangët e mia jesin...; Hije...jo! – por një grue; kërkoj me gjetë një kafshatë më të mirë...; Ta shof si dridhet nga grusht' i paligjshëm...; u derdh nga parzm' e errsinës...; nuk zbardh për ty drita e ditës...; Xhamiat dhe kishat madhshtore ndër vende tona të mjerueme...; Kumbonoret dhe minaret e nalta mbi shtëpia tona përdhecke...; Zani i hoxhës dhe i priftit në një kangë të degjenerueme...; i një grues së dashun...; verbojnë nga zbardhimi...; Hesht njeriu pran grues që qan e turpnueme...; ... e vëtemndëgjon; dhe shpërthen ndër vargje të lira...; që kumbojnë me tinguj të sinqertë...; O kangë e dejë e dhimbës krenare...; Kot e kanë sot njerzit, dhe më kot diktojnë djersën...; Afrojnë buzët te gota, dojnë një hurm të vetëm...; asht kjo jetë njeriu...; ndoshta ka me ardhun...; ndoshta ka me zbardhun...; Dhe syparja ra...; Protagonisti vdiq...; se nesër do vdesin... Vall! A ka shpëtim ndokund?!; - kaloi rrugës së qytetit si ejll i arratisun...; dhe ua zbulon veten...Smirë ua kam shejtënvet:; Na shprehun të ngushlluem gjetme në vaj...; me jetë...se kjo botë mbarë; shfrimin me gjetëmnis së vet të mnertë...; dhe e ... qetsuen; Vall, shpirt i therun... fli e një lteri të ri; me diell t'artë në ball, me qiellat'azurta në sy...; O shpirt! Pëllumb i gjorë!

Lajm i idealit të ri...; i dhimbset vetja shpirtit... o vall, se ç'idhnim!; e lotë xhevahiri derdh ... o vall, u fik një hy!; edhe aq ma tepër e ngatërruemny'n...; Me çaluen'anë të djathtë, me çaluen'anë të majtë...; KangëPërndimi, kangë njeriu të dehun nga besimi në vete...; KangëPërndimi, kangë njeriu të dehun nga besimi në vete...; E në nesërmen fatale, kundrojmë një horizont me njolla...; ...shtegtarë të mërguem, shpirtënt tonë n'origjinë po kthejnë; sa mirë e presin...megjithse nuk asht ditë vere; ...dhe pravera erdhi...; ...dhe dallndyshja erdhi...; ...triumfon bylbyli...; ...dhe vesa shkëlqen...; ...dhe pranvera erdhi...; ndër do bota të larta...; e në fund u mërguen...; dhe gëzimin ma vodhne...; me kaltrina të kullueta në qiellë e në sy tand...; sa hall...; më një valle dëfryese, pa marrun frymë...; me pudër, karmin...jo? – por me përshtypje të mirë; dhe na shtrëngon laku...; e fantazis sonë, i hapen ylber – velat...; - qashtu vuejmë, dëfrejmë...; rishtas, me plot dashje, vallet ndiqen, ndiqen...; Për njenin ky gëzim, për tjetrin gëzim tjetër...; m'i krijue jetë të tjetër, njeriun e gurit...; ...po, një ringjallje mbi të vjetrkalbsinat; Pak dritë! O burrë! O hero! Ngado që të jesh!...; ta shkruejshe kushtrimin... Ehu Burrë i tretun!; Por pishë nuk kam e vetëm janë burrat, shokët...; Dergjem n'errsinë pa gjumë dhe pa dritë...; Askush s'mëndigjon, çirren kot më kot...; Kur ti këndon thonë se asht afër drita...; e si buzqeshjam'asht e hishun...; ...dhe po ndij; Far, e idhtë...far' e idhtë...; në ndërgjegje dhe një dangë...; as fluturimet...Nëpër balta...; Zemër që vuejn, që ende po vuen...; dhe t'u e dergjë ndoshta do hesht e molisun...; ...dhe askush s'mund të thotë.

Vargjet e autorëve tanë, të ndërprera me tripikësh, i lexojmë me intonacion të lënë pezull dhe me një përjetim ose ironi që merr fuqi më të madhe. Shumë prej këtyre pikave sinjalizojnë konfuzion, mospajtim, hezitim, këputje mendimi, me qëllim që të nënkuptohet vazhdimi nga lexuesi i mundshëm.

Ky krahasim përshkrues edhe pse vë në pah ndryshimin e autorëve në formën e përdorimit të figurës, pra në rrafshin stilistik, poezitë e Migjenit dhe Kokalarit komunikojnë idetë e tyre

kryesisht nëpërmjet imazheve të zakonshme dhe përditshmërisë. Ata janë të ngjashëm në artikulimin e temave dhe duke bërë qytetin dekor të poezisë së tyre autorët rezultojnë me shenja të holla dalluese. Në vazhdim jepen titujt e disa poezive të tyre në mënyrë paralele ku motivet thellohen si të veçanta. Ishin këto vargjet e para dhe të mbrama të këngës së tyre të fundit, ku njëri i këndon mjerimit, tjetra dëshpërimit.

Kolla e vdekjes!
Rreth pjatës...,
Pas xhamave të dritares,
Në gji të nënës,
Pse rri vetëm?,
Zgjohu prej zërit të largët,
Shi...,
Përse ke lindur?,
Këngë e vërtetë,
Ti,
Një melodi,

Lëvizje...,
Goja...,

Poema e mjerimit
Mbas tryezës
Lagjja e varfun
Një natë pa gjumë
Vetmia
Zgjimi
Vjeshta në parakalim
Të lindet njeriu
Kangë në vete
Shpirt'i ri
Hidhet e përhidhet

Zgjimi
Dy buzë

Aleksandër Çipa

Etnoteksti i shkrimtares disidente

(ese)

Shkrimtarja Musine Kokalari mbetet disidentja e vetme shqiptare e cila parandjeu dhe paratha se totalitarizmi i instaluar në Shqipëri ishte tirani. Në njëkohësi, diçka të tillë e kishte formuluar edhe Milovan Gjilasi, të cilin e citon Giovani Sartori kur i nevojitet një formulim retorik dhe pohon se : "Totalitarizmi është tirani e lashtë në kushte të reja, apo fenomen i ri?". Disidentja shqiptare i gjegjej në gjuhën e vet analitike. Sepse ajo disidencën politike e sendërtoi në përditshmërinë e përvujtshme të jetës së vet, qysh pa ardhur dita fizike e totalitarizmit shqiptar. Ajo e lexoi dhe paratha këtë mbërritje, duke u ngjizur me kohën edhe ferri i jetës vetjake.

Ndodhte pikërisht në atë kohë, në të cilën siç e thotë Viktor Hygoi: "Mund të kishte shumë gjuhë, por kishte pak mendje". Në mendjen e paktë dhe guximin e madh u përfshi Musine Kokalari.

Bëhet fjalë për aristokraten e mendjes e cila e para lexoi plotësisht instruktivizmin politik që po instalohej në përballje me botëkuptimin dhe formimin e saj socialdemokrat. Qëndrestaria e Musine Kokalarit

ishte dukuri e brendshme karakteriale dhe sjellje natyrale. Përkonte me shumëcka të virtytshme që trashëgonte, por, njëherazi edhe me atë investim formues e edukues që kishte ndjekur në jetën familjare dhe personale. Kjo qëndrueshmëri, në vjetët dhe sidomos kohën politike me të cilën u përball refuzueshëm dhe antagonisht, qysh në ditët e para, përkon me sentencën filozofike gjirokastrite të cilën unë e huazoj nga profesor Muzafer Xhaxhiu: "As varri nuk ka frikë nga i vdekuri, as i vdekuri nga varri". Dhe disidenca e Musine Kokalarit i kishte të dyja aspektet : atë të kontestimit të hapur dhe të paepshmërisë, e cila në gjithë jetën e vet mbetet reminishencë me atë të shkrimtarit sivëlla rus Aleksandër Sollzhenicin.

Disidenca e Musinesë natyrisht që kishte një premisë të fuqishme, të cilën ajo ndër qindra e mijëra të tjerë e vlerësoi dhe e shndërroi në pikë mbështetjeje. Vinte nga një përvojë, shkollim, dijesim dhe kulturim prej hapësirës europiane multikulturore. E kishte të natyrshëm formimin e vet filozofik të pluriideve dhe mbartte njëkohësisht ndërgjegjen e formuar nga shkolla e aq iluminuar e atëkohëshme. Ajo kishte për idhull të filozofisë dhe mbrothësisë kombëtare Sami Frashërin. Jo më kot, ndodhte kjo, pasi përfshihej ndër ato intelektuale që lehtësisht depërtonte në thelbe dhe substancë të filozofisë.

Në qëndrestarinë e vet disidente, Musineja ishte haveliane; nuk rreshtte së reflektuari dhe analizuari logjikisht rendin dhe sistemin e ri totalitar.

Tekstet e zhdukura, të sekuestruara dhe djegura dhe sidomos memuaret e pakta të mbetura, formësojnë një substancë *sui generis* të dijes dhe reflektimit eseistik intelektual dhe prej shkrimtareje me klas. Kjo shkaktonte dridhje tek njohësit e saj sundonjës, apo siç preferonte t'i vetëquante, "Të ngjitur për t'u varur", por që ishin tek pala tjetër, ajo e sundonjësve. Dija e saj "atje poshtë" i drithte ata "atje lart". Ata e kishin kompleksin e dijes së saj, pasi e njihnin fort

mirë se ç'brumi intelektual dhe çfarë kapaciteti shkrimor mbartte në vetvete shkrimtarja e privuar.

Privimi, shkrimtares disidente, iu shndërrua në një masë radikale, absolute nga sistemi dhe sidomos shërbestarët fanatikë të monokulturizmit ideologjik. Kjo ndoshta ishte dhe arsyeja bazë që mes saj dhe të mbeturit "Aty lart" u instalua moskomunikimi dhe distancimi, harresa e shpërfillja vrastare, lënia në kthetrat e ferrit dhe mospërmendja e cila u shtri në tri dekada, përjashto atë moment fatlum të rikujtimit në një hapësirë tjetër, në rrethana dhe frymë tjetër, siç ishte Kosova.

E kam fjalën për vitin 1983, kur filologu, studiuesi ndër më të cilësishmit e thellësisë në kohë, të letërsisë shqipe, në numrin 2 të mars-prillit të këtij viti, botonte në revistën "Jeta e re" katër tregimet e saj. "Mos qofshin vjehrrat e zeza", "Kulloi odaja","Për mustaqet e Çelos","Ulurima e qenit" , të cilat i shoqëroi me një shënim për këtë autore, e cila ishte e panjohur në Kosovë.

Ishte pikërisht viti kur pasi e kishin sulmuar kurmin e saj gjithëfarë vuajtjesh e lëngatash, po e mësynte edhe e fundit më e papërballueshme, ajo e së keqes në Rrëshen. Mirëpo censurës së trashëguar të Musinesë iu shtua edhe ajo e këtij publikimi në Kosovë. Kurrkush nuk e përmendi këtë fakt në Shqipërinë e asaj kohe. Por se çfarë e shtyu Doktor Rugovën, se kush e bëri me dije atë, se si u gjend në kontakt me letërsinë e Musinesë?

Këto janë dilema të cilat ish Presidenti i Kosovës i mori me vete në amëshim. Nëse do të kishim mundësi ta dinim dhe njihnim rrethanën, ndoshta do të kishim informacion për një perimetër më të gjerë kontaktesh dhe qarkullimi të letërsisë së Musinesë në atë kohë.

Doktor Rugova sipas fondit arkivor që zotërojmë për shkrime jo vetëm memorialistike, por më së shumti studimore për shkrimtarinë e Musine Kokalarit, është i pari që i referohet pasurisë dhe vlerave etnotekstuale të Musinesë. Në shënimin shoqërues të botimit në Prishtinë, tek numri 2 i "Jetës së re", Doktor Rugova shprehet: "

Eshtë mirë të dihet se Kokalari i shkroi tregimet e saj në të folurit çam, pra, të krahinës së Çamërisë dhe njëherësh është njëra ndër shkrimtaret e rrallë shqiptarë që shkroi thjesht në këtë të folme madje me qëllim artistik, sepse siç e dimë në historinë e letërsisë shqiptare shumë shkrimtarë tanë kanë shkruar në dialektin e tyre, meqë e ndienin si gjuhë të përgjithshme, e po të vepronte kështu, atëhere M.Kokalari do të shkruante në toskërishten letrare". Më tej Doktor Rugova vazhdon: " Për librin e saj, më 1940 në gazetën "Bota e re" nr 1 të 30 korrikut poeti ynë i njohur Lasgush Poradeci, bëri një kritikë mjaft interesante. Ja si e vlerëson Poradeci, esencialisht prozën e Kokalarit: "Krijim original. Zënia e jetës, kapja e menjëhershme e saj në fond dhe formë dhe faqja immediate pa asnjë ndërmjetësim, me anën e artit, kjo është origjinalitet-origjinalitet letrar. Kurse stilin e saj e quan stil substancial, që u përshtatet subjekteve". Doktor Rugova zbulon në tekstin e vet dhe një njohës tjetër të rëndësishëm të letërsisë së Musinesë, e ka fjalën për albanologun e famshëm Maximilian Lamberc i cili në vitin 1949, në librin "Albanaiches esebuxh", Lajpcig , prej nga ka marrë edhe tregimet e botuara në Prishtinë.

Por është me rëndësi të vijojmë citimin e Doktor Rugovës, i cili sugjeron se këto tregime, pra të Musinesë, "janë me interes edhe për gjuhëtarët tanë, madje edhe për elemente për gjuhësinë historike, sepse dialekti që përdor autorja përmban shumë trajta gjuhësore që i ndeshim në veprat e autorëve të njohur arbëresh si te De Rada, Gavril Dara, Serembe, Santori e të tjerë, sepse shumë prejt tyre ishin me origjinë nga këto vise dhe e kishin marrë gjuhën e atëhershme me vete…".

Tekstet autoriale të Musine Kokalarit për t'u shqyrtuar drejt, sidomos në vlerat dhe pasurinë e tyre etnotekstuale, nevojitet të shqyrtohen duke i mbajtur në rrafshe krahasimtare dhe rivlerësuese edhe me shkrimtarë të tjerë bashkëkohës, matanë kohës dhe pas kohës së Musinesë. Pasuria leksikore e librave të Musine Kokalarit

përkon dhe takohet me pasurinë që trashëgon letërsia jonë kombëtare qysh nga autorët e famshëm zanafillorë si Budi dhe Bardhi. Pjetër Budi në poezinë e vet thotë: "O i pafat njeri" dhe vijon "ndo plak jo a ndo i ri", apo te "Ku janë ata djelm të ri"…. dhe natyrshëm rishfaqet proza e shkurtër e Musinesë me atë vlerë të papërsëdytshme të nëndialektit tosk të Gjirokastrës apo që përfshin edhe nga fondi leksikor i Çamërisë.

Studiues të ndryshëm të vënë në punën e tyre shqyrtuese mbi tekstet e Musine Kokalarit kanë evidentuar kujdesshëm këtë pasuri që la shkrimtarja e privuar deri në pengimin fatal. Prej letërsisë së saj rezulton një fjalor i leksemave, i cili përbën ndoshta pasurinë më atipike etnotekstuale të një autoreje e cila i përket origjinës së këtij qyteti, pra Gjirokastrës, por që dimensionet dhe valencën për cilësinë e vet shkrimore dhe gjuhësore i ka të krahasueshme me autorë të rëndësishëm të letërsisë europiane të shekullit XIX.

ALBUM /EKSPOZITË VIRTUALE

SHTYPI — 3

Jeta Ekonomike - Letrare e Shoqnore

Libri i ri Turk mbi **Nasredin Hoxhën**

me 400 anekdotat e famëshme të tij u botua tani shpejt në Turqi dhe përkthehet në tërë gjuhët e botës.

Kush ishte Nasredin Hoxha

ku, kur dhe si jetoi dhe si përfillet ky Esop i Tyrqis?

Këto ditë u botua në Turqi një libër, që u përhap në të katër anët me shpëjtësi dhe që sigurisht do të përkthehet në tërë gjuhët e botës. Ky libër merret me Nasredin Hoxhën e famshëm, Esopin Anadollit, e të cilit anekdotat e çuditëshme dhe tërheqëse dhe plot me kuptime, kanë marë dheun brez pas brezi dhe akoma sot vashdojnë të përmenden duke argëtuar tërë popujt e botës.

Në Shqipërin t'onë Nasredin Hoxha nuk ësht i pa njohur. Përkundrazi, shumë kujtojnë se ka qenë shqiptar. Dhe këtë e thonë se emëri i tij nuk ka lënë kasolle e vatër e pallate pa u përmendur. Mirëpo duhet të shenohet se shumë nga këto anekdota që qarkullojnë gojë pas goje dhe që kujtohet se janë të Nasredinit, nuh janë të vërteta, se kushdo që trillonte ose pësonte ndonjë „hata" qesharake, ja kushtonte Nasredinit. Këjo pra shkaktoi kujdesin e një shtëpije të madhe botonjëse në Stamboll, e cila do të studjonte mbledhjen e këtyre anekdotavet të Nasredinit, por ato të vërtetat.

Për këtë punë, shtëpija botonjëse mhlodhi njerëzit me kulturë, nga më të mirët e Turqis, duke dërguar postafat nëpër vënde përkatëse ku rojti dhe ku vdiq Nasredini me qëllim studimesh dhe gjurmimesh. Dhe që andej u mblodhën shumë anekdota interesante, të cilat përfshihen në librin që tani u botua.

Sigurisht brenda 400 anekdotave që mban libri në fjalë, çështja është se 50 që janë të njohura, dhe këto të ndryshuara dhe të bestardhuara shumë. Këtë libër interesant „Shtypi" do t'a përkthej dhe fillon me radhë botimin e anekdotavet.

Me këtë rast, sa për të nisur punën dhe të kënaqim këndonjësin t'onë, i cili ka nevojë për pak zbavitje, herën e parë i hedhim një sy të shpejtë Nasredin Hoxhës mbi jetën e tij.

Kush ishte Nasredin Hoxha

Hoxhë tyrqisht d. m. th. mësonjës, d. m. th. njeri që di shumë. Dhe në kohën kur rojti Nasredini, njerëz të tillë ishin të rallë, sepse atëhere kur në thellësit e Anadollit njerëzit tërë kohën luftonin, kush kishte nge të mësonte! Në kohën që vajti Nasredin Hoxha, krahinat qendrore t'Asisë së Vogël, si Konja, Ankaraja dhe rrethet e tjera ishin zaptuar prej të fa-

Nasredin Hoxha ka qenë njeri me kulturë të gjërë dhe vezhgonjës i thellë i jetës. Filosofija e tij përmban tërë njohjet e shpirtit anadollak që i pëlqejnë alegorit edhe parabolat. Eshtë e vërtetë se Nasredini në shumë anekdota të tij, kallzohet si budalla. Mirëpo atëhere ishte koha kështu, që ky si me të qeshur mundej të përgjigjej kudo lirisht e pa frikë.

Kerakteristika më e madhe e Nasredinit ka qenë që përgjigjej aty për aty në të shpejt. Aqë i shpejtë ishte në përgjigjet, sa shumë veta që t'a zinin e pyetnin porsa e takonin, mbi çdo gjë, por Nasredini përgjigjej aty-për-aty pa menduar fare. Këto përgjigje, mbase nuk ishin të sakta gjithëmon, por kishin me vehte krip' e shije e kuptim që çuditnin pyetësit.

Dikur e pyeten:

— Hoxhë efendi nuk na thua, njeriu ku duhet të rijë në një ceremoni vdekjeje, përpara apo pas tabutit?

— Le të mos gjendet brenda tij, pa le të jetë kudo. S'prish punë. U përgjegj Nasredini.

Atdheu i Nasredin Hoxhës

Nasredin Hoxha lindi në Sivri-Hisar t'Asisë së Vogël gjat vjetit 1198 dhe vdiq në Ak-Sehir më 1267. Prej Imamit të fshatit mësoi letrat e para dhe pastaj vate në Konia dhe studioi në Shkollën Fetare të famëshme. Siç duket, Nasredinit nuk i mjaftonin këto, po mësonte edhe dituri të ndryshme, në gjuhën Persane dhe Arabishte.

Ishte studionjës i thellë i cilësive tyrke dhe njohës i shpirtit të popujve t'Anadollit. Prandaj krijoi — rreth personazhit të vet, famën e një dijetari, dhe njëkohësisht të një njeriu të çelur, emëri i të cilit mori dheun, Me fjalë të tjera, Nasredin Hoxha ishte një „causear" i kohëravet t'ona, me ndryshim që shakat e tij, më tepër i thoshte për të edukuar, se sa për të argëtuar dëgjonjësit.

Kohën më të madhe t'jetës së tij Nasredini e kaloi në Ak-Sehir, qytet i rrethit të Konias, ku edhe sot gjendet varri edhe mausoleumi i tij. Gjer para disa vjetësh, varri i tij, ishte krejt i haruar dhe një pakicë e vogël e vizitonin. Tani përkrahjet dhe fushatat shtetnore e bënë të famshëm dhe sot ai varr është bërë një qendër turistike, ku mijra njerëz shkojnë dhe e vizitojnë.

ÇËSHTJE ARËSIMORE

MESONJESIT A I MUNGON VULLNETI ?

S'është vetëm puna për të cilën detyrohet mësonjësi t'a bëjë, s'është vetëm sjellja shëmbëllore e nevojshme dhe e domosdoshme, s'është vetëm aktiviteti në punët e shkollës që priten prej tij, po shteti i ynë si i ri, pret edhe më prej ktij intelektuali, i cili mund të gjejë kohe të bëjë edhe diçka më tepër; fjala është për revista pedagogjike, botime të ndryshme mësimore dhe shumë e shumë të tjera, gjë që mësonjsi ka fushë të lirë e të gjërë. Porse mësonjësit i mungon vullneti.

Nuk do t'ishte më mirë që mësonjësi a mësonjësia në vend që t'i kalonte orët e lira në kafene a nër mbledhje miqsh, të cilat përgjithësisht e dëmtojnë nga çdo pikpamje, të mund të mësonin diçka nga pedagogjija e re, dyke u a bërë të njojtur dhe të tjerëve me anën e botimit të tij?

Mësonjësi duhet t'i përshtatet parimit pedagogjik që thotë: "Një mësonjës i mir, ësht kurdoherë nxënës„. Metodat e pedagogjis janë në reformim dita ditës, gjë që i lehtëson punën mesonjësit dhe nxanësit nër mësim, prandaj duhet që edukatorit t'onë të mos i shpëtojnë këto metoda të provuara, po si kur thamë, të vihet t'i studiojë për të përsosur sa më mirë kulturën e tij.

Biblioteka Pedagogjike a duhet të çfrytëzohet? A duhet të studiohen librat q'u blenë po me të hollat e tij, të komentohen, dhe si të koregjohen në përshtatje të shkollave t'ona, të zbatohen?

Ku janë konferencat e mësonjësve nër bujq, nër popull, nër nxënës etj.? Ku janë sakrificat e mësonjësve, në dhënien e mësimeve në të burgosurit, analfabetët, etj.? Ku janë sallat e mbushura me edukatorë që rahin çështjet pedagjike pas vendit.

Gjithëkëto e sa e sa të tjera mësonjësi ynë i ri i ka lënë pas dore, dyke u mbështetur në themel që ngrehu kur ishte në shkollë, dhe se ka filluar të çkatërrohet, nuk kujdeset aspak t'a ndreqë dhe t'a pëmirësojë. Nuk mejton se po vjetërohet trupërisht dhe mendësisht. Një mësonjës sidomos, vjetërohet në trup, po bëhet i ri në kulturë.

Prandaj kolgë le të punojmë me ndërgjegje dhe pa përtim, dyke i dhenë popullit të kuptojë se na, nuk jemi "dhaskenjt„ si pat qenë kuptimi më përpara, po udhëheqësit, frymëzonjësit dhe gatonjësit e një brezi të ri fëminjësh i cili nesër do të jetë populli e shteti, si kush një aktivitet i mirë dhe i dobishëm për shoqërinë, passi ësht rritur dhe stërvitur me t'atilla mësime.

Le të risim pra, fëmijën e shoqërisë për shoqërinë. Le t'a zgjasim aktivitetin t'onë edhe më tepër; le të punojmë me vullnet, dhe të jemi të sigurtë se prestigji në shoqëri do të jetë i lartë, do të zërë vëndin dhe gradën që meriton dyke u konsideruar mësonjësi si më i nevojëshmi për shoqërinë nga çdo tjetër funksionar shteti.

Pra, le të punojmë!

V. A. Pr.

NË MISTERIN E SHKENCËS

Çpikjet e Savantit të Madh MARCONI

Që në moshen 20 vjeç, Marconi filloi eksperimentet e telegrafit pa tel — në kopshtin e t'et. Ahere nuk bente tjetër veç të perseritë eksperimentet e Branley-it.

Në vitin 1896, Marconi mori brevetin e mënyrës së komunikimit pa tel. Po, në këtë kohë, ariti të lidhi me telegraf pa tel Bournemouth me ishullin Wight. Më 1899, në prani të një Komisjoni Ndërkombëtar, kapërzen Pas de Calais me valët duke i drejtuar Branley-it telegramin e famshëm me të cilin iavdëronte zbulimin themelor të savantit frëng.

Duke vazhduar eksperimentet e tij, Guglielmo Markoni u interesua për përdorimin tregëtar të çpikjes së tij, dhe mundi të ketë ndihmen e disa kapitalistave.

Dhe ja si fillon transmetimi me distanca të gjata: Me 12 Dhjetor 1901, u shkembyen shenja përmes Atlantikut, midis

coni përfitoi nga savantët e mëparshëm ose prej bashkëkosve të vet — Branly, Tesla, Dueretet, Popoff, Lodjre, është jashtë dyshimit se ay dijti t'a bejë telegrafin pa tel, të dalë nga laboratuari i ngushtë në përdorime të guximshme. Këtij i detyrohen shumë perfekcionime teknike dhe zbulime gjeniale që e benë të përparojë mrekullin e ré, telegrafin pa tel.

Eksperimentet e fundit të Guglielmo Marconi-t drejtoheshin në zgjidhjen e problemit të mikroondave.

Ky problem qëndron në faktin se valët e shkurtëra të drejtohen me ndihmën e një projektori parabolik dhe nuk përhapen në mënyrë qarkore, ndalohen sot nga disa pengesa materiale midis ik-nisjes në vijë të drejtë dhe nuk ndjekin kurben e dheut; vendi i veprimit eshtë pra i kufizuar.

POSTA E „SHTYPIT"

A. Ç. Berat, — Na shkruani mbi qytetin. Të fala.

L. V. Vlorë, — Shkrimeve me karakter të përgjithshëm dhe me

KRONIKA GJYQËSORE

Epilogu i ometimeve t' Intendancës

Para disa ditësh Gjyqi i Diktimit, Dega Penale, e përfundoi procesin kunder zz. Nenkolonel Luigj Baba, ish-Kryetar i Intendances së Përgjithshme, Tare Avoricani, nëpunës i Intendances, Lato Abdyli, Sali Dibra, ish-arketar i Inten. dhe Ibrahim Hallulli, ish-arketar i Qendrës, t'akuzuar për ometim detyre me pervetimin e afro 60.000 fr. ari prej të vetë-vrarit, shef i Arkës s'Indendancës, Muharrem Çaçi.

Proçesi u zhvillua në katër seanca, dhe t'akuzuarit me arësyet që shfaqen nuk e pranuan akuzen që u ngarkohej si ometonjës të detyrës dhe të dënuarshem në virtyt të nenit 203 të Kodit Penal të fuqi.

Në seancën e fundit, u deklarua vendimi me të cilin t'akuzuarit zz. Nenkolonel Luigj Baba, Tare Avoricani, Lato Abdyli, Sali Dibra dhe z. Ibrahim Hallulli, u dënuanë në bazë të nenit 203 të Kodit Penal me nga 300 fr. ari gjobe, dhe këtë denim, me qenë se këta nuk janë dunuar ndonjë herë tjetër, i u a pezulloi për një kohë prej dy vjetesh në bazë të nenit 86 të Kodit Penal.

Me gjithëse denimin i u a pezulloj Gjyqi i Diktimit, informohemi se të gjithë, e kanë diktimuar vendimin e sipërme përpara Keshillit të Përgjithëshëm të Diktimit.

COPA LETERSIJE

Rreth pjatës. . .

Ju pashë kur kalonja. Të gëzuar e të lumtur pritnit copat e bukes së zezë dhe të thatë. Fytyrat u shkëlqenin prej një gëzimi te patreguar, ndërsa gjishtrinjt e vegjël dhe të regjurë shume shpejt prej punës, futeshin në pjaten e kosit.

Sa shije ndjenit! Sytë i mbyllnit nga pak prej thartësirës dhe me shpejtesi i përtypnit kapshatat e hedhura njera-pas-tjetrës. Stomaku, i zbrazët që prej mëngjezit, u mbush me ushqimin e thjeshtë. Po, ah asnjeri nuk i-u pa ndërsa qëndronit të mbështetur në shtyllën e elektrikut, në këndin e rrugës. Veç edhe ju nuk vërenit njeri!

Flitnit ngadalë dhe me kënaqësi, pse bukën e kishit fituar me punën edhe me djersën e ballit. Pa u munduar, pjata e kosit u mbarua dhe me habi shikuat shoqi-shoqin. Ju erdhi çudi...

Të gëzuar u ngritët dhe pa u vënë re prej asaj shumice njerëzish, pa fare kujdes, shkuat drejt në punë, për të siguruar edhe në mbrëmje ndonjë pjatë tjetër.

MUZA

E MARTE 27 Korrik 1937

Komunikasjoni:

I. AUTOMOBILA

NISJE (çdo datë)

për **Shkodër:** ora 9.30, agjensia Abdullah Tagani, pranë Hotel Splendid; ora 10.30 po kjo agjensi (posta).

për **Dibër:** ora 9 agjensia Ismail Dibra pranë hotel Ballkan.

për **Durrës:** ora 12 agjensia Zemblaku (posta); ora 18 po kjo agjensi (posta).

për **Elbasan:** ora 16 agjensia Qëndra, Elbasan.

për **Korçë:** ora 8.30 Shoqëria Tomori ora 10.30 agjensia Zemblaku, rruga 28 Nëndor (posta).

për **Berat:** ora 9.30 agjensia Hotel Europa rruga Lore Dano.

për **Vlorë:** ora 9 agjensia Hotel Ballkakan (kundrejt Bashkisë).

për **Gjinokastrë:** ora 8 Agjensia Hotel Bristol (rruga Nana Mbretneshë).

II. AEROPLANA

NISJE

Të Martë: Peshkopi, Vlorë e Korçë Shkodër ora 7; 8.50; Brindisi-Romë ora 10.15.

Të Mërkurë: Korçë, Shkodër e Kukës ora 7; Vlorë 9.30; Selenik. ora 12

III. VAPORE

NISJE

Të Mërkurë: Ora 9 Bari; ora 2 mbas dreke Triesht.

Të Enjten: Ora 9, Durrës-Bari

MAMIT' E BASHKISË

Zonja Diedari, Rruga Carnarvon Nr. 3.
Zonja Lako, Rruga e Shkodrës Nr. 6.
Zojusha L. Betisha, Rruga Bimbashi Nr. 8.
Ofiqari i Gjendjes Civile rruga Babaraka Nr. 136.

PADITURIA I MPLAKE FEMËRAT

26 Ans mais... elle laisse se tarir le "biocel" de sa peau.

41 Ans, mais... elle sait comment conserver la peau riche en biocel.

Zgjoje biocel-in e lëkurës s'ate dhe ki një fytyrë të ré cilado qoftë mosha që ké

BIOCEL-i është ajo lënda e çmuarshme në lëkurën t'uaj që e mban të forrtë e të freskte.... por hallet e thajnë biocel-in duke bërë që 7 femra mbi dhjetë te duken me plaka se ç'janë. Jepni fytyrës s'uaj biocel-in e freskët të nxjerrë nga palca e celulave nder kafshët e reja. Ky ushqim i mrekulluarshëm për lëkurën do t'i zgjojë rezervat naturale të biocel-it. Ahere lëkurës s'uaj do t'i hiqen shenjat e moshës — rrudhat, vijat, pikat e zeza — duke e bërë fytyrën të duket e ré. Vetëm një ushqim ka për lëkurën t'uaj: *Krema Tokalon* (ngjyrë-trëndafili). Fillonie që sonte perpara se të fleni. Në mëngjes përdorni kremën Tokalon, ngjyrë të bardhë. Rezultate të mahnitshëm: femrat 72 vjeçare nuk i kanë më rrudhat, grati 40 vjeç nuk duken veçse 25. Vajzave u duket fytyra si e një engjelli. Suksesi ësht i garantuar prej Tokalonit, në rast të kundërt u këthehen të gjitha shpenzimet.

Skica e parë, botuar me pseudonimin Muza në gazetën *Shtypi*, 1937, nr.58, 27 korrik, f.3.

FRYMËZIME

T' isha një lule...

Zbardhoi drita, lindi dielli; u bë ditë dhe në shpirtin t' im ndjeva një gjë të re. Ishte një pyetje që donte përgjigje. Së mbrëndëshmi ndëgjova një zë që më pyeti «Ç' është jeta?»

Hap sytë për një çast, vështroj rrotull dhe asgjë nuk gjej, asnjeri nuk përgjigjet në vënd t' im. Ulem dhe u përvishem librave, kërkoj mendimin e atyre që kanë shkrojtur .. por dhe atje asgjë.

Pa shpresë largohem prej vëndit ku ndodhesha, e pa kënaqur hedh këmbët e mia; rëndë rrëshqasin, diçka shkelin. Një faqe libri të vjetër. Ulem, e mar, e vështroj dhe vetëm një fjalë këndoj, mosknaqsia...

Mendimet më trubullojnë dhe më së fundi m' u duk se e gjeta të vërtetën, se jeta është mosknaqsia.

E drejtë, e pa gabuar. Të gjithë thrresin sikur t' isha .. dhe unë gjithashtu.

Jam njeri, më krijoi natyra duke më dhënë dhe tru. Më vërviti në tokë, më bëri më të lartë nga të gjithë shtazët dhe bimët, me gjith atë nuk knaqem, i kërkoj vehtes të jem kështu, të jem ashtu; si kjo dhe si ajo dhe më së fundi e gjeta...

T' isha një lule-lule are, e vogël dhe me erë. Të çelnja në prendverë dhe në vjeshtë të vishkesha në vetminë t' ime.

T' isha një lule vjollce në mes të ferrave, Të qëndronja e fshehur, e pa dukur dhe një ditë të zbulohesha prej duarve të dy të rinjve. Prej frike, të larguar prej njerzis do t' më këputnin, do të dhurohesha te njëri - tjetri për shënjë kujtimi Do të ndëgjonia se ç' flitnin, fjalët e bukura dhe plot shpresë. Do t' më thurnin dhe mua disa vargje të lehta për hir të dashuris.

Një trandafil i egër të mbinja për mbi varrin e ndonjë të riut. Të mirrnja pjesë në lotet që do të derdhnin mbi atë tokë të ftohët.

Karafil i kuq të lulzoja dhe me kujdes të vaditesha .. një ditë të vendosesha në jakën e pall tos. Do të shetitnja dhe unë rrugët e qytetit, do të kuptonja jetën djaloshare dhe të gjithë do të vështronin atë dhe mua;.. që të dy qënkan të bukur do të thoshin.

Më së fundi le t isha së paku një lule e egër, midis rrugës dhe gurëve, pa kujdesin e të tjerëve. Një ditë do të shtypesha prej ndonjë këmbe njeriu, burrë ase grua... e di; por s' ka gjë, një lule isha dhe jo njeri ..

MUZA

Shtypi, 1937, nr.100, 16 shtator, f.2.

Musine Kokalari

Siç më thotë nënua plakë

TIRANË — Shtyp. „Gutenberg“

Nëna plakë në Romë!

I. Në shtëpi

Wah moj korba!... [illegible] (... [illegible])
Hëh moj Gjinzo.. ([illegible]).. [illegible]
[illegible] sitë nga gazi, më [illegible] zëmra si [illegible]
(vër dorën në gjoks). I vështoi [illegible]
nga nja [illegible]. "Ku
është mua [illegible]? Hatixheja? Pse s'kanë
dalë të më presin? Po më thoni si jeni?
Gjithë mirë? Të vogjëlitë si i keni! [illegible]
një të [illegible]? Hëh gazi [illegible], shpirti [illegible]
Eja një çikë këtu ([illegible] vogël.
Po ti je rritur e bërë burrë. Po më thuaj a
[illegible] një nuse more [illegible]?"

Të gjithë [illegible] e [illegible]
[illegible] në shtëpi. Ajo e [illegible] i [illegible]
i [illegible], [illegible] një [illegible] pastaj [illegible]
[illegible]. – "moj Hozo [illegible] e ke [illegible] [illegible]
[illegible]. Po [illegible] pse më [illegible]
e [illegible] nga [illegible]? Ti [illegible]
[illegible] në [illegible]."

[illegible] u-[illegible] [illegible] [illegible] e [illegible]
"O-o .. më në [illegible] e më në [illegible], [illegible]
[illegible] e vogël -- [illegible] [illegible]. [illegible]
të bë [illegible]. [illegible] -- [illegible] za [illegible]
[illegible] e kam të [illegible]!

Të gjithë [illegible] në [illegible] [illegible].
Kur [illegible] i [illegible] – "Po [illegible]
[illegible] moj [illegible]! [illegible] Pse [illegible]
këtu? . [illegible] të [illegible], [illegible]
[illegible]. Pastaj [illegible] nga [illegible]. [illegible]
[illegible].

2
23
121-126
A01H
F.837 d. 23 f. 121

Legjenda e trëndafilëve

Shqipëruar prej: VASIL D. ALARUPI

— Të të shes trëndafilët e mij, ò princ ?... e me paret tua ç'gjë më të bukur se trëndafilët mund të ble ?

Princi persan të cilit, ndo një mijë vjet më parë i u dha kjo përgjigje e bukurë nga një plakë e ëmbël si mjalti, pasuria e tërë e së cilës përbëhej nga një kujtim dhe nga një rrënjë trëndafili, deshi t'a njohë më mirë këtë grua të çuditëshme. Shtyu kanatën delikate të portës së drunjtë të kopshtit dhe i tha:

— O plakë, unë jam mbreti i yt, fjalët e tua janë fort të bukura cila je ti pra, ti që s't'u mbajtka goja përpara meje dhe që u jep çmimin e merituar trëndafilëve që e merituojnë?

— Më e përulura nga subjektet e tu.

— Jo, se ti zotëron pasurinë që ke zgjedhur dhe nuk je aspak e zotëruar nga të tjerat. Tregomë jetën tënde si dhe arësyen për të cilën fytyra jote duket si e pudrosur me lumtëri?

Plaka nënëqeshi me gëzim dhe tha:

— Princ, më ke mrekulluar, jam e lumtur, ësht' e vërtetë, që kurrisht zisë në të cilën ndodhem nga shkaku i dashurisë që prej shumë kohësh. Po jeta nuk më rëndon aspak sepse e di që Ormuzi do të më paraqitë në banesën e shpirtrave të pastërt tek Zoti i ëmbël që ka qënë gëzimi im dhe pres të vdesij duke ritur trandafilët e mij.

— Ah! këta trëndafilët e tu.. përhrëtiti princi, është shumë e vërtetë se ata janë më të bukurit në botë dhe nuk gjenden të njëllojshim në kopshtet e mbretit t' ënd. Në këtë m' a kallzo edhe mua. Që nga të ka zgjedhur ky adhurim për lulet? A mund të m' a thuash?

— Mbret, tregon shumë mirë si dhe do të jetë gjë tepër e ëmbël të të kënaq. I dua trëndafilët mbi çdo tjetër pasuri sepse atyre u a detyroj lumtërinë t' ime.

— Paske qënë e lumtur, ti, o grua?

— Nuk pandehnja kurrë se mund t' isha aqe nga fati i një burri.

— Paske hasur pra një burrë që ka ditur të të dashurojë gjer në pikën sa që ti s' e ke njojtur kurrën, veç se që nga çipi i hijes së tij, dhe që ishte i pajisur me dëshira të qëndrueshme?

— E kam hasur këtë njeri, i lartur mbret.

— Dhe kush është përpjekur midis jush për martesën t' uaj?

— Një buqetë trëndafilash.

— Tregoma, o plakë e mirë, në qoftë se shpirti i yt e pranon.

— Po, mbret, dhe ke për t'a dëgjuar shpjet, sepse ç' ësht e vjetër thuhet me ni' herë.

Në kohën e çupërisë, isha një pasaniku e më kërkonin shumë për bukurinë t' ime të rallë sepse isha edhe e bukur. Dy princ dergjeshin pas meje; më bënin aqe njeri sa edhe tjetri dhe nuk dinja si t' i ndanja në zemrën t' ime, kur bariu t' onë, që ishte i mënçur, më tha: «Zonjushë martoju me atë që do të të sjellë buqetën më të bukur trëndafilësh» «Lojte mëndsh me trëndafilët e tu, ç'na hynë në punë, i thashë bariut! Kështu u bënka burri i mirë a?» «Dëgjomë mua, Zojushë», më tha. Dhe unë atëhere i u luta gallantonëve të mij të më sjellin secili nga një tufë trëndafilë.

«Erdhën pas pak, njëri solli një tufë shumë të bukur me fletë e hapura, të nxehta, që çfaqnin tërë dëshirën, që ishin krejt të gjalla në flakë dashurije; tjetri më dhuroj një buqetë me deçka të thjeshta pa asnjë lezet, të shtrënguara njëra me tjetrën, të mbështjelluna si fukaraçka dhe me burbuqet aqe të vogla sa që do thuaj u zemërova.

«Babaj im, nëna ime, si edhe unë, kishim tashmë një mendim shumë më të mirë për të dergjurin e parë se sa për të dytin. Por bariu më pëshpëriti diçka në vesh dhe unë u thashë atyre: «Kur doni t' a merni përgjigjen t' ime! »

Ay që më kish sjellë trëndafilët më të bukur m' u përgjigi me zjarr: «Nesër më t' aguar, o vashëzë e dëshëruarë! » Tjetri pëshpëriti pa u ngutur: «Oh! pas një a tetë ditësh. »

«Po matesha t' a ve në vënd gallantonin për ngutjen e pakët që tregonte për të marë për vehte, kur pashë barinë të nënëqeshë me një mënyrë aqe të kuptueshme sa që thashë: «Ashtu qoftë kthehuni pas tetë ditë.

«Është gjatë këtyre tetë ditëve, o mbreti im i dashur, që shpirita e së ligës dhe i urrejtëshmi Arhiman, u mposhtën! «Mendoju me gjith ato, më kish thënë bariu. Veri buqetat në dy vazo dhe vërreji me kujdes».

«Dhe atëhere ò princ, e kuptova mendimin e bariut.»

«Sa vinte, me të vërtet, tufa e shkëlqyer, që ishte në një gjendje dëshire pa durimi dhe të përciptë, shtrihej në vazon, fletët e luleve po përthaheshin, degët dukeshin të lodhura, kurse buqeta fukaraçkë e dhuruar nga një zemër e rallë dhe që dinte të presë, që nuk tregonte aspak cilësit e saja në fillim, zu të hapej dal nga dal, me fletët e luleve të gjalla e në një shkëlqim të papandehur në krye. «Ditën e tetë, thira të dy gallantonët përpara vazove të cilat përmbanin dhuratat e tyre.»

«Ata vështruan me kujdes të dy tufat e trëndafilëve, njëra ishte e zverdhur dhe e përtharë dhe tjetra triumfonjëse, pastaj u panë në sy, në heshtje. Dhuronjësi i trëndafilëve që nuk kishin dajandisur, dyke e ndjerë kuptimin e brëndëshmë të provës, u përul me hidhërim dhe shkoj.

«Tjetri, dhurata e të cilit ishte zbukuruar si për çastin, u gjunjëzua përpara meje dhe më puthi dorën, dhe tërë jetën t' onë të përbashkët pashë të shkëlqei në tek ay dhemshurit e sinqerta si dhe vetë trëndafilët e mëndjes së tij, që s' mi kish parashtruar aspak para se të më njohë... Bariu, q' u ndodh në provën, më bëri një shënjë të vogël miqësore dhe iku.

«Q' atë ditë i dua aqe shumë trëndafilët! »

KULTURA FASHISTE

Kapital dhe Punë

— Përse puna është një detyrë shoqërore?

— Puna është një detyrë shoqërore sepse ay që punon nuk bën vetëm interesin e tij, por bashkëpunon n'interesat e Kombit.

— Atëhere fatet e punëtorit janë të lidhur me ata të Kombit?

— Po. Fatet e popullit punëtor janë të lidhur ngushtësisht me fatet e Kombit. Kur Kombi madhohet, edhe populli bëhet i madh dhe i pasur; por në rast se Kombi humbet, edhe populli vdes.

Për këtë arësye të lartër shoqërore bashkëpunimi midis kapitalit dhe punës është i domosdoshmë.

— Kush e rregullon bashkëpunimin midis kapitalit dhe punës në Shtetin Fashist?

— Bashkëpunimi midis kapitalit dhe punës në Shtetin Korporativ Fashist është rregulluar me anë të Kartës së Punës.

— Ç'është Karta e Punës?

— Karta e Punës është një lloj statuti që çakton formulën e marëveshjes që duhet të rregullojë dhënien e punës.

— Përse Shteti Fashist e përkrah punën?

— Sepse puna, nënë të gjitha format e saj — intelektuale, teknike dhe të krahut — është një detyrë shoqërore; dhe si të 'tillë edhe vetëm si të 'tillë, Shteti e tutelon dhe e dishiplinon.

— A mos tregon kjo se organizimi është i detyruarshim?

— Jo. Organizimi sindakal ose profesional ësht i lirë; por vetëm sindakata ligjërisht e njohur dhe e vënë nënë kontrollin e Shtetit ka të drejtë të përfaqësojë kategorin e punëdhënësvet dhe të punëtorëve për të cilët është formuar.

— Ç'të drejta lejon kjo njojtje?

— Organizata sindakale e njohur prej Shtetit, për këtë njojtje, mund t'i tutelojë të regjistruarit e saj përballë Shtetit edhe të të tjerave shoqërira profesionale, të lidhë kontrata të përbashkëta pune, t'u imponojë taksa anetarëve, të veprojë përkundrejt tyre, funksione përfaqësimi të një interesi publik.

— Atëhere korporatat janë organe të Shtetit?

— Ligji me të vërtet i njeh si organe të Shtetit.

(BIBLIOTEKA E FASHISTIT Nr. 2 — Doktrina Fashiste shpjeguar popullit. VASIL D. ALARUPI.

Vepra Botore në Shqipëri



PALLATI NE NDERTIM I MINISTRIS SE BUJQESISE DHE PYJEVE

NENUA PLAKE NE ROME

I. NE SHTEPI

Uah... moj korba, mpë... mpë. (i puth) Ueh moj Ojuzo... nuk di, më vishen sitë nga gazi, më hidhet zëmra.. (vë dorën në gjoks). Po ku është nuse Shuqurit, Hatixheja, pse s'kanë dale të më presin? Si jeni, gjithë mirë, me shëndet, të vegjelit ç'bëjne. a kanë bërë të liga? Ueh gazi nënos, shpirti nënos pa eja këtu (nipit të vogël). Po ti je bërrë burrë. Ashtu de... pa më thuaj se harove gjë nënon more jezit. Moj Haso sikur e ke hollë këtë djalë. Po Manushaqja pse më duket e prishur nga surati, ti nuse të keqen mos i mba ato gjëra në duar...o..o.. më në funt e me në bisht na duket dhe nusja e vogel.. hidhi këmbet. Lerme të të puth, mos ma ze dorën se e kam të palarë.

— Po urdhëró brënda moj katenxhikë — i thote nuse Shuqurit, pse ri në kembe. Dal të të mar nga krahu, se si ngjit dot shkallat se je e keputur nga udha. Xhemó bjeri sheshëlat (¹) këtu.

— Oh, le të ulemi këtu mbi minder në dëndivan — thotë nenua. I veshtron një nga një të gjitha, që nga koka gjer në këmbe. I prune kafene... një nga nuset i hodhi pall'on krahave. Aliu nipi m'i vogel iu fut në pëqi dhe i kerkonte xhepin e çitjaneve. Mbesat e tjera i rinin në këmbë përpara.

Të gjithë mirë ju gjegj — u thotë prapë nënua. Shaqirin e paçë ne sheshin e policisë, aqai më priti në fundin e udhës. Uh korba... më dukesh sikur nuk do të vija prapë... uh moj shtëpi, moj shtëpi, m'u-duktë vari si ti,

Nuk ju thaçë, keni të fala e të përfala nga ajo vajza në Romë. Më gezoj e më gëzoj kur i vajta. E laçe mirë, po i mbushi sitë me lot kur më përcolli e po u mësua, se mos ndenja pak, njëzet ditë.

Po ju ç'më thoni, ç'keni ndonjë te re këndej? Ojuzó si e ke djalin e kunatit q'e laçë të kequr? Si e kanë vajzen tek Xhevdeti, kush e di se ç'kanë bërë, se e pritnin djalë. Po ulu në shesh moj nuse, mos me ri duduk (²) në kembë. Po pse s'flitni moj kallogrera. Si veni me të ftohtë, e ngritet odan e zjarrit, gjerat i shkundët, i vute nëpër vende. Hapset e sepetit i gjetët, q'i kisha vënë mbi oxhak dhe harova t'ju thojsha kur ika?

— Të gjithë mire jemi, të marim doren (³) — u pergjegj Atsheja, nusja e dite. Mos u bën merak zotrote. Tani vete të të bije, nje sahan me çorvë te ngrohët të të mbledhë barkun, t'a rufisësh (⁴) ashtu pa bukë. Mirë që na erdhe, se na dukesh shtepija shut.. S'ka hije shtëpija pa të madh. Dhe të vogjëlit hinin e dilnin me koke varur, pa le Aliu që, që në mëngjes e gjer në darkë te kerkonte nepër odara.

— E more karten e fmilir moj nana (⁵) e pjeti Hasnua, vajza e vogel për te burri. Ubëmë merak që s'u kishit shkruar fare, se ç'thanë atje për kemben, se qe rematizmë apo ndonjë gjë tjeter? U-gezuam per Hasanin që s'kishte gjë, e keshtu i dodhi meraku.

— Çit.. çit.. moj shkretëtire, bjeri moj maçes, ulurit nënua në mes të fjaleve.. uh ju rëmbeu thelën me mish. Mbillni derën e qilarit, shini se mos kenit lënë tenxheren hapur. Pu..pu, u-ngjit nëpër shkalla, do të bijë munxur nga të katër anët. Bieri moj që të rafte pika. Ngreuni nusera, zeni punën, le t'i lëmë fjalet, e beni ç'keni për të bërë se erdhi koh'e drekës dhe vine burrat ne shtëpi. Dhe ju (femijve) q'u-martë të keqen nënue dilni tek porta se pastaj do t'ju jap plot të mira. Ti Ojuzó bjeri ato gjëra sipër, se do vete të ndrohen nga koka ne kemebe, se jam bërë nga udha si mos o Zot. Po të vije plaku brënda më folë... thuajme biró të keqen, tha gjë për mua kur ika. Sokollijti (⁶) gjë si e ka zakon? Sa filxane kodhi natën se i bën gropen (⁷) raki zezes kur nuk jam unë. Shaqiri ra gjë pas lodrëpape apo jò. M'u-duk si me tuzë të varura nusja, ç'ka, apo janë gjë me kunaten. Shë..shë, se po vjen...

— Nuse..nuse, bjemë një qelq me uje dhe dergó nje çike djalin tek Zërhaja. Ti thotë që erdha dhe se gjërat ja kam blerë, të vijë t'i marë kur të dojë. Bëni për të ngrenë, une vete të kumbisem, (⁸) dhe po të më zëri gjumi mos me folni fare.

Tap-tup nëper shkalla u-ngjit sipër dhe vete në odën e vogël. Hapi musandarene, futi kokën, pa në se gjerat ishin nëpër vënde apo jo, dhe nga një rëzë kreu çitjanet. I veshi. Hoqi jemenin'e kokës e shkundi dhe e vuri tek perona. (⁹) Pastaj hoqi sheshëlat nga këmba dhe eci mbi minder, Uli nje jastek nga të radhës (¹⁰) dhe u-shtri. Per sipër hodhi një palltò nga të fëmilës q'e gjeti në shesh.

Hapi, mbldhi sitë ca here dhe i qeshi surati qe ishte në shtepi. Nuset vajzat punonin përdosh. Të vogjlit kishin zënë lodren përjashta. Qjëmonte shtepija dhe asaj i prëhej shpirti.

1) Sheshëlë — a = pandofël, heqëla.
2) duduk në këmbë = si hu në këmbë, njeri që s'leviz as andej, as këtej.
3) të marrim dorën = të puthim dorën.
4) ta rufisesh = ta shkosh në gojë pa e përtypur një gjë me lëng.
5) nanë = nënë.
6) të sokëllitur = të neuritur.
7) i bën gropën = i gjen fundin një gjeje shpejt, sidomos në të ngrenë. E hedh në bark.
8) të kumbisem = të mbështetem me kuptim te fjetur.
9) peronë a = gozhdë.
10) jastëk i radhës = jastek me bar që vihet mbi minder.

Ujku dhe Qengji

E drej'a e më të fortit është m' e mira gjithmonë;
Do t' a tregojmë nashti në këtë prallëzën t' onë.

Një qengj ishte duke u freskuar
Në tallazin e një rreme të kulluar.
Një ujk i pangrënë del, që kërkonte avanturë,
Dhe që uria e madhe këtë hëna e kish prurë.
„Kush të bën kaq guximtar të trubullosh ujin t'im ?
I tha qengjit kafsh' e egër me tërbim.
Po dënohesh për këtë guximin t' ënd.
— Sir, gjegjet qengji, Madhnia Juai një mënd
Le të mos më zëmërohet;
Por më parë të mendohet
Që jam duke u freskuar
Në tallazin e kulluar
Më shumë se njëzet çape ndënë të;
Dhe që, prandaj, kurrsesi
Nuk mund t' i a trubulloj ujët e tij,
— E trubullon, tha ujku, me gjith' atë,
Dhe bile e di që vjet më ke sharë shumë herë.
— Si do t' a bëja këtë, kur akoma s' kisha lerë ?
Ia pret qengji, u pi sisë dhe një mënd.
— Në s' je ti, është pra vëllaj t' ënd.
— S'kam vëlla — Është pra një tjetër nga kushërinjtë:
Se më ndiqni në çdo kënd,
Ju, qentë t' uaj dhe barinjtë.
M' a kanë thënë: duhet të marr hakë pra."
Mbi këtë ujku e shple
Brënda në pyll, dhe e ha
Pa tjetër formë padije.

LA FONTAINE
Përkthim nga Dr. Omer Nishani

QYSH FILLOI DHE SI MBAROI...

„O kangëtor hyjnor, a po qetsohe
në pellgun e vorrezve të shkretueme
prej kohës të harrueme
qi pasqyrohen n'ujin e Bosforit"?

Kështu e fillon vjershën që i ka kushtuar Naim Frashërit, Et' hem Haxhiademi. E ka radhitur qysh më 1934 dhe kjo së bashku me disa vjersha të tjera formojnë « Lyra »-n që u vu në qarkullim pakë kohë më parë.

Një kryevepër e vogël ësht ky kushtim, nga pikpamja e artit poetik, dhe e nderon gjith'ashtu autorin inspirata sublime për të caktuar si subjek të vjershës eshtnat e shënjta të Poetit që dergjeshin të harruara në vorrezat e Bosforit dhe thirjen që i bën Kombit për t' i sjellur në atdhe.

Po autorin e nderon edhe një fakt tjetër: Veprën e tij e vë në dispozision të studentëve të cilët e deklamojnë qytet më qytet dhe publiku që e dëgjon mallëngjehet, jep obolin e vetë për t' u-mbledhur shuma e të hollave që nevojiten për trasportimin e eshtrave dhe ngrehjen e tempullit se qëllimi kryesor i deklamimit ishte pikrisht mbledhja e fondit - dhe kudo konstatohet gëzimi për këtë fushatë naltësisht patriotike.

Vetëm qeveritarët nuk e panë me sy të mirë këtë nisjativë dhe këtë fushatë. Haxhiademi në këtë vjershë atakon edhe reptësisht bashkë me apathinë e qeveritarëve edhe gajlen e tyre që të bëjnë vetëm pallate dhe të mbushin xhepin. Ministri i brëndëshëm i ahershëm e dënon me giobë dhe me kërcënim pushimi dhe internimi në rast se merret përsëri me objekte të tilla, se autori ka qënë funksjonar i Dikasterit të Brëndëshëm.

Në fakt kështu këndon poeti:

„Por kur kjo tok' me ajk' të kangve t' ueja
U ngjom për deri lulet sa i çeli,
I yti trup të ngeli
Në vëndin e anmikut qi luftove?
Të tretesh n' balta t' hueja
E lark prej nesh të jeshë
Dhe as nji vorr t'mos keshë
Qi aq dëshir t'a shohish t' lir ti pate
Kur sot n'kurris të saj ngrihen pallate ?...

Po ky Ministër vë dorë edhe në fondin e mbledhur nga studentët, jo me qëllim përvetimi, por për t' a shpërndarë ndër ata që kontribuan, se-thoshte Shkëlqesia në qarkoren e posaçme-ësht « Sovrani » ay që do t' i sjellii me të hollat e veta eshtrat për t' iu realizuar një endërr që e kishte patur... prej kohe! Dhe i sjell me një... xhandar nga Stambolli me të hollat e Arkës së Popullit kurse organët e tij turbetoñin se shpenzimet i pagoi nga xhepi i tij.

Por merita e Haxhiademit, me gjithë qarkoren e Ministrit, qëndronte e paprekur në gjykimin dhe çmimin e të gjithve se të gjithë tashti e kanë kuptuar se ka qënë vjersha dhe deklamimi i saj që xgjoi qeveritarët në sjelljen e eshtrave.

Në fakt autori thotë në këtë vjershë.

„Hei! turp i ardht' mbar' kombit, turp pa masë,
Kur s' të kujton shërbimet, o kangtar,
Qi dhe luftëtar
Ma fortë kunora e liris t'dhurohet!
Po as nji s' don t' pikasë
nga koha e kaluëme
se gjëndja e hutuëme
asht tyke korrun farën qi ti mbolle
dhe ka harruë qi qe ma par n'kasolle.

Dhe këtë kryevepër të vogël Haxhiademi kështu e përfundon:

Dhe ju qi dini vlerën e t' harruëmit,
aviti pran' të gjith e të mendojmë
se s'duhet të vonojmë
në themelim t'faltores s'on të kombit;
Përkundi ma prej gjumit
gabimin me qindisun
dhe prap me stolisun
se si ç'do kombi qi i erth profeti
nj'ashtu për gjindjen t'on' do t'jet' poeti"

Sot eshtrat e poetit prëhen në tokën që ay me kaq dashuri dhe mall e këndoi, dhe populli shqipëtar u-gjunjëzua me rispekt kur në Shqipërinë e sotme eshtrat iu vëndosën me ceremoni madhështore dhe të mëshirëshme në tempullin që i meritonte. Et'hem Haxhiademi ndjente edhe nji sadisfaksion në atë çast.

Një sadisfaksjon të ëmbël dhe të meritueshëm.

Dokumentari i „Triennale d'Oltremare"

Dolli në këto ditë një botim interesant me titullin « Documentario ».

Gjashtëdhjet e ca faqe i janë kushtuar përshkrimit të veprave gjiganteske të mureve që bujnë mostrat e ndryshme të ndara në tri seksione: historia, gjeografia dhe Puna italiane në Afrikë.

Volumi ka 305 faqe dhe 55 tablo jashtë tekstit. Në këtë vepër paraqiten të gjalla dhe leçitësi admiron grumbullin e math dhe krenar të Kullës së Partisë, ngrehjen madhështore të Theatrit Lirik « Acquario Tromicale », Theatri i hapët, Eksedra etj. Mbi një milion dhe më shumë katrorë sipërfaqeje, 54 godina janë ndarë midis 14 kilometra rrugë parke dhe kopshte dhe përmbledhin material të destinuar për të dokumentuar vashdimin e atij qytetërimi që bashkon lavditë e Perandorisë së Cesarit dhe realizimet e Perandorisë së Liktorit.

Mbas këtyre vashdon paraqitja e të gjitha industrive italiane që kanë kontribuar në përpjekjen madhështore të fuqizimit të Perandorisë.

Pastaj pasojnë artikui që shpigojnë të gjitha veprat, të shkruara nga pëndë të zgjedhura.

Volumi ka një paraqitje të denjë për çfaqjen e madhe të Napolit, me mbulesë origjinale dhe me gust të hollë, me shtypje të bukur, në mënyrë që arti tipografik italian paraqet një arritje të çkëlqyer.

LAJMERIM

Të gjithë atyne pajtimtarëve që u ka skadue afati dhe që nuk i janë gjegjun ftesës të bame nga an'e Administratës, gazeta qysh nga data 1 Qershuer 1940 nuk do t'u dërgohet më.

Gjith'ashtu dhe pajtimtarëve të tjerë që nuk kanë qënë në rregull me pagesën e të prapamberurave, do t'u ndalohet po në datën e sipërme.

Administrata e Gazetës

"Shkëmbi i Qorkës„

LEGJENDË

PREJ: VASIL D. ALARUPI

—Na Balik na, koj... koj... koj! ariu ndolli qentë, me të na arë të ngjitemi përpjetë ma-li, në drejtim të kopesë, u-ërsulë mbi ne porsi të tërbuar e të lehura egërsore. Kishim illuar të matim çapet dhe të regatitemi për mbrojtje, por riu ngriti zërin, që buçiti në hona nëpër mal, dhe qentë -bindën duke u-kthyer pra-ë tij.

Kish më shumë se një orë ë po ecnim n' atë të përpjetë ë thikë. Rast i mirë tani për marë një frymë. U sheshuam bi një majë, poshtë rëzimave frikëshme të « Shkëmbit të, orkës ». Vështrimet t' anë u ulë mbi 'të. Ishte madhë-tor e sundonjës n' ambientin malit: përrenj, shkëbinj, ta-pjeta dhe një panoramë që trihej e mrekulluarshme, e pa-ndme në gjatësi dhe në gjë-si. Reth e rotull, gjer poshtë rëzën e malit, shkëmb e rr; asnjë bimë, asnjë shelg, tëm, këtu, atje, ndonjë dri-që edhe vetë botanistët do ngatroheshin për t' i gjetur mërin. Shkëmbi ishte shumë i rtër, me një të çarë në mes fillonte nga kryeja në fund. enduam se ndonjë shpellë e llë duhej të fundosej brenda alit, e errët dhe e ftohtë.

— Çudi! se si më ngjan ky këmb? tha njëri nga shokët.
— Mos u-lodh, shtoj tjetri. duket porsi Sfinksi që e ke rë kaqe herë nëpër fotografit librave dhe të fletoreve.

Pushuam dhe po vërenim. ish të drejtë. Shkëmbi, veça-risht që ku ndodheshim ne, pte me të vërtet, pamjen e finksit misirli. Çudi! se ç'bën tura. Diçka misterioze shtry-i zemrat t' ona. Por edhe ma-e atij mali, një tjetër çudi naturës. Me përjashtim të a-s lindore, të tri të tjerat for-nin si një mur të lartër shkë-binjsh në thikë; si një mur të rehur nga ndoca punëtorë gji-ndë. E, mbi ata ngriheshe di-r. madhështore dhe sundonjë-e një kështjellë e vjetër. A ish gjë, qënia e gërmadhave ir malit, apo vetëm një le-dë popullore, nga ato le-dat që ç' do çip i vëndit onë na paraqit me bollëk? mrekulli vështrimi që zgja-j nënë këmbët t' ona! Fusha jellore e mbështjellë me kodra pas tyre, male të lartër, maj-t e të cilëve ishin akoma të shtuar me dëborën e bardhë dimërit t' egër t' atij viti he shkëlqente për bukuri në-ë rezet e arta të diellit pran-eror. Mbi kodrat tej fushës, atunde me shtëpit e dëndura ë dukeshin së këtejmi si kuti-kat e lojdrave të kalamanëve. Togje togje, ja edhe katundet fushës të rethuar nga shelgje shumtë. Nga krahu i mën-ër Korça plakë zbardhëllen në-vreshtat e brigjeve të saj. do pëllëmbë toke e fushës e uar nga krahët e florinjtë bujqve të palodhur. Me gjith o: pellgje, ujovina, vënde vë-e kishin mbytur atë fushën ellore. Përrenjt e malit të pa-shiplinuar derdhen me tërbim tëpjetë fushës në kohën e di-rit dhe e teptisin në zhur e rrë që zvarisin poshtë me gur-llimin e tyre të furishmë. Ja he plaga tjetër e fushës: kë-eta, që ka plakosur një pje-ë të madhe të vëndit të bega-shmë. Tej çipit të Malit të hatë, prapa kodrave të mbu-ara me dushk, xixëllojnë uj-at e kaltërta të liqerit porade-ar. Soditja e panoramës e shku ra e vëndit, na mbushin kokën e një mijë mendime. Çohemi he me këmb' e me duar ngji-emi akoma. Të dy shokët e ij drejtohen me vrap, të kë-aqur e me nxitimin e njërës-et që bëjnë një zbulim të adh. Dukeshin tani gërma-hat e mureve, një pash të gjë-ë, të kështjellës që dikur ngri-ej madhështore sipër malit. U-ë ndenja afër burrimit me u-jin e ftohtë si akulli, burrim ë në kohën e lulëzimit të kë-htjellës, kishte qënë një krua humë i bukur brënda mureve ë saj.

— Ngjatjeta zotëri, më tho-... një nga gurrët që rethonin burrimin.

Ishte një burrë shumë i moçmë, bariu i malit. I parojtur e i pa qethur, kush' e di që prej sa kohësh. Por fytyra e tij më habiti me freskëtin e saj. Mollëzat e faqave m' i kish të kuqe porsi mollçinka Mokre. Ishte i thatë nga trupi, por i gjatë dhe i hijeshmë në pamjen e tij egërsore. Plasi gunën e dhirtë nj'a dy çape më tej, u-mbështet mbi krabën prej thane dhe filloi të më vështrojë i habitur. Veshja ime e çuditte e sidomos ora e dorës. I dhashë një cigare dhe i a ndeza me dorë në zemër. Tepër nder për 'të, se e çfaqi kënaqësin e tij me një falënderim të dukëshmë dhe të sinqertë. Për herën e parë pinte një cigare fabrike. Pastaj fillova t' a pyes gjatë e gjërë mbi bagëtin e tija, mbi bulmetin e mbi gjëra të tjera që e preknë. Kështu u bëmë miq.

— Oh! jam nj' a tetëdhjet e pesë vjet, m' u-përgjigj ay, kur e pyeta për moshën. Atje lart në mal, asnjë mendim nuk e turbullonte jetën e tij monotone. Ditët i kalonte fillka vetëm. Brengosje asnjë. Bukën e misërtë i a sillnin një herë në javë që poshtë Kuç-it dhe në dimër vetëm, zbriste në katund, rëzë malit, ku dimëronte edhe atje pothuaj i veçuar. Krabën, fyellin, qentë e dhëntë, ja shokët e tij. Era e pastërt, një panoramë e mrekulluarshme, gjumë të ëmbël... Kusuri nuk e merakoste. U çudita pa masë kur më tha se në Korçë, gjatë jetës së tij, kish qënë vetëm një herë, nja gjashtëdhjet e pesë vjet më parë. Ishin të çuditëshme përshtypjet që i kish bërë Korça plakë asaj kohe. Kusurin e jetës së tij e kish kaluar atje në mal rotull bagëtis së vetë.

— Ky vënd, këto gërmadha, këta shkëmbinj... i a bëri ay. E... u... a...: Lojti dorën e djathtë nga kraba duke shënuar në erë një qerthull që desh të thesh se historia e 'tyre humbiste në errësirën e shekujvet. Lëvizjet i kish shumë të ngadalëshme. Shumë gjëra të moçme besa... E sheh atë bregun atje tej, shtoj ay, duke zgjatur krahun në një drejtim posh të malit, përtej një përroj: ne quajmë « Korieja e Vakëfit ». Dikur ajo ka qënë e mbuluar me pemë. Atje mbreti kish ndërtuar një Kishë por tani s' i ka mbetur gjë. Gërmadhat e saj janë mbuluar me dheun dhe fletët e pemëve që i kanë plakosur. Vështroje, vështroje « Shkëmbin e Qorkës », atje ne ajo e çara e majës, atje ësht « Vëra e Kaurit ». Posi, posi, ka banuar një mbret në këto vise në kohët e moçme. Si s' i ditkam, i kam mësuar nga im' atë që rojti më shumë se një qind vjet edhe ay vetë i kish dëgjuar nga gjyshi im, kështu i kujtojmë ne gojë pas goje.

« Në kohët e moçme - vazhdoj bariu - shumë të moçme, ata muret atje tej, ngriheshin, të treshë nga një pash dhe tepër të lartër buzë shkëbinjve me rëzimat e frikëshme. Kështjella çfaqte një pamje force të jashtëzakonëshme. Në 'të banonte një mbret i fuqishmë i këtij vëndi. Ay na kishte bërë luftëra të mbëdha, të përgjakëshme por e kishte mundur armikun kudo duke i dbuar mbeturinat e tij nga kishin erdhur. Kështu ishte bërë me nam të madh. Trimërija, mënçurija dhe urtësija e tij qënë të parëfyeshme. Tërë njerëzit e tij e deshin me mish e me shpirt dhe ishin kurdoherë gati të lënë kokën për mbretin e tyre të dhemshur. Kur u-martua mbreti me një vashëzë të ëmbël si vetja dhe aqe e bukur sa s' i gjendeshe shoqja në botë, u bënë ziafete të mbëdha. Jeta këtu ishte e këndëshme dhe i tërë populli jetonte në paqe dhe begati. Kishin kaluar vite të shumtë. Po erdhi një ditë mjerisht që kjo gjendje të tronditet nga disa lajme që mori mbreti. Me të vërtet një mizëri ushtërije armike po i tureshe vëndit. Mbreti s' humbi kohë. Mblodhi ushtrin e tij dhe i dolli armikut

natës, një kalorës vjen e lajmëron se të tjera fuqi të mbëdha armike po drejtoheshin për të kapur kështjellën. Atëherë mbreti la në vënd të tij kumandarin më të zotë për të vazhduar luftën atje dhe vetë vrapoj në kështjellë. Ariti me kohë se posa u-sos këtu, armiku me vrap po i sulej kështjellës për t' a rethuar. Mbreti u-përqafua me mbretëreshën e cila po e priste me zemër të thyer për fatin e ushtrive. Ay regulloj me një herë mbrojtjen dhe me të shpejtë, natën, i dërgoj kumandarit një kalorës për t' a lajmëruar mbi gjëndjen dhe për të mësuar se ç' përfundim kishin marë rjedhjet e betejës andej. Kumandari me ushtërin që i kish mbetur u këthyen në kështjellë se edhe armiku e kish çuditur të nesërmet me tërheqjen e tij gja-

mbledhur tërë dhit e cepinjt e fshatrave, u kish varur nga një kandile mbi brirët. U hoqi zilet e këmborët dhe i kajtisi përpara përpjetë malit duke i shpërndarë në të tëra anët. Kur roja i kështjellës i pa, arboj i llaftarur dhe lajmëroj se po vinin xhindët. Ushtarët u-tronditnë thellërisht e s' dinin ku të futen nga tmeri. Jashtë dëgjoheshin zëra e klithma të tmerëshme, daulle, pizga, berjaje e ulërima shumëllojesh që të gërrnin mishtë. Por sidomos një tradhëti e kurdisur mirë nga armiku i hapi dyert e rënda të kështjellës. Mbreti e kuptoj rezikun e madh. Çveshi shpatën dhe me ushtarët besnikë, i ndihmuar edhe nga kumandari, luftoj tërë natën duke i dërmuar sulmet e armikut që turrej si i marë. Gjaku derdhei si lumë dhe lufta çvillohej përmbi tru-

e mori mushkën e tij më të pëlqyer, hipi mbi 'të mbretëreshën, pastaj me shamin e vetë lidhi syt e kafshës; e hoqi për kapistalli gjer në buzë të rëzimës së tmerëshme të shkëmbit pastaj u-hodh edhe vetë mbi vithet e mushkës. « De o bandille de... Mushka bëri nj' a dy çape përpara dhe u rëzua n' errë... Poshtë shkëmbit, mbreti e mbretëresha nuk ishin më veç se dy kufoma të copëtuara.

« Hordhit armike teptisnë kështjellën, përlanë ç' gjetnë, pinin si të xhindosur dhe tallëshin me kufomat e ushtarëve të vrarë trimërisht. Qejfet e tyre kishin aritur kulmin kur vetë Zoti e mori hakën e mbretit të urtë. Një tërmet i fuqishmë zuri të lëkundë vëndet, malet e shkëbinjtë dhe muret e kështjellës tundeshin si lecka. Në një kohë shumë të shkurtër,

Punë Botore në Shqipëri

PUNIME NË RRUGËN TIRANË - ELBASAN

NENUA PLAKE NË ROME

II. UDHES...

— Nuse, nuse moj nuse Shuqurit, ku je, futur, unë të flas, ku je, fu'ur unë te flas. Hë mirë që më erdhe. U-ju prejtë Zoti ditën, u-f'ju bjerë një pikë ne mal të kokës, u-lunt shtëpisë, po ju keni bërë badërdinë. I keni krïër fundin teneqesë së gjalpit në njëzet ditë e sipër. Po ç'keni bërë, me bukë e keni ngjier. Po hapni sitë se dotë dalim me këpucë të kuqa.

Une të laçë por më të madhe në shtëpi. Jo biro, rojçi e qofçi, po jo dhe kështu të zezën dorë fare të lëshuar. Ik, ik mbaró punën se për këtë të fola. Shi, se mos vinë bukët shumë, dhe dërgo djalin në furë se iku dhe koha...

— Mirë moj katenxhike (1) të keqen, mos m'u hidh në kokë (2) ashtu, se mos i kisha vetem unë hapset në dorë, pastaj kemi pasur dhe njerëz për darkë e për drekë... Ika se më qan djali.

— Nënò, neno i thrret Allu u.. u.. erdhen plot zonja.. uhu teto Shanua me kokë të madhe.

— Uh — more i përmbisur, ike këtej se mos të më shohin, se jam e pa veshur. Poll abllase (3) t'i fute në oda.. Haxho futi njerzit brënda se tani vi une...

Ishte teto Shanua me di gra të tjera që u-ulne në divan sipër dhe zunë krejnë. Pas një çike me të dalë nënua në krie të shkallave, hop u-ngrenë të gjitha në këmbë.

— Oh.. miserdhe; miserdhe moj kapetane. Thamë se na mbete andej. Hajde, hajde, na u-bere Evropjane fare, thame se do të të gjenin dhe me leshra të prera..

— Uluni, uluni. Shano zeza gjithë jeten një soj i thote nënua. Kurrë s'ndrove, dhe atje që jeshë gjithënjë të kujtoja. Mire thone, shi sa të duaç, kajde ku të duaç vëndi dhe njerzit që ke rojtur gjithë jeten, ate të do shpirti.

— Po uluni de. Po si jeni, gjithë mirë, familen si i keni

— Si do Zoti vetë u-përgjegj në. Tani është e tepërtë të zgjatemi, pa na thuaj si shkove andej, nga ajo botë tjetër ç'pe e ç'nuk pe...

— Uh.. sa ju kam për t'u thënë e për t'u mollaisur, me barë e me thes — thotë nënua.

— Më duket e pa besuar që vajta, që laçë shtëpi, djelm e vasha. Vdëkëlën e kisha menduar në 60 vjeç po të veja n'Itali jo. Çh bej më kreu sëmundja e djalit, që desh Perëndia s'qe gjë. M'u vune vajzat, shko moj nënë shi dhe një here këtëkëmbë. Ma mbushnë menden, he.. he si me shaka u-be e vetë. Pastaj atë mbese e kisha atje. Malli më kish marë për korbën, e po vetem e zeza...

— Zbëre ndonjë turp moj nëne — i thote Shanua. Na trego si shkove u'hë, me thanë që të hoqne dhe çitjanet.

— U-pika e ku e dëgjove moj korbe — e pjeti nenua. He dhe atë e bëra. Ato ditë që vesha sadenë për herë të parë më dukesh vet'a si kur kisha bënë ndonjë turp, pastaj sikur isha me nder zotri s'uaj lakuriq. Rija rija pa ulja fundin. Po djall, q'ë htë për të krier sitë me cingriste. (4) Të mos zgjatemi, nga Tirana, si e dini që kishë një javë vatur, vamë në Durës. Të them të drejtën m'u druadh zemra kur hipa në vapor. E po, e pa dalë kurrë. Të mos më kishin mbajtur në ato të zeza shkolla si çengele në funt të dëtit isha për t'u gjëndur. Sa zuri udhën vapori se mos paçë më, hira drejt në kamere, (5) dhe u-shtriva në krevat. Po qe një det moj të keqen, që s'tregonet. As... e vu.. aa.. e vu, kreva zorrët (6) që kur erdha atje mi, si i thoni, Bari thaçe se do të jipja shpirt.

— U-ngrita ashtu kok'-këmbë, Hasani nga një anë mbante gjërat në duar nga njëanë mua. Kur xermuam (7) Uóóó, ç'milet që qd, adhr., adhr një gjuhë tjetër, ku i mar vesh unë. Se si nuk shti eshin nuk e di, qe dhe natë. Nuk shinte i pari të ditin. Po janë mësuar si thua.

— Kasaba e madhe, a e zezë — fualnë me një zë të di grate e tjera.

— Qe dhe natë, shtoi nënua. Zumë një karoce dhe vamë në hotel, se s'di as t'i them këto të zeza emra. Unë ca e lodhur dhe e këputur raçë si kopan dhe më zuri gjumi. Kur hapa sitë, ilahtarisa, (8) nga oshëtima e madhe, thaçe se do të shurllohesha...... moj Haxho, Haxhó e ç'e bëtë këtë të zezë kafe, tre sahat. Mos bini pas fjalëve andej... e se preva dhe fjalën, ku e laçë... thaçë se do të shurllohesha.

Më tha djali do të dalim të shohim një cikë. Un jo të keqen jemi për udhë dhe le të sosemi për atje ku jemi nisur.

As hangra as piva. Më vanë makarona përpara. Hapa sitë, ishin të gjata s'dija as t'i haja, pastaj një kulupi. (9) U more Hasan e ku do t'i hedh gjith' këto? S'i zura me dorë, i laçë të gjalla, (10) Më prunë mishtë, oh atë sa e cimbisa (11) një cikë.... kur shpejt na thonë se niset shëmendiferi. Ja hipmë dhe asaj. Zumë vënt afër e afër me djalin. Atë kohë u-kujtova për shtëpi e për njerëzi, thaçe me vehte si më lanë trutë dhe u niso, më dukesh sikur rija mbi gjëmba.

Na u-duk dita një vit. Ne jemi mësuar të gorobisim (12) gjithë ditën e jo të rimë me duar lidhur. Pastaj pa fjal'e pa kuvend, ne vënt të huaj. Atje pranë kisha dhe një plakë. Ç'të shihje, më këndonte gazetën. U pika thaçë me vehte, ç'të lipsen ti këto. Më foli një herë, po me se unë, isha si prifti pa gjuhë. Po ajo s'e prishi terëzinë. Ja shtroi fjala fjalës me ca burra atje që qenë me ne. Gër si mulliri pa koqe, na kroi zorët gjithë kohën, më shumë ajo se ata që qenë dhe burra. Moj si s'pushoi ajo çikë, e vër me duar e me këmkë, e puf cingare, e puf cingare, nga veshët ma krente timin.

Nga një herë nxirja dhe kokën në pënxhere. Ç'bukurira, ato vende të punuara aqë mirë. Takánda, ti shikoje, pastaj që dhe një kohë që s'bënesh, behar fare.

Kur u ngris u-pushua kuvendi. U kumbisa dhe më rufisi gjumi. (13) Ati nga darka u-afruam na thanë kur ja shemendeferi hiri në kasaba, ngadal ngadale...

U-ngremë në këmbë dhe ndenjnë n'atë copë divan përpara. Kur po qëndronte shëmendëferi, kur paçë mbesën që na kish dalë përpara dhe kokën fëre andej e fëre këtej po s'na shikonte. Une sikur do t'i hidhesha andej nga jeshë.

Kur na pa.. vër një të hire brënda dhe më bodhi duartë. E putha se kisha kohë që s'e kisha parë..

— Mirë q'u kujtove dhe na prure kafenë. E po ta pimë tani sa është e ngrohët.. óf.. óf.

1) **katënxhikë-a** = vjehrë-a.
2) **mos m'u hidh në kokë** = mos më fol me inat.
3) **ablla-ja** = zakonisht nipërit thrresin hallën më të vogël kështu.
4) **më emigr's** = më ngacmon.
5) **kamare** = kabinë e vaporit.
6) **kreva zorët** = u-vodha.
7) **xërmuan** = zbritën.
8) **ilahtarisa** = u-trondita pa pandehur.
9) **kulupi** = shumë.
10) **i laçë të gjalla** = i lashë ashtu si qenë.
11) **e cimbisa** = e preka pak.
12) të **garobisim** = të punojmë me vënd e pa vënd.
13) **më rrufisi gjumi** = e zuri gjumi i lehtë.

FLUTURA N'ERË

Rri këmbë-kryq në trotuar
dhe kur i afrohet „klienti"
bën sikur qan
tuke vajisur kokën nga një anë dhe tuke perënduar sytë
ndërsa fytyra i merte pampjen e një të mjeruari
që mba shpirtin me dhëmbë
por posa dora e mëshirëshme i heth obolin në prehrë
plaka lypëse e ndryshon fytyrën
dhe tashti duket e qeshur
dhe tuke qeshur vashdon muhabetin me një kalama që mba pranë
gjer sa shkon një „klient" tjetër
se ahere kthehet prapë në pamjen e mëparëshme
ipokritja!
dhe kur një djalosh ia hodhi në sy këtë marifet të dobët
ajo tundi kokën
dhe me një zë të shtruar e këshillot
që të mos vrapojë në gjykime mbi sende që lypin eksperiencë
dhe duket se kishte të drejtë

SHQIPTARET E EGYPTIT DHE ITALIA

Në fillim të lëvizjes kombëtare, kur në Itali, kish frenat e shtetit në dorë Krispi i cili mburej që ish te Shqiptar prej gjaku, një grup Shqiptarë që jetonin në Pellgun e Nilit, dhe që kishin formuë « Shoqërin' e parë » i shkruanin një permëndje ku i luteshin të mbronte dhe të drejtat Shqiptare.

Kjo, një mbërthamë e lashtë, por e kthjelltë, e bashkpunimit natyral midis dy vendesh që Adriatiku, nuk mund t'i ç'qitte njerën prej tjatrës, kurrë!

Kur duall në shesh shkrimet e de Radës, e Shqiroit, e. t. t., Shqiptarët këtu thoshnin kështu « nuk ësht êmeri Siqelia ose Kalabria, por Shqeria, dhe Ka-Labëria. »

Takimet nuk munguan dhe u njojtin më së miri, zunë marëveshjet, dhe ndjenë një adhurim të thjeshtë për Italinë, moter e mike, dhe s'andejmi i kthyen sytë, me një shpresë ndihme për rilindjen e vërtetë të Shqipërisë, që kishte zënë aqë thellë në hosin e mjerimit terësuër.

Me kohë pas kaqë kërcnimesh dhe mardhara të mbrëndeshme dhe të jashtëme u duk një farë drite çlirimi tokësuer i çalë, por në vend që Vëndi t'e mirte firomë, desh u mbyt në shpargër të jetës 'tij politik, pa ndihmën morale të mikes së vetëm Italisë.

Shkoi kohë dhe vimë në luftën e tmerëshme të vitit, 1914, ku Vëndi 'ynë pa dashur u fut në tallazin dhe si i-pa gatitur për as-gjë, pa patur brumë të mjaftë, për mos tronditjen e thellë të ndjenjavet kryesore të saj; në atë kohë istorike dhe aqë të veshtirë, dolli prapë Italia, dhe çpalli e garantoi me fuqit' e saja, pamvarësin e Vëndit' ynë: në këtë kohë, Shqiptarët e Misirit, me vrap e ndien dhe s'munguan të çfaqin kenaqesin e 'tyre, duk me shkuar në shumicë në Ambasadën Italiane, dhe kërkuan dhe muar me vrap, mbrojtjen e saja bujare, që i ndihmoi ne caste mjaft të vështira dhe të pa harruara.

Shumë prej 'tyresh i ruajnë akoma këto vërtetesa, mbrojtjeje.

Kur më von u arritnë marëveshje të ndryshme, midis Vëndit 'ynë dhe Italisë, për dobira të larta shoqërore dhe xhvillimi, nuk munguan kurrë së lavdëruari ndihmën vllezrore, se, duk me rojtur në mergim, e shikonin me sy më tëkthjelltë e të qëruar, jetën dhe rojtjen e Vëndit, si geografikisht ashtu ekonomikisht dhe shoqërisht.

Pas bashkimit të dy Mbretrive më një kurorë të vetëm, më një fuqi të vetëm, me aritjen e rendit ri, pas xhastisjes parë, me që as-njeri s'prite një gjë të tillë, në pak kohë, e muar vehten, dhe zuri me një-herë të komentohet ngjarja, në pamjen e saj të vërtetë, pëlqye në shumicë, se pasqyron, drejt dheshkurt interesat e vërteta të dy Vëndeve, që me vulnetin e lumtur të Duçes, u realizua me një menyre aqë të pëlqyerë dhe fisnike.

U lëkundën dhe upërpoqnë me çdo menyrë, që së bashkut të njohin Rendin e ri, por si nga herë, gjetën një kundërshtim nga gjith ata, që quajnë Patriotisme vetëm interesat e xhepit dhe të një rethi vetëm, që ketë radhë derdhin lotë, se gjith ëndrat e bukura, me det!, vanë mbë erë.

Mir-po të tjerët, grup i vogël por i kulluar, mundi dhe bëri çudira: në pak kohë, riorganizoi dhe radhiti kolloninë në reshtet e vërteta, pregatiti dhe bëri mbledhje të përgjithëshme në Kairo më 3 Dhjetor 1939, mu në shtëpi të Italisë, dhe në zërin e 'tij, s' mungoi njeri, më tepër se 150 veta muar pjesë, dhe spontanisht, çfaqnë gëzimin e 'tyre, për bashkimin fat bardhë të Vëndit 'ynë me Italinë motër të madhe dhe besnike.

PETRO MANDI

Karkalec ne Permet

Zyra Bujqësore e Përmetit njoftoi Ministrin e Bujqësis dhe të Pyjeve se ndër këto ditë krejt zona bujqësore e qarkut asht prekun

127
ARKIVI E PERGJITHSHEM E SHTETIT
AQIH
F.837 d. 23 f 123

NENUA PLAKE NE ROME.

I. Ne shtepi.

Nenua plake verdhe-dille nga surati, me kembe tee drehura e bere nga udha si mos o Zot, kaperceu prakun e porte. Erdhi ne avli, po fundi i frexhee i varesh nga nje ane, nje kuti e mbante ne dore dhe jemeniu i kokes i kish shkare. Kur pa njerzit e shtepise q'e pritnin u leshut. Uli kutin ne shesh dhe iu hodhi duarte. Puth njeren e puth tjetren.

-"ueh moj korba..." tha " ju pace dhe nje here! Ueh moj Gjuzo (mori frime)..nuk di me vishen site nga gazi, me hidhet zera si pule. (vuri doren ne gjoks)." Pastaj i veshtroi nje nga nje, po nuk i pa te gjitha. "Po nuse Shuqurit ku eshte? Natixheja? Pse s'kane dale te me presim? Pa me thoni si jeni" dhe bente ere me jemeni me njeren dore dhe me tjetren hapte jakan e amtrise. Po menden e kishte nevat. Donte te dinte cdo gje.."Pa me thoni si jeni? Gjithe mire? Te vogjelit si kane gene? kane bere gje te liga"

N'ate kohe Aliu me gjisht ne gole, nga prapa e nga prape nenes se tij nderi koken. Ajo e pa dhe "gazi nenos ? i tha " shpirti nenos! Eja nje cike ketu ai iu qas me koke ulet, duke mbajtur nnes nga fundi sadese, e i turpuruar. Ajo e mori ne peqi. I gezoi leshrat dhe i thoshte "po ti je ritur e bere bure. Pa me thuaj te mori gje malli per nenon? Me harove gje more jeit?.

Te gjitha rinin e veshtronin, plaken e shtepise. Ajo e maliecuar, pjete gjithmone, tani per nje gje, pastaj per nje tjeter "Moj Haso sikur e ke holle kete djale" dhe i futi te di gjishtret prapa zverkut dhe pa se c'kish perposh. "Po Manushaqja pse me duket e prishur nga surati Ti nuse mos ri kembe e mos i mba ato gjera ne duar. Pa mbaruar mire fjalen dhe kembe u degjuan neper shkalla. Ishte nuse vogel qe xermonte dhe kjo e priti me fjale "o..o.. me ne funt e ma ne bisht na duket dhe nus e vogel..hidhi kembet..lerme te te puth..jo..jo doren mos ma ze se e kam te pa lare."

S'kish mbetur njeri i shtepise pa ardhur ne dendivan. Neper avlira kishin hire te vogjelit e mehalles dhe ndernin koken tek dera, qe te veshtronin. Kur ja nuse Shuqurit i thote: Po urdhero brenda moj katenxhike. E pse mbeme ketu? Mos na vije dhe njeri. Eja pa te marim nga krahu, se gjithe keto shkalla sbenen dhe pastaj zotrote je dhe nga udha."

"Oh s'vete gje siper nuse te keqen dhe le te vije kush tedoje. Je ri dhe nje cike, pa do vete te bije se jam e keputur" Me kete fjale ne gola hodhi site neper mure se mos kish mbetur gjekundi ndonje fallangonje, minderet ne ishin shtruar mire, shkallat ne ishin te lara. Pastaj njerzit



La mia vita universitaria

Nel giugno dell'anno 1937 terminai a Tirana gli studi della scuola media e nel medesimo tempo pensai intensamente per mesi e mesi a una nuova aspirazione, per noi ragazze albanesi, tarecchie volte avevo sentito parlare in un modo piacevole e pieno di sogni, e di dolce bella, intorno alla vita universitaria. Siccome la facoltà nel nostro mancava, questo studio per noi ragazze albanesi era o meglio è ancora un sogno. Ecco in che consisteva il mio grande desiderio.

La vita che pensavo di svolgere durante questi anni non fu altro che il contrario di quello che aveva creata la mia fantasia.

Siccome sto per finire e non mi sono pochi mesi per laurear mi, deciso di scrivere qualche cosa, prima che io salutassi l'Italia.

Questo libro è una testimonianza personale della mia propria esperianza di vita e più del pensiero di mia prosa quotidiana e naturale.

Le mie idee qui espresse sono state pensate

Dorëshkrim nga shënimet e veprës *Jeta ime universitare*



Il quarto anno.

71 (131)

Seduto davanti al tavolo mio con le macchie domande
o fogli di qua e di là cominciai da l'ultimo anno
della vita universitaria. Per tutti i giorni avevo da lavorare,
ma ogni momento mi sentivo più stanco di prima —
Continuai così per una ventina di giorni, ma poi quando
vidi che non ero soddisfatto del mio lavoro e meglio di non
pieno a concludere nulla
poter da fare — allora cominciai di scrivere. Scrissi — avendo
avendo, avevo interrotto il lavoro del libro
che mai poteva mentre pubblicare. E così un
giorno con quello di giornale le mie compagni le leggevo
così mi divertivo. Uscivo per andare all'università. Se
nella via mia, mi ne vidi nella giornata più che sola
per altre ore, nel entrare — nelle quali mi fa compagnia
piacevole pensiero.
affari. Così come in repetizione di canto mi formazione
mi diè mi chiamò per vedere chi c'è.
molto le studentesse e gli studenti del primo anno
con questione e molto di più ci trovavamo a parlare
sul serio
gli argomenti. Ci salutavamo i belli che ci conoscevamo
e ci conoscevamo bene e ci bevevamo e così —

Divenimmo le mie amiche. Contento della loro amicizia.
Allora ci erano molti argomenti di novità. Ero io
ero stanco e non volevo restare nessuno. Andavo
in biblioteca e nel mentre trovavo i miei letterari Autori

DREJTORIA E ARKIVAVE TË SHTETIT

Dorëshkrim nga shënimet e veprës Jeta ime universitare

R. UNIVERSITA' DEGLI STUDI DI ROMA

Facoltà di " BELLE LETTERE "

TESI DI LAUREA IN ""LETTERATURA ALBANESE""

" N A I M F R A S H E R I "

(1846-1900)

MUSINE KOKALARI.

ANNO ACCADEMICO 1940-1941 - XIX - E.F.

Z. Mid-hat Frashëri, i kushtoj
studimin e "Poetit Patriot", si
shenjë respekti dhe falenderimi.

Musine Kokalari

Roma, 15 Tetor 1941.

PARTE PRIMA

- PREMESSA -

Ho ritenuto opportuno premettere alla trattazione della tesi vera e propria un breve cenno storico sulle varie fasi di lotta e di evoluzione dello spirito albanese.

In una monografia su Naim Frasheri, poeta cresciuto ed educato alla scuola patriarcale della vecchia Albania e nella cui opera si rispecchiano in armonia poetica, oltre alle bellezze della natura, anche le speranze, i dolori e le esaltazioni del popolo albanese non si poteva prescindere da presupposti storici. Essi varranno a completare la visuale della sua vita e delle sue opere, nonchè ad agevolare la comprensione del suo mondo spirituale.

- - - - - - - -

Pjesa e parë.

Hyrje.

Më parë se të hy në themë, e gjeta t'arësyeshme të përmënd shkurt disa ngjarje historike të historisë shqiptare. Bashkë me to të dëftoj përpjekjet e popullit shqiptar ~~di~~ zhvillimin që ~~fëri~~ gjatë shekujve.

Për të folur gjer'e gjatë mbi poetin t'onë Naim Frashëri, lindur, ritur the mbrujtur në tokën arberore, me ndjenjat e jetës patriarkale, nuk mund të shkë pu-tësha nga ~~nga~~ ngjarjet historike. Ay në veprat e tija pasqyron jo vetëm bukurit e natyrës, por edhe shpresat, vnojtjet, ndjenjat që ziejnë në shpirtin e ketj populli. Të gjitha keto bashkë, që më vonë do t'i numerojmë një nga nje, do të ndihmojnë punën që të dalë e nurë. Ketej do të rjedhin të gjitha shkaqet e veprave të tij, se si e shkojt jetën, the se si u-mbruyt. Më në fund lehtazi do të na vijë vet-vetiu, e kjartë the e kuptuar kota mendere si the gjëndja e shpirtit të poetit Naim Frashër.

*

* *

GRUAJA SHQIPTARE

BASHKIMI
DËN FUQIË

ORGAN I UJDHESBASHKIMIT TË GRAVE ANTIFASHISTE SHQIPTARE

VITI I I-rë MORRIK 1943 Nr. I

DY FJALË.....

O gjuha Shqiptare...nën'e Kombit,shpres o Atdheut,ti që tund djepin e foshnjës,që pret ditën e Lirisë së vëndit ku je lerë e rritur,të përshëndes.

Nuk e dëgjon jehonën që vjen së largu?pushkët që bjen, djemt që vriten,gjaku që po derdhet?...Shpresat sa vjen e shtohen dhe dita e Lirisë po afrohet.

Ti nënë që ngryse e gdhihe në kasollen më të shkretë,ti motër që vajton vëllan e vrarë,ti grua që ke mbetur pa burrë dhe me fëmijë për të rritur...ju o gra që rroni me gjak të ngrirë dhe keni shpresë dita ditës,ti o foshnjë që me lot në sy pret babanë të vijë në shtëpi...të bashkohemi.Të jemi një!Është e mirë e vëndit.Jemi të gjitha motra,pra të jemi të pandara në këtë ditë të mjerimit,për të qënë më të bashkuara dhe nesër.

Bijtë e vëndit,me dyfeg majë krahut kanë lënë vatrën:hënën babanë,gruan,motrën e vëllanë!kanë marë udhën e vëndeve të shkreta...ku era fryn,ku e ftohta të mundon,ku zjarri e buka të mungojnë.Malet janë plot me djemtë t'anë!Ca luftojnë sot!Ca do luftojnë nesër!Të gjithë për Shqipërinë!Të gjithë për të shpëtuar këtë vënd nga thundra e armikut.

Të bashkohemi le t'i japim dorën njëra tjetërs!Të punojmë edhe ne,ashtu si kemi bërë gjer më sot.

Bijtë t'onë janë të zhveshur,le t'i ndihmojmë sa të kemi fuqinë!Bijtë t'onë janë nëpër burgje,nos të kursehemi për 'ta!Shatrat t'onë janë djegur..e shkretuar bura e gra e fëmijë kanë mbetur udhës,le të ndajmë me 'ta atë që kemi.Me duart t'ona le të qepim,me kursimet t'ona t'u blejmë ato g'u lypen.Të japim aq sa na vjen për dore.Kush më shumë e kush më pak,se janë vëllezërit t'në.Të punojmë për të ndërtuar Atdhenë,ashtu si e kanë bërë edhe të parët t'onë.

Revista "GRUAJA SHQIPTARE"

NOVELË

Hieja e djalit.....

Natë...errësirë kudo! Vetëm aty këtu një dritë e harruar ndezur. Yjtë në qiell shëndrisin dhe Hëna e plotë humbet pak e duket prapë nëpër ret'e vogla q'i shkojnë sipër.

As një zë nuk dëgjohet! Vetëm nj një erë e lehtë fryn me ngadale. Degët e pemëve lëkunden pak dhe gjethet pëshpëritin një këngë të heshtur si zëri i nënës, i ulët, kur shoh se djalin e saj po e zë gjumi. Kur pa papandehur krisma pushkësh dëgjohen së largu... Një... dy... tre... Nëna u zgjua. U ngre në këmbë... e saj e tretur, mollzat e faqeve të fishkura, syt' e mërehun, të gjitha bashkë i u erën.

Vuri veshin dhe në një kohë e tepër vështroj fëmijët që po flirnin. Jo, jo nuk i bënin veshët. Pushkët binin... binin shumë larg. Nuk ju durue. Kapërxeu vajzën që kishte pranë dhe me majë të gjishtrinjve vate tek dritarja. Hapi xhamin dhe vështroj jashtë.

Pushkë binin, po shumë thellë dhe nëna vështronte në errësirë. Së shkretës, lotët zun t'i bien nga sytë dhe era e lehtë i hidhte në fytyrë flokët e thinjura.

"O Zot" pëshpëriti "o kërindi! Skënder bir, ku të kam...!"

Sa pushkë që binin, aq plumba ishin për shpirtin e nënës. Dy murë si unë janë vrarë. Të gjithë p për vëndin t'onë, Fshij lotët se dua t'iki i qetë..."

Dhe nëna rinte si e ngrirë. Lotet ju thanë nëpër faqe dhe mjekra po i dridhesh. Pak nga pak mbështeti kokën tek muri dhe me vehten e saj tha: "bir, mirë që të pashë edhe një herë... si n'ëndër, sikur më bënë sytë. As unë vetë e di. Skënder të pashë edhe një herë".

Hieja e zezë u larguadhe humbi n'errësirën e natës dhe s'u duk më.

Nëna u ul në shesh dhe vuri kokkën tek dritarja. Nuk qante më.

aj më parë, një mesnatë; krismat u dëgjuan. Dikush u vra, thanë, dhe në mëngjes nëna mbeti pa djalë të math. Për këtë qante...

Kur ja, në mes të pemëve, një hije e zezë u duk. U afrua ngadale Nëna u tmerua se shikonte t'i vinte afër? Ç'ishte vallë. Po ky ishte Skënderi... i plagosur... lyer me gjak nga koka gjer në këmbë... po zvarriset... sikur e shtyn njeri nga prapa...

"Bir" i thotë nëna me gjysmë zëri. Duart e holla dhe të dredhura i zgjati përpara, sikur donte t'a zinte...

"Nënë..." u dëgjuaw një zë i mbytur nëpër lote..."nënë mos qaj mos më vajto! Lermë të dergjem i qetë dhe në tokën e ftohtë. Lotët e tu janë si ato plumba që bjenë sonte atje larg. Janë thikë për zemrën t'ime. Nënë ke djem të tjerë ...nënë... për t'ta. Nënë mua më vranë dhe e derdha gjakun për vëndin t'im..."

Nëna dëgjonte këtë zë dhe e tmerruar hapte sytë. Mos vallë shihte ëndërr! Mos i bënin sytë... mos i bënin veshët! dhe zëri digjohesh.

"Mos qaj nënë të thom. Ke dy djem të tjerë të gjallë dhe motrën t'onë të vetme. Pse të qesh? E sa nëna janë si ... sa djem të tj

Mblodhi duart grusht mbi gjoks, mbylli sytë dhe po mendohesh për ëndrën që pa me sy hapur.

Nuk dëgjohesh më pushkë, hyjt nuk shndritnin si më parë dhe hëna q'e e mbuluar me ce re të zez a që vënin e vinin në qjell. Një erë e fortë u ngre. As një dritë n nuk dukesh nëpër shtëpira dhe aty nuk dëgjohesh një dritarexx që mbyllesh. Degët e pemëve lëkundeshin dhe gjethet bënin fësh, sh, sh sikur këndonin një këngë të trishtuar, si vaj i mbytur i nënës kur qan me vehte djalin e saj të vdekur..."

Tacita

Gruaja shqiptare, 1943, nr. 1, korrik, f. 11-12.

Zëri i Lirisë

DREJTËSI SHOQËRORE ✠ ✠ ✠ LIRI POLITIKE

Nr. 1 Viti I. ORGAN I PARTISË SOCIAL-DEMOKRATE E Shtunë 1 Kallnor 1944

Atdhetarizma shpëtimi i Shqipris

Të flasish për Shqipërinë është sikur të tregosh historin e hidhur të një nëne që një mijë e një të zeza ka parë e ka hequr. Ditë me radhë, me shpirt në dhëmbë dukej sikur drita e syrit po venitej dhe do të shuhej një herë e përgjithmonë nga kjo jetë. Dhe në këto ditë mjerimi, përzier me lotë e me kuje, bij të dhëmshur e kanë kthyer e rotulluar, i kanë lidhur plagët dhe mijra mundime e rezige kanë kapërcyer. Kanë lënë kokën për 'të dhe më në fund e kanë shpëtuar. Lindi gazi në buzë të saj dhe shpresa dita ditës u shtua. Dhe ajo ndjenjë që në fund të zemrës qe futur, u rit me ngadalë e buçiti sa herë që reziku qe i madh, lidhi e bashkojti bijt' e saj. Dhe kjo dashuri nga një brez në tjetrin, nga gjaku i të jatit shkoi tek i biri dhe nga i biri tek i nipi mbrujti e gatoi atdhetarizmën shqiptare.

Sa të këqija ka parë ky vendi ynë, e sa dallgë i janë hedhur sipër dhe kanë dashur ta humbasin nga faq' e dheut. Sa të zeza e mjerime ka shkuar. Dhe kush e ka shpëtuar këtë nënë të dhembshur? Këtë baltë ku është trat e gjysherve t' onë dërgjen gjithmonë të dredhur për fatin e zi të lombit ndënë token e ftohtë? Bijt e nënës Shqipëri.

Kohrat e para kur armiqtë njeri pas tjatrit e shkelnë këtë vend, barbarë e të huaj shkretuan e dogjnë anë mb' anë, fshatra e qytete i bënë germadha.... gjaku ! bijve të saj u derdh.

E shekuj me radhë... e vjete që dukeshin sikur nuk do mbaronin kurrë, sikur rezja e diellit nuk do të shkëlqente më nga këto anë dhe buza e venitur e shqiptarit dukej sikur nuk do ta shikonte më vëndin të lirë... po prapë gjaku i bijve të saj e shpëtoi.

Historija e Shqipërisë, është historija e gjakut dhe e lotit, është historija e atdhetarizmit, trashëgimi që na kanë lënë të parët.

Dyzet e kaq vjetë luftë bëmë me Turqinë, me Skenderbenë në krye dhe Shqipërinë e mbajti të pa mundur se qe e fortë dashurija dhe në shpirtin t' onë vlonte atdherizma.

Dhe si mote shkuan e qindra vjetë në roberi, kur në vëndin e gazit dëgjohej vetëm vaji, kujua e nënës mbetur pa djalë, zëri i kukuvajkës nga një pyll në tjetrin dhe përhapej në mes të shkretësirës e gërmadhave, ku shqipëtarët dukeshin se dergjeshin nga një sëmundje e pashëruar dhe armiku në derë rinte me hannxhar në dorë, gati për t' ja futur në zëmër po të ngrinte zënë... dhe me gjith' atë patriotizma nuk vdiq.

E kur një gjëmë u dëgjua dhe u përhap nga të gjitha anët se nëna Shqipëri po coptohej e ndahej pjesë pjesë, ndahesh vëllai nga vëlla, mishi nga thoi, qe zëri i patriotizmës që buçiti dhe ngriti njerëzinë në këmbë. U-bë Lidhja e Prizrendit. Besa u dha, u lidhnë burrat e arbërit që gjak të derdhin, të mbeten të vdekur në fushën e luftës po asnjë pëllëmbë tokë shqiptare nuk do të lëshohet. E burra si Abdyl Frashëri, Prenk Bib Doda, Hodo Pasha i Gusinës e shumë të tjerë rëmbyen armët dhe luftuan kundër armikut. E gjaku u derdh, e burgjet u mbushnë plot por dashuria për lirin c vëndit nuk u shua.

Edhe kur vendi u zvesh nga djemt' e saj e u dërguan nëpër qytetet e largëta, atje të heshtur e ndënë dhe, punuan e kurrë s' pushuan për vendin që kishin lënë në brengë e mjerim.

Edhe brënda vatrës arbërore u bënë shumë kryengritje. Një vullnet i pa thyer i burrave trima si Isa Boletini, Azem Bejto me shokë, si bënë betejen e Kaçanikut shkuan përpara. Nga prapa i ndoqnë shumë fise Kosovare, midis vrasjeve që pësuan, djegieve e shkatërimeve që u ndodhën drejt për të shpëtuar Shqipërinë. Kështu në Shqipërinë e mesme, kështu n' atë të jugës, ku shpirtrat ishin ndezur deri sa një ditë flamuri Kuq e Zi, larë me gjak, i qindisur në një këndë të fshehu me frikë e me lotë nga duartë e Marigosë u ngrit në Vlorë, më 28 Nëndor 1912, prej Ismall Qemalit.

Gazi nuk mbaroi me gaze. Hidhërime të tjera erdhën.

E në kohën kur Shqipërija e jugës po përvëlohesh nga barbarizmat e imperjalistëve grekë e qindra fshatra si Frashëri, Kolonja, Leskoviku bëheshin shkrum e hi e njerëzia këmbëzbathur thereshin si bagëtija, Shqipërinë e mbajti gjallë atdhetarizma.

Programi i Partis Social-Demokrate

1. Partija Social-Demokrate ka për qëllim kryesor të sigurojë „drejtësi shoqërore“ dhe „liri politike“.

2. Partija Social-Demokrate është evolusioniste për sa i përket kolektivizmës ekonomike dhe siguron të drejtat e njeriut.

3. Partija ka për qëllim kryesor t'i sigurojë bujkut tokën e mjaftueshme për ta punuar, të zhduki shfrytëzimin, spekulimin dhe parazitizmin. Gjith' ashtu do t'i sigurojë proletarit bukën, banimin dhe të gjitha ndihmat e tjera për t' ja bërë jetën të këndëshme. Reforma agrare do të jetë etapa e parë ndaj ndarjes së tokës. Partija do të përpiqet të vërë në zbatim një sistem sigurimi shoqëror për mbrojtjen e të gjitha klasave shoqërore.

4. Lirija politike konsiston në sigurimin e të drejtës që jep çdo shtetasi të ketë lirin e fjalës, të mendimit, të shtypit, të inisjativës private dhe të votës (opozita parlamentare). Partija do të mundohet që të krijojë premiza të tilla që të kontribuojnë në edukimin e të gjitha klasave të popullit shpiptar demokratikisht dhe paragatitjen e tij për regjimin e ardhëshmë ku do të mbretërojë drejtësija shoqërore dhe lirija politike.

Lirija politike në drejtësin shoqërore gjen shkakun e parë të kufizimit të saj.

5. Për sa i përket marëdhënjevet me kombet e huaja, partija do të frymëzohet jo prej një nasionalizme të ngushtë egoistike, po prej një patriotizme të thjeshtë që pajtohet me ndjenjat e respektit e të simpatisë për atdhetarët e kombevet të huaj dhe do të përkrahë zhvillimin e idesë për realizimin sa më parë të një konfedetrate ballkanike,

6. Partija ka për qellim të luftojë kundër çdo okupatori për independencën e një Shqipërije t'unjisuar brënda kufive të saj etnike.

Dhe atdhetarizma i frymëzoi djelmoshat kolonjarë që gazi u shkëlqente në sytë e tyre që duke kënduar venin drejt vdekjes, për të shpëtuar vendin.

Trimat e Kolonjes mbenë të vrarë në greminat e Starovës edhe kur gjaksorët e Gjiritit ndeznë zjarr' e flakë e digjej vëndi anë mb' anë, atdhetarizma na mbajti të gjallë.

E sa halle e brenga kemi shkuar e sa ditë dhe netë me radhë kemi qëndruar duke qarë, po një zë i ëmbël, një ndjenjë e ngadalshme që levrinte nëpër damarët dhe vinte nga fundi i shpirtit, na jepte zëmër. Ishte zëri i Shqipërisë që fiitte dhe na mësonte si të mos kishim frikë e gjithmonë përpara, përpara të patrëmbur të shkonim. Dhe kështu e bëmë.

Shqipërija vëndi m' i vogël i Ballkanit, vëndi m' i lënë mbas dore në Kongresin e Berlinit, në Konferencën e Londrës, ku i muarnë vëndet më të bukura të saj, lëngoi, po nuk vdiq.

Sakrificat që bënte ky komb i vogël, plagët që hapnin dita difës në trupin e tij edhe gjaku i thithej nga të gjitha anët, në kulmin e dëshpërimit ky popull ngriti kryet. Një pakicë e brengosur dhe e dëshpëruar prapa vdekjes së kombit, me armë në dorë, me sy të pa-trembur, zgjodh më mirë varrin e ftohtë se sa zgjedhën e robërisë. Dhe ky zë i përbashkët gjëmoi në kongresin e Lushnjës 1920, mbrujtur me gjakun e Abdyl Ypit.

Edhe kur zëri i një Frashërjoti thërriste se qeverimi i qarkut të Korçës lidhej me qeverin e Tiranës, jo shumë ditë më vonë për të shpëtuar tërësia e tokës shqiptare e për të bashkuar Vlorën me nënën e saj të vërtetë një grusht njerëz u nisnë të luftojnë me një fuqi të madhe si Italia.

Ishte zëmra e luftarit që luftonte ishte zëri i kombit, që për të jetuar kish vendosur të vdiste me nderë. Shqiptarët asnë nuk kishin veç atyre të pakave e të ndryshkura e me gunën maje supit, me një copë bukë misri në torvë, me kamën në dorë, me gjysmë opinge në kembë dhe me gjoksin e tyre mburojë i bënë municjoneve, mitralozave fortifikatave të hekurta, ushterisë së madhe, flotës që rëndë rëndë qëndronte në ujrat e Adriatikut e ballë për ballë me vëndin t'onë. Plumbat binin, topi gjëmonte, mbi telat bëhej fushë, rrugë e drejtë dhe lufta nga një çast në tjetrin shtohej, behej më e furishme. Gjaku shkonte rrëke, të vrarët binin njeri pas tjetrit e lulet e kombit e huadhnë armikun përtej detit.

Këto luftra, mijra përpjekje i dhanë kombit vetëm njëzet e pese vjet liri me gjysmën e vëllezerve jashtë atdheut.

E ç' qe ay zë që buçiti eë zëmrën e Shqiptarit dhe këtë herë? Atdhetarizma. Qindra veta lidhur këmbë e duar u dërguan përtej detit. U internuan e u burgosnë. U rahnë, pa ngë- në u lanë, andej këndej i zvarisën. Ishte prapë zëri i Shqipërisë që flite [illegible] dhe ajo hapi krahët e na mbledhi në gjirin e saj. Dhe luftoni bijt' e mi tha, luftoni për nënën t'uaj.

Nga fundi i dheut një rënkim dëgjohej, thellë vinte: ishte zëri i të vdekurve. Ishin eshrat e tyre që përpeliteshin ndënë dheun e ftohtë, ato të Skerderbeut, të Abdylit, të Samiut, të Naimit, të Vaso-Pashës, të Vretos, të Koto Hohit, të Gërmenjit, të Abdyl Ypit, të Çeços e shumë të tjerëve. Bashkohuni për mëmëdhe e bëni frontin kombëtar.

E rrëth birit të Abdylit, flamurtarit të 78 u mbluadhën bajraktarët e maleve, burrat e Kosovës, pleqtë e shkuar, zogistat, të rinjtë patriotë, grupi i komunistëve 'me të vërteta shqiptarë, zjarristat e pa-tundur, të gjith në luftë për atdhe.

Dhe luftat filluan. Topi gjëmoi në Gjormë, në Selenicë. Në Dinaqar në Ruzhdije e kumandant Jashar Çakrani vet i njëzeti u vra. Në Gramsh, e Selfo Hekali ra dëshmor. Më vonë në Drenije, në Ballsh, në Gramsh, Çorovodë, Mifol, Llakatund, Bestrovë e në shumë vende të tjera. Në Grihot ku gjaku u derdh si rëke e heroi kombëtar, me më shumë se 30 veta ra dëshmor për mëmëdhe. Shpirti i Hysni Lepenicës u vate pas shokëve në Qafë të Shtambës, në Reç të Shkodrës, në Drashovicë e në shumë lufta të tjera.

Në mes të këtyre luftrave, të vrasjeve, të shkatërimeve, të djekjeve, gatuar me shpirtin e shqiptarit, dalë nga gjiri i shqiptarit mbrujtur me atdhetarizmë, lindi partija shpiptare Social-Demokrate. E për luftë dhe ajo në ndihmë të atdheut, e mirëdashëse ajo, në bashkimin e erergjive të kombit, e arësyeshme ajo, për një të neserme të lumtur të Shqipëris së unjisuar brënda kufive të saj ethnike dhe për një demokraci, gjeti vëndin e saj bashkë me rrumat e tjera politike, në BALLIN KOMBËTAR.

A.

BIBLIOTEKA SHQIPTARE

MUSINE KOKALARI

RETH VATRËS

MESAGJERITË SHQIPTARE
TIRANË 1944

304.188

Tiranë, 14/VI/ 1944.

Z. Kolea

Po ju dërgoj pesë copë të librit "Rreth vatrës". Më në fund doli në dritë dhe besoj se si punë nuk ka dalë keq dhe ideja që kam zënë me nuk është e gabuar. Kur keni qenë së mbrëmi ja u-kam këndonar. Nuk di në e mbani mënd. Sido qoftë mendimi im ka qenë t'ju ap të vegjëlve një libër që mos t'i lodhë edhe vehten e tyre mos të gjejnë në një botë të huaj, veç besoj në një botë shqiptare, në një vatër ku dhe të mbërthej, të të thonë se vërtet kështu kemi rrojtur. Kur e kam shkruar, nuk kam qenë veç një po një kujtim e vogël dhe si e tërë me mendime të thjeshta e gjithë ... e pa gjëgjje.

Besoj se nuk bëra keq që përrallat i dëftova nga goja e nënës, plotë osa tetë lalesë. Kam këndonar libra me përralla, qoftë edhe të shkrimtarëve të huaj, dhe duke mos dashur t'i ve unë që gjithë n'atë shkallë, po vetëm përrallën të rrëfyerë më është dukur një punë e thatë.

Mbesa ime e këndoi (është afro nandë vjeç) dhe q'atë ditë më është afruar më shumë. Nuk e gjeti aspak të vështirë. Veç kësaj, duke qenë si familje e mbante mënd gjithë ngjarjet, më thotë se nëna plakë i pëlqen më shumë se tetë lalen. Pastaj Azmin s'kishte të drejtë kur

DREJTORIA E PER...
E AR...

Prallë nga të Shkupit.

"Bukuria e Dheut"

Jan'jtan tri motra nëpër oborr tue folë. Masanej ka kapërcye djalë i kralit. Ato jan kan tuj kuvendue njana me tjetrën. "Me kan me m'marr mue djalë i kralit, unë e mveshi tanë asqerinë me kmishë të pëlhurës," thot e madhja. E mesmja thot: "Unë kam me m'marr mue djalë i kralit, unë e marroi ngallit nji bukë t'ngjândhe me ngjëm asqerinë". A e treta thot: "Me kan me m'marr mue djalë i kralit, m'lergjetë vjetes m'jap Zoti nji djalë e nji cikë me yll (kyçell) n'ballë e me hanë nën sjetull".

Djali kralit i ndigjon. Shkon n'shpi t'vet, i thot babës s'vet qi due me lyp çikën e madhe. E martojn t'parën. E me m'i len e cet me bâ pelhur. Ajo s'un gjo për hiçgja asqerinë. Masanej e la për ismeçore ata dhe i thot "nuk je për mue". Kesila e martojn t'dytën. E edhe ajo e'asella s'mundet me ngjâmë bukën për tanë asqerinë. E i thoti edhe ti s'je për mue. Të mramen e martojn të tretën. E mas nji vjetës asaj i a fal Zoti djalin edhe çikën me ynjëll n'bâll e me hânë nër sjetull.

Motrave ju-vjen zor. I marrin fmit



BIBLIOTEKA SHQIPTARE

MUSINE KOKALARI

...sa u-tunt jeta.

TIRANË
MESAGJERITË SHQIPTARE
1944

62

13/IV/1945. —

E shtunë. Ditë e vdekjes për 17 veta. Plagë të reja që hapen, lotë që po derdhen. Lotë njerinish që s'kanë të pushuar, se plagë të reja, të tjera, do hapen dhe që s'lënë as të vjetrat të mbyllen. Hija e vdekjes mbulon qytetin. Dridhma serkojnë në trup të çdo njeriut. Ngjajmë me gjethet e pemëve që era i lëkund. Një nga një bien dhe ikin. Një nga një po na lënë. Kënga e vdekjes u-përhap kudo dhe po hyn shtëpi më shtëpi. Ka më tepër se një mot që ka nisur me të marrë ~~dhe~~ nuk dihet se ku do ~~mbarojë~~ të vejë dhe ku do të mbarojë.

Pse heshti njerëzia? Pse nxijnë rrugët e Tiranës? Mos vallë zemra ime e zezë që ~~[illegible]~~ gjak i sheh kështu? Pse shtëpia më duket e ftohtë dhe çdo gjë po shuhet? Fytyrat t'ona, çdo ditë kanë nga një rrudhë më tepër se plaga e shpirtit çdo ditë ftohet dhe kështu dhimbja shëmbëllehet ~~kështu~~ sëmurë.

Ulem në këndin e odës dhe e mbyllur në vete time mendoj orët e ditës, librin që mbarova në darkë, përpara se të mbyllesha librarinë. «Novelle Svedesi» të Selma Lagerlöf. Pas ~~së~~ Romusat, një tjetër shkrimtare më kënaqi me novelat e saja, një ditë të tërë. Njera më bukur se tjetra. Penda e saj nuk shkruan po ~~[illegible]~~ i bie telitë që tingëllojnë muzikën e ndjenjave të zemrës. Fjalët e saj të kulluar i ngjajnë poezis, stolisur me ngjyra zëra - ku natyra merr pjesë dhe këndon e qan me njerinë bashkë. Legjenda të kulluara gërshetuar dhe ~~[illegible]~~, bërë një. Ndjenja



Elbasan, 19 Prill 1945

11

Zonjëzës'
Musine Kokalari

Tiranë

Zonjëz' e dashurë,

Me gjithë se lajmet' që më pru Nasmiu kur ktheu nga Tirana këtë her' të funditë, qenë sadopakë të buta dhe të mbara, po prapë se prapë nuk' m' uhoq nga zemra frika mos lëndonj një plagë të hapurë, që vetëm' gjyqimi dhe mëndja dhe oha dot' mundin' tëtulasinë.

Lash' të shkojën' prapë ditë përmbi ditë dhe me zij' sot' guxonj të vënj gur në zemërë.

Shuplaka e fatit' që shkrepi mbi ju, Zonjëzë, dhe mbi der' të juajë është aq" e tmerrëme sa ndofta as emër' nuk' ka të posaqëmë në gjuhënë t' ënë, në gjuhën' e njëj kombi që, për të gjat' të shekujve, ka pas' qënë rrahur' dhe pjekur' e djegur' ndër cen' e rrëbjera.

As fjalë ngushullimi nuk' kam ku t' i gjenj se hèlëm' i zî, që ju shtrydhi zemrënë juve dhe të juajëve, ,është nga ata që nuk' kan' të sbutur' me fjal' as me lotë.

Bashkë me ju dhe me miqt' të mirë të derës' së juajë, kam qarë së largu dy miqt' të çëmuarë që hikën' e na lanë në lulen' e moshësë; kam qar' të dy të rinjtë që nuk' qenë vetëm' lëvdijë për të vehtëtë po qenë së bashku dhe shpresa për ne për të paskëtajmenë, se kombi ka nevojë për bijë, si ç' qenë Mumtazi dhe Vesimi, me zemër' për së mbari dhe me gjyqim të matur' dhe mëndje të pjekurë.

Vdekja ka detyra si ç' ka ç' do gjê në botë, po rredhi i tyre është veht-vehtiutë tepër' i kufiturë; me qënë se detyrat' të jetës' së të gjallit' as anë kan' as masë; ç' do ditë që shkon u sgjat' e u rrit' vargunë, se jan' të shumëduarëta; detyra faqe vehtesë jo vetëm' sa rreh zemëra po dhe mê pas, se jeta sgjatet' pak' a shumë edhe përtej' varritë; detyra faqe njerësvet' që ka njeriu të vehtë dhe faqe atyre që kan' qën' mê parë; detyra faqe miqëvet' dhe faqe njerëzimitë; detyra faqe kombitë, atdheut' edhe botësë.,,,,

Zemërës' së juajë dhe Zotit' Hamit ju qoftë ngushullim të kryerët' të detyravet' të ra dhe të rënda që her' e prap' e sotëme ju shtoj' mbi gjithë t' jeratë edhe faqe prindërvet' dhe faqe të miturvet' dhe nënavet' të tyre, që jeta nëpërkëmbi me kaqë egërsim.

Një gurrë ngushullimi gjith' aqë të vërtetë dot' jua falinj' puna, kjo detyr' e shenjtë edhe faqe vehtesë edhe faqe botësë, që është prëjt' e zemrësë dhe shëndet' i trupitë dhe pus' i harrimit' për trocet' të jetësë.

Labor consolator ac protector maximus, ka qën' n[illegible]

II

12

Vërtetë për kohët' të shkuara, pa është dhe sot dhe ka për të qënë gjith' mon' e vërtetë.

Fati ju ruajtët', Zonjëzë, bashkë me gjithë të afërmit' të zemrës' së juajë, nga ç' do mërxij' e brengë,

Leter ngushëlluese e e Aleksander Xhuvanit drejtuar Musine Kokalarit

SEKSIONI II_te
N°ICI/686 Prot.

VF.L.P.
Tirane me 6.IX.945,

S.E.M.P.-it
-K e t u

Gjegje shkreses I735 date 27.8.945

Nga informata te marra per Musine Kokalari rezulton:
MUSINE KOKALARI,me pare ka qene me luften N.Cl. dhe merrte pjese ne grupet antifashiste.Me von dezertoi dhe hyri ne grupe te Ballit dhe te Legalitetit.Kjo bashkepunonte me te quajt turen Qefsere Beshirin,ndihmojshin ne hudhjen e trakteve bile kj kjo shkruente dhe vete.Me çlirimin e Tiranes i jane vrare dhe dy vellezer.Sot shifet te shoqerohet me familje reaksionare gji thashtu dhe me Qéfsere Beshirin qe kishte nderend te organizonte g rate.Qefsere bente levizje te shpeshta por e mori vesh se gjyr rmohej dhe nuk del,ka hapur dhe nje fjale se gjoja nuk eshte ke tu.Musine Kokalari shkon shpesh ne shtepi te saje.(Marre nga In)

Musine Kokalarin ne kohen kurohyne partizanet e are stuan dhe e mbajten disa kohe ne burg,por ne mungese faktesh e liruan.

Kohet e fundit nuk eshte degjuar te leshoi ndonje pa rrulle.Ne dyqanin e saje shkojne disa elementa te dyshimte,si psh.e ema e Bashkim Dizdarit dhe Ramadan Sokolit gjithashtu rrin shume here dhe nje grua e cila eshte malazeze dhe qe kete e kemi pare shpesh here te bizedoi me engleze.Kjo ka dy dyqane nje ne rrugen e 28 Nendorit dhe nje prane Lahatit ngji tur me Qamil Hotin.Ketu poshte ju shkruajme lebizjet e saje brenda ketyre dy tre diteve:

Me 3 k.m. vjen ne dyqan e saj i quajturi Ramadan Sak kolli i cili ndenji atje 2 ore resht.Ne oren 11 u largua nga dyqani.Nga ora I2.30 vjen ne dyqanin e saje nje grua tjeter e cila nuk njihesh prej zbukuesit,Musineja se bashku me te mbylle dyqanin e shkuan nga rruga e Elnasanit.Ke Sindikata punetore ndahet me kete grua,gruaja shkon nga rruga e Shengjergjit kurse kjo shkon nga rruga e Elbasanit ,te ura e Lanes takohet me nje burre plak nja 55 vjeç dhe qe te dy marrin drejtimin per ne Misionet e Aleateve.Ne te djathte te rruges,pa shkuar ne Misio nin ushtarak amerikan,plaku kthehet ne rrugicen qe te qet ne Tirane te e kurse Musia shkoi drejt rruges.Prane Misioniy ushta rak francez kjo hyn ne nje rrugice dhe me sa u informuam atje ka nje kusherire te saje.Mbas dreke vjen ne dyqan ne oren 4.30 dhe gjat nje ore e gjysem nuk behet as nje levizje,nga ora 5.30 vjen prape Ramadan Sakoli i cili rrin 45 minuta dhe largiohet, Io monita me von vjen malezezja qe permendem me larte e cila rri in nje ore ne dyqan dhe largohet.Pas nje dhejete minutash komshi iu Qamil Hoti vjen ne dyqan dhe bizedon me te per I5 minuta.

Me 4 k.m. ne oren IO.I5 ne dyqanin e Mysines vjen pr prape Ramadan Sakoli ku rrin 50 minuta dhe astaj largohet.As nje levizje tjeter para dite.Po pas dreke ne oren 4.30 kjo doli ne dyqan dhe ne 5.30 vjen serisht Ramadani dhe pas pak iken. Ndersa Musinaa rrinte perjashte ne karrike vjen nje grua dhe filluan te bizedonin,pas pak vjen nje oficer dhe u fjalos pak me até gruan dhe se fundi nje nga nje ata largohen.Me oren 6.30 vjen prape malazezja ku rrin 1/2 ore.Assnje levizje tjeter.

P. SHEF I SEKSIONIT TE II-te
Ballut

41 32

vDekje Fashizmit

Liri Popullit

Tirane më 4.Jenar.9[illegible]

RAPORT MBI LEVIZJET E MYZENE KOKALARIT:

Ne vezhgimet e bera për Myzene Kokalarin konstatuam keto:Më daten 24 t m.k.ndodhesh ne Librari Venus si gjithmon arketare,ketu vijne dy vajza,njera prej te cilave nuk njihesh mbasi për te paren her shihesh ne Tirane dhe tjetr Nime Cani,nenpunse ne Bange dhe nga Gjinokastra,ndenjen pake kety,pastaj muar Myzen dhe duallen,si shtetën pake shkuan ne CIDA,prej bileta dhe Nimetja iken për Durres,ndersa keto te dyja shkojne ne nje pastiçeri dhe si ikin prej kety shkojne gjene ne Librari dhe ndenjen deri ora 7 te mbrëmjes,aty ka ra ne sy v tem kjo gjë:Vajza e panjohur,shoqe Myzenes ncjer pjej çante tre cop letra dhe ja tregone Myzenes dhe i thot se"i kam marr nga ay"letrat ishin flet blloku t cilat mbasi i kendoj Myzeneja ja dorzoje vajzes përsëri.Pakë minuta më vonë e dhi Adjutanti Gjeneralit Englez.Me te foli Xhaxhaj Myzenes ne gjyh Inglisht,i cili pastaj i dha dhe nje pako me gazeta jo t'onat,kur i dha pakon ne fjalë,My ze a i thot Xhaxhajt sojë"po ato"dhe ay u përgjegj"jo-jo"Englezi iku duke mar dhe pkon me vetë.Si iku Englezi duell dhe shoq Myzeneja.Më vone aty vjene nje grua me moshë mezatare,posa huri ne Librari u drejtua me nje here ne Myzeneja me te cilën foli 10 minuta me zë t'ulët,ndersa Myzeneja mbante shenim ne nje b llok.Në këtë kohe hynte dhe dilte shpeshe ne Librari Zef Nika pronar'inje Shty pshironje ketu ne Tirane,dhe fliste me Myzenen.Myzeneja si iku nga Librarija s koje për ne shtepin e saje qe e ka prane Misjonit Frances Nr.4,u vehgue deri ora 10 te nates por nuk dolli nga shtepija më.

Më daten 25 te m.k.Myzeneja shkoje ne Durres bashke me Nimete Canin.

Më daten 27 të m.k.esht pare përseri ketu ne Tirane dhe gjat kesaj dite e shte takue me Mësuesen pran Institutit Femnuer Marija Berisha dhe me Profesore po prane Institutit sipërmë Angje Berisha.

Më daten 28 të m.k.ësht takuar po me vajzat e më sipërme(Nimeten e tjetre dhe me Filip Guraziun qe banon ne Rr.Qemal Stafa Rrugica Qoraliu Nr.49.

Myzeneja përveç te sipërmave takohet dhe me shum gra dhe vajza te tjera Si mbas konstatimeve ndushohet qe kjo te punoje me masat e gruas esidomos me a in lektualet.

Më daten 29 të m.k.ka dale nga shtepija n'oren 15,ndenjti nje orë ne Mesa gjerin e Shtypit,prej ketu shkoje ne Foto Skenderbej,ketu ndenji deri ora 18,s dolli prej ketu shkoje ne shtepi te saje me nje karroc me gjith te vllan e Me sinit.

Më daten 3o nuk ësht pare te dalin fare përjashta mbasi binte shi

Shefi Seksioonit te II-të
(Dhosi Progri)

Bodluk

INSTITUTI MUSINE KOKALARI MK



Burgi

8

Vdekje Fashizmit - Liri Popullit

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PROKURORIJA E
GJYKATËS USHTARAKE E NALTË
Nr. 17 i R. P.

Letër-rreshtim

Kondra:

Musine Kokalari e bija ie Reshatit dhe e Anushes vjeç 28 nga Turqi - Tirane me profesion libra shitëse

Akuzohet

Si Sabotatore e Pushtetit dhe Armike e Popullit

Me qenë se faji i parashikohet prej Nenevet 1 të Ligjit Nr.21 date 15.XII.1944 dhe 15 parag.II.të Ligjit Nr.41 date 14.I.1945

Ne Prokuror i Gjykatës Ushtarake në bazë të Nenit 20 parag.III te Ligjit Nr.41.-

Urdhërojmë:

Rreshtimin e tij për një kohë të pa caktuar në burgun e Tiranës.

Organet e M. P.. Policis dhe çdo fuqi e armatosur ngarkohet më zbatimin e këtij letër-rreshtimi.

PROKURORI
(Kap.Ire Nevzat Haznedari)
Nevzat Haznedari
KRYETARI ~~OSE ANTARI~~
(Major Fredarik Nesi)
F Nesi

Tiranë, më me 10.V. 1946.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PROKURORIJA E GJYKATËS USHTARAKE
TË NALTË
Nr. 5 Regj. Them.

AKT - AKUZE
(KOMUNIKATE)

GJYKATES USHTARAKE

K Ë T U

Sikurse do të konstatohet dhe nga proces-verbalet e mbajtura prej Sekcionit te M.P. te Tiranes, që bashkangjitur paraqiten, i pandehuri MUSINE KOKOLARI bija e RESHATIT dhe e ANUSHES vjeç 28, nga TIRANA, me profesion ose efektiv LIBRA-SHITESE i arrestuar më datën 23 Janar 1946. akuzohet se Musine Kokolari gjat okupacionit Fashist-Nazist, ka bashkë-punuar me kreret e Ballit Kombetar dhe Legalitetit, si: Hitat Sraseri, Gaqo Gogo, Xhelal Staravecka e tje.-

2)- Mbas clirimit te Shqiprisë ka zabotuar pushtetin, duke bashkepunuar me Suat Asllanin, Qenan Dibren, Sami Çeribashin etjere.-

3)- Ka marë pjesë ne të gjitha mbledhjet e fshehta që ka bërë Grupi Monarkist, Grupi i Rezistences dhe i Social-Demokrates, duke zgjedhur një; Komitet te përbashkët, e cila ne bashkëpunim me t'aratisurit, si Figeri Dineja dhe Muharem Bajraktari etj, kishin përgëllim përmbysjen e Pushtetit të sotmë me violence.-

4)- Bashkerisht me kreret e Grupeve te tjere tradhetare kane përpiluar nota e programe për aleatet, te cilevet ja u kane paraqitur te trumbull gjendjen ne Shqipri e dhe me kete mënyre, duke i genjyer, kane kerkuar : nderhyrjen e tyre.-

Mbasi faji i tij parashikohet i ndëshkushëm prej Nen. 1, te Ligjës Nr.21 datë 15.12.944 është parë e nevojshëme që ky të gjykohet. dhe 15 & II ~~XXXX~~ te Ligjës Nr.41 dat 14.I.945.

P r a n d o j:

Kërkoj gjykimin e tij nga ana e asaj Gjykate dhe mbasi t'i faktohet faji që akuzohet, në përfundim të vendoset ndëshkimi tij në bazë të Nen. 18, te Ligjës Nr.41 datë 14.I.945 mb i organizimin e fukcionimin e Gjykatave Ushtarake.

Tirane, më 10.VI 194 6

PROKURORI:

(KAPITEN i I-rë NEVZAT HAZNEDARI)

Nevzat Haznedari

29/6/46.-

224

MBROJTJA

Duke parë zhvillimin e proçesit e shof të arësyshme të them vetë se i gjithë aktiviteti i atij grupit të vogël Social-Demokrat nuk është gjë tjetër veçse një notë e drejtuar aleatëve të perëndimit për shtyrjen e votave kur qeveria u-njoh me të drejtë opozite. Një hap i tillë nuk do të thotë përmbysje e Pushtetit të sotmë me violencë se ne, të 37 të pandehurit, në bankën e t'akuzuarve nuk jemi pjesëtarët e një organizate por antarët e katër korenteve të ndryshme, te jashtë Frontit dhe i katërti i dalë nga gjiri i tij dhe i shkëputur qëndej. Katër korente me konsepte politike-shoqërore të ndryshme dhe vet-vetiu me veprimtari të përshtatshme që pas prirjes që përmban, duke qenë secili përgjegjës për vehte. Tre të parët nuk kanë patur tjetër lidhje veçse në dërgimin e një note të përbashkët për shtyrjen e zgjedhjeve. Koalision nuk do të thotë shkrirje, as bashkim zoti kryetar po impenjim moral rreth një programi aktual ose të përhershëm midis partive ruajtur e duke qenë vetë përgjegjës për çështjet e brendëshme në arritjen e qëllimit ose idealit, në respektimin ose jo të parimeve që ka zgjedhur.

Duke qenë në pragun e rindërtimit të vendit i dalë nga lufta me dëme të mëdha, me plagë të shumta materiale dhe morale, në pragun e zbatimit të reformave shoqërore ku cenohen interesat e një klase të privilegjuar gjer dje, d.m.th. në përmbysjen e një bote feudale drejt ngrehjes të një koncepti shoqëror demokratik ku baza e jetës është puna e gjen një pjesë të popullit shqiptar jashtë Frontit. Gjurma të një të kaluare jo shumë të largët, nga koha e luftës ku organizata të



DIVISION OF COMMUNICATIONS AND RECORDS
TELEGRAPH BRANCH

DEPARTMENT OF STATE

INCOMING TELEGRAM

ACTION COPY

DC/R

ACTION: EUR
INFO:
S
U
LE
NEA
A-B
SA/N
OCD
PC
DC/R

JSP
Paraphrase before communicating to anyone.

CONFIDENTIAL

CORRECTED COPY (7/1/46)
5:05 p.m.

CORRECTION UNDERLINED

10267

Tirana via War

Dated June 27, 1946

Rec'd 8:46 a.m., 29th

SECSTATE

357, June 27, 4 p.m.

At trial June 26, Larry Post testified he had been connected with opposition movement since May last year and acted as intermediary American and British missions (last statement heard in court but not published) (MTTKL 161, June 26). He said he introduced Dendanjsreis-Hasho and Abdullah-Muca to Majors Palmer and Smith, British Mission. He added defendant Balla told him of attendence at meeting at which Asllani had said Brg. Hodgson said movement needed men of courage like Kakoshi who dared speak out in front meetings.

Yesterday after trial, crowd attacked prison van and beat defendant badly. Kokalari, one of two females accused, had most of hair torn from head. Guards stood idly by.

Sent Caserta 163; repeated to Department as 357.

JACOBS

IMS-IW

CONFIDENTIAL

"Dje, pas seancës gjyqësore, turma sulmoi furgonin e të burgosurve dhe rrahu keqaz të pandehurit. Kokalarit, njërës nga dy gratë e akuzuara, i shkulën më shumë se gjysmën e flokëve. Rojet bënin sehir."



Emni e Mbiemni Myzejen Kokalari Pseudonimi (Muza)

Fajt i ...le — Profesioni

data e lindjes 1917 Vendi i Lindjes Turgi

/Prefektura(per te huajt kombesija)Nenshtetesija shqiptare

Kombesija shqiptare Feja Myslimane vend banimi Tiranë

Emni i Babes Reshat i nanes Anushe e lindur Gjirokaster

Gjendja civile Begare emni e mbiemni i pare i bashkeshortes —

numuri i fe ijeve — dhe emrat e tyre —

Studimet shkollore dhe teknike Universitetin

Cilet gjuhe shkruan e flet Frengjisht e Italisht

Vend banimi i perhereshme, rruga dhe numuri Tiranë

Informatat Per çeshtje politike personat le lidhje

~~Informatat~~ Objekti

Dosja Nr.

Pse eshte futur

Vendimi (decisione) Synua me 20. vjet.

SHENIMET

Shtati (trupi) 1.65 floket Gështej syte Si ullir goja rregull

dhembet te sajat hunda e rregull mustaqet —

mjekra — shenja te veçanta —

Galigrafija Musine Kokalari

SHENJAT (GJURMAT)

INSTITUTI MUSINE KOKALARI MK



AMNESTI NDËRKOMBËTARE
SEKCIONI I NORVEGJISË
Një lëvizje për liri opinioni dhe fjalë

Oslo, Norvegji, 25 mars 1966

Sekretarit të parë të Komitetit Qëndror

Enver Hoxha

T i r a n ë

Shkëlqesia Juaj,

Po ju shkruajmë si anëtarë të një grupi të Amnesti Internesionall në Londër. Sikurse mund ta dini, kjo lëvizje punon për lirimin dhe lehtësimin e kushteve të të burgosurve të ndërgjegjes në mbarë botën, siç do të keni mirësinë të shihni në deklaratën spjeguar këtu ngjitur.

Grupi ynë është përgjegjës për një të burgosur nga Rodezia, një nga India dhe një nga Shqipëria, për

Zonjushen Musine Kokolari

Sipas njoftimeve që kemi ajo është arrestuar më 1945 për aktivitet politik dhe dënuar me burgim të përjetshëm. Duke ditur se aty ka patur një amnisti të përgjithëshme më 1962 dëshirojmë të dimë në se ajo ish ndërmjet të burgosurve të liruar apo ajo është akoma në burg.

Ne mund të jemi të dsinformuar për të. Në këtë rast ne do ta çmonim shumë në se do të na bëni të ditur për sa më sipër.

Duke ditur se qeveria Juaj po ndihmon për të krijuar kushte të mira për çdo njeri, shpresojmë se do ta merrni në konsideratë këtë çështje.

Lutemi pranoni, shkëlqesia Juaj, sigurimet e konsideratës sonë më të lartë.

Tuajt plot respekt,
Harald Thiis,d.v.

Adresa:
Oscargt.86
Oslo, Norvegji.

A P R O V O H E T

KRYETARI DEGES PUNVE TE BRENDESHME

(PANDI KITA)

"TEPER SEKRET"

Mirdite me 7- 6 - 1968.

INSTITUTI MUSINE KOKALARI

M.K.

P L A N - D E T Y R A S H.

agjenturale-operative per kontrollin 2/B, te Musine Reshat Kokolarit dhe lidhjes se saj Bilal Xhaferri.

Dega e punve te brendeshme Durres me shkresen e saje Nr.524 date 15/5/1968, na njofton se nga perpunimi qe i behet Bilal Xhaferrit ne kategorine II/A si agjent i mundeshem i zbulimit Jugosllav, del se gjate vitit 1962, per disa muaje Bilali ka punuar hekur kthyes ne Rreshen dhe ne te njejten kohe eshte mare dhe me disa shkrime, si shkrimtar. Ketu ky person eshte shoqeruar dhe njohur me disa persona te internuar, si me Musine Kokolarin, familjen e te aratisurit Izet Osmani e tjera. Për verifikimin e ketyre te dhenave dhe zbulimin e karakterit te ketyre lidhjeve me Bilal Xhaferrin, mendojm te marim keto masa agjenturale-operative:

1) Ne radhet e te internuarve kemi nji b.p. me pseudonim "Njizabutka" i perjashtuar, te meret ne lidhje dhe te behet nji bised e pergjithshme reth problemeve te punes, te rethit shoqeror te tyre e tjera, duke e lidhur biseden per Musinenë, siç eshte fjala ku punon, sa leke merr, ne se ka banim te veçant, çfar studjon e tjera, po ketu te sqarohet se me kë ka mardhenie shoqerore e miqesore. Kjo çështje te realizohet deri me daten 30/6/1968 nga puntori operativ Refat Mena. Ro

Ro 2) Te bisedohet me b.p. tone, ne se ka njojtur reth vitit 1962, ndonji puntor qe vinte dhe i shkonte ajo ne shtepi, dhe me çfar pune merrej ky, ne se perfundimishte do te dal nga kjo bised se Bilali njifet prej b.p. për lidhjet qe ka me Musinenë. Kryhet nga p.op. R.Mena deri 30/6/68

Ro 3) Musineja dhe vajzat e te aratisurit [redacted] e [redacted] punojne ne sektorin e ndertimit, ne kete sektor neve kemi b.p. "Shkendija" qe i eshte pushkatuar babaj, ti jepet nji vije sjellje per tu afruar me Musinene dhe me vajzat, per te mesuar se si reagojne keto aktualishte, me cilet persona kane lidhje ne ndertim, kush i simpatizon, kush i mban afer, çfar librash studjojn, si i komentojne, çfar shkrimtaresh simpatizojne dhe romanet e tyre. Kryhet nga p.op. R.Mena deri me 30/6/1968.

Ro 4) B.P. "Brisku" qe banon afer Musinese te na japi te dhena mbi levizjet e Musinese dhe [redacted] te [redacted], kush u vjene ne shtepi atyre, nga jane keto persona, si quhen keta dhe anasjelltas kujt i vene keta ne shtepi ketu ne Rreshen dhe cilet persona bjene me shume ne sy: qe kane lidhje me te lartpermendurat. Kryen p.pp. R.Mena deri me 30/6/68.

Ro 5) Te krijohen mundesite dhe te behet studimi per te bere nji bisede me ish te denuarin [redacted], tani pa trisk fronti, me te permendurit ky banon ne nji [redacted], personat qe ne kemi nen kontroll jane kontigjente te hapura, te na sqaroje ky se çfar bisedash bejne ato me ty, kushe u vjene ne shtepi e tjera, kryhet nga p.op. R.Mena deri 15/7/1968 se bashku dhe me Zv/Kryetarin e Deges p.brendeshme.

Ro 6) Te korespondohet me Degen e p.Brendeshme Dures qe te na dergoj kopjet e letrave qe ka korespondua Musineja me [redacted] mehmet [illegible] materialesh te tjera kane qe implikojne objektin ton dhe

(54)

pë 7) B.P."Kalaja" qe punon ne Rubik qe njifet dhe me objektin Musine Kokolarin [redacted] te drejtohet per te na sqaruar si reagojne keto aktualishte per situaten, çfar pikpamjesh çfaqin për shkrimtaret, silet simpatizojne me tepër per romanet e tyre e tjera, me qellim qe te na dali ne se e simpatizojne Bilal Xhaferin ose jo. Kete detyre e kryen Zv/Kryetari degës Koço Agora.

pë 8) Te ngarkohet me detyre per te na sqaruar rreth personave qe bejne pjese ne rethin letrar Rreshen [redacted] ku te na sqaroje se çfar mbledhjesh kane bere, çfar kan diskutuar per romanet e tregimet e ndryshme, çfar kritikash ka pasur, për cilet shkrimtar ka pasur simpathi dhe cilet jane keta persona [redacted]

pë 9) Te studjohet perberja e njerzve qe marin pjese ne rethin letrar ne Rreshen, ku jane keta dhe cilët jane, çfar tematikash kane shtruar per diskutim, ne se ka pasur debate ne favor ose kundra ndonji shkrimtari dhe kush jane keta. Kryen p.op. R.Mena deri me 30/7/68.

pë 10) Nga studimet qe do te bejme ne kete reth letrar dhe personat e mir qe jane ketu te krijohen biseda te ndryshme me ta për te mesuar s[illegible]kush kritikohet dhe kush simpatizohet nga shkrimtaret, dhe kush mban lidhje me keta shkrimtar, sidomos per keto çeshtje te pyetet shkrim[illegible] [redacted] e tjer. Kryen p.op. R.Mena deri me 30/7/68

[redacted]

"Çajupi Kreshnik" ku te na sqaroje se si reagojne keta reth shkrimeve e shkrimtarve, simpathine e ketyre per keta dhe kundeshtimet dhe çfar fryme kane keta kundrejte shkrimeve pro ose kundra partise tone. Kete detyre e kryen p.op. Refat Mena deri me daten 15/7/68.

pë 12) Te interesohemi per perberjen e rethit letrar : A) Ne se ka ne kete reth njerze me perberje te mire dhe keqe dhe çfar thon keta, si reagojne. B) Ne raste se ka ndonji b.p. ne radhet e letrarve aktiv ose te perjashtuar, te shikohe mundesite per ti aktivizuar dhe riaktivizuar ne kete drejtim. C) Diskutimet qe ka bere ky rreth dhe pikpamjet qe jane çfaqur per çdo veper te diskutuar. ç) Çfar tregimesh ose poezira kan ber pjestaret e rethit letrar dhe permbajtja e tyre, permbajtja politike ne fryme partije ose kundra. D) Te studjohet ne pergjithsi ky rreth letrar për pikpamjet e tyre dhe lidhjet qe kane me shkrimtaret e tjer, siç esht Bilal Xhaferi e tjere.

pë 13) Te studjohen lidhjet qe dalin nga dosja e Musine Kokolarit siç eshte Raile Luzi, Drita Kosturi, Elizabeta Lufi e tjer, si dhe Frida Sadedini, te verifikohen se ku ndodhen sote, ne se jane ne perpunim nga ndonji dege, çfar lidhjesh mbajne me Musinene dhe çfar te dhena te perbashketa kane. Kryen p.op. Refat Mena deri me daten 30/8/68.

pë 14) B.P."[illegible]amja e pjekur" qe eshte mbajtur ne lidhje nga p.op. Hysen Haxhiu, i drejtoris e Tirane, te korespondohet per kete çeshtje me Drejtorine e P.Brendeshme Tirane per te na sqaruar per lidhjet e Musines qe u thane me sipër, si dhe te verifikohet lidhjet e tjera ne Tirane siç eshte e [redacted] si reagojne keta ne drejtim te objektit tone, ne se interesohen per te, a mbajne korespondence e tjera. Kryen p.op Refat Mena deri me date 15/8/68.

15) Te bashkpunohet me degen e sig. Ushtrise per te derguar ne

(55)

rreth lidhjeve qe ka Musineja me Nurien, Driten e tjera. Kryen p.op. Refat Mena deri me daten 30/8/68.

pò16) Te pyetet Dega e II-te dhe Dega e IV-te per kontrollin postar ne se legata Franceze u ka kthyer pergjigje shoqeris e amnistise ndërkombtare ne Norvegji lidhur me Musinene, per kete te pyeten dhe organet tona qendrore (Ministrija e P.Jashteme) ne se kan mare letra nga kjo shoqeri, ne se ka mar te njoftohemi dhe neve te na kthehet pergjigje ne se eshte njoftuar kjo shqqeri per Musinenë, dhe mundet ti thuhet Ministrise jashteme qe Musineja eshte e lirë. Kryen p.op. Refat Mena deri 30/8/68.

pò 17) Te studjohen lidhjet familjare dhe shoqerore te Musinese, se ku jane keto, ç"qendrim mbajne keto lidhje, ne se ne radhet e ketyre lidhje ka b.p. dhe te kombinohet puna me deget e rethve perkatese ku jane keto lidhje qe te zqarojme ne se kjo u ka vajtur ndonji here dhe ne se ato i kane ardhur kesaj ne Rreshen, si dhe çfar halle familjare kane te afermit e saj prej familjes, keto me qellim qe te pregatisim konditat dhe te legjendojme largimin e saje per te te afermit e saje ne rethet ku jane ato qe te bejme kontroll sekret ne dhomen e saj ketu ne Rreshen pa te kapur ne se ka shkrime ose romane me permbajtje kundeshtare ne dhomen e saj ne Rreshen. Kjo detyre kryhet nga p.op. Refat Mena deri me daten 30/7/1968.

pò 18) Te sqarchet se cili eshte b.p. "Rrufeja" qe ka dhene para pak vjetve ne drejtim te lidhje te Musinese, dhe te studjohet mundesija ns munde te meret ne lidhje dhe te ridrejtohet tek lidhjet e Musines" dhe tek kjo, po keshtu te behet nji bisedë me Preng Nue Mollën nga Tarabshi dhe me pune ne ndertim ne Rreshen, duke e pyetur reth musinese se çfar din ky per kete. Kryehet nga p.op. R/Mena deri me 20/6/68.

pò 19) Te shifet dhe studjohet me p.op. te tjer te kesaj dege se mos nga kontigjentet e inteligjences dhe rinise me perberje armiqesore dhe nga perpunimet qe ndjekin ne kete drejtim u del se ndermjet tendencave armiqesore qe zhvillojne mund te kene dhe tendencen e perkrahjen te shkrimeve ose romaneve me permbajtje armiqesore ose te shkrimtarve negativ ne kete drejtim, dhe ne se kane degjuar ose perkrahin çeshtjen e Hil. Kaferrit. Kryen p.op. Refat Mena deri me 30/6/1968.

INSTITUTI MUSINE KOKALARI

PUNTORI OPERATIV
(REFAT MENA)

59

INSTITUTI MUSINE KOKALARI
MK

SHËNIM OPERATIVE

Sot më datën 6/3/1975, më erdhi në zyrë N/Oficer Vasil Ndoj magazinjer i repartit ekonomik, dhe ndër të tjera më tha se shumë herë e shikoi të internuarën M.Kokalarin që lëvis rrethë repartit, bile shkon deri nga ura e fshatit e tjer, ndërsa me datë 1/3/1975, unë isha bashkë me Oficer Kujtim Dokum dhe pamë M.Kokalarin që shkonte nga ura e zezë dhe kur ne po kthehshim kjo bëri një lëvizje të një kopse të palltos. Mua më bëri përshtypje kjo për faktin se edhe para disa ditësh kur po vinte ushtar [illegible] i komp.Z.P.U. e kishte në shpinë disa çarçaf e materiale tjera M.Kokalari edhe atë ditë lëvizi kopsen e palltos. Kjo shpesh her del nga ura e zezë duke marë një çader dhe një libër në dorë. Unë thot Vasili dyshoi se kjo mos kryen ndonjë veprim armiqsore dhe prandaj erdha tju vej në dijeni.-

Rreshen, me 6/3/1975.

PUNTORI OPERATIV

(Xhetan Muça)

Xhetan

INSTITUTI MUSINE KOKALARI
MK

11.3.75



Pseudonime të informatorëve të Sigurimit të Shtetit

Pamje e shtëpisë ku u strehua gjatë një pjese të internimit në Rrëshen

Rruga që bënte përditë.

Varrezat e Rrëshenit. U varros e veçuar.


Musine
KOKALARI
SI LINDI PARTIA
SOCIAL DEMOKRATE
Artikuj, shkrime, esse, kujtime...



Faqja e fundit e dorëshkrimit *Si lindi Partia Social Demokrate*

SAPIENZA
UNIVERSITÀ DI ROMA

Facoltà di Lettere e Filosofia
Dipartimento di Storia Culture Religioni

Lunedì 4 dicembre 2017, Città universitaria
Piazzale Aldo Moro, Palazzo del Rettorato
Aula degli Organi Collegiali

UNA MUSA ALBANESE ALLA SAPIENZA

giornata di studi in onore di

MUSINE KOKALARI

(Adana 1917 - Rrëshen 1983)

ore 10, saluti

Eugenio Gaudio, *Magnifico Rettore della Sapienza Università di Roma*
Stefano Asperti, *Preside Facoltà Lettere e Filosofia, Sapienza Università di Roma*
Emanuela Prinzivalli, *Direttrice Dipartimento Storia Culture Religioni, Sapienza Università di Roma*
Micaela Procaccia, *Direzione Generale Archivi (MiBACT)*
Paolo Buonora, *Direttore Archivio di Stato di Roma*
Anna Rosa Iraldo, *Vicepresidente Associazione culturale italoalbanese Occhio Blu "Anna Cenerini Bova"*
Linda Kokalari, *Presidente Istituto Musine Kokalari di Tirana*

***ore 11, presiede* Marina Caffiero** (*docente di Storia moderna, Sapienza Università di Roma*)
Letture scelte da *La mia vita universitaria* di Musine Kokalari a cura di **Carlotta Caimi**
Elio Miracco, *docente di Lingua e letteratura albanese, Sapienza Università di Roma*
Franco Altimari, *docente di Lingua e letteratura albanese, Università degli Studi della Calabria*
Luigi M. Lombardi Satriani, *docente di Antropologia culturale, Sapienza Università di Roma*
Laura Faranda, *docente di Antropologia culturale, Sapienza Università di Roma*
Visar Zhiti, *poeta, studioso, Ambasciata albanese presso gli Stati Uniti d'America*

pausa pranzo

***ore 14.30, presiede* Manola Ida Venzo** (*Archivio di Stato di Roma*)
Persida Asllani, *Direttrice Biblioteca Nazionale di Tirana*
Mauro Geraci, *docente di Antropologia culturale, Università degli Studi di Messina*
Matteo Mandalà, *docente di Lingua e letteratura albanese, Università degli Studi di Palermo*
Ardian Ndreca, *docente di Storia della filosofia, Pontificia Università Urbaniana*
Rando Devole, *sociologo, studioso della migrazione albanese*
Simonetta Ceglie, *Archivio di Stato di Roma*

a seguire, "Musine Kokalari a Roma: luoghi, immagini, documenti, oggetti"
percorso multimediale a cura di **Simonetta Ceglie** e **Persida Asllani**

COMUNICATO STAMPA

SAPIENZA
UNIVERSITÀ DI ROMA

UNA MUSA ALBANESE ALLA SAPIENZA

giornata di studi in onore di

MUSINE KOKALARI (Adana 1917 - Rrëshen 1983)

Sapienza Università di Roma

Facoltà di Lettere e Filosofia - Dipartimento di Storia Culture Religioni
Città universitaria - Palazzo del Rettorato - Aula degli Organi Collegiali
Lunedì 4 dicembre 2017, ore 10

Musine Kokalari, oggi in Albania riconosciuta Onore della Nazione, è stata la prima, grande scrittrice e poetessa albanese del Novecento, sensibile alla nascente "questione femminile" e alla miseria delle società rurali da lei denunciata in intensi, partecipati componimenti. Nel 1938 è a Roma per laurearsi in Lettere alla Sapienza. Impegnata nella costruzione di un'Albania democratica, rientrata nel suo paese nel 1946, viene additata dal regime comunista quale "sabotatrice e nemica del popolo" e condannata al carcere e all'isolamento forzato fino alla morte avvenuta nel 1983.

Musine Kokalari
VEPRA E ZGJEDHUR
3

In occasione del centesimo anniversario della sua nascita, la Sapienza dedica a **Musine Kokalari** questa giornata di studi quale complessiva riscoperta del suo alto profilo umano, poetico, civile. A partire da *La mia vita universitaria. Memorie di una scrittrice albanese nella Roma fascista. 1937-1941*, pubblicato nella collana *La memoria restituita. Fonti per la storia delle donne* (Viella, Roma 2016) autobiografia giovanile che solo oggi vede la luce in quello stesso italiano in cui fu composta a Roma, gli interventi punteranno a rintracciare nella sua produzione letteraria la grande sensibilità introspettiva, filosofica, antropologica di Musine Kokalari. La giornata vedrà inoltre la presentazione della traduzione albanese de *La mia vita universitaria* appena pubblicata in un'antologia in tre volumi curata dal Ministero della cultura albanese e dalla Biblioteca nazionale di Tirana, nonché una mostra multimediale dedicata ai luoghi, alle immagini, ai documenti, agli oggetti di Musine Kokalari a Roma. Le pagine italiane di Musine Kokalari sono risultato di un punto di vista dialettico, albanese e italiano, di una ragazza che si trovava a studiare in un'Italia fascista che nel '39 occupava la sua Albania; testimonianza di drammi vissuti dall'autrice giorno per giorno, negli anni che la videro frequentare la Sapienza, di cui descrive ambienti, relazioni, complicità. De queste riflessioni autobiografiche che restituiscono l'importanza da lei riposta in una brillante, partecipata formazione universitaria, si farà strada così in Musine l'appassionata ricerca intellettuale e politica di una via democratica, ostile a ogni dittatura. Condannata a vita dalla morsa comunista albanese, Musine resta ancor oggi una "ragazza uragano" che sa infondere alle future generazioni l'amore per la giustizia e la libertà.

Musine Kokalari

Siç më thotë nënua plakë

BOTIM' I DYTË 1984
SHOQNIA BOTUESE LETRARE
LIVONIA - MICHIGAN

MUSINE KOKALARI

VEPRA

FAIK KONICA

MUSINE KOKALARI

Vepra

Vëllimi i parë

Përgatiti: Novruz Xh. Shehu

Geer, 2009

MUSINE KOKALARI

Vepra

Vëllimi i dytë

Përgatiti: Novruz Xh. Shehu

Geer, 2009

MUSINE KOKALARI

Letërkëmbime, shënime, kujtime

Përgatiti: Bibika Kokalari

Botimet DUDAJ

La memoria restituita
Fonti per la storia delle donne
Musine Kokalari
La mia vita universitaria
Memorie di una scrittrice albanese nella Roma fascista (1937-1941)
a cura di Simonetta Ceglie e Mauro Geraci
con un saggio di Visar Zhiti
VIELLA
HOEPLI.IT


MË QUAJNË...
Musine Kokalari
Unë jam shkrimtarja e parë shqiptare
Persida Asllani
Ilustruese: Semela Mero
albas

Instituti
Musine Kokalari

Boceti i pullës shqiptare dedikuar Musine Kokalarit
Emetuar gjatë vitit 2017, pjesë e emisionit "Figura të shquara kombëtare"
miratuar nga Komisioni Shtetëror i Pullës Postare Shqiptare



Musine Kokalari

VEPRA E ZGJEDHUR

1

Musine Kokalari

VEPRA E ZGJEDHUR

2

Musine Kokalari

VEPRA E ZGJEDHUR

3

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"
Musine Kokalari, vetëdija e shkrimit dhe e qëndresës : konferencë shkencore : në kuadër të 100-vjetorit të lindjes së Musine Kokalarit : Tiranë, 10 shkurt 2017 / Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë; Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" ; përg. prof. dr. Persida Asllani ; red. Loreta Loli. – Tiranë ; Prishtinë : BK ; BKK "Pjetër Bogdani", 2018 ... f. : me fotot e ekspozitës ; ... cm.
Bibliogr.

ISBN 978-9928-4494-0-5
ISBN 978-9951-13-076-9

I.Kokalari, Musine për atë

1.Letërsia shqipe 2.Kritika, interpretimi 3. Gra autore
4.Persekutimi politik 5.Antropologjia 6.Konferenca

821.18 (062)
929(496.5) [Kokalari, Musine] (062)